

FATMIR
GJATA

vepra
letrare 9

E

BLIOTEKA

SHTETIT

GJIROKASTËR

Personazhet

BABË DUDË KARBUNARA

LLAMBI OPINGARI

LOLI – i biri

ZOICA – e bija

VASIL PRIFTI – bujk i pashës

PETRITI – i biri

TEFIK VENDRESHA – kaçak

PASHA I BERATIT

HAXHI ADIL BEU – ministër turk

ZIJA BEJ EFENDIU – mytesarifi i Beratit

ROJA E PASHËS

ZARIFI

TURKU

FSHATARI

NXËNËS, USHTARË, TË BURGOSUR, KRYENGRITËS ETJ.

(Ngjarja zhvillohet në vigjilien e Shpalljes së Pavarësisë.)

AKTI I PARË

Tabloja e parë

Një dhomë e thjeshtë karakteristike beratase. Dëgjohej melodia e këngës së katër trimave beratase «Një zi e madhe ka rënë...» e përzier me melodinë e këngës patriotike: «O djem, o luftëtarë, o bijt' e Skënderbeut». Në dhomë janë babai e fëmijët, Llambi dhe Zoica. Babai pi kafën te dritarja. Vajza rregullon dhomën.

LLAMBI – Ç'u vonua kaq shumë ky djalë?!

ZOICA – Ku e dërgove qëmenatë, baba?

LLAMBI – Osmanllinjtë e dreqit! I kanë mbushur rrugët me ushtarë. Na e mbyllën edhe pazarin. Se ku do të hajë ky millet, një zot e di!

ZOICA – Mos i bëjnë gjë Lolit?!

LLAMBI – Jo, moj bijë. S'kanë ç'i bëjnë. E dërgova gjer në xhokaxhihane të marrë veglat. S'ngryset pa punë tërë kjo ditë. Pastaj në shtëpi s'kemi gjë prej gjëje. Pa nesër duhet të paguaj edhe këstin e taksës. Dreqi e mori! Kushedi se ç'kanë ndër mend të bëjnë në Aziz pasha me mytesarifin! S'i kanë marrë kot këto masa.

ZOICA – (Pas një pauze, lexon abetaren.) Në-na! Ba-bal At-dhe-u!

LLAMBI – Ç'bën ashtu?

ZOICA – (E mbyll shpejt abetaren.) Asgjë! Pashë abetaren dhe m'u kujtua Babë Duda. A do të vijë sot të japë mësim?

LLAMBI – Kur ka munguar ndonjëherë Babë Duda? (Troket porta.) Erdhi më në fund. Ç'u vonove kaq shumë, more djalë?!

ZOICA – (Pasi ka dalë për të hapur derën.) S'është Loli, baba. Janë shokët e tij. Urdhëroni! (Hyjnë tre djem.)

DJEMTË – (Njëzëri.) Mirëmëngjes, xha Llambi!

LLAMBI – Mirëmëngjes, djem!

DJALI I – S'paska ardhur Babë Duda?

DJALI II – Më duket se erdhëm shpejt. Të prishëm rehatin, xha Llambi. Na fal!

LLAMBI – S'ka gjë, bijtë e mi. Uluni!

DJALI III – Loli po fle?

LLAMBI – E ka zënë gjumi në rrugë, duket. E dërgova gjer në dyqan të më sjellë ca vegla dhe akoma s'po duket të vijë! Po, pa më thoni: ç'morët vesh gjë? Përse u mbyll pazari? Ç'është gjithë kjo ushtri që ka pllakosur qytetin?

DJALI I – Flitet se vjen një njeri i madh nga Stambolli.

DJALI II – Haxhi Adil beu...

LLAMBI – Haxhi Adil beu?!... Ai është ministër i Punëve të Brendshme të Perandorisë Turke. Babë Duda më ka thënë se ka ditë që ka ardhur në Shqipëri.

DJALI – (Me ironi.) Vjen të shohë mrekullitë e Beratit, mejhanet që shtrihen nga Baba Tomori e gjer këtu, në të dyja anët e Osunit.

DJALI II – (Me ironi.) E ka marrë malli për kalanë Haxhi Adilbeun!

DJALI I – E ka marrë malli zotërinë e tij për ndonjë plumb... kokës.

LLAMBI – Babë Duda thotë se qëllimi i ardhjes së tij, është që të na qetësojë pakëz, të na gënjejë me të mirë dhe, po s'i doli gjë, të na kërcënojë, të na burgosë, të na nënshtrojë.

DJALI I – Të hipë këtu Haxhi Adil beu e të shohë Stambollin! (Qeshin. Ndërkaq bien pushkë. Qielli

skuqet. Të gjithë afrohen te dritaret. Një zë nga jashtë thërret i alarmuar.)

ZËRI – Zjarr! Zjarr! Zjaaarr!

LLAMBI – Ku ka rënë ky zjarr?!... A, qenka në Kala!

DJALI II – Më duket se janë shtëpitë e Kristo Opingarit!...

LLAMBI – Jo. Shtëpitë e Kriatos janë më lart.

DJALI III – Bre! Sa zjarr i madh! Flakët mbulojnë qie-llin. Duket sikur digjen mullarë me bar...

DJALI II – Mos janë ushtëresat e turqve?!

DJALI III – Ty të lumtë goja! Të përvëlohen turqit si minjtë!

LLAMBI – Ushtëresat janë poshtë ullinjve. Djem, ka rrezik të digjet tërë Kalaja. S'kam parë zjarr të tillë!

(Porta troket fort. Zoica vrapon për ta hapur. Hyn Loli me torbën e veglave në sup. Është nxirë nga tymi dhe përzhitur pak në duar.)

LOLI – Baba! Po digjen shtëpitë e Babë Dudë Karbunarës! *(Heshtje e zgjatur.)*

LLAMBI – Po njerëzit a shpëtuan?! Ty të pyes, a shpëtuan Baba, e ëma?!

LOLI – Shpëtuan. Nënë plakë ia nxora unë nga flakët. Me atë pak zë që kishte, thërriste: «A, kur s'kam këllqe, pa dija unë t'i përvëloja turqit me vaj të valuar!»...

LLAMBI – *(Sheh duart e Lolit të përzhitura.)* Bjer vaj, Zoicë! Shpejt!... S'ka gjë, o bir i babait! Një përzhitje e voaël. *(Zoica sjell shishen me vaj dhe ia lyen duart vëllait.)* Po ndonjë plaçkë, a shpëtoi i ziu Babë?

LOLI – Vetëm rrobat e trupit.

DJALI I – Po gazetat e librat?!

DJALI II – Po abetaret?!

LOLI – Asgjë! Mbetën vetëm katër muret...

DJALI III – I shkreti Babë!

LLAMBI – I mjeri, thuaj! Po mirë, o bir, më trego, si ra ky zjarr në ato shtëpi kalaje, ndërtuar vetëm me gurë e llaç?!

LOLI – Thanë nga pakujdesia...

LLAMBI – Si kështu?! Babë Duda gjithnjë ka qenë i kujdesshëm!

LOLI – Kështu thanë. O xhaku s'ishte fshirë që në kohën e sulltan Muratit. I mjaftoi një shkëndijë, që të merrte flakë...

LLAMBI – S'e besoj kurrën e kurrës! T'jua them unë, troç. 'Ia dogjën shtëpinë ministri i Punëve të Brendshme të Turqisë, Aziz pasha dhe kryetari i fesë, Dorothea!... Po, shkojmë, more djem! Mbase shpëtojmë gjë.

DJEMTË – (Njëzëri.) Shkojmë!

LOLI – Është e kotë, vëllezër. Çdo gjë u përvëlua!
(Troket porta fort dhe hyn Djali IV.)

DJALI IV – Vëllezër, Babë Dudën e arrestuan!

LLAMBI – E arrestuan?! Kush të tha?

LOLI – E pe vetë ti?

DJALI IV – E pashë midis dy kriminelëve të Azis pashës. Pastaj u bashkuan me ta edhe katër ushtarë dhe e vunë në mes.

LOLI – Ua tregoj unë pashës dhe ushtarëve të tij. (Del.)

LLAMBI – Loli!... Loli!

TË GJITHË – Loli!... Ku vetë!... Kthehu!

LLAMBI – Këtë djalë e kam si furtuna. O Loli!... Po dale, more djalë, se po vij edhe unë. Më ngadalë, se s'të arrij dot! Eh, ç'u plaka! Dreqi e mori edhe këtë pleqëri! Zoicë, më s'll xhaketën dhe opingat!... Sa shumë e do Babë Dudën, more bir!

DJALI I – Babën e duam të gjithë, xha Llambi. Prandaj e thërresim babë. Për të edhe ne hidhemi në zjarr. Ai është mësuesi ynë i gjuhës shqipe. Po na hap sytë. Po na tregon rrugën e vërtetë të lirisë...

LLAMBI – Keni të drejtë, o djemtë e xha Llambit! Gjithë Berati e do Babë Dudë Karbunarën. Të gjithë e duan dhe e nderojnë.

DJALI I – Jo të gjithë, xha Llambi. Ka që nuk e duan...

DJALI II – Ka që e urrejnë aq shumë, sa ta pjekin të gjallë...

LLAMBI – E kush na qenkan këta?

DJALI I – Osmanllinjtë, Aziz pasha e bejlerët e vendit, mitropolit Dorothea e Fanari. Ata të gjithë e kanë halë në sy. Po ju prindërit tanë e thoni një fjalë, xha Llambi: «Kur armiku s'të do, domethënë se je në rrugë të drejtë.» A po e kam gabim?!

LLAMBI – Ashtu është, o djemtë e xha Llambit. Kështu thotë gjithnjë edhe Loli im! Babës do t'i bëhej zemra mal po t'ju dëgjonte që flisni kështu për të. Babë Dudë Karbunara është në rrugë të drejtë, more djem. Në rrugën e zotit e të popullit. Prandaj edhe tërë vegjelia e quajnë me dashuri e respekt të thellë Babë. Tani shkojmë! Ja edhe unë u vësua. Duhet ta ndihmojmë me ç'të mundemi. Mbase e shpëtojmë. Jo mbase, po duhet të ngremë gjithë popullin dhe ta shpëtojmë patjetër. Patjetër duhet ta shpëtojmë! Prandaj mësimi i sotëm shtyhet për një ditë tjetër. Do t'ju lajmërojë Loli vetë. Kur të l'rohët Baba...

(Bëhen gati të dalin. Troket porta. Hyn Babë Dudë Karbunara dhe të gjithë shtangin.)

TË GJITHË – *(Njëzëri, të gëzuar.)* Mirëmëngjes, Babë!
BABË DUDA – *(Pas një pauze, i gëzuar edhe ai.)* Mirëmëngjes, o trëndafila me vesë! *(Ë zënë për krahu dhe e ulin në divan me shumë kujdes.)* Mungon njeri. Ku është Loli?

LLAMBI – Na thanë se të arrestuan, o Babë. Ja, ky çuni na e solli lajmin. Me të dëgjuar këtë kob, Loli shkoi. Tani, pas t'j, po vinim edhe ne...

BABË DUDA – A është djegur shumë Loli?!

LLAMBI – Pa rrezik... Epo, të rroshe vetë, Babë. Malli vihet përsëri. Njeriu s'bëhet më, po iku! Shtëpia ime është jotja! Mirë se më erdhe!

DJALI I – Edhe shtëpia ime, është jotja, babë!

DJALI II – Edhe jona, e Xhokaxhinjve...

DJALI III – Edhe jona, e Gornicarëve...

DJALI IV – Edhe jona, Babë Dudë, gjithë Mangalemi!

BABË DUDA – Të rroni ju, o stërnipërit e Skënderbeut! Jua shpërblefsha këtë të mirë, siç e meritoni, me tërë bukuritë e rinisë! Mua s'më vjen keq për

shtëpitë që m'i dogjën. Më vjen keq vetëm për Shqipërinë që është e robëruar. Ja, zjarri i shtëpive u shua. Kurse mua m'u shtua zjarri këtu në gji, zjarri i dashurisë për mëmëdheun, për vegjëlinë, për gjuhën tonë amëtare, për ju, o trima, që jeni shpresa e Shqipërisë. Pa m'u shtua edhe flaka e urrejtjes për osmanllinjtë, për Aziz pashën, për ministrin e Punëve të Brendshme turke Haxhi Adil beun, për Dorothe të që shtypin e përçajnë shqiptarët. Këta tiranë kujtojnë se, duke na vënë zjarrin, do të na trembin, do të na zimbrapsin e do të na gjunjëzojnë. Po shqiptarët kurrë nuk janë gjunjësuar, o trima, e kurrë nuk do të gjunjëzohen, o trëndafila me vesë! (*Hyn Zoica me tilxhanët e kafes. Baba e merr dhe uron.*) Më rrofsh, moj gjeraqinë! Gëzuar, o Llambi Opingari, në dasmën e Lolit e të çupës! Gëzuar, o djemtë e mbarë të Beratit tonë të bukur! (*Llambi e djemtë e urojnë. Pauzë.*)

DJALI I — Babë, gjithë shtëpia u dogj?!

BABË DUDA — Po, more bir, veç gurëve.

DJALI I — Po ndonjë libër a gazetë nuk shpëtove?

BABË DUDA — S'mbeta pa hiç, jo. (*Nxjerr nga xhepat libra e abetare. Djemtë ia rrëmbejnë.*) Lexojini, ju pastë Baba! Mësojini! Përhapini! Janë librat e shenjtë të gjuhës sonë të ëmbël. Ata armiqtë nuk i djegin dot. Shtëpitë mund të na i shkretojnë, ne mund edhe të na vrasin, po këtyre të uruarve s'kanë ç't'u bëjnë! Edhe në i groposshin, këto mbledhin rrufetë. Dhe kur bien rrufetë, populli, domosdo, ngrihet në këmbë për të shpëtuar mëmëdheun!... Ja Naimi ynë i madh! Pa dëgjoni ç'shkruan?! (*Lexon vargjet: Ditët e mira/ Paskëtaj vijnë/ Lum kush të rrojë/ Ta shohë zonjë!*) Bukur, ë!

DJEMTË — Shumë! Shumë!

BABË DUDA — Këto janë letra që më kanë ardhur nga Korça, nga Vlora, Myzeqeja, Fieri, nga Poshnja, nga Paftali, edhe nga Gjakova e gjakut. Gjithandej djemtë si ju mësojnë fshehurazi. Çdo gjë

mund të na e ndalojnë armiqtë: bukën, ujin, se i kanë në duart e tyre. Po kurrë të drejtën për të mësuar gjuhën tonë e për të luftuar për lirinë e Shqipërisë. Këtë, kurrë... kurrë s'na e ndalojnë dot!... Hajt, pra, ju pastë baba! Nxirrni defterët, kalemat, abetaret e shenjta!... A e keni nxënë mësimin?

TË GJITHË – Po, babë!

BABË DUDA – Të mos e humbim kohën, se është flori. Fillojmë! Gjer më sot kemi mësuar shkronjat dhe me to kemi formuar fjalë. Tani do të mësojmë se si bashkohen fjalët e krijojnë fjali. Të na thotë Loli një fjalë!... Harrova. Lolin s'e kemi këtu... Do të vijë ai, patjetër do të vijë!... Atëherë na e thuaj një fjalë ti, Petrit?

DJALI IV, PETRITI – *(Pasi mendohet gjatë.)* Atdheu!

BABË DUDA – Shumë mirë! Atdheu! Shkruajeni këtë fjalë. Atdheu! *(I kontrollon, ndërsa nxënësit murmurisin fjalën.)* Ashtu, ju pastë Baba! Ta bashkojmë tani me fjalë të tjera. Shkruani «ynë». *(I kontrollon i kënaqur.)* Veçojeni fjalën! Shkruajeni veç... Veç! Ashtu. Shumë mirë! Vazhdoni: «është»... *(I kontrollon. U përkëdhel flokët.)* Bukur! Ju lumtë!... Pra, keni shkruar: Atdheu ynë është...

TË GJITHË – Shqipëria!

BABË DUDA – Bukuri! Atdheu ynë është Shqipëria! Ta këndojmë këtë fjali të gjithë së bashku.

TË GJITHË – *(Lexojnë.)* Atdheu ynë është Shqipëria!

BABË DUDA – *(Pas një pauze, i menduar.)* Shqipëria! Unë them se është vendi më i lashtë në Evropë, jo si vend, po si popull. Ja, edhe Berati ynë është ndër qytetet më të lashta. Ka qenë dikur qendër ekonomike e fisit ilir të Dasaretëve që banonin në këto male e pyje. Emrin e parë nuk e njohim akoma. Shkrimtarët antikë e kanë quajtur Antipatrea. Më vonë, në kohën e Bizantit, u quajt Pulkeriopolis e pastaj Berat. Edhe themelet e kallasë i kanë hedhur ilirët në shekullin e katërt para Krishtit. Pastaj i rindërtoi një mijë e treqind vjet

më parë perandori bizantin Justiniani. Në shekullin e 13 vuri dorë zoti i Epirit, Mihal Engjëll Komneni. Atëherë vetëm në kala kishte 40 kisha si ajo e Villahernës dhe e Shën Triadhës. Pastaj erdhën Osmanllinjtë dhe e dëndën Beratit me xhami, si ajo e Bajazitit II, e Plumbiçit, e Beqarit. Erdhën... e kush nuk erdhi?! Po armiqtë lanë kockat e ne mbetëm gjallë, shqiptarë safi, me gjuhën tonë të bukur, të ëmbël si mjalti e të rreptë si shpata!... (Fjalën e Babë Dudës e ndërpret një trokitje e fortë në portë. Hyn Vasili.)

VASIL – Kalimera!

BABË DUDA – Kalimera e ka vendin në Greqi, o Vasil. Jo këtu. Këtu është Shqipëri. Na thuaj «mirëmëngjes!»

VASIL – Mirëmëngjes!

BABË DUDA – Kështu, de! Mirëmëngjes, o trandafil me vesë! Dhe tani urdhëro e fol. Përse ke ardhur?

VASIL – Për këtë kopuk që ka ikur nga shtëpia pa gdhirë. (Të birit, njërit prej djemve.) Edhe më gënjeve, ihë?! Pizeveng! Më the se do të vije në kishë për t'u falur! Kjo paska qenë kisha jote, shtëpia e Llambi Opingarit, me prift Babë Dudë Karbunarën! Turp të kesh! Ngrehu, edepsëz! Pas meje!

BABË DUDA – Qetësohu, o Vasil Pifti, o njeriu i mirë i tokës! Qetësohu njëherë, o bujk i mirë dhe i mjerë! Që të ka gënjyer, s'ka bërë mirë yt bir. (Djalit të Vasilit.) Herë tjetër, mos e gënje tët atë, more trim! Thuaji të drejtën: Do të vete të mësoj gjuhën e mëmës, shqipen!

DJALI IV – Ia them, o Babë, po ai përsëri nuk bindet e nuk më lejon.

BABË DUDA – E përse?

DJALI IV – Ku di unë! Le ta thotë vetë!

VASIL – A, zoti Jorgji, zoti Jorgji! Edhe unë habitem se si të është ndërruar emri dhe të është bërë Babë Dudë! E dije, pra, se po na i merr djemtë më qafë! Qeveritari, mytesarif Zija bej efendiu, e ka ndaluar gjuhën shqipe, kurse zotrote po ua mëson

fshehurazi. Kryemijësi i xhandarmërisë Refat Sami efendiu i var në mes të Bezistanit ata që mësojnë, kurse zotrote, tërë jetën s'ke pushuar së përhapuri shkrimin shqip. Kryepifti, zoti Kalinite Delikani, e mban meshën greqisht, kurse djemtë tanë, duke shkuar pas teje, psallin në kishë vetëm shqip. Dhe Dorothea u dërgon mallkimin këtyre, ty mua...

DJALI IV – Mjaft më, baba!

VASIL – S'është punë kjo, o Dudë Karbunara! Na i more më qafë djemtë! Na more më qafë edhe ne, prindërit!

DJALI IV – (I nxehur.) Baba!...

BABË DUDA – Lëre të zbrazë vrerin edhe frikën gjer në fund, se vetëm ata t'i errësojnë sytë edhe mendjen kaq shumë.

VASIL – S'kam ç'të them më! (Të birit.) Ngrehu!

LLAMBI – Vasil! Me këto që the, më ke fyer edhe mua. Mbaje gojën, të paktën përpara fëmijëve!

BABË DUDA – A dëgjon, o Vasil! Pifti? Të m'i kishte thënë këto fjalë ndonjë bej, as do të nxehesha e as do të thosha gjë. Vetëm do ta pështyja. Po ty, o Vasil, s'të pështyj dot, se je njeri i vegjëlisë, një fukara i këputur që rron me zahmet me diersën tënde, si gjithë këta djem këtu e si ky Llambi Opingari. Po përse ke kaq frikë, more derdimen?! Sulltanit po i dridhen këmbët. Iku e vate ai satrap! Turku e ka vendin atje, në Turqi. Ne, këtu në Shqipëri. Ne jemi shqiptarë e duhet ta mësojmë gjuhën tonë, gjuhën e Skënderbeut. E duhet ta mësojnë, në radhë të parë, fëmijët, rinia, që janë shpresa e Shqipërisë. Kurse zotrote vjen e na përshëndet «kalimera»! Eh, Vasil, Vasil!

DJALI II – Nuk do të bësh keq, xha Vasil, sikur të ulesh edhe ti e të mësosh së bashku me ne!

TË GJITHË – Ulu, ulu, xha Vasil!

VASIL – Koka ime s'mban më. Është plot...

BABË DUDA – Duhet ta zbrazësh ca e ta mbushësh me këta libra të shenjtë të Shqipërisë.

VASIL – S'kam atë nge unë, zoti Jorgji. Kam një karvan

me fëmijë. Duan të hanë, të vishen e të mbathen. Duhet ushqyer në këto kohëra të rënda e të këqija. Apo s'jam mbytur edhe në borxhe, gjer në grykë!

BABË DUDA – Për këto, ke të drejtë, Vasil. Po, që je kaq i varfër, fajin e kanë robëria dhe padrejtësitë e Aziz pashës. Prandaj, të punojmë ditën edhe natën, për t'i zhdukur robërinë dhe padrejtësitë e bejlerëve.

VASIL – Për mua Aziz pasha nuk është i keq. Më ka bërë një të mirë që nuk do t'ia harroj. Njëherë, kur mbeta me gisht në gojë, bëri sevap e më dha pesë lira turke, pesë lira...

BABË DUDA – Dhe tani ato pesë lira, janë bërë pesëdhjetë, prandaj je mbytur në borxh. Nesër do të bëhen akoma më shumë dhe do të mbetesh në mes të rrugës, si mijëra e mijëra shqiptarë të tjerë.

LLAMBI – Baba ka të drejtë, o Vasil! Vëru veshin këtyre fjalëve dhe ec në rrugën e drejtë të shqiptarëve! Djalin mos e pengo, se është në rrugë të drejtë, të ndershme!

VASIL – Nuk dua të më djegin shtëpinë si Babë Dudës.

BABË DUDA – Ty do të ta djegin kasollen në një mënyrë tjetër. Ndryshe, ndryshe, po do të ta përvëlojnë patjetër!

VASIL – (Të birit.) Ngrehu! Ty të them! Mos më bëj që të xhindosem! Merr vesh, apo jo?!

DJALI IV – (Duke iu lutur.) Sa ta mbaroj edhe sot mësimin, baba! Po të iki, mbetem prapa nga shokët. Nuk është turp?!

VASIL – (Në kulm të zëmërimit) Gremisu! Bëj fëmijë, të të hanë shpirtin! (Del.)

BABË DUDA – (Djalit IV.) Shko, shko Petrit! Mësimin po i japim fund me kaq. Dhe sillu mirë me tët atë! Shka faj ai. Ia kanë plasur shpirtin. Ti t'i flasësh gjithnjë me urtësi dhe më në fund ai do ta kuptojë e do të vijë me ne. Te njerëzit e ndershëm, edhe kur humbin ndonjëherë gjykimin, atdhedashuria mbetet e gjallë. Yt atë e ka këtë ndjenjë

fshehur diku në shpirt.. Zgjoja dhe ke për të parë se sa baba të mirë ke!... Mirë pra, djemtë e mi. Fund me kaq! Në mbrëmje ejani në han, te sheshi i vogël. Kurse nesër do të mbliidhemi te shtëpia e Gjeçit! Haj, dalçi gëzuar, djemtë e Babës!

LLAMBI – Ti do të bësh mirë të rrish këtu tek unë, babë. Hafijet vijnë rrotull. Çdo gjë e keqe mund të ndodhë. Ti e di që emrin ta kanë bërë me bojë të kuqe. E di që edhe shtëpinë ta dogjën ata. Të tëra i di ti, Babë!...

BABË DUDA – Po, o Llambi Opingari, i di! Se m'i thua ti e shokët, e miqtë e tu... Po tani kam merak për mëmën dhe 'mëmë s'të bëhet kush, o Llambi. Mëma edhe dyqind vjet të jetojë, është mëmë. Edhe dyqind vjet të vdesë, të dhimbset se është mëmë. Prandaj i thonë mëmë. Nga kjo fjalë ka dalë edhe ajo e madhja, Mëmë-dhé! E dëgjon, o Llambi? Mëmë-dhé! Sa fjalë e bukur!

LLAMBI – Po ku është tani, ajo e mjera?! Nuk e dëgjova mirë Lolin. Ku e shpuri ai?!

BABË DUDA – Te gjitonët u rregullua... në Kalâ.

LLAMBI – Dërgojmë dhe e marrim. Sa të vijë Loli, atje po e dërgoj. (Thërret.) Zoicë!... Moj Zoicë!

ZOICA – (Nga jashtë.) Lepe, baba!...

LLAMBI – Bëji edhe një kafe, Babë Dudës!

ZOICA – Si urdhëron! Xhezven e kam në zjarr!

LLAMBI – Dhe përgatit drekën e darkën se ke mysafir Babë Dudë Karbunarën,... familisht!... Dëgjon, Zoicë?!

ZOICA – Po, baba, po! Nga veshët jam bilbil!

Perdja



Tabloja e dytë

Dhoma e pritjes e Azis pashë Vrionit me tërë pajisjet. Beu është veshur me uniformë të lartë. Shërbyeset shtrojnë tryezat. Hyn roja personale, si ngadhënjimtar.

ROJA – Pashë! E solla.

PASHA – Ku e ke?!

ROJA – Në bodrum.

PASHA – Po me Vasil Priftin, a mbarove punë?

ROJA – Ai s'kishte asnjë grosh, pashë! Kështu që ia sekuestruam shtëpinë. E sikterisëm përjashta vetëm me plaçkat e trupit. Urdhri yt u zbatua, pashë, një për një!

PASHA – I qofshim falë allahut! (*Bën shenjë dhe shër-bëtorët dalin menjëherë.*) Ma sill këtu atë lapanj-gjoz! (*Roja del. Vetëm.*) Do të hedh edhe një gur në Osum. Po doli gjë, mirë. Po s'doli (*Fshikullon kamxhikun.*) ...kokën!... Allah! Na shpëto Padishahun! (*Rojat sjellin Lolin të lidhur e të torturuar.*)

ROJA – Ec tutje, jeziti!... Ec, qafir!

PASHA – Pa shih kush qenka!... Apo më bëjnë sytë mua? Jo. Unë sytë i kam të fortë...

LOLI – Nuk gabohesh, pashë! – Unë jam ai, Loli! i biri i Llambi Opingarit, nga Berati. Kam qenë edhe një herë në këto saraje, i vogël, gati kërthi...

PASHA – Ke qenë, bir, ke qenë, nja dhjetë a dymbë-

dhjetë vjet të kaluara. Atëherë ishte çun gushëpëllumb. Tani je bërë pak si burrë, po përsëri je gushëpëllumb!

LOLI – Kurse zotrote, je plakur krejt... Je plakur, pashë!

PASHA – Kush të paska goditur kështu?!

LOLI – Larot që lëpijnë sahanët e pashës.

PASHA – Lirojani duart, more edepsëzë! (Rojat e zgjidhin.)

LOLI – Tani mund të flasim ndryshe, pashë. Krejt ndryshe.

PASHA – Edhe unë ashtu mendoj... A ke parë florinj me sy, o trim?

LOLI – Florinj?!... Kurrë në jetën time.

PASHA – Pa qasu këtu! Qasu! Afrohu! (Derdh një qese mbi tryezë.) I sheh, o trim!

LOLI – Të verbuakan sytë! Kam dëgjuar e s'kam besuar. Tani i shoh dhe besoj!

PASHA – Kjo është lirë turke, Loli. Ky është napolon njëzetfrangësh. Ky, flori katër cekinash. Ky tjetri është flori Venediku. Këta të tjerët janë të vjetër, mandohije e rubije dhe çmimi i tyre është 500 groshë... Të pëlqejnë, hë, Loli?!

LOLI – Shumë, besa!

PASHA – Po burrnotin, a e heq, o trim?

LOLI – Jam i ri ende për burrnot, pashë.

PASHA – Do të plakësh dhe do ta heqësh... (I mbledh paratë në kutinë prej argjendi.) Merre këtë kuti argjendi o bir, me gjithë florinj! Po ta fal, se e meriton!

LOLI – (E peshon në dorë.) Dua të të bëj një pyetje, pashë, po kam frikë se gaboj...

PASHA – Pyet, pyet, o bir!

LOLI – Ku i ke gjetur gjithë këta florinj?

PASHA – M'i ka lënë trashëgim babai, ndjesë pastë...

LOLI – Po yt atë, ku i ka gjetur?!

PASHA – Ja ka lënë trashëgim gjyshi i nderuar, pasha i madh, i gjetët rahmet shpirti!

LOLI – Po mua, përse m'i dhuron? Çfarë shërbimi kërkon prej meje?

PASHA – Asgjë! Vetëm të gjurmosh Babë Dudë Karbunaren dhe të më njoftosh menjëherë ku vete ai edep-

- sëz, me cilin ka lidhje të fshehta, kush e përkrah, kush ia kreh bishtin...
- LOLI – Po kjo është puna më e thjeshtë, pashë. *(I flet në vesh sikur i zbulon ndonjë sekret.)* Babë Dudë Karbunara shkon në popull, ka lidhje me popullin, përkrah popullin dhe populli lë kokën për të!
- PASHA – *(Shumë nervoz.)* Ç'kërkon të thuash me këto fjalë, more haram?!
- LOLI – Dua të them se, t'i shitesh pashës, është tradhti dhe poshtërsi!
- PASHA – Qepe, qafir!
- LOLI – Nëse ka djall, më mirë i shërbej atij, sesa ty, o Aziz pashë Vrioni! *(Ia hedh në fytyrë kutinë me florinj.)* Këta s'janë florinj! Ky është gjaku i stërgjyshërve tanë, gjaku i Vasil Priftit, i bujqve, i prindërve tanë, që zotrote ua ke thithur si një shushunjë e pangopur...
- PASHA – *(Rojave.)* Kapeni! *(Mezi e lidhin.)* Do të ta pres gjuhën, gjarpër, që të mos vjellësh më vrer!
- LOLI – Babë Duda më ka mësuar që të mos tutem nga vdekja, kurse ti po dridhesh si miu në çark!
- PASHA – Pusho, kaur! Do të të ndaj më dysh me shpatë!
- LOLI – Bijtë e Shqipërisë mbarojnë gjithnjë nga plumbi e nga shpata. Por dije, pashë, se gjaku i tyre nuk humbet kurrë.
- PASHA – Nëse ky gjarpër nuk vdes sonte në bodrum nga hekurat e skuqur, nesër t'i pritet koka!
- LOLI – Babë Duda më ka thënë: nëse duhet të vdesim, le të vdesim me nder, si të parët tanë. Dhe unë nuk do ta turpëroj mësuesin tim!
- PASHA – *(I xhindosur.)* T'i pritet koka dhe trupi të lihet te sheshi i Bezistenit 24 sahat pa u varrosur.
- LOLI – *(Këndon.)* Aziz pashë, o qen i dheut, S'tuten 'bijt' e Skënderbeut! *(E nxjerrin duke kënduar.)*
- PASHA – *(Vetëm, duke mbledhur florinj të shpërndarë.)* Florinj të! Nuk i pranoi florinj të! Po kur unë s'i blej dot këta njerëz me florinj, atëherë me se t'i blej?! Me shpatë?!... Ata s'kanë frikë as nga shpa-

ta, as nga zjarri, as nga allahu! *(Pas një pauze.)*
Jorgji Karbunara, Jorgji Karbunara! O djall i mallkuar! Të erdhi vdekja! Do ta thërres dhe do ta vras me dorën time! *(Përplas pëllëmbët dhe hyn roja.)* Dërgo dy njerëz të gjejnë Jorgji Karbunarën dhe të ma sjellin këtu!

ROJA – Si urdhëron! Por, në qoftë se nuk pranon të vijë me të mirë, a ta sjellim me forcë?

PASHA – Me forcë e të sakatuar. Veç e dua të gjallë. Do ta vras me dorën time!

ROJA – Si urdhëron, pashë! *(Del.)*

PASHA – *(Vetëm.)* O do t'i shtroj këta rebelë, o do t'i përvëltoj si minjtë. Le të dridhet Berati nga forca ime. Le ta marrë vesh i madh e i vogël se zot në këtë vend, nën hijen e sulltanit të madh të Turqisë, është Aziz pashë Vrioni!

ROJA – *(Hyn.)* Pashë! Mbërritën mysafirët e Portës së Lartë!

PASHA – I qofshim falë Allahut!

(Hynë ministri turk Haxhi Adil beu dhe mytesarifi i Beratit Zija bej efendi.)

MINISTRI – Selam alekim, Aziz pashë Vrioni!

PASHA – Alekim selam, Haxhi Adil bej! Selam, mytesarif i Beratit! Urdhëroni! Kur mora vesh se pranuat ftesën time, m'u bë zemra mal. Është nder i madh për familjen e pashallarëve të Vrionit të presë mysafirin e lartë, ministrin e Punëve të Brendshme të Imperatorisë Turke, Haxhi Adil beun! Me mytesarifin tonë, Zija bej efendiun, jemi miq të vjetër. Urdhëroni, bej i nderuar, pa teklif! *(Ulen.)*

MINISTRI – Ejvallah, Aziz pashë! Në Arnautistan, në sarajet e pashallarëve të nderuar, e ndiej veten si në shtëpinë time. *(Shërbëtoret i gostitin.)*

PASHA – Juaja është...

MINISTRI – Veçse përjashta nuk ka shumë qetësi. Nuk ka as siguri. U detyrova të vij gjer këtu nëpërmjet rrugëve të fshehta.

PASHA – Ka ndonjë kaçak që turbullon ujët, Haxhi Adil bej.

MINISTRI – Të ishte vetëm ndonjë, ujët kullohej shpejt, Po, me sa di unë, këtu po zien diçka e madhe. Dhe unë kam ardhur pikërisht për këtë punë: t'i qetësoj gjakrat e arnautëve.

PASHA – Shpatat tona kanë qenë gjithmonë të bashkuara dhe tehu i tyre është drejtuar gjithmonë kundër të njëjtit armik të përbashkët. Edhe këtë herë, si gjithnjë, pashallarët Vrionas, nuk do t'ia nxijnë taqen Portës së Lartë.

MINISTRI – Nuk dyshoj aspak në besnikërinë tuaj ndaj Portës së Lartë, përdërisa kemi një qëllim! Mytesarif, ku i keni ata defterët e fëlliqur?

MYTESARIFI – *(Nxjerr menjëherë disa libra të gjuhës shqipe.)* Këtu i kam Haxhi Adil bej. Urdhëroni!

MINISTRI – Pashë! A i keni parë ndonjëherë këto ndyrësira?!

PASHA – *(U hedh librave një sy.)* Jo, vetëm një herë! Dhe, sa i kam parë, i kam sekuestruar...

MINISTRI – Këto s'është nevoja t'i sekuestroni!... U gjetën mbrëmë në shtëpinë e Karbunarëve. U gjetën edhe në shtëpinë një oficeri arnaut nga Dibra, edhe te kasollet e një Bektashi, edhe në hatullat e njëfarë Muharremi... Këta të tre i arrestuam. Kurse i katërti u fsheh e s'e kapëm dot. Flitet se është drejtuar nga deti.

PASHA – Edhe Jorgji Karbunarën e arrestuat?!

MYTESARIFI – Atë jo...

PASHA – Ai është më i rrezikshmi sot për sot. Vetëm se ka lidhje të forta me popullin.

MINISTRI – Prandaj është vepruar mirë që nuk e keni arrestuar. Nuk duhen futur të gjithë në një thes, Aziz pashë. Dhe nuk duhet përdorur e njëjta taktikë për të gjithë kundërshtarët. Apo jo, Zija bej efendi?!

MYTESARIFI – Hafijet e gjurmojnë. U përpoqëm t'i futnim një hafije brenda, po s'na ndezi. E kuptoi menjëherë. Shtëpinë ia dogjëm. E kemi marrë edhe me të mirë dhe e kemi vënë anëtar në Xhemietin Osmanlli. E çfarë s'kemi bërë?! Por ai, në vend

që të heqë dorë, vazhdon punën me angulm,
nën dhé.

PASHA – Bile, kur u krijua klubi «Bashkimi» i Beratit, e zgjodhëm si nënkryetar të parë. Unë e drejtoj klubin. Po Karbunara, së bashku me sekretarin e klubit Sulo Resulin, e kthyen klubin në një çerdhe ku përhapen ide të këqija. Tani s'ka mbetur gjë, veç ta vrasim!

MINISTRI – Pikërisht kjo duhet bërë: të zhduket pa lënë gjurmë dhe jo të arrestohet!

PASHA – Qenkemi në një mendje, Haxhi Adil bej! Dërgova njerëzit e mi ta thërresin. Dua ta vras vetë me duart e mia!

MINISTRI – O, jo! Ky do të ishte një gabim i madh! Po ta vrasësh me duart e tua, ke vetëm humbje. Do të humbasim besimin, ti edhe ne, te njerëzit. Ti vetë the se Karbunara ka lidhje me popullin. Populli nuk do të na e falë vrasjen e tij ashiqare.

PASHA – Domethënë, të hedhim gurin e të fshehim dorën!

MINISTRI – Në një rast të tillë, është mirë kur gësh-tenjat i nxjerr tjetërkush nga zjarri. Dora nuk të përzhitet!

PASHA – Atëherë po lajmëroj që të mos e sjellin Karbunarën këtu.

MINISTRI – S'ka gjë. Le të vijë. Bile, është më mirë të vijë. Prite si mik. Mos i thuaj asgjë të keqe. Apropoja mendimet e veprimet e tij. Ai këto do t'i përhapë në popull. Pastaj fut një njeri, një kriminel të dëgjuar që s'e hap gojën, sido që të vejë puna. Ai le ta dërgojë në xhehenem. Dhe kur të bëhet varrim: shiko edhe ti, së bashku me mytesarifin dhe derdhi mbi varr ndonjë lot. S'ju kushton gjë.

PASHA – Ç'mendim i ndritur! Për pak isha duke bërë një marrëzi! (Shërbëtoret shtrojnë tryezën.) Po urdhëroni! Provoni gjellët që kanë qatuar këto vajza! Gëzuar, Haxhi Adil bej! Qofshi me ymër tërë jetën! (Pinë dhe hanë.)

MINISTRI – Arnautkat janë racë e mirë, të pashme dhe

fisnike. Si thua, mytesarif? Ti që ke kaq kohë këtu, mund ta dish më mirë se unë.

MYTESARIFI – Ashtu vërtet, po unë tani jam plak, shkëlqesi!

MINISTRI – Ka rrezik që, po të rri edhe disa ditë këtu, gruan e shtatë ta marr nga kjo racë. Gëzuar, Aziz pashë!

(Pinë, hanë e qeshin.)

PASHA – Bujrëm, bujrëm! U bëftë mirë! Është mall i tëri nga çifligjet e mia, i zgjedhur për mysafirët e lartë!

MINISTRI – Më thanë se diçka lëviz përpjetë këtyre maleve. Si quhen këto male?

MYTESARIFI – Tomor, Shpirag.

MINISTRI – Pikërisht aty. Nga disa fshatra kanë dalë kaçakë që duan të fillojnë luftën e armatosur.

PASHA – Është e vërtetë. Po ç'mund t'i bëjë miza buallit?

MINISTRI – Ka një përrallë ku tregohet se si miza e tërboi buallin.

MYTESARIFI – Ajo është vetëm përrallë, shkëlqesi!

MINISTRI – Nuk duhet nënvleftësuar asgjë! Mushkonjat kur shtohen xhalavitin elefantin. Edhe karanxhatë tok ia grisin fëkurën luanit! Kështu ndodhi në kohën e Skënderbeut. Këtu po shpërndahet shtypi arnaut. Të rinjtë po e mësojnë gjuhën me dëshirë të zjarrtë. Mësojnë gjuhën dhe së bashku me të mësohen të na urrejnë e të na luftojnë. Në mal kanë dalë kaçakët. A nuk të shqetëson kjo gjendje, mytesarif? Duhet të kesh mendjen të shushatur, që kur e sheh gjarprin në mes të rrugës, të mos e godasësh me gurin që mban në dorë! Mytesarif, sa veta kanë mbaruar në litar vetëm e vetëm se janë kthyer në armiq të vëtvetes, përderisa e kanë pasur armikun përpara dhe nuk e kanë vrarë?!

MYTESARIFI – (I foret buka.) Kemi marrë masa, shkëlqesi! Do të veprojmë me të gjitha mjetet e format, sipas porosive tuaja të ndritshme!

MINISTRI – Duhet të fillojë menjëherë shtypja dhe shpërndarja e librave me alfabetin turko-arab të Kara

Rexhepit dhe të dënohet rreptë kush përhap gjuhën arnautë me shkronjat e shejtanit. Duhet të lëvizin hoxhallarët. U mora vesh me mitropolitin e Beratit, Dorothenë. Ai është i një mendjeje që të ndizet më tej përçarja midis krishterëve e muhamedanëve arnautë. Një komb që ka grindje e përçarje të tilla qeveriset lehtë. Apo jo, Aziz pashë?

PASHA — Unë kështu veproj me bujqit e mi. Ia di vlerën kësaj pune.

MINISTRI — Kisha dhe një dëshirë të fundit. Siç e shihnin, ne, javash-javash, pa mbyllemi në qytet. Malet s'janë tonat. S'ka mundësi, Aziz pashë, që ju, me njerëzit tuaj, me ata që m'ani në bodrumet e këtyre sarajeve, e kam fjalën për besnikët tuaj, të krijoni ndonjë çetë e ta nisni maleve. Andej përjetë le të kacafyten çetat me njëra-tjetrën.

PASHA — Po të jetë nevoja. edhe ajo mund të bëhet.

MINISTRI — Dhe gjeja anën sa më shpejt atij Karbunarës. Ta dinë të gjithë, pra, se, kush ngre kryet e bën davanë, e keqja i vërsulet nga çdo anë... Këshillat i sosa. Tani më falni se më presin punë të tjera. (Ngrihet për të ikur.)

PASHA — Ju falënderoj edhe një herë nga zemra, Haxhi Adil bej! Kjo do të mbetet dita më e shënuar e jetës sime!

MINISTRI — Alekim selam, Aziz pashë Vrioni!

PASHA — Selam alekim, Haxhi Adil bej! Dëshira juaj ishte këshillë dhe ma thatë shumë mirë. Unë atë do ta zbatoj një për një. Dhe kini mirësinë e pranoi në shenjë miqësie dy vajza, arapka të reja nga Maroku.

MINISTRI — Dhurata me gjithë zemër është amanet i aliahut! Ju falemnderit.

(Pasha i përcjell të dy. Ndërkaq shërbëtorët pastrojnë tryezën dhe dalin. Pasha kthehet me rojën.)

PASHA — (Rojës) Dëgjo këtu: më duhet një njeri, një trim, një kriminel që është nxjerrë jashtë ligjit. Po të jetë nga ata trima që e ruajnë të fshehtën, edhe sikur t'ua bësh trupin copa-copa.

- ROJA – I tillë është vetëm një: Tefik Vendresha...
- PASHA – Tefik Vendresha?!... E kam dëgjuar këtë emër.
- ROJA – Është ai që vrau për punë gjaku në mes të pazarit atë dyqanxhiun...
- PASHA – A, po. E di. Mos e zgjat! Po floringjtë a i ha ai?
- ROJA – Kush?! Tefik Vendresha?
- PASHA – Po.
- ROJA – Për zonë e vërtetë, ai s'ka petka në trup. Ka edhe një karvan me fëmijë. Domsodo, kur njeriu është nevojtar, i lakmon floringjtë.
- PASHA – A zbret në Berat?
- ROJA – Sigurisht rrallë e tek, kur e merr malli për gruan. Ka dy ditë që ma zuri syri në breg të Osunit, aty pranë Urës së Gorricës.
- PASHA – Bëju erë e ma gjej, edhe sikur të jetë futur në vrimë të miut!
- ROJA – Si urdhëron!
- PASHA – Do ta futësh në sarajet nga dera e fshehtë... Tani lajmëro të vijë miku që pret në odën tjetër. (I jep një monedhë. Roja e pret në pëllëmbë dhe me të fërkon mjekrën.)
- ROJA – Si urdhëron, pashë! Të puthça këmbë e duar! (Del.)
- PASHA – (Vetëm.) Florin e bën tjetrin të lërë shpirtin për ty! (Hyn Babë Dudë Karbunara.) O, Jorgji efendi! Selam alekim, zoti Jorgji!
- BABË DUDA – Tungjatjeta, pashë!
- PASHA – Ka kohë që s'të kam parë dhe, të të them të drejtën, më ka marrë malli shumë... shumë. Urdhëro e ulu!
- BABË DUDA – Falemnderit!
- PASHA – Si je me shëndet?
- BABË DUDA – Shyqyr zotit, mbahem!
- PASHA – Më dukesh si i plakur, i lodhur...
- BABË DUDA – Rrojta dhe u plaka, po për të lodhur, nuk jam lodhur. Kam fuqi, kam.
- PASHA – Po para, a ke?
- BABË DUDA – Fitimet e mia gjer tani kanë qenë: rre-

ziku i jetës, bastisjet, fyerjet, borxhet, shtëpia e djegur. Megjithatë, marr 200 groshë...

PASHA – 200?! Shumë pak. S'të dalin për duhan e kafe. (Një shërbëtor i gostit me kafe.) Do t'i them mytesarifit të ta bëjë rrogën 500 groshë. Berati një Jorgji Karbunara ka, s'ka dy. Dhe mezi të ka. Kur të jesh ngushtë, mos u fut! Eja tek unë! Kam borxh të të ndihmoj. Mos harro, zoti Jorgji, jemi shqiptarë!

BABË DUDA – Unë kurrë s'kam harruar që jam shqiptar. (Pauzë.)

PASHA – E di përse të kam thirrur?

BABË DUDA – Nuk shtie fall, pashë, se nuk i besoj fallxhinjtë.

PASHA – Mbrëmë bastisën shtëpinë tënde dhe të kanë ajetur abetare, libra shqip, gazeta...

BABË DUDA – S'është hera e parë. U mësova me bastisje edhe me djege shtëpish.

PASHA – Dua të them se donin të të arrestonin. Po unë ndërhyra. I thashë mytesarifit: «Dëgjo këtu! Po arrestove Karbunarën, zëre sikur më ke arrestuar mua.» «S'kam ç'të bëj, – më tha. – Më ka ardhur ministri Haxhi Adil beu.» «Karbunarën mos e prek, i thashë. Po preke atë, ke prekur nderin e pashallarëve Vrionas...» Dhe më dëgjo!

BABË DUDA – (Me ironi.) Të falemnderit! Megjithëse ata arrestuan të tjerë...

PASHA – Cilët?

BABË DUDA – Tre shqiptarë të vërtetë.

PASHA – S'di gjë për ta. Në qoftë se ti mendon që duhen liruar, unë po ndërhyj menjëherë.

BABË DUDA – Është e kotë dhe tepër vonë. Ata i syrqiynosën dhe ndoshta i kanë vrrarë. Po munde, bëje një të mirë që e ke ti në dorë.

PASHA – Urdhëro e fol! Me gjithë qeif!

BABË DUDA – Më thua se më ke mik e vëlla. Në hall e në shtrëngicë njihet miqësia e vërtetë. Liroje, pra, Lolin!

PASHA – Cili është ky Loli?

- BABË DUDA – Më thanë se e mban në bodrumet e sarajeve...
- PASHA – Bodrumet e mia s'janë hapsana, zoti Jorgji!
Hapsana, ti e di se ku është!
- BABË DUDA – Kështu thonë...
- PASHA – Kush?
- BABË DUDA – Populli!
- PASHA – Nuk ndyja as dorën as nderin e shtëpisë me krime të tilla. Dhe më vjen keq që i beson edhe ti fjalët e rrugëve, ti që je miku im, burrë i vjetër e shqiptar i kulluar.
- BABË DUDA – Ku ka zjarr, del tym, thotë një fjalë e urtë, o pashë.
- PASHA – Sikur të ishin të vërteta tërë fjalët që pëshpëriten vesh më vesh, do të na merrte lumi.
- BABË DUDA – Me fjalë të kota mos e humb nderin, pashë!
- PASHA – More, po kush është ky Loli, zoti Jorgji?
- BABË DUDA – Shqiptar.
- PASHA – I biri i kujt është?
- BABË DUDA – I një shqiptari.
- PASHA – Bujku im është?
- BABË DUDA – Jo. Është një nxënës imi. Një djalë i Shqipërisë, një trim!
- PASHA – Ka ditë që është zhdukur?
- BABË DUDA – Po, ika ca...
- PASHA – Mos kishte shtënë merak më ndonjë vajzë dhe u mbyt në Osum?
- BABË DUDA – Do ta kishin nxjerrë valët!
- PASHA – Mos është hedhur më ndonjë pus?
- BABË DUDA – Do ta kishin gjetur gratë duke mbushur ujë!
- PASHA – Atëherë, do të jetë në hapsanën e qytetit.
- BABË DUDA – (Sheh përreth.) Me siguri, në hapsanën e qytetit!
- PASHA – Do të shkoj te mytesarifi dhe do të kërkoj lirimin e tij, meqë qenka nxënësi yt dhe shqiptar e bir shqiptar...
- BABË DUDA – Ashkollsun, pashë! (Ngrihet.) Është e mi-

ra jote që ç'ke në dorë, të mos e mundosh, po ta shpëtosh!

PASHA – (Duke e përcjellë.) Edhe një herë e përsëris, zoti Jorgji: për çdo nevojë që të kesh, eja tek unë! Dhe jo vetëm për çështjet e tua të vogla e personale, po për hallet e Shqipërisë që s'kanë të sosur! Vrionasit brez pas brezi kanë qenë mëmëdhetarë të shquar. Ata kanë përhapur vëllazërinë, dashurinë, bashkimin dhe s'kanë kursyer gjë për mbrothësinë e kombit!

BABË DUDA – (Ironik.) E di! Fshati që duket, s'do kallauz!

PASHA – Bëju të fala të gjithë miqve të tu, që janë sigurisht edhe miqtë e mi. Nesër mbrëma të pres për darkë. Dua të jesh miku i parë, kryemiku i kësaj dere!

BABË DUDA – Pas Portës së Lartë, sigurisht! Ditën e e mirë! (Del.)

PASHA – (Vetëm.) Ditën e mirë, Jorgji Karbunara! Shiko edhe sonte ëndrra të bukura, pastaj shih zjarret e xhehenemit. Të vdekur nga kalaja përposh të kam për të vërvitur, që të tmerrohen gjithë të gjallët!

ROJA – (Nga një hyrje e fshehtë.) Pashë?!

PASHA – E prure?!

ROJA – Armatosur gjer në dhëmbë, me mjekrën një pëllëmbë, trim mbi trima, Tefik Vendresha. A ta fut këtu?

PASHA – Mos humb kohë! Sille!

(Roja bën shenjë dhe hyn Tefik Vendresha, veshur komit.) Si je, o ujk mali?

TEFIKU – Po hyj në këto saraje me besën e shqiptarit.

PASHA – Bujrëm, si në shtëpinë tënde! Në qoftë se ke ndonjë dyshim në besnikërinë time, mos i hiq armët! Mbaji të mbushura e gati për zjarr!

TEFIKU – Ato kanë mbirë në trupin tim, o pashë, dhe nuk mund t'i heq.

PASHA – Sa viet t'u bënë që ke dalë kaçak, o Tefik Vendresha?

TEFIKU – Nuk e di. Nuk i numëroj vitet.

- PASHA – Dhe s'të kanë kapur dot!
- TEFIKU – Më ndjekin. Po unë jam si era e s'kanë për të më zënë! Veç në përdorshin ndonjë dredhi a grackë.
- PASHA – Askush s'do të të ndjekë më. Je në mbrojtjen e Aziz pashës!
- TEFIKU – Të falemnderit e ta shpërblefsha këtë të mirë!
- PASHA – A dëshiron të jesh i lirë?!
- TEFIKU – E cili është ai qorr që s'do sy!
- PASHA – A do t'u sigurosh jetën çiliminjve?!
- TEFIKU – Vetëm ata mund të ma hanë kokën, dhe askush tjetër.
- PASHA – (I hedh kutinë e argjendtë mbushur me florinj.) Merri! t'i fal se je trim! E mbi të gjitha, se je shqiptar.
- TEFIKU – (Si e kontrollon kutinë, e fut në brez.) Urdhër, Aziz pashë!
- PASHA – S'dua gjë prej teje, veç një shërbim të vogël. Këtu në Berat, një kaur i keq i është shitur grekut e shejtanit dhe po dëmton shqiptarizmin.
- TEFIKU – Kaurët që i shërbejnë Junanit, dua t'i pjek të gjallë që të marr hakun e gjyshit, se ashtu ma poqën, të gjallë!
- PASHA – Një kaur i tillë na është ngjallur në Berat. Është i rrezikshëm, ka futur përçarjen dhe kërkon të sjellë Grekun gjer këtu!
- TEFIKU – Si e ka emrin?
- PASHA – Joraji Karbunara. S'e ke dëgjuar?
- TEFIKU – Unë iam kaçak i maleve, pashë. Këtë njeri s'e njoh. Po kam aq miq, sa të ma tregojnë.
- PASHA – Ta tregojnë njerëzit e mi. Dëgjo, o Tefik Vëndresha, o trim i maleve. Unë e vrisja edhe me njerëz të tjerë, po desha një njeri si ti, që të mos e zbulojë të vërtetën. A e mban fjalën ti?
- TEFIKU – Jam shqiptar e fjalën s'e bëj dysk kurrën e kurrës!
- PASHA – Po e vrave këtë tradhtar, të siguroj jetën dhe lirinë.
- TEFIKU – Bëhesh veqil për këtë?

PASHA – Bjere dorën, o trim! Të jap besën e shqiptarit!
(*Shtrëngojnë duart.*)

TEFIKU – Edhe unë, besën e shenjtë! Kur duhet ta
qëroj?

PASHA – Sa më shpejt të hiqet qafe, aq më mirë për
Beratin e për Shqipërinë!

TEFIKU – Brenda 24 orësh, kauri Jorgji Karbunara
do të hajë shtatë plumba kokës!

PASHA – Të lumtë, Tefik Vendresha!... E, ç'trim mbi
trima ka Shqipëria!

Perdja

Tabloja e tretë

Dhoma beratase në shtëpinë e Llambi Opingarit, si në tablonë e parë.

LLAMBI – Po pastaj, ç'të tha, o Babë?

BABË DUDA – U mburr me shqiptarizmën e tij. «Vrionasit – tha, – brez pas brezi kanë qenë mëmëdhetarë, kanë përhapur vëllazërinë, dashurinë, bashkimin dhe s'kanë kursyer asgjë për mbrothësinë e kombit!

LLAMBI – Kurse zotrote i the: fshati që duket, s'do kallauz. Ç'ia paske hedhur! Ç'ia paske bërë mirë! Ai është turk nga shpirti, gjakpirës, vrasës dhe, gjersa është armik i vegjëlisë, s'bëhet mik me mirësi e me të fënkuar.

BABË DUDA – Mirë e the, o Llambi. Fjalën për të vërtetë s'ia zë kurrë atij të ligu. Ai është gënjeshtar dhe gënjeshtari, edhe kur flet ndonjëherë ndonjë gjë të vërtetë, gënjen i thonë, s'e beson kush. S'kemi ç'bëjmë. Çdo enë qit jashtë atë që ka brenda. Kështu edhe pashai ynë i Beratit. Diçka po kurdis, po unë s'i bie dot më të. Që më thirri për të keq, këtë e di si një e një që bëjnë dy. Po ku rrihte çekani i tij, s'e zbulova dot.

LLAMBI – Gjarpri di t'i fshehë këmbët mirë.

BABË DUDA – Jam në merak për tët bir. Është i papërmbajtur dhe gjaknxehëtë. Ata po e ndiejnë kryengritjen dhe mund të bëjnë çdo gjë.

LLAMBI – Edhe ne kemi marrë parasysh çdo gjë... Më fal, Babë, se të lash pa punë. Po shkoj të qep ato opingat për luftëtarët. Zoicë! Bëji Babës edhe një kafe! *(Del.)*

ZOICA – *(Nga jashtë.)* Si urdhëron!

BABË DUDA – *(Vetëm.)* Edhe pak kam dhe thirrja është gati. *(Fillon të shkruajë. Zoica pa zhurmë i sjell kafën dhe del. Baba lexon duke pirë kafën.)* Mëmëdhetarë! Në të gjitha krahinat e atdheut tonë ka shpërthyer lëvizja e kryengritësve. Administrata turke po lëkundet nga tërmeti. Kohët e fundit ka ardhur në Shqipëri ministri turk i Punëve të Brendshme Haxhi Adil beu, për të përçarë shqiptarët dhe për të krijuar turbullira të reja. Po le ta marrë vesh ai se patriotët shqiptarë nuk do t'i hedhin armët gjersa të shpëtojnë nga zgjedha dhe errësira turke në të cilën gjendet sot. Turqit po arresojnë e po burgosin patriotët... *(Hyn Tefik Vendresha veshur kaçak, si më parë.)*

TEFIKU – Mirëmëngjes!

BABË DUDA – *(S'e dëgjon. Vazhdon leximin me zë të ulët.)* Por asgjë nuk i ndalon shqiptarët, stërnipërit e Skënderbeut! Ata janë të vendosur: Ja vdekje! Ja liri!... Shqiptarë! Priftnit e hoxhët ju kam hutue, për me ju da e me ju vorfnue... Këto fjalë i ka shkruar patrioti i flaktë i Shkodrës, Pashko Vasa!

TEFIKU – Mirëmëngjes!

BABË DUDA – Mirmëngjes, o trëndafil me vesë!

TEFIKU – Hyra drejt e brenda se dera është e hapur. A është këtu Llambi Opingari?

BABË DUDA – Nga na vjen, o trim?... Nga mali?!

TEFIKU – Nga mali.

BABË DUDA – Po fol, more i uruar! Si ta thonë emrin?

TEFIKU – Tefik Vendresha.

BABË DUDA – Nga je?

TEFIKU – Nga Skrapari.

BABË DUDA – Domethënë, na sjell lajme o nga Prishtinën, o nga Kulmakul!

TEFIKU – As nga njëri, as nga tjetri. Kam ardhur për punë të tjera. Dua Llambi Opingarin.

BABË DUDA – E për çfarë pune tjetër mund të vijë në qytet një luftëtar i çetave tona?! Pa afrohu këtu! Eh, Ç'div që qenke! Çfarë trimi! Gjak në vetull i merr turkut ti! Pa shiko ç'armë të lara që paskel! Me trima si ti Shqipëria do ta fitojë lirinë... O Llambi!... Llambi, more i uruar! Po hajde e shih njëherë kryengritësit tanë!
(Llambi hyn dhe, me të parë Tefikun, shtang në vend.)

TEFIKU – Si je, o vëllam?

LLAMBI – Kush je ti? S'të kam parë ndonjëherë.

TEFIKU – E si mund të më njohësh me këtë mjekër, me këto leshra. Jam bërë si ari mali. Po jam vëllami yt, o Llambi!

LLAMBI – Tefik Vendresha!

TEFIKU – Unë, i tëri! (Përqafohen.)

LLAMBI – Sa ke ndryshuar! Sa shumë ke ndryshuar. Po ç'bën, more lumëmadh? Si jeton, o vëllam?

TEFIKU – Si kaçakët rroj! Po ti, si je? Si i ke fëmijët?

LLAMBI – Mirë, mirë! Po urdhëro e ulu! (Babës.) Është vëllami im ky, o Babë. Kemi pirë gjak që në vegjëli. Andartët i vranë gjyshin. Baballarët tanë, ndjesë paçin, ishin barinj dhe shkonin si vëllezër. Një ditë, për të forcuar miqësinë, na prenë gishtërinjtë, ne pimë gjakun e njëri-tjetrit dhe që nga ajo ditë u bëmë vëllezër.

TEFIKU – Ashtu është, tamam.

BABË DUDA – Më pëlqen shumë kjo vëllazëria juaj. Feja ju ka ndarë. Ju jeni të bashkuar. Sa bukur! Po më bëhet zemra mall!

LLAMBI – Po ka disa vjet që s'e kam parë. Vrau për hasmëri një dyqanxhi dhe iku maleve. Histori e dhembshme dhe e gjatë. Turqit e ndoqën dhe pastaj e harruan.

TEFIKU – S'më kanë harruar. Më ndjekin akoma, Llambi. Po, më në fund, më duket se shpëtova. S'kanë për të më ndjekur më.

BABË DUDA – Po lidhje a ke me çetat kryengritëse?

TEFIKU – Kam, kam...

BABË DUDA – E përse, ore bir, nuk do të të ndjekin më turqit, kur ata ndjekin tërë shqiptarët e vërtetë?

TEFIKU – U bë veqil Aziz pasha.

BABË DUDA – Aziz pasha?!

TEFIKU – Po.

LLAMBI – Aziz pashë Vrioni u bë veqil për ty?!

TEFIKU – S'e beson?! (*Tregon kutinë me florinj.*) Ma fali edhe këtë plot me florinj. Më siguroi jetën dhe lirinë. Veç duhet t'i kryej një shërbim dhe duhet ta kryej sot gjer në mbrëmje. Prandaj erdha te ti, te vëllami, që të më ndihmosh.

LLAMBI – Po mirë, pa më trego, ç'punë të ka ngarkuar pasha e ç'ndihmë kërkon prej meje.

TEFIKU – (*Tregon me kokë Babën duke mbledhur supet.*) Këtu s'flas dot.

LLAMBI – Fol, fol! Mos u druaj nga ky. Është Baba ynë. Me të s'kemi asgjë të ndarë e asgjë të fshehtë. Dhe shumë mirë që ndodhet këtu, se mund të të ndihmojë shumë më tepër se unë... Të shtrëngojnë armët?!... Hiqil... Më parë dal unë i vdekur nga kjo shtëpi!

TEFIKU – (*Heq armët dhe Llambi ia var në mur.*) Më ka ngarkuar të vras një njeri të rrezikshëm.

BABË DUDA – (*Si me vete.*) Dhe unë e mora për kryengritës.

LLAMBI – Cilin të vrasësh?

TEFIKU – Një grek.

LLAMBI – Si e quajë?

TEFIKU – Jorgji Karbunara!

(*Pauzë e gjatë.*)

LLAMBI – Kush të tha që është grek?

TEFIKU – Pasha.

LLAMBI – E njeh ti Jorgji Karbunarën?

TEFIKU – Prandaj erdha, që të ma tregosh ti se ku mund ta gjej sonte.

LLAMBI – Po në mos qoftë grek, ç'do të bësh?

TEFIKU – I kam dhënë fjalën pashës.

LLAMBI – Po në qoftë shqiptar i flaktë, njeri që ka punuar tërë jetën për Shqipërinë e që është gati të vdesë për të?!

TEFIKU – Të më ketë gënjyer pasha?!

LLAMBI – Pasha gënjeshtar, kriminel, gjakpirës e tradhtar ka qenë tërë jetën. Ai kërkon të zhdukë me duart e tua mësuesin tonë, njërin nga patriotët tanë më të shquar, rilindësin e fundit, Babë Dudë Karbunarën!... O vëllam, Tefik Vendresha, a e di se ne, të gjithë, atë që kërkon të vrasë pasha me dorën tënde, e thërresim Babë?! Babë e thërret tërë veçjëlia e Beratit. Babë!

TEFIKU – Domethënë, më paska futur në grackë pasha?!

LLAMBI – Im bir, Loli, ka ditë që dergjet në bodrumet e sarajeve të pashës dhe as unë s'e di fatin e tij. Kuit i ke besuar, o vëllam?!

BABË DUDA – Dëgjo, o trim! Ti i dhe besën Aziz pashë Vrionit...

LLAMBI – Gjarprit, thuaj.

BABË DUDA – Po ia dhë pa e d'itur të vërtetën. Tani, në do të vrasësh njeriun që kërkon, ja ku më ke. Merr patllaken dhe zbraze! Unë jam Jorgji Karbunara.

(Pauzë e gjatë.)

TEFIKU – Ti?!

LLAMBI – Ai është Babë Duda, o vëllam, Baba ynë!

TEFIKU – A, Aziz pashë Vrioni! Dhëlpër e tradhtar! (Flak kutinë me florinj dhe rrëmben armët.)

LLAMBI – C'ke ndër mend të bësh, Tefik?!

TEFIKU – Të vë nderin në vend.

BABË DUDA – Ndaluj pak, o trim i Skënderbeut. E shoh që ke marrë një vendim të prerë, po të shpejtuar. Shqipëria ka nevojë për burra si ti. Punët që të presin dhe që do t'i bësh për lirinë e Shqipërisë, vlejnë më shumë se koka e një pashe. (Troket porta. Llambi e hap. Hyjnë Vasili me djalin e vet, Petritin.)

LLAMBI – Urdhëro, Vasil!

VASILI – (Përshëndetet.) Mirë se ju gjej!

PETRITI – Mirëmëngjes, babë!

BABË DUDA – Mirëmëngjes, o trëndafil me vesë!

VASILI – Mbeta midis katër rrugëve! Babë Duda ka pasur të drejtë. Pasha më rrëmbeu çdo gjë dhe më la me gisht në gojë... Ku të mbytem?!

LLAMBI – Të rrosh vetë! Të të rrojnë kalamajtë!

PETRITI – Ndodhi ashtu si na pat thënë Babë Duda...

TEFIKU – E përse jua punoi kështu pasha?

VASILI – I morëm ca groshë hua kur kishim një hall familjar. Groshët ia lamë një për një, po për fajdenë na iku shtëpia e katandia...

TEFIKU – Gjarpri!

BABË DUDA – Mos u dëshpëro, o Vasil! Në hallin tënd është tërë populli... Ty qafiri ta grabiti shtëpinë, mua ma dogji. Po Shqipëria ka një hall më të madh: robërinë shekullore që i rëndon mbi shpatulla! Ka ardhur koha që ta groposim këtë robëri! Për këtë duhet të mendojmë e të veprojmë. Ky është qëllimi i jetës sonë. Të parët tanë e kanë filluar këtë luftë qindra vjet më parë. Unë e Llambi e yt bir Petriti e filluam këtë luftë dje. Ti dhe ky mysarifi nga mali erdhët sot. Nesër do të vijnë të tjerë dhe mëmëdheun do 'ta çlirojmë! Atëherë hallët tona familjare do të bëhen më të lehta!... Ti thua: ku të mbytem! Nqrije kokën, o Vasil! S'është koha që të mbytemi. Është koha e kryengritjes! (Trokasin në portë dhe hyjnë tre nxënësit e Babë Dudës.) Ja ku erdhën edhe djemtë e mi... Pa uluni shesh të gjithë. Sot kemi një mësim tjetër. Mësimin e kryengritjes!

DJALI I – Babë, që sot do të nisemi?

BABË DUDA – Ti s'ke armë, o trim. Ç'do të bësh në mal pa armë?

DJALI I – Ja ku i kam, babë! Tri e jo një! (Tregon dy revolverë e një thikë.)

DJALI II – Të gjithë jemi të armatosur.

DJALI III – Ua kemi zhvatur xhandarëve turq!

BABË DUDA – Lum Shqipëria për ju, o trimë kapëdanë!

LLAMBI – Kam edhe unë një dogra fshehur në hatulla.
Pa ta shoh se mos më është ndryshkur! (Del.)

PETRITI – Të gjithë paskan armë, vetëm unë jo.

TEFIKU – Po ta fal unë një, o trim. (I jep revolverin.)

VASILI – Merre dhe mbaje fort, o dialë! Kur të qëllosh,
mendo se na kanë lënë pa shtëpi e katandi.

BABË DUDA – Armë do të kemi. Do t'ua rrëmbejmë
turqve!

LLAMBI – (Duke hyrë me armë në dorë.) Vetëtin, e uruara!
(Shpërthejnë bubullima e vetëtima.)

TEFIKU – Po shtie baba Tomori!

VASILI – E, i qofshim falë!

BABË DUDA – Ej, ej! A e patë ju? Kush e hiqte topin,
Babai? (Qeshin.) Këto janë besime të kota, shkenca
s'i pranon. Ua kam shpienuar diemve ajerë e
gjatë... Pra, ku e kishim fialë?... Armët do t'ua
rrëmbejmë turave!... Tani dëgjoni: këto ditë në
qytetin tonë do të hapen dy shkollat e para
shqipe...(Djemtë duartrokasit e brohorasin.) Me nga-
dalë! Ulni zërin, djem! Njëra pranë banjave të
ngrohta dhe tjetra në Murat Çelepi pranë sahatit.
Tek e para do të japë mësim Sulo Resuli dhe tek
e dyta unë. (Duartrokitje e brohoritje.)

PETRITI – Domethënë, turqit e lejuan qihën tonë!

BABË DUDA – Kushtetuta e re turke ka lënë ca të çara.
Komiteti ynë i shfrytëzoi ato. Ne e detyruam xhemi-
etin osmanlli të lejojë hapjen e dy shkollave të
para, të cilat ka rrezik të mbyllen përsëri. E de-
tvruam gjithashtu të urdhërojnë kthimin e batalionit
të rezervistëve të Beratit nga Maqedonia. I presim
bijtë tanë të vijnë këto ditë. Tani po kërkojmë ca
të na lirojnë vëllezërit e burgosur, të gjithë të bur-
qosurit politikë. Dhe do t'i lirojnë se u ka hyrë
frika nga forca e lëvizjes kryengritëse. E dinë mirë
që në mal janë çetat tona. (Duartrokitje e broho-
ritje. Porta troket fort e me rrëmbim. Të gjithë
çohen. Një zë i alarmuar thërret nga jashtë.)

ZËRI – Llambi! O Llambi!... Dil, o Llambi!

ZËRA – (Jashtë e brenda.) Ç'është?!... Ç'ka ndodhur?!..

DJALI V – *(Hyn e thërret i alarmuar.)* Të kemi sjellë Lolin, xha Llambi!

LLAMBI – *(Del me vrap. Thërret nga jashtë.)* Loli, biri!

ZOICA – *(Del me vrap. Thërret nga jashtë.)* Vëllai i motrës! *(Ngashërehet.)*

LLAMBI – Ma prishën djalin!... Ma kanë sakatuar!... Ia kanë prerë kokën e bukur!

BABË DUDA – Mbahu, Llambi!... Ajo kokë e bukur e trimit, ra në altarin e shenjtë të Shqipërisë!

LLAMBI – Hallall i qoftë!

BABË DUDA – Djem! Vëllezër! Nuk duhet të humbim kohë. Tefik! Merr këtë letër dhe shpjere në Sinjë. U thuaj se aty do të mbliidhen mëmëdhetarët shqipëtarë të Jugut. Merr me vete edhe këtë çun! Ju bëftë pushka top, o trima! *(Tefiku e djali I dalin.)* Petrit! Merr këtë letër, shumëzoje dhe shpërndaje, si gjithnjë. Pastaj do të shkosh menjëherë në Paf-taj, në çetë, te Vangjel Ndrekë Kusta! *(Petriti për-qafohet me t'anë dhe del.)* Ti *(Djalit II.)* nis u për Prishtë dhe ti *(Djalit III.)* për në Kulmak, në çetat. Do të dërgoni një njeri të lidhet me Çerçiz Topullin e Mihal Gramenon. Të përhapet kudo, si në tërë krahinat e Shqipërisë, se ka ardhur koha e kryengritjes! *(Djemtë dalin me vrap.)* Ashtu, ju pastë Baba! Dhe tani, Loli!... *(Afrohet te porta. Thërret.)* Loli! *(Pauzë.)* Për herë të parë nuk përgjigjet nxënësi im! *(Pauzë.)* Një flamur të Shqipërisë! Sillni një flamur të Shqipërisë, 'ta mbulojmë trimin! *(Zoica sjell flamurin. Ndërsa perdja fillon të mbyllet ngadalë, dëgjohet kënga «O trima luftëtarë,/ O bijt'e Skënderbeut!...»*

Fundi i aktit të parë

AKTI I DYTË

Tabloja e katërt

Shesh pazari. Në një ndërtesë është vënë tabela «Shkollë shqipe». Sheshi është bosh, pa njeri. Është mëngjes herët.

TURKU – (Nga jashtë.) Çok jasha, Padishah!

ZARIFI – (Nga jashtë.) Ç'thotë turku?

ROJA – (Nga jashtë.) Turku thotë të vlojë vazhdimisht kërbaçi. Këtë porosi kam nga pashai im, nga mytesarifi dhe nga ministri Haxhi Adil beu.

ZARIFI – (Nga jashtë.) Ky po na vdes në këmbë! Nuk do ta shpiem dot gjer në yqymet!

TURKU – (Nga jashtë.) E sjell unë në vete. Na! Na! Na! I numërove? Sa shkopinj u bënë? (Dëgjohef fshikëllima e kërbaçit.)

ZARIFI – (Nga jashtë.) Ia more shpirtin! Mjaft, o turk! gjynah! Plak njeri!

TURKU – (Nga jashtë.) Të shohim se si do ta hapë atë shkollën e mallkuar shqipe. Çok jasha, Padishah!

ZARIFI – (Nga jashtë.) Ç'thotë ky dreq turk?

ROJA – (Nga jashtë.) Thotë se ka porosi nga Haxhi Adil beu të dënojë rreptë atë që përhap gjuhën arnante me shkronjat e shejtanit. Thotë se duhen

djegur librat shqip. Thotë, gjithashtu, se do të na shpërblejë mirë që e ndihmuam për të zënë Jorgj Karbunarën.

TURKU – (Nga jashtë.) Qafir! Do të t'i shkul një nga një qimet e mjekrës! (Dëgjohet fshikëllima e kërbaçit.)

ZARIFI – (Nga jashtë.) Gjynah!

ROJA – (Nga jashtë.) Hë, se kaur është! (Turku hyn me flamur me gjysmë hëne në dorë. Pas tij edhe Babë Duda i torturuar sa mezi mbahet në këmbë. Hyjnë dhe Zarifi e roja i pashës).

TURKU – Çok jasha, Padishah!

ZARIFI – Ç'thotë ky?

ROJA – Turku thotë që këtu të digjen librat arnautë, që iu gjetën Jorgji Karbunarës. Janë librat e shejtanit thotë.

TURKU – (Hedh përtokë një turrë librash dhe u vë zjarrin te pragu i shkollës.) Ngrohu, o pis arnaut! (E godet Babë Dudën fort.) Ose hiq dorë, ose do të digjesh edhe ti së bashku me to.

ROJA – (Turkut.) Do ta varim, apo do ta pushkatojmë? T'i fut plumbin kokës?

TURKU – Jo me armë zjarri, se zgjohet mileti. Me kërbaç.

ROJA – Po sikur ta varim te qemeri i shkollës?

TURKU – Çok jasha, Padishah!

ROJA – E mora vesh, o turk! Ja, sa të gjej një copë litar.

ZARIFI – Lëre t'ia marrë shpirtin perëndia! Lëre, bre, se gjynah! Ta hajë dreqi edhe këtë punën tonë!

ROJA – S'gjej dot litar.

TURKU – Do të të var për gjuhe në çengel, more gjidi edepsëz! (E godet Babë Dudën fort.) Ja, këtu, te qemeri i mejtepit që këron të hapësh. Ja ku qenka një kanxhë! Hiq dorë, gjidi derr, se të vara! (E godet përsëri fort dhe Babë Duda rrëzohet gati pa ndjenja.)

ZARIFI – Ç'turk i ndyrë qenka ky! S'paska pikë mëshire! More kriminel, lëre plakun e gjorë të vdesë re-

hat. Unazën, qesen me para, qostekun, prej floriri ia more. E rrahe sa pate qejf. Ia shkule edhe qimet e mjekrës. Ç'kërkon më prej tij?!... Ja ç'bëre!... E sheh?... Vdiq!

(Pauzë e gjatë.)

BABË DUDA – (Me mundim e me urrejtje.) Halldup shallvaregjerë, s'kanë lerë ata burra që të trembin shqiptarët e Skënderbeut!

ROJA – (I gëzuar.) S'paska vdekur. Zarif, ngrije ta varim! Ore, plak matuf, je osmanlli apo grek?

BABË DUDA – Me ç'gjuhë po më flet?... Jam mëmëdhetar dhe jo tradhtar i vatanit si ti...

TURKU – (E godet.) Ngordh, edepsëz!

(Pauzë e gjatë.)

ZARIFI – Vdiq, i shkreti plak! Dhe s'ia bëri syri tërt! S'pati frikë as nga vdekja. Ndjeje, o zot!

TURKU – Çok jasha, Padishah?

ZARIFI – Ç'na çan veshët ky! Ç'thotë?

ROJA – Thotë të ikim që të mos na shohë njeri se po gdhin. Dhe mbylle gojën, Zarif! Po fole, ta preu turku kokën me satër! (Dalin të tre. Pauzë e gjatë. Hyn një djalë i vogël dhe përkulet mbi të tur-turuarin.)

DJALI – Mirëmëngjes, Babë!

BABË DUDA – (Me vështirësi.) Mirmëngjes... o trandafil... me vesë! (Djali bën shenjë me dorë dhe hyjnë nja dhjetë fëmijë, djem e vajza ndihmojnë dhe më në fund plaku ngrihet në këmbë.)

DJALI – Oh! Sa shumë të kanë munduar, Babë!

BABË DUDA – Të mos ju vijë keq për mësuesin tuaj, o fëmijë të dashur! Këto plagë që shihni në trupin tim, janë nishanet që mora në luftë për lirinë dhe mbrohtësinë e Shqipërisë!... (Fillojnë të ecin. Babë Duda mezi çapitet. Bën një hap e qëndron. U përkëdhel flokët fëmijëve dhe mezi flet.) Nuk po vdes prej sëmundjeje, po prej dëshpërimit se nuk e pashë vërtet të lirë popullin, ashtu si dëshiroja,

zot të vendit të tij, me qeveri të tijne dhe për
hallet e tij!... (Pauzë.) Po ju do ta shihni, o fëmijë
të dashur!... Patjetër do ta shihni, o trëndafilë me
vesë!... Tani me shpini në shtëpinë e Llambi
Opingarit... Dhe përgatituni se Baba nuk vdes pa
hapur shkollën shqipe në qytetin tonë.
(Dëgjohet kënga: «O djem, o luftëtarë»)

Perdja

Tabloja e pestë

Po ai shesh pazari. Ka shumë njerëz. Bien kambana e saze. Lexohet mirë tabela «Shkolla shqipe».

FSHATARI – Ore ti, çun, përse është mbledhur tërë ky kallabalëk këtu? Përse bien kambanat, sazet? Muharebe do të bëhet?

DJALI – Do të hapen shkollat, o dajë!

FSHATARI – Çfarë shkollash?

DJALI – Shkolla për të mësuar gjuhën shqipe.

FSHATARI – Pse? Në shkollë mësohet gjuha, more kukudh?

DJALI – Në shkollë, o dajë, në shkollë.

FSHATARI – Ik, more lumëmadh! Mos më gënje! Gjuhën e mësojmë nga nëna. Më thuaj të drejtën, ç'bëhet këtu? Çfarë donomaje është?

JALI – Ehu, or dajë, paske kokë më vete, zotrote! (Largohet.)

FSHATARI – (Tërheq litarin e gomarit që s'duket). Ush! Ush, or të hëngërt turku turinjte!

BABË DUDA – (Duke hyrë, Llambit e Vasilit.) A i sollët librat me alfabetin arabisht të Kara Rexhepit?

LLAMBI – I kemi këtu, në thes.

BABË DUDA – Shpërndaua fëmijëve të shkollës!

VASILI – Do të fillojmë tani?

BABË DUDA – Të presim edhe pak, sa të vijnë të burgosurit.

LLAMBI – *(U shpërndan libra fëmijëve.)* Këto do t'i digjni kur të ndezin zjarrin!

VASILI – Librat tanë do t'ua japim kur të hyni në shkollë!

TEFIKU – *(Hyn i veshur komit.)* Babë! Xhandarët nuk duan ta hapin burgun. Na drejtuan pushkët.

BABË DUDA – Do ta hapin se s'bën! Ne e detyruam xhemietin osmanlli që ta bëjë këtë patjetër, urtë e butë e pa sherr! Meqë s'binden, shkojmë edhe një herë nga burgu. *(Del i shoqëruar nga Tefik Vendresha e nga disa të tjerë. Sheshi gumëzhin nga vallet popullore.)*

QYTETAKI – Vëllezër! Po vjen batalioni i rezervistëve të Beratit!

PLAKU – Hej, shyqyr! Na u kthyen djemtë!
(Hynë ushtarë. Përqaftime e puthje.)

PETRITI – Të burgosurit u liruan!
(Brohoritje.)

FSHATARI – Ç'the ashtu, ore, të lumtë goja?!

PETRITI – U hap burgu, xhaxha!

FSHATARI – Me gjithë mend e ke?!

PETRITI – Ja ku po vijnë!

FSHATARI – Të gjithë u liruan?

PETRITI – Të gjithë.

FSHATARI – E kush i liroi?

PETRITI – Babë Dudë Karbunara me shokët e tij!

FSHATARI – Hej, rrofsh sa Baba Tomori, ore Dudë Karbunara! Isha nisur për në burg. Atje kam tim bir. Ja! Ja ku po vjen! Ai është, apo më bëjnë sytë?! Ai qenka, ai, im bir. *(Përqafohet me të. Hynë Babë Duda, shokët e tij, të burgosur. Brohoritje e përqaftime.)*

BABË DUDA – Tani jemi gati. Mund të fillojmë. *(Hipën në një vend të dukshëm.)* Vëllezër! Mëmëdhetarë! Ka kohë që në Manastir është mbajtur Kongresi ku është vendosur që alfabeti arabisht i Kara Rexhepit të mos pranohet, se nuk i shkon për shtat gjuhës sonë amtare. Ne këtu në Berat, kemi ngritur zërin shumë herë, po mytesarifi nuk na ka dëgjuar.

Atëherë ne vendosëm që t'i djejm, këtu, në mes të sheshit, librat me këtë alfabet! (Brohoritje.)

LLAMBI – Ndizni zjarrin! (Duken flakët.)

BABË DUDA – Nxënës të dashur! Digjini librat turqisht në zjarr! (Fëmijët i hedhin në flakë.) Dhe tani shpërndahuni këtyre kapedanëve të vegjël librat tanë, abetaren tonë! (Shokët e Babë Dudës shpërndajnë librat shqip.)

FËMIJËT – Edhe mua! Edhe mua! Edhe mua një abetare!

BABË DUDA – Vëllezër! Sot, ditë e hënë, 4 gusht 1908, është një ngjarje e shquar. Po hapim në Berat dy shkolla të gjuhës shqipe. E kremtojmë këtë ditë si më të madhen të kremte. Ajo do të shënohet në kronikat e qytetit Berat me shkronja të arta, se na shpie drejt vetëqeverimit të vendit. Që sot e kësaj dite ne do të fillojmë të shporrim përjetë errësirën shekullore dhe do të sjellim diturinë, bashkimin, dashurinë dhe vëllazërinë që i kemi në gjak, se vërtet jemi vëllezër, dhe besimi fetar s'duhet të na ndajë! Shkolla shqipe do të na bashkojë më shumë. Fëmijët do të mësojnë paskëtaj gjuhën tonë, gjuhën e Skënderbeut e të Naimit! Sa e sa mëmëdhetarë të shquar të pajisur me ndjenja patriotike dhe kombëtare, dhanë jetën për këtë gjuhë e për këtë Shqipëri...

BROHORITJE – Rroftë Shqipëria!... Rroftë liria!

BABË DUDA – Vëllezër! Nderoni Shqipërinë, mëmëdheun tuaj! Të mos u dhimbet jeta për lirinë e saj! Të jeni përherë të gatshëm në çdo lloj shërbimi për të mirën e vendit tonë të shumëvujtur! Vdekjen mos e merrni përparasysh, se s'ka më ëmbël se vdekja e trimit që vdes në fushë të luftës për liri! Bekimet e mëmëdheut qofshin mbi ju!

Rroftë Shqipëria!
Rroftë gjuha jonë!
Rroftë liria!

(Midis brohoritjeve e duartrokitjeve, fillon të këndojë.)

O djem, o luftëtarë,
O 'bijt' e Skënderbeut...

*(Bashkohen me të zërat e të gjithëve që shkrihen
në një kor të fuqishëm.)*

Kërkoni, ju shqiptarë
Lirin e mëmëdheut!
Se mjaft në robëri,
E mjera Shqipëri!
O djem, rrëmbeni hutatë,
Ja vdekje! Ja liri!

Perdja

Tabloja e gjashtë

(Bëhet errësimi i ngadalshëm dhe i plotë, ndërsa kënga buçet në errësirë. Diku faksin shkronjat e projektuara: «Viti 1912». Kur hapen dritat, jemi po tek ai vend, te sheshi i pazarit, pranë shkollës. Janë po ata luftëtarë e nxënës dhe gjallëria e gëzimi janë të përgjithshme.

LLAMBI – Mëmëdhetarë! Le t'i urojmë Babë Dudë Karbunarës udhë të mbarë për në Vlorën kreshnike! *(Brohoritje.)*

PETRITI – Babë Dudën ne e çmojmë, e nderojmë dhe e duam shumë se ka punuar për ne, për popullin, për Shqipërinë. Prandaj e zgjodhëm si përfaqësuesin tonë në Kuvendin e Vlorës, prandaj e zgjodhëm anëtar në Kuvendin Kombëtar. Na përfaqëso, o Babë! Shpjere zërin tonë atje. Zërin tonë dhe zemrën tonë! T'u bëftë rruga ujë! *(Brohoritje.)*

BABË DUDA – Pas 500 vjetësh robërie e lufte, i shporrëm osmanllinjtë. Këtë e bëri populli dhe pushka e tij. Shtrëngojin fort armët dhe këtë flamur, vëllezër! Mos i lini t'u bien nga duart, se armiqtë e Shqipërisë janë ende të shumtë!... Ju më zgjodhët. Unë do t'ju përfaqësoj si shqiptar. Nuk do t'ju turpëroj. Shqipëria për mua është gjithçka! Kam ecur 70 vjet në rrugën e mundimeve për lirinë e Shqipërisë... Po, sikur ta filloj jetën nga e para,

do të eci përsëri vetëm në këtë rrugë! (Puth flamurin. Brohoritje. Përshëndetet me njerëzit ndërsa kënga buçet.)

○ djem, o luftëtarë,
○ bijt e Skënderbeut...

Perdja mbyllet ngadalë

THE UNIVERSITY OF CHICAGO
DEPARTMENT OF CHEMISTRY

PHYSICAL CHEMISTRY
LABORATORY

1950

REPORT OF THE
PHYSICAL CHEMISTRY
LABORATORY
FOR THE YEAR 1950

PARTIZANËT

dramë

1944

Personazhet

- LIM GURA – fshatar i varfër
TIXHJA – e shoqja
AGIMI – djali i madh
BENKOJA – djali i vogël
LATIFI – polic
TOSUN BEU – çifligar, ballist
HAJROJA – fshatar i varfër
PETRITI – mësues fshati
FANI – punëtor
THOMAI – punëtor
VANGJOJA – punëtor
SKËNDERI – student
MYRTEZAI – gardian burgu
DANIA – i burgosur
LIRIA – komisarë
KRYETARI i këshillit nacionalçlirimtar të fshatit
Partizanë, fshatarë, italianë, ballistë, robër etj. .

Ngjarja zhvillohet në vitin 1943.

AKTI I PARË

Tabloja e parë

Oborri i një shtëpie fshati malor. Nga larg dëgohen të shtëna armësh. Skena është bosh për një çast. Përmes saj vrapon Benkoja i ndjekur nga e ëma.

TIXHJA – Po dale, more djalë, ku vrapon kështu?

BENKOJA – Ika unë. S'e dëgjon që po kërcet?

TIXHJA – Le të kërcasë. S'është punë për ty! Kthehu!

BENKOJA – E, mirë, mirë...

TIXHJA – Benko, po ç'të duhet ty, more bir, të marrësh vesh se kush i zbraz këto pushkë? Prit! Pse, punë kalamajsh është lufta! Prit, të thonë, mos shko!

BENKOJA – Ehu, edhe ti! Po, pse unë kalama jam! (Del.)

TIXHJA – Benko!... Benko!... Ruaju, more bir!... Iku!... S'dëgjojnë më fëmijët. Janë bërë të prapë! Edhe ata e kanë mendjen te lufta.

LIMI – Nga shkoi?

TIXHJA – Sipër, andej nga zbrazen armët.

LIMI – Me siguri, luftohet te Qafa e Pishave.

TIXHJA – Mos pësojë gjë djali! Ai është kalama. Trembëdhjetë vjet sa i mbushi.

LIMI – U rralluan armët. Do të ketë rënë në pritë ndonjë

autokolonë italiane. Janë vende të përshtatshme ato për prita. Në të dyja anët e xhadesë ka shkëmbinj. Ishallah, e ibëhen pluhur breshkaxhinjtë!

TIXHJA – Na u vonua edhe Agimi. Është nisur që pa gdhirë e s'duket të vijë.

LIMI – Pazari ka të papritura, grua. Fillon mirë po ngandonjëherë mbaron keq. S'e sheh ç'bëhet. Është kohë lufte.

TIXHJA – S'është vonuar ndonjëherë, kaq shumë.

LIMI – Po ti e di tani, veç pazarit ai ka edhe ato punët e tjera në qytet. Sa për Benkon, mos u bëj merak fare. Ja edhe armët pushuan. Do ta kenë ngrënë keq italianët. (*Hyn Agimi.*)

AGIMI – Si u ngrysët, mirë?

TIXHJA – Erdhe, bir i nënës? Na bërë merak. Të qenka dirsur kurrizi.

LIMI – Si dole?

AGIMI – Si gjithnjë, mirë të themi.

LIMI – Ç'kishim nga qyteti?

AGIMI – Fashistë që u vjen festja vërdallë. Se ku kanë ngrënë ndonjë dajak të mirë, mbasi në tërë rruget kishte roja. Edhe postbllokun e kishin forcuar. Kontrollonin shumë.

LIMI – Edhe këtej krisi përsëri te Qafa e Pishave.

AGIMI – I dëgjova pushkët. Zjarr gjithandej. Po përvëlohen si minjtë. Gjëmojnë malet, gjëmojnë. (*Nxjerr një tufë me trakte.*)

TIXHJA – Përsëri ke sjellë nga këto? Po kujdes, more bir, se do të marrësh veten më qafë.

LIMI – Ti the se kontrollojnë në postbllok. Si s't'i gjetën kartushkat?

AGIMI – I fsheha në veshët e gomarit... Po ti, nënë, përse ke frikë? Ti vetë më ke thënë që të jemi gjithnjë me hallallexhan me të drejtën, të themi të drejtën e të luftojmë për të drejtën. Unë s'po bëj gjë tjetër. Po zbatoj ato që më ke thënë ti edhe babai.

TIXHJA – Po mos harro edhe hallët që na kanë zënë. Ne jemi pleq. Por sikur të të zënë e, mos e dhëntë zoti, të të futin në burg, vaj halli për ne! Kush

do të na mbajë? Benkoja? Ai ka vetë nevojë për hyzmet. Ti do të na mbash, o bir, e do të na ushqesh. E nusja jote do të na bëjë hyzmet.

AGIMI – Po kemi hasmin në vatër, nëneee! Na ka robëruar, po na shtyp, po na vret, po na djeg. Si thua ti, të rrimë duarkryq e ta mbajmë kalakiç në qafë. Po a e di, se po nuk i luftuam fashistët dhe tradhtarët, ata do të na shuajnë si popull?

TIXHJA – Për këtë ke hak. Dushmani në vatër s'durohet!

LIMI – Mirë e ka djali. Duhet t'i luftojmë... Po, është kral i madh dreqi, kurse ne një grusht popull dhe pa armë. Me se ta luftojmë!?

AGIMI – S'jemi vetëm, baba! Gjithë popujt e urrejnë dhe e luftojnë këtë murtajë të zezë.

TIXHJA – Po mendo edhe për ne pleqtë, edhe për tët vëlla të vogël... edhe për shtëpinë...

AGIMI – Për ju mendoj, për ty nënë, për ty baba, për Shqipërinë, prandaj i kam hyrë kësaj pune. Me luftë do ta çlirojmë Shqipërinë dhe do të zhdukim varfërinë që na ka pllakosur. Dhe do të fitojmë se na udhëheq Partia Komuniste.

LIMI – Eh, zoti na e bëftë mbarë. Parti u bëftë e tërë bota! Si e thonë ata shokët e tu, o bir? Kështu nderojnë, me gusht. Vdekje façishtës!

AGIMI E TIXHJA – Liri popullit!

AGIMI – Ata shokët e mi u dukën gjë sot këtej?

TIXHJA – Kush, mësues Petriti?

AGIMI – Edhe Fani me Lirinë?

LIMI – Lajmëruan se do të vijnë nga darka.

AGIMI – Epo mirë, atëherë. Ti, nënë, na gatuaj ndonjë gjë. Do të flenë te ne sonte.

TIXHJA – Fasulkat i kam gati në poçe.

AGIMI – Po shkoj të rregulloj gomarin. (Del.)

TIXHJA – Kam një djalë, për kokë të djalit!

LIMI – E kemi të dy, grua!

(Hyn Latifi.)

LATIFI – Tungjatjeta, o kushërinj! Si jeni? Si shkoni?

LIMI – Si je, Latif?

TIXHJA – Si je, mor bir, si i ke nga shtëpia?

- AGIMI – More, po ti fol më shkoqur, se s'po të marr vesh.
- LATIFI – Ja, ore, shkoqur, po flas.
- AGIMI – Po kujt ia thua këto fjalë ti?
- LATIFI – Ty, ore, t'i them, tyt eti, s'at ëme!
- AGIMI – Oj, po që kur u bëre kaq trim ti? Që kur veshe atë rrobë? E di ç'të bëj, o derr? Të shqyej e të nxjerr zorrët, qelbanik!
- LATIFI – Kujt i thua derr e qelbanik ti?
- AGIMI – Ty të them.
- LATIFI – Më ke ndyrë rrobën ushtarake.
- AGIMI – Ta ndyj që ç'ke me të. Se për të ndyrë është. Dhe mos e nxirr revolen. Fute prapa më mirë.
- LIMI – Daleni, more djem, ç'bëni kështu? Jeni edhe një gjak, dreqi e mori, farefis, kushërinj!
- AGIMI – Ai ka gjak fashisti. Unë s'e kam gjë.
- LATIFI – Mbaj gojën, Agim, se kam edhe revole unë.
- AGIMI – Na trembel Fute atje, ku të thashë.
- LATIFI – Ja, do të më shohësh. S'duroj sharje unë. Ti më shan, po unë ta punoj. Vallahi-bilahi, me revole.
- AGIMI – Revolen ta hedh në hale!
- LIMI – Ç'na gjeti, jemi katër e fjalosemi tetë. Pushoni! Ndaluni! Dhe ti, Latif, të mos shkelësh më në shtëpinë tonë. Nuk i duam ata që zgjedhin shoqërinë e fashistëve, të hajdutëve, të batakçinjve, të tradhtarëve e të vrasësve.
- LATIFI – Nuk jam i tillë unë.
- LIMI – Gjersa ke veshur rrobën e tyre, i tillë je!
(Hyjnë Tosun beu e Hajroja.)
- TOSUN BEU – Paska plasur sherri këtu. Ç'është ky sherr, o Lim?
- LIMI – Asgjë, Tosun bej. Punë rinie. Vlon gjaku. Ti, Hajro, si je?
- HAJROJA – Mirë, desh zoti!
- TOSUN BEU – Këtu qenke ti, Latif trimi?
- LATIFI – Si urdhëron!
- TOSUN BEU – Andej lart nga Qafa e Pishave, a ishe gjë?
- LATIFI – Jo, Tosun bej.
- LIMI – U bë luftë e ashpër. Nuk zgjati shumë.

TOSUN BEU – E kam thënë që partizanët do të na për-
vëlojnë. I kam urdhëruar që në krahinën time të
mos i futin hundët e të mos bëjnë asnjë aksion, se
ndryshe, unë do të detyrohem t'i godas pas shpine.
Po kujt i thua? A merr vesh shkëmbi?

HAIROJA – Ashtu, ke të drejtë, Tosun bej. S'merr vesh
shkëmbi.

AGIMI – Tosun bej, partizanët luftojnë për liri, për
Shqipëri.

HAIROJA – Ke të drejtë, o bir.

TOSUN BEU – Domethënë, unë s'luftuakam për Shqipëri.
Ata luftojnë, ne jo, Kështu? Kështu, o Hajro?

HAIRO – Si urdhëron, Tosun bej!

AGIMI – Ti lufton me llafe, bej, ata me pushkë.

TOSUN BEU – Dhe t'i hedh mua këto romuze?! Parti-
zanët janë banditë e hajdutë. Ata bëhen shkaktarë
të ziarreve e të vrasieve. Ata grabisin e vrasin
njerëz të pafajshëm. Ata s'kanë nder. Ata flenë
me nëna e motra! Ata s'luftojnë për Shqipëri, po
për të huajin. Ata janë grekë, serbë, rusë, çdo gjë
janë, vetëm shqiptarë jo.

AGIMI – Këto janë profka e ajapura që i trillon fashizmi
e i përhapin shërbëtorët e tij.

LATIFI – Ç'flet kështu, Aaim! Tosun beu është patriot
e i ndershëm denbabaden.

TOSUN BEU – E ke hak një plumb ti, more qen i Limit.
Po nuk dua ta ndvi dorën e të bëhem vrasës. Unë
jam patriot i radhëve të para që në kohën kur ti
i bije maces me luge, qurravec!

LIMI – Me naadalë, o bej, me naadalë. se është im
bir ai dhe ha bukë veç, s'është si ky shërbëtori i
fashistëve, si ky maskara që auhet Latif. Im bir
ka të drejtë. Ju i keni lyer duart me gjakun e
prindërve tanë. E kam të gjallë kuitimin e padrej-
tësive, të dhunës që pësuan prindërit e gijshërit
e mi. Ju ieni vrasës. përhindësh, na keni rrëmbyer
tokat, bagëtitë, pyjet. Ju u shërbeni fashistëve, hashkë-
punoni me ta, prandaj i shani partizanët. Po par-

tizanët janë bij të popullit dhe do të na sjellin lirinë, fitoren.

TOSUN BEU – Siç e sollën sot te Qafa e Pishës, ku u shpartallua tërë çeta e tyre... Mblidh mendjen, plak matuf, se më rëndove tepër!

LIMI – Hiq dorë nga kjo rrugë, Tosun bej, sa nuk është vonë. Tregoji sinorin armikut dhe bëju me popullin. Ndryshe, me ne hesapet i ke të ndara. Edhe ti, Latif, herë tjetër rruaje mjekrën në pazar, po mos na e trego në fshat, se bëhesh gaz i botës. Dhe fjala e fundit: Po të vesh pas brumbullit, mbaron në hale! Mos e harro këtë!

HAJROJA – Fjalë me mend!

TOSUN BEU – Mirë pra, ja ku ju paralajmëroj për të fundit herë: Mos pranoni partizanë në shtëpi. Po pranuat, do t'ju djegim shtëpinë. Ju këshilloj që të kyçni edhe qojën. Kush e zajat llapën shumë, ia shkurtojnë. Dhe në fund: ky fshat është i zonës së Ballit Kombëtar. Këtu s'ka punë Nacionalçlirimtarja dhe askush tjetër.

AGIMI – Veç fashistëve, sigurisht, të cilët ju i luftoni vetëm me llafe.

TOSUN BEU – Fashistët do t'i luftojmë edhe me armë, kur të vijë koha. Sa për liri ju s'meritoni, se, po të keni, të rripni të gjallë. (Del.)

AGIMI – Po ti ç'pret, o polic?

LATIFI – Po më përzini? Më qafë paçi veten! (Del.)

LIMI – Gomari gomar mbetet, edhe po t'i presin veshët.

HAJROJA – Fjalë me vend. Ika se më zuri nata.

LIMI – Po rri, o Hajro, të pimë nga një kupë. Me ç'kemi për vete. Rri të bëjmë cazë muhabet.

HAJROJA – S'di si të bëj. Jam me dy mendje. Njëra më thotë rri, tjetra më thotë ik. Kështu më ndodh gjithnjë mua.

LIMI – Mos dëgjo asnjërën, po rri të pimë nga një çikëz.

HAJROJA – Por, po të mos dëgjoj asnjërën, mbetem pa mend në kokë. Ika. S'është kohë për të ndenjur. Është turbulluar bota. Një herë tjetër do të rri.

Mbeçi me shëndet!... Si i thonë? Vdekje façistës!
(Del.)

LIMI – Mirë ardhsh! Liri popullit!

(Pauzë. Merren me punët e shtëpisë.)

TIXHJA – Mirë ia bëtë atij qen beut! Ashtu e do ai i mallkuar e i pacipë! Është maskara! Vetëm se kam një lëmsh këtu në gjoks. Më duket se do të na ndodhë ndonjë e keqe. Është kafshë ai, s'është njeri. Të bën të pabërën!

(Hyjnë Benkoja, Petriti e Fani.)

TË TRE – Vdekje fashizmit!

AGIMI – Liri popullit! Urdhëroni, shokë!

LIMI – Si je, mësues Petriti?

PETRITI – Top, xha Limi, top!

LIMI – Po ti, more Fani?

FANI – Shih e shkruaj, xha Limi!

TIXHJA – (Pasi i përshëndet, Benkos.) Erdhe, more b'ri! T'u bëftë nëna! Sa u bëra merak! Dale, pa vishe këtë setrën e re! (Benkoja e vesh.) Sa bukur të rri. I kisha mbledhur paratë nga një lopkë e nga një lopkë, ja, për këtë setër, për ty.

FANI – Sikur ia ke qepur me porosi. E mbajç me shëndet, Benko!

PETRITI – Me shëndet e dhëndër!

BENKOJA – Faleminderit!

AGIMI – Si dolët?

PETRITI – Shumë mirë. Mbledhjen e rinisë e bëmë në pyll. Janë djem të zjarrtë devollinjë.

LIMI – Po ç'morët vesh ndonjë gjë? Ç'ndodhi te Qafa e Pishave?

PETRITI – Pse? S'dini gjë ju?

LIMI – Dimë diçka, dimë. Tosun beu na tha se çeta partizane u shpartallua.

BENKOJA – Të gënjyer që ka bërë! U shpartalluan fashistët, baba.

FANI – Po. U shpartalluan. Partizanët s'patën asnjë humbje. Dogjën katër kamionë dhe tërë ushtarët u zunë rob, me përjashtim të disave që u çakërdisën nëpër pyll.

- TIXHJA – Ç'ua paskan bërë paq!
- LIMI – M'u lumtë!
- AGIMI – Tani urdhëroni brenda dhe mos na e vini re varfërinë.
- PETRITI – Po për të fituar lirinë dhe për të zhdukur këtë varfëri po luftojmë, o Gimi.
- FANI – (Me zë të ulët që të mos e dëgjojë Agimi.) Është djalë i gjallë, i papërtuar e i vendosur gjer në vdekje.
- PETRITI – Ashtu është. Kush vuan shumë, bëhet më revolucionar. Agimi ka qenë shumë mirë edhe me mësimë.
- AGIMI – Benko! Futi shokët në dhomë! (Benkoja, Petriti e Fani dalin.) Nënokë, bëj gati darkën, po një çikë shpejt, se do të fillojmë mbledhjen ne?
- TIXHJA – Përsëri mbledhje?! Me siguri, do ta gdhini.
- AGIMI – Si gjithnjë.
- (Hyn Hajroja.)
- HAJROJA – O Limi! U bëra pishman unë!
- LIMI – Po haxhipishman je ti, o Hajro. Urdhëro!
- HAJROJA – Vajta gjer te dera e shtëpisë e thashë me vete: ç'do të bëj që të hyj në shtëpi kaq herët? Do të mërzitem. Kthehu, Hajro, e shko te Limi, i thashë vetes. Ai t'u lut për një gotë, për muhabet... Ja, e sheh, u ktheva.
- LIMI – Po shumë mirë, more Hajro vëllai.
- TIXHJA – Urdhëro, urdhëro, zotrote! E ke si shtëpinë tënde. S'të pyeta, si t'u bërë gruaja, se sikur e kishe pa qejf.
- HAJROJA – Mirë është. E hodhi.
- TIXHJA – Po çupa?
- HAJROJA – Çupa, çupë.
- TIXHJA – E ke të mirë, zotrote, punëtore, namusqare... (Del.)
- LIMI – Po këta? Ç'janë këta njerëz të armatosur?! (Hyjnë Tosun beu, Latifi dhe ushtarakë italianë.)
- TOSUN BEU – Të mos luajë asnjeri!
- ITALIANI I – Rrini aty ku jeni! Arrestojeni!

LATIFI – Ja, ky është komunisti i fshatit tonë?

(*Agimin e lidhin.*)

AGIMI – Të poshtë! Polic i fëlliqur! Bej gjakatar!

ITALIANI I – Kontrolloni shtëpinë! (*Ushtarakët hyjnë brenda. Disa i turren Limit e Hajros.*)

TOSUN BEU – (*Për Hajron.*) Këtë jo. Mos e prekni! Nacionalist. Burrë i ndershëm. (*Për Limin*) Edhe këtë jo. Plak njeri.

LATIFI – (*Agimit.*) Të thashë? Ja, e hëngre. Ti i bëje të gjitha dallaveret në fshat e na sillje vërdallë.

AGIMI – I!k, tradhtar!

ITALIANI I – Kontrolate da per tuto! Kjo shtëpi ka lidhje me partizanët. Kështu, sinjor Latif? Ju na keni thënë.

LATIFI – Po, po, zoti oficer!

ITALIANI I – Ju jeni shkaktarë të asgjësimit të kolonës te Qafa e Pishës. Ju jeni spiunë e agjentë të partizanëve. Ju i njoftoni ata për lëvizjen e trupave tona! Ju i përkrahni! ju i ushqeni!... Të gjitha këto do t'i paguani me kokë!

LATIFI – Me kokë, me kokë, që të vënë mend të tjerët.

AGIMI – Shpirtzi! Për lekët e të huajit merr më qafë vëllanë! I shitur! Po do të vijë dita që të japësh llogari, këtu në fshat. Do të vijë dita që të kafshosh dhë.

LATIFI – Pusho, harbut! Të pret litari!

AGIMI – Javash se na trembe, tradhtar!

(*Një ushtarak e godet Agimin.*)

ITALIANI II – Xito, maskalcone!

LATIFI – Ç'ta bëri mirë!

AGIMI – Përpara të lidhurve me zinxhirë jeni trima ju, këlyshët e Duçes.

(*Hyjnë Petriti e Fani të lidhur, të shoqëruar nga ushtarakët, nga Tixhja e Benkoja.*)

TIXHJA – Edhe ty të lidhën? Ç'është këtu, Agim?

AGIMI – Tradhti, nënë. Po, ti mos u tremb! Mbahu!

LATIFI – Hiq këtej ti, teze. S'janë për ty këto punë.

AGIMI – Shokë! Nuk e keni nga njerëzit e mi këtë tradhti.

- FANI – E dimë, Gimi. E dimë mirë nga na erdhi.
- PETRITI – Tosun beu tërë jetën i tillë ka qenë.
- LIMI – Mbahuni, bij! Rugët e gjata të lirisë bëhen vetëm me lot e me gjak! Kryet lart, o bij! Ngrihuni si malet që t'ju shohë bota... ngrihuni që t'ju shohin këta krimba e të pëlcastin.
- TIXHJA – O bir! O bijtë e nënës!
- ITALIANI II – Hiq ti, shtrigël! (E shtyn.)
- ITALIANI I – Via! Portatela fuori!
- TIXHJA – (Shtyn ushtarakun. I drejtohet Tosun beut e Latifit.) Ju, o shushunja, e bëtë këtë? Mallkuar qafshi për tërë jetën! Ju shofshin vatrati! Ju jeni katilë! Ju i keni zemrat të zeza. (E nxjerrin përjashta, por ajo hyn përsëri e përqafton të birin.)
- TOSUN BEU – Ja si e pëson njeriu kur s'i vë veshin të madhit!
- HAJROJA – Jo mirë kështu, bej, jo mirë! Jo mirë! Jo mirë!
- ITALIANI III – Non abbiamo trovato nul altro!
- ITALIANI I – Vabene, dobbiamo andare!
- AGIMI – Nënë, baba, Benko, lamtumirë!
- PETRITI, FANI, AGIMI – Vdekje fashizmit!
- LIMI, HAJROJA, NËNA, BENKOJA – Liri popullit!
(Dalin Tosun beu, Latifi, italianët, djemtë e arrestuar, të shoqëruar nga Limi e Hajroja. Mbeten në skenë Tixhja e Benkoja. Pauzë e gjatë.)
- BENKOJA – Nënë, unë do t'ua marr hakun.
- TIXHJA – Për ku u bëre gati kështu? Ku do të vesh?
- BENKOJA – Te partizanët.
- TIXHJA – Te partizanët?! Po ti je i vogël, more bir.
- BENKOJA – Ka edhe më të vegjël se unë.
- TIXHJA – Benko, nuk i bën dot ballë ti asaj jete. Është e mundimshme, e rëndë. Do të flesh në dëborë, do të rrih pa ngrënë, do të udhëtosh ditë e net. Dëgjon, Benko!
- BENKOJA – Unë do të iki, nënë...
- TIXHJA – Benko! (I hidhet në qafë, e puth.) Bir i nënës!
Po unë tani vetëm ty të kam. Mos më ler vetëm.
- BENKOJA – (Shkëputet prej saj.) Mos m'u lut më. Do të

iki. Do të shkoj të vras katilët. Të marr hakun e vëllait e të shokëve të tij.

TIXHJA – (E ndjek.) Me gjithë mend po ikën nga shtëpia? Po prit gjersa të lirohet Agimi! Prit, të paktën, të kthehet yt atë! A kështu po ma punon?! Të bëra edhe xhakëtë të re. Më mirë të të kisha lënë me atë rosoken e grisur.

BENKOJA – S'më duhet xhaketa. Na, ja ku e lashë! (E zhvesh dhe e lë përtokë.)

TIXHJA – Benko! Po dale, more bir. Unë bëra shaka. Na, merre! Vishe se të mban ngrohtë! Është prej shajaku.

BENKOJA – Nuk më duhet! Nuk më duhet!

TIXHJA – Benko! Merre, xhan! Dhe, meqë ke vendosur, shko! Shko, o bir! Pushka top! Po xhakëtën merre... Benko!... Benko!... Benko! (E ndjek nga pas duke dalë.)

Perdja

AKTI I DYTË

Tabloja e dytë

Një birucë burgu. Të burgosurit punojnë për të hapur një kanal nga mund të arratisen.

PETRITI – Pushoni, shokë! Dëgjoj hapat e gardianit. Pa vini veshin edhe ju! Fani, kujdes ti, nga porta. Thoma, njoftoji shokët të mos punojnë. (Thomai fut kryet në të çarën e murit.)

FANI – Këtëj s'ka gjë, mësues Petriti. Më duket se po ndërrohen rojat.

DANIA – (Nga jashtë. Me fytyrë te katrori i vogël i derës.)
Si jeni, shokë?

PETRITI – Lot gjë andej, Dane?

DANIA – S'lot gjë. Po përgatiten të ndajnë bukën.

FANI – Na njofto po lëvizën karabinierët.

DANIA – Mos u bëni merak fare.

MYRTEZAI – (Nga jashtë.) Dane, shko e merr bukët e kaushit 17.

DANIA – Si urdhëron, zoti gardian! (Pauzë.)

PETRITI – U larguan. Thoma, njoftoji shokët të vazhdojnë punën! (Thomai i njofton.)

THOMAI – Duhet nxjerrë dheu, se mezi punojnë. Unë i mbusha xhepat. (Del.)

FANI – Po ju ndihmoj edhe unë. (Mbush gjirin me dhé.)

PETRITI – Aty ku e derdh, hidh ujë që të shpëlahet mirë e të mos mbetet gjurmë.

FANI – Ashtu kemi vepruar vazhdimisht. (Del.)

PETRITI – (Vetëm.) Sa shumë na e vonuan Agimin sot! U bënë... gjashtë orë... Gjashtë orë në torturë. E tmerrshme! Nga ne hoqën dorë, kurse atij s'i ndahen. I është qepur Tosun beu. Kërkon me këmbëngulje që ta pushkatojnë, ose ta varin për të tmerruar kështu tërë fshatin... Gjynah të ikë ai trim djalë në lulen e jetës. Populli ka aq shumë nevojë për djem trima si Agimi!

SKËNDERI – (Zgjat kryet nga e çara e murit.) Na u shua qiri. A ke shkrepëse, mësues Petriti?

PETRITI – Kam. Na! Si vete puna? A gërmohet pjesa e çimentuar?

SKËNDERI – Me shumë mundim. Ca hekura mezi i premë me limë. Edhe vendi është shumë i ngushtë. Vangjos iu bënë duart gjak, po megjithatë s'e lëshon limën.

PETRITI – Ju jeni lodhur. Bëju zë shokëve. Dilni ju e të hymë ne.

SKËNDERI – Mund të punojmë edhe ca. Më keq e kemi me ajrin. S'na mjafton dhe është tërë pluhur.

PETRITI – Ku dreqin na doli kjo pjesë e çimentuar?

SKËNDERI – Mendojmë se pas çimentos, do të jetë rruga. Sonte ose nesër e përfundojmë. Kështu u kemi shkruar edhe shokëve të Partisë. Ika! Ju ejani pas ndonjë ore! (Del.)

PETRITI – (Vetëm.) Si zor që të përfundojë. Sidoqoftë, këtu duhet t'i derdhim tërë fuqitë. Le të rrimë pa gjumë e pa ingrënë. Koha s'pret. Agimi mund të dënohet rëndë. Ne duhet të jemi gati për ta shpëtuar (Hyjnë Thomai e Fani.)

FANI – Gardian Myrtezai më tha se Agimin e dënuan me varje.

PETRITI – Mos, more! Kur ta tha?

FANI – Ja tani.

PETRITI – Sikur s'më besohet.

FANI – Për dënimin me vdekje mos dysho aspak. Fashistët kanë vrarë edhe njerëz krejt të pafajshëm, fshatarë që shihnin vetëm punën e tyre, dhe jo Agimin.

PETRITI – Për se e akuzojnë?

FANI – Lëre, lëre. Gardian Myrtezai më tha se i kanë vënë gjithë ato akuza. E akuzojnë edhe për prerjen e telave të telefonave, për shpërndarje traktesh, bile edhe si pjesëmarrës në atentatin kundër kuestorit. Ka shumë akuza. Nuk shpëton dot.

PETRITI – Habitem përse po e vonojnë kaq shumë. Ku e mbajnë?

THOMAI – Në kuesturë ose në karabinieri, në ato birucat e ftohta ku kam qenë edhe vetë. Me siguri e torturojnë.

FANI – Dhe s'thotë asnjë fjalë. Asgjë s'tregon.

PETRITI – Ai është komunist i vërtetë. E pra, bir bujku është, i varfër që s'dinte gjë tjetër veç të punonte tokën e të mbante në kurriz koshat me pleh të agallarëve. Po ja ku u qëndron fashistëve ballë për ballë, si dragua, si hero! E bëri të tillë Partia jonë.

VANGJOJA – (Duke hyrë tek e çara e murit.) Shokë, këtu jeni? S'ju shoh dot, se më vret drita sytë.

PETRITI – Këtu jemi. Hë, Vangjo, ç'do të na thuash?

VANGJOJA – E morët vesh?

PETRITI – Çfarë?

FANI – Po fol, more!

VANGJOJA – Dritë! Dritë! Pamë dritë nga një e plasur e voqël.

PETRITI E TË TJERËT – Dritë!?

VANGJOJA – Shshsh! Ulni zërin, shokë! Po e përsëris: Pamë dritë!

PETRITI – Nga jashtë dalloni gjë?

VANGJOJA – Si, ore, jo?

PETRITI – Rrugën e shihni? Duket rruga ku patrollojnë karabinierët?

VANGJOJA – Duket!

PETRITI – Dale të të puthim, për këtë s'hariq. (E puthin.)

VANGJOJA – Tani më jepni kovën që të nxjerrim dheun.

Fani, kujdes atje te porta, mos na zbulojnë në çastin e fundit.

FANI – Mos ki hiç merak.

THOMAI – Ty të qenkan gjakosur duart.

VANGJOJA – S'ka gjë. S'më dhembin.

PETRITI – Vangjo, rri këtu ti! Mjekojani duart! Po shkoj unë.

VANGJOJA – Po ju them që s'kam qië.

PETRITI – Vangjo, hesht! Mjekoji duart! (Thomai ia miekon.)

VANGJOJA – Mirë atëherë, po dëgjo, mësues Petriti: Ki kujdes në krahun e majtë, atje ku është qiriri, se mos vithiset toka. Unë mendoj që, me të nxjerrë dheun, të mos punohet më se ka rrezik shembieje. Punën ta rifillojmë menjëherë sa të erret. U thuaj shokëve.

PETRITI – Mirë, mirë, (Hyn në të çarën e murit.) shokë, unë do t'jua sjell dheun gjer këtu. Ju mbushni xhepat e drejt e në WC. Po me kujdes, se mos diktohem! (Del.)

VANGJOJA – Më në fund, e çamë kanalën! O, ç'lumturi!

THOMAI – Po, me ajihtë mend doli dritë? S'më besohet.

VANGJOJA – S'të besohet nga gëzimi. S'e besova as unë që isha aty. Ja bënim me Skënderin: «Nuk është dritë. Na bëjnë sytë.»

FANI – Domethënë, sonte edhe mund të provojmë për të dalë.

VANGJOJA – Jo të provojmë, por të dalim e t'u lëmë mallkimin këtyre birucave të errëta të fashizmit.

THOMAI – Ç'lumturi! Është aq e bukur, sa s'më besohet.

VANGJOJA – Lumturi vërtet!

FANI – Domethënë, të bashkohemi me partizanët. Të bëhemi partizanë.

VANGJOJA – Të jeni të sigurt. Nesër mënqjesi do të na gjejë së bashku me partizanët, me luftëtarët e lirisë. Do të marrim pushkë, fishekë, bomba dhe do t'i hidhemi në fyt fashizmit të urryer që rropi popullin fukara, na nxiu jetën, sfiliti, vrau e preu sa e sa

bij nënash shqiptare. Po, po. Do të dalim, me siguri, dhe do të shkojmë te Qafa e Pishave, atje ku na ka thënë Agimi. Ç'lumturil... Po Agimin akoma nuk e kanë kthyer? Përse e mbajtën kaq gjatë sot? Mos ka ardhur gjë? Mos dini gjë ju e ma fshihni. Fani, Thoma!

FANI – Nuk dimë gjë.

VANGJOJA – Por përse jeni kaq shumë të shqetësuar?

FANI – Na thanë se gjyqi ushtarak e dënoi me vdekje.

VANGJOJA – Nuk do ta zbatojnë vendimin. Agimin do ta nxjerrim sonte. (Thoma e Fani mbushin xhepat me dhé e dalin. Pauzë.)

VANGJOJA – Ç'janë këta hapa? Ç'është kjo zhurmë në oborr?

THOMAI – (Duke hyrë.) Shpejt! Lajmëroji shokët të dalin nga kanali. Një grup karabinierësh hynë në oborrin e burgut.

VANGJOJA – (Tek e çara e murit.) Petrit, Skënder! Dëgjuat? Dilni shpejt... shpejt!

PETRITI – (Nga e çara e murit.) Ç'ka ndodhur?

THOMAI – U mbush burgu me karabinierë.

SKËNDERI – (Duke dalë.) Po Fani ku është?

THOMAI – Po vëzhgon në korridor. Po ndihet zhurmë. Po vijnë.

PETRITI – Mbuloni të çarën e murit! Vini një dyshek! (Shtrojnë një dyshek.)

THOMAI – (Skënderit.) Ti je llangosur me baltë. (Skënderi fillon të fshihet.) S'ka kohë, s'ka kohë, Skënder. Futu në shtrat, mbulohu me batanije e bëj sikur fle! (Skënderi vepron siç i thonë.)

FANI – (Te katori i portës, nga jashtë.) Shokë! Po sjellin Agimin.

MYRTEZAI – (Nga jashtë.) Në kaushin 17. Atje e ka shtratin! (Dëgjohet zhurmë hapash e zinxhirësh. Porta e kaushit përplasët. Hyjnë Agimi, Fani, karabinierë e një oficer italian.)

OFICERI – Këtu, maskalone! (Karabinierët e shtyjnë dhe Agimi rrëzohet përtokë.)

- AGIMI – Bisha! S'u mjaftuan torturat, po edhe këtu do të vazhdoni. (*Shokët e rrethojnë Agimin.*)
- OFICERI – Pusho, tradhtar!
- AGIMI – Ju jeni xhelatë, që s'ngopeni kurrë me gjak njeriu! Po dijeni se një ditë si rrufe ka për të rënë mbi kokat tuaja hakmarrja e popullit.
- OFICERI – Pusho! Pusho! (*Karabinierët e godasin me kamxhik.*)
- AGIMI – S'më tremb kamxhiku juaj, as zinxhirët, as qelitë e errëta, as litari. Në varrin që përgatisni për ne, do të kalleni vetë. Aty do të mbaroni të gjithë. Shpata e drejtësisë do të bjerë pa mëshirë mbi ju, breshkaxhinj të fëlliqur të Duçes. (*Karabinierët e qëllojnë përsëri me kamxhik dhe dalin së bashku me oficerin.*)
- PETRITI – (*Ia merr kokën e ia mbështet në gjoksin e vet.*) Gimi, Gim i dashur!... Sa të kanë torturuar! Sa të kanë munduar!
- FANI – Katilët!
- THOMAI – Satrapët gjakpirës!
- PETRITI – Na sillni pak ujë! (*I japin të pijë.*)
- AGIMI – Ku jam kështu?... Oh, më dhemb tërë trupi... E kam plagë! A, qenkam te shokët. Petrit, Fani, Skënder, Thoma, Vangjo... Ma bëni hallall. Unë bëra çmos. Durova dhe asgjë s'tregova.
- PETRITI – E dinim këtë. Tani hesht! Qetësohu! Ja, t'u vëmë plagëve ca napa me ujë të ftohtë dhe të të shtrijmë. Duhet të flesh, të çlodhesh, se natën mund të kesh rrugë për të bërë.
- AGIMI – Pse? Si është puna?... Doli gjë në kanal?...
- PETRITI – Doli ajo që prisnim. Dritë... Sonte, po të jesh në gjendje ti, mund të dalim.
- AGIMI – Unë jam në gjendje. Po edhe në mos qofsha, dilni ju...
- PETRITI – S'të lëmë këtu, edhe sikur ta dimë se vritemi të gjithë. (*I lidhin kokën.*)
- AGIMI – M'ju lumtë, shokë! Më jepni një cigare! (*E ndez.*) M'ju lumtë... A dërguan shokët ndonjë lajm?
- PETRITI – Ne i njoftuam që mbrëmë se kanali o sot, o

- nesër është gati. Po gjer tani, s'na janë përgjigjur.
- AGIMI -- Do të përgjigjen, patjetër. Me siguri, po marrin masat që të na presin në vend të sigurt. Mbase njoftojnë edhe ndonjë çetë që t'i afrohet qytetit. Atëherë, më lini mua e shikoni secili punën e vet. Vëzhgoni me kujdes çdo gjë. Dhe sidomos bëni kujdes për kanalin. Jashtë bie shi. Mos mbushet me ujë. Mos shembet.
(I ë burgosurit shpërndahen. Në korridor dëgjohet zhurmë.)
- FANI -- Shokë, dikush po vjen? I dëgjoni hapat? Po fjalosën dhe i janë drejtuar kaushit tonë. Skënder! Zëre shpejt shtratin! (Skënderi shtrihet në dyshek.)
- PETRITI -- Dreqi i mori! Si e kanë hallin!?
- MYRTEZAI -- (Nga katrori i dritares.) Agim Gura! Të ka ardhur nëna. Lejohet takim!. Ngrehu!
- AGIMI -- Nëna! Nëna ime! (Mezi ngrihet i ndihmuar nga Petriti.)
- PETRITI -- E shkreta plakë!
- AGIMI -- Nënë! Nënë! (Përqafohen.)
- TIXHJA -- Bir i nënës! Kapedan i nënës!
- AGIMI -- A, jo kështu! Jo kështu! Jo me lot.
- TIXHJA -- Si je, o bir?
- AGIMI -- Mirë. Shëndoshë si molla!
- TIXHJA -- Të numërohen brinjët, o bir. Mos je gjë i sëmurë? Po këto vurrata të zeza, në fytyrë, në kraharor, në duar ç'i ke? Mjerë unë e zeza! Sa qenke dobësuar? Po si shkon? A mërzitesh? A të rrahin ata rezilë? Me se ushqehesh?
- AGIMI -- Mos ki merak për asgjë. Ushqim na sjellin shokët e qytetit. Nuk rrojmë keq, jo. Pastaj nuk do të kalojmë tërë jetën këtu.
- TIXHJA -- Po ç'flitet? Kur do t'ju lirojnë? S'ke marrë vesh gjë? Mua më thonë sikur do të të heqin në burgjet e Italisë, sikur...
- AGIMI -- Mos dëgjo ç'thonë bota, nënë. Dëgjomë mua: Do të lirohem së shpejti. Shumë shpejt bile.
- TIXHJA -- Ashtu?! Të lumtë goja! Mua ma kanë bërë

- mendjen çarçaf. E ç'nuk më thonë! Bir i nënës!
Edhe ëndrrat i kam parë të këqija.
- AGIMI – Tani flije mendjen! Po baba! si është?
TIXHJA – Ka zënë këndin. Ky burgimi yt e ka vrrarë shumë.
E si të mos e vrasë? Plak njeri.
- AGIMI – Po Benkoja, ç'bën ai? Përse s'e more me vete?
TIXHJA – Ku ta gjeja! Që atë ditë që të hoqën ty, ai iku në mal te partizanët. Që atë ditë s'e kam parë, ditëshkurtrin. Kam mbetur vetëm, si qyqe.
- MYRTEZAI – Hajde, shpejt, plakë! Mjaft e zgjate muhabetin. Mbaruan dekikat.
- TIXHJA – Ja, mbarova. Sa t'i jap torbën.
MYRTEZAI – Ç'ke aty? (E kontrollon torbën.) Lakror, duhan, fanellë dhe çorape leshi. Tjetër gjë ke? _
- TIXHJA – Jo.
MYRTEZAI – (Agimit.) Merre torbën dhe ndahuni tani!
Të mos e bëjmë punën me të zëna. Dëgjove, plakë?
- TIXHJA – Çorapet i ka punuar çupa e Hajros. T'i dërgon peshqesh. Ke shumë të fala. (Ul zërin). Në çorape ke një letër nga shokët!
- MYRTEZAI – Tani e teprove, plakë. Pesë minuta kaluan. Lëri fjalët e tepërta. Këtu bisedohet vetëm për hallët e familjes.
- TIXHJA – Bir i nënës! Zoti të dhëntë ymër! Dhe kokën mbaie lart gjithnjë! Këtë porosi ke dhe nga yt atë.
- AGIMI – (E përqafton.) Nënë e shtrenjtë! Të fala të gjithë shokëve, miqve. Babait i thuaj se kokën ashtu do ta mbaj, gjersa të shporren këta fashistë të tërbuar. Nuk e turpëroj familjen e Lim Gurës. Udhembarë!
- TIXHJA – Rr: me shëndet, o trim i nënës! (Del)
- MYRTEZAI – Ik tani, ik! (Del duke e ndjekur nga pas.)
(Pauzë.)
- AGIMI – E shkreta nënë! Ç'zemër të fortë ka!
- PETRITI – Sa u helmua sot, aq do të gëzohet nesër, kur ta marrë vesh që u arratisëm.
- AGIMI – Pa ndajeni këtë lakror, se na ka marrë malli. Bie erë magje fshati. Ku janë çorapet? Këtu qenkan. Ajo më tha se këtu është një letër. Ja ku qenka. (Lexon:) «Të dashur shokë. E morëm vesh

qëndrimin heroik të Agimit përpara torturave të xhelatëve. Qëndrimi i tij na ka frymëzuar të gjithë. Ai është dënuar me vdekje. Po ne nuk do ta lëmë në duart e armiqve. Nëse kanalini e keni hapur, sonte, në orën 9 të mërkurës, ju presim të varrezat. Nëse nuk dilni dot sot, ju presim nesër mërkurë në të njëjtën orë. Njësitet e qytetit i keni atje. Pranë është dhe një çetë partizane. Nëse nuk do të dilni dot këto dy net, ne do të marrim masa të tjera. VFLP.»

PETRITI – Epo, udhëzimet janë të qarta. Duhet të përgatitemi.

AGIMI – Sa merak kanë shokët për ne! Shikoni ç'parti të fortë që kemi! Si të mos fitojë populli, kur ka në krye një parti të tillë! Epo, filloni nga përgatitjet, shokë. A ka më në tunel dhera që na pengojnë?

SKËNDERI – Jo. Dhera s'ka, po janë ca gurë që duhen hequr për të kaluar pakëz më lirshëm.

AGIMI – Mirë, futuni ju të dy! *(Thomai dhe Vangjeli.)* Pastroni vendin dhe vini veshin. Gërmoni me kujdes. Pas çdo goditjeje pushoni një kohë. *(Thomai e Vangjeli dalin nga e çara e murit.)*

AGIMI – Ti, Fani, mos u largo fare nga porta. Të gjithë duhet t'i hapim mirë sytë edhe veshët.

SKËNDERI – *(Ndani bukë.)* Merrni nga një pjesë. Në mos na e nxënë barku, ruajeni në xhep, se s'dihet ç'ndodh.

FANI – Nuk ndihet kurrëgjë, S'ua pret mendja se ç'do të ndodhë këtë natë.

SKËNDERI – Po del Vangjeli nga kanali.

VANGJELI – *(Nxjerr fytyrën tek e çara e murit.)* Shokë, qetësi. kudo. Rojat janë duke ngrënë bukë. Kanali është i hapur. Nëse jeni gati, mund të heqim edhe një pllakë prej guri. Unë mendoj se tani është rasti më i mirë për të dalë.

AGIMI – Mirë. Po dalim. A jeni gati, shokë?

TË GJITHË – Po.

AGIMI – Në rregull. Tani dëgjoni. Mbani gjakftohësinë,

se çdo gjë mund të ndodhë. S'është çudi që edhe të diktohem, edhe të na qëllonë me armë. Kini ndër mend këtë: Prapa s'kemi për t'u kthyer. Po na qëlluan, edhe shokët tanë do t'u përgjigjen me zjarr. Ne do të ecim përmes plumbave, gjallë, a vdekur, te kjo qeli s'do të kthehem më kurrë. A u morëm vesh?

TË GJITHË – Po.

AGIMI – Gati, pra! Ti Vangjo me Thomanë, që është brenda, do të kaloni të parët. Pas jush do të vijnë Skënderi e Petriti. I parafundit unë. Ti Fani qëndro rojë aty te porta gjersa të dal edhe unë. Para se të ikësh, shuaj dritën! Do të kalojmë me rregull, disa hapa larg njëri-tjetrit. Vendi i takimit, s'ido që të ndodhë, është varreza. Caktojmë dhe një parullë: «Fashizmi falimentoi». A u kuptuam?

TË GJITHË – Po.

AGIMI – S'kemi gjë tjetër? Jo? Dilni pra, me shpejtësi. Vdekje fashizmit!

TË GJITHË – Liri popullit!

(Dalin njëri pas tjetrit nëpër të çarën e murit.)

AGIMI – Tani më erdhi radha mua. Fani, ndihet gjë andej?

FANI – Heshtje varri.

AGIMI – Unë po dal. Ke radhën. Mos u vono! *(Del. Fani dëgjon me vëmendje, shuan dritën dhe rrëshqet nëpër të çarën e murit. Skena mbetet bosh për një çast.)*

MYRTEZAI – *(Nga jashtë.)* Kaushët për bukë! Njëshi, treshi, pesa, shtaça... shtatëmbëdhjeta!... Dane, merr këto bukë e shpjeri te kaushi shtatëmbëdhjetë.

DANIA – *(Nga jashtë.)* Si urdhëron! *(Zgjat kokën në kaushin e errët.)* Ej, vëllezër, merrni racionin! Agim, Petrit, Fani,.. merrni bukën!... Ku jeni, more? Po kjo pikë e zezë, s'duan as të përgjigjen. Mos vendosët të bëni grevën e urisë?... O gardian Myrtezai, po këtu flenë, mor jahu?

MYRTEZAI – *(Nga jashtë.)* Kush fle?

- DANIA – (Nga jashtë.) Shtatëmbëdhjetë!
- MYRTEZAI – (Nga jashtë.) S'është e mundur.
- DANIA – (Nga jashtë.) Kanë shuar edhe dritën...
- MYRTEZAI – (Nga jashtë.) S'është e mundur. Si u shuajtka drita. Është e ndaluar të shuhen dritat.
- DANIA – (Nga jashtë.) Ore, po këtu është errësirë fare.
- MYRTEZAI – (Nga jashtë.) Kushedi. Do t'u jetë djegur llamba e elektrikut. (Hapet porta. Hyn Myrtezai me elektrik dore i ndjekur nga Dania.)
- MYRTEZAI – Djalli t'u marrë, ku jeni? (Sheh të çarën në mur.) Ç'është kështu? Kanal?! Bo-booo! Kanë çarë murin! Kanë ikur. Oficer i rojës! Oficer i rojës! (I bie bilbilit.)
- DANIA – Ç'është, more gardian? Bre, bre? Kanë ikur! Hë m'u lumtë komunistëve! (Hyn oficeri italian me vrap.)
- OFICERI – Ç'ka ndodhur?
- MYRTEZAI – Të burgosurit e kaushit 17 janë arratisur!
- OFICERI – Edhe Agim Gura?
- MYRTEZAI – Të gjithë!
- OFICERI – Ma kome e posible? Kome?
- MYRTEZAI – Kanë çarë murin, këtu!
- OFICERI – Jepni alarmin! (Vërshellejnë bilbilat. Dëgjohen hapa që vrapojnë.) Rrethoni burgun! Të kapen, gjallë a vdekur! Gjallë a vdekur! (Dikush thërret: «Ndaa!» Dëgjohen dy krisma pushke.)

Perdja

AKTI I TRETË

Tabloja e tretë

*Në pyll, te Qafa e Pishave, është çeta partizane.
Po gdhin. Partizanët flenë rreth zjarreve. Vetëm
rojat janë zgjuar.*

SKËNDERI – Ndal! Mos luaj! Parullën!

AGIMI – Jam unë!

SKËNDERI – Qëndro në vend! S'të njoh! Parullën!

AGIMI – Partizani! Kundërparullën!

SKËNDERI – Përpara!... Tani po, afrohu!

AGIMI – Ti, Skënder, qenke, s'më njohë?

SKËNDERI – Të them të drejtën, si zë i njohur m'u duk.
Po unë, shoku komandant, bëra detyrën. Pa më
dhënë parullën, s'lejoj të kalojë njeri këtej.

AGIMI – Mirë ma punove. Vetë i kam fajet. Ç'kemi këtej?

SKËNDERI – Qetësi.

AGIMI – Flenë shokët?

SKËNDERI – Të gjithë, veç pleqve. Tani do t'i zgjoj Ben-
kon e Fanin se u erdhi radha për të zëvendësuar
rojat. Ti nga ishe?

AGIMI – Kontrollova rojat... Çdo gjë në rregull. Mund
të pushojnë shokët pa merak. Komisaren e pe?

SKËNDERI – Është atje, te guva, së bashku me shoqet.

AGIMI – Atje po shkoj. (Del.)

(Skënderi zgjon Fanin e Benkon.)

SKËNDERI – Çohuni, gjumashë! Erdhi koha e rojës.

FANI – Sa është ora?

SKËNDERI – Pesë. Po gdhin! Benko, o Benko! Zgjohu!

BENKOJA – Paskemi bërë gjumë, jo shaka. Bërrrr!

(Benkoja e Fani shkojnë e zënë vend mbi një shkëmb, ndërsa të tjerët flenë.)

FANI – Çfarë ke qejf të bëhesh, ti Benko?

BENKOJA – Komisar.

FANI – Mirë e ke menduar. Po që të bëhesh komisar, duhet të kesh ca gjëra. E para, si të ta them, ja ti ke sy të fortë, unë kam kokë të mençur, ne të dy duhet të jemi sa më tepër afër njëri-tjetrit. Unë të flas, ti të më dëgjosh e t'i futësh fjalët e mia në tru... Luan gjë andej?

BENKOJA – Do të jetë ndonjë lepur, që duke ndier që po gdhin, po kërkon ndonjë shtrofkë të sigurt.

FANI – E dyta, që të bëhesh komisar, duhet të hysh në shpirt të njerëzve, t'i drejtosh, t'i edukosh e t'i frymëzosh për luftë, për punë, për sakrificë. Të luftosh me trimëri po edhe me mend, me zotësi...

BENKOJA – Dale! Më duket se diçka lot aty përposh.

FANI – Unë s'dalloj gjë. Pa vëre re mirë.

(Pauzë.)

BENKOJA – S'ka gjë, jo.

FANI – Ç'duhet më?! Të mos kesh frikë nga vdekja, të durosh si yt vëlla të gjitha dhembjet e mëdha, të mendosh se edhe ti, je njeri, mund të vritesh... Ja, po i pate këto veti, je komisar i vërtetë.

BENKOJA – Shshsh! E di që është njeri. Shih si fshihet nëpër pemët. Ndonjë spiun, me siguri. Po vjen drejt nesh.

FANI – E pashë. Dale. Ti dili në atë krah e unë në këtë tjetrin. Qenka plak, apo më bëjnë sytë.

BENKOJA – Plak është, plak!

FANI – Lëre të afrohet edhe ca. Ndal! Duart lart! Parullën!

PLAKU – E, ore, ç'pëllisni: kështu? Ç'kërkoni?

FANI – Ty të duam.

PLAKU – A, prandaj m'u qepët si rrodhe. Domethënë, më zutë rob, më rrethuat e unë s'kam nga t'ia mbaj tani.

BENKOJA – Lëri fjalët, xhaxho, dhe përgjigju pyetjeve.

PLAKU – Xhaxho, xhaxho! Spurdhjak! Hiqe atë armë nga turinjtë e mi!

FANI – Pa na u përgjigj: Ku shkon natën nëpër pyll në këtë kohë lufte? Ç'nuhat dhe cilin ndjek në këto monopate?

PLAKU – S'ju them asgjë.

BENKOJA – Ç'e zgjat, o shoku Fani, futi gjysmën e lekut. S'e sheh që është spiun.

PLAKU – Ti, qurravec, mbaj gojën! (Teshtin.)

FANI – Shëndet!

BENKOJA – Ti mos teshtit, po përgjigjiu pyetjeve, si plak njeri që je. Ç'kërkoni në pyll, natën, duke e ditur që këtu ka partizanë?

PLAKU – Ç'të ka pjellë i ziu yt atë kaq hajvan! Po këtë s'e kuptoni? Doni të dini se kush jam? Jam komandanti i njësitit vullnetar të fshatit këtu pranë, nën Qafën e Pishave.

BENKOJA – Po kështu të na thoshe që në fillim, o xhaxha!

PLAKU – E ku të lini ju të merresh vesh.

FANI – Po shokët e njësitit ku i ke?

PLAKU – Ja o, u kam ju, band'llët. A, u kripsha mendtë! Po unë kam qenë edhe me Mihalini e me Çerçizin, more tuafë! Ku është shtabi? Më shpini drejt e në shtab se kam punë me rëndësi, e jo llafe.

FANI – Shpjere, o Benko, sipas rregullave, pa le të thotë ç'të dojë ai.

PLAKU – Po a keni nuhatje ju. Nuk nuhasni gjë? Asgjë. Po çfarë partizanë jeni, kur u mungon kryesorja, nuhatja. Në dy fshatrat poshtë kësaj qafe erdhën gjatë natës ushtarë nazistë dhe ballistë. Ballistët i drejton Tosun beu. Kanë zënë shtëpinë e kodrave dhe përgatiten për sulm. Kanë vendosur të dje-

gin dy fshatrat, t'i bëjnë rrafsh me tokën, shkru mb e hi që të vënë mend të tjerët. Ja, për këtë kam ardhur që të ngriheni e t'u bini menjëherë. Shtigjet jua tregojmë ne. A keni shkrepëse a çakmak? M'u ça hunda për duhan.

BENKOJA – S'lejohet këtu të ndezësh shkrepëse. Duro edhe pak, sa të vemi gjer te guva. Ec përpara, xhaxha! Atje janë shokët e shtabit. (*Dalin Benkoja e plaku. Partizanët fillojnë e zgjohen.*)

SKËNDERI – Po ti, o Thoma, zgjuar qenke?

VANGJELI – Zgjuar është, po s'i hapen sytë.

PETRITI – Mos ke parë ndonjë ëndërr tjetër?

THOMAI – E gjete. Sikur hymë në Tiranë, në një pallat, u dendëm me tërë të mirat e pastaj u shtrimë mbi dysheqe tri pëllëmbë.

SKËNDERI – Prandaj s'ta do shpirti të ngrihesh, se të duket sikur je mbi dyshek të butë, me pupla.

THOMAI – Veç asaj, po mundohem t'i mbyll sytë, se mos kushedi më zë gjumi e shoh përsëri atë qengjin e pjekur që pashë ëndërr.

PETRITI – Hajt, se edhe qengjin do ta hash. Ngrehu!

THOMAI – Ama edhe ëndrrat diçka të vërtetë kanë, gjersa më sillen natën nëpër sy.

(*Një pjesë e partizanëve dalin për t'u larë. Hyjnë Agimi, Liria, plaku, tre komandantë kompanie.*)

AGIMI – Kështu. Sipas lajmeve që na solli komandanti i njësitit vullnetar, hitlerianët kanë ndër mend të ndëshkojnë krahinën tonë. Në ndihmë të tyre është dhe Tosun beu me forcat e veta.

LIRIA – Ku janë përqendruar repartet e tyre?

PLAKU – Sërtit të kodrave, mbi të dy fshatrat.

LIRIA – Duhet t'i sulmojmë e t'u rrëmbejmë iniciativën.

AGIMI – Patjetër. Mblidhni kompanitë, u sqaroni situatën dhe bëhuni gati për rrugë! E para do të presë rrugën nga mund të tërhiqen. E treta do të sulmojë në befasi. E dyta rezervë. E qartë?

(*Komandantët e kompanive shpërndahen duke thirrur.*)

- KOMANDANTI 1 – Kompania e parë, mblidhuni! (Del.)
- KOMANDATI 2 – Kompania e dytë, pas meje! (Del.)
- KOMANDANTI 3 – Kompania e tretë, këtu! Shoqja komesare, ku do ta bëjmë mbledhjen e komonistave?
- LIRIA – Lajmëroi shokët të mblidhen te shpella. Po shpejt, ama.
- KOMANDANTI 3 – Si urdhëron, shoqja komesare! (Del.)
(Shtohet lëvizja. Partizanët vrapojnë te kompanitë e tyre.)
- LIRIA – Do t'u them shokëve të kenë kujdes që të mos na përsëritet ajo që na ndodhi në fillim të muajit. I dëmtuam rëndë nazistët, po patëm shumë humbje. S'kishim pasur ndonjëherë aq humbje.
- AGIMI – Ishte natë. Ndodhin në luftë këto.
- LIRIA – Mos e bëjmë si Leloja, që e futi skuadrën në grykë të mitralozit dhe, kur e kuptoi, shkoi e u hodh vetë mbi të.
- AGIMI – Ishte trim. Ç'ta kritikojmë! Ai s'është më e s'na dëgjon.
- LIRIA – Por, shoku Agim, puna është që pësimi të na bëhet mësim. Leloja ishte trim. Po, edhe të vdekurve s'u falet gabimi.
- AGIMI – Ke të drejtë, shoqja komesare.
- LIRIA – Për atë të drejtë luftojmë, shoku komandant...
- FANI – (Nga vendi i rojës.) Ndal! Ku shkoni?
- BALLISTI 1 – Në shtab.
- FANI – Çfarë jeni ju?
- BALLISTI 2 – Ballistë!
- FANI – Ç'doni në shtab?
- BALLISTI 3 – Kemi për të dorëzuar një urdhër të Tosun beut. (Afrohen Liria e Agimi.)
- AGIMI – Lëri të vijnë, Fani!
- FANI – Ballistë, eoni përpara!
(Hyjnë të tre ballistët. Ballisti i parë është veshur me çizme e xhakëtë lëkure dhe armët i vetëtijnë. Dy të tjerët janë fshatarë të thjeshtë me qeleshe.)
- AGIMI – Ç'erë ju solli këtu?
- BALLISTI – Vijnë me porosi të Tosun beut.
- AGIMI – A, të Tosun beut!

BALLISTI 1 – E njihni?

AGIMI – Po si jo? Më dhëmbë e dhëmballë.

BALLISTI 1 – Aq më mirë!

LIRIA – Pa hë, t'ju dëgjojmë: ç'porosi ju ka dhënë Tosun beu?

BALLISTI 1 – Krahina është mbushur me trupa gjermane. Komandanti superior i tyre ka paralajmëruar se, po të goditen nga partizanët, do ta bëjnë shkumb e hi tërë këtë krahinë. Prandaj Tosun beu ju bën thirrje juve, që t'i lini të qetë gjermanët e të mos i godisni. Ndryshe, po u zutë pritë, atëherë edhe ai me trupat e tij do të detyrohet t'u bjerë partizanëve nga krahët e nga shpina.

AGIMI – Bravo i qoftë Tosun beut! Po këtë kërcënim e kemi dëgjuar disa herë, edhe kur ishin fashistët italianë. I thoni se partizanët nuk marrin urdhra nga Tosun beu, po nga Shqipëria, nga populli e nga Partia. Ne do t'i luftojmë nazistët kudo që të jenë. Dhe Tosun beu, po të guxojë të shtjerë kundër nesh, ta dijë mirë se partizanët do të jenë kundër tij të pamëshirshëm. E qartë?

BALLISTI 1 – Shumë e qartë. Na falni. Ne bëmë detyrën. Po largohemi, po ju lutemi, jepni urdhër se mos na gjuajnë prapa krahëve.

AGIMI – Partizanët nuk janë ballistë dhe nuk gjuajnë prapa krahëve. Mund të largoheni pa merak.

LIRIA – E, more të humbur e të gënjyer. Po ju, përse i mbani ato armë?

BALLISTI 1 – Për të luftuar.

LIRIA – Përse luftoni?

BALLISTI 1 – Për liri?

LIRIA – E kundër kujt?

BALLISTI 1 – Po ja, kundër të huajit e tradhtarëve...

LIRIA – Po ju të huajin po e mbronni dhe do të na godisni ne që e luftojmë. Si ta kuptojmë këtë? Del se të huaj për ju s'ka, kurse tradhtarë qenkemi ne. Edhe ju kështu mendoni? (Ballistët mbledhin supet.)

AGIMI – Po a na paralajmëruat se po të sulmojmë gjermanët, Tosun beu do të na godasë nga krahët!

Edhe ju të dy kështu mendoni? Flisni, more, pse heshtni? (*Ballistët 2 e 3 mbledhin supet.*)

AGIMI – Po mirë, ja ta zëmë se edhe ju e luftoni nazimin. Ti, zotni, (*Ballistit 1.*) me ato armë të lara që paske, sa gjermanë ke vvarë?

BALLISTI 1 – Unë... nuk i harxhoj fishekët bosh... Unë jam udhëheqës shpirtëror i ballistëve.

LIRIA – Aa! Udhëheqës shpirtëror. Si shenjt! S'i lyen duart me gjak. Po kundër nesh edhe mund t'i përdorni ato armë!

BALLISTI 1 – A, jo. Atë mos e thoni! Akuzë e kotë!

AGIMI – Po me ç'armë do të luftoni kundër nesh? Me duart e kujt do t'i zbrazni armët? Me duart e këtyre?! Flisni, more? A dëgjoni? (*Ballistëve 2 e 3.*) Ju do të shtini kundër nesh?

BALLISTI 2 – Unë, ore byrazer, kundër vëllezëve të mi nuk luftoj. Po që kundër hasmit, po.

AGIMI – S'ndahet vëllai me vëllanë...

BALLISTI 1 – (*Shokëve të tij.*) Ju mbylleni gojën! Edhe porosinë e keni që ta mbyllni!

AGIMI – E shikoni? (*Ballistit 1.*) Ti do të luftosh kundër nesh së bashku me Tosun beun, por pa këta, pa popullin. Vetëm ju do të luftoni, se jeni bythë e brekë me nazistët.

LIRIA – Nuk e kuptoj, ç'shpresë ju mban gjallë e ku ju shpie mushka. Ju ecni në qorrsoak, në rrugë të gabuar, në rrugën e tradhtisë... Po tradhtinë ne e dënojmë me vdekje. Edhe ju vdekja pa lavdi u pret.

BALLISTI 1 – I kemi marrë parasysh të gjitha. Edhe në u vrafshim, vritemi për atdhe dhe historia do të flasë për ne.

LIRIA – Sigurisht, historia do të flasë edhe për tradhtinë. (*Pauzë.*)

AGIMI – Ikni tani! Përgjigjen e morët! (*Ballisti 1 del si kapadai. Dy të tjerët vonohen, kthejnë kryet, duket sikur duan të qëndrojnë.*)

BALLISTI 2 – Vdekje fashizmit, o shokë! (*Del me gjithë ballistin 3.*)

LIRIA E AGIMI – Liri popullit!

AGIMI – Sa drejt e ka Partia, kur na porosit që të tregojmë kujdes të madh në lidhje me Ballin Kombëtar, të ndajmë krerët nga njerëzit e thjeshtë që janë gënjer, si këta të dy. Sa drejt, sa drejt!

LIRIA – Për atë të drejtë luftojmë, shoku Agim! Shkojmë te shpella se na presin shokët komunistë.

AGIMI – Shkojmë! Dhe duhet ta rishikojmë planin e sulmit, se ka shumë mundësi që të biem midis dy zjarresh. E ndiej se kësaj radhe do të përgjakemi me Tosun beun. *(Dalin. Pauzë.)*

BENKOJA – Bie erë luftë. Me sa duket, nesër, ndaj të gdhirë, do të kërcasë. Jam i gëzuar, se do të shoh prindërit, nënën...

PARTIZANI 1 – Janë larg gjermanët që këtu?

BENKOJA – Ç'ne, bre! Pas këtij pylli me pisha është fshati im.

PARTIZANI 1 – Po ku janë, a janë shumë larg?

BENKOJA – Po ti s'më dëgjon ç'them? Pas këtij pylli me pisha, domethënë para hundës i kemi.

PARTIZANI 1 – Jo, more?

BENKOJA – Ç'hidhesh kështu! Kujtova se ke qejf që të jenë sa më pranë, kurse ti dashke që të jenë sa më larg.

PARTIZANI 2 – Është i ri ai, Benko. Sa ka ardhur në batalion. Po kjo mund të ndodhë edhe me të tjerët. E kupton, çunak?

BENKOJA – Mos më thuaj çunak.

PARTIZANI – Po si të të them, burrë me mustaqe?

BENKOJA – Partizan.

PARTIZANI 2 – Partizan i vogël, atëherë. Merrjani, shokë! *(Këndojnë.)*

*Ke marë pushkën ke dalë për liri vatan
Dhe fshatari nga vatra ty s'të ndan,
O i vogël, o partizan!...*

PARTIZANI 2 – Kryesorja është që moralin e kemi të ngritur, sytë na vetëitjnë nga guximi, jemi të çelur

e të gëzuar, edhe zërin e kemi si të bilbilit. Dome-
thënë, jemi luftëtarë të vërtetë. Vetëm urdhër presim
që të nisemi. Dhe ti, Benko, përgatitu të na pre-
sësh në shtëpinë tënde me ç'të të ndodhet.

BENKOJA – Ta çlirojmë fshatin, pa di unë si ju pres, me
pula e me qengja...

PARTIZANI 3 – Mos e zgjat, më, se po më lëshon goja
lëng e po më bie të fikët. (*Bën sikur i bie të fikët.*)
Ah, unë i ziu, që jam i varfër. Ah, unë i ziu, që
s'kam para!

PARTIZANI 2 – Shkruaju polic e të kesh para, bile edhe
pushtet, edhe bark të madh që të hash sa të
pëlçasësh?

PARTIZANI 3 – Shkruaju vetë, se ty të pëlqen të japësh
urdhra, e të hash e të pish sa për shtatë. (*Qeshin.*)

PARTIZANI 2 – Shokë, bëjmë shaka e qeshim, se shpirtin
e kemi të pastër. Jemi në luftë të drejtë dhe ajo
na ka bërë më të mirë na ka kalitur karakterin, na ka
hequr ndryshkun, na ka bërë ta çmojmë shoqërinë,
dashurinë, jetën.

KOMANDANTI 3 – (*Nga jashtë.*) Kumpania e tretë, gati
për rrugë! (*Hyjnë Agimi, Liria etj.*)

AGIMI – Shokë partizanë! Po nisemi për luftë. Do t'i
sulmojmë nazistët që kanë ardhur për të djegur
e shkatërruar krahinën tonë. Përpara, shokë, në
sulm, si gjithnjë. Pushka top! Vdekje fashizmit!

TË GJITHË – Liri popullit!

TË GJITHË – (*Duke dalë këndojnë.*)

*Ato maja ripa-rripa seç gjëmojnë
Ndizet lufta për liri e derdhet gjak
Janë trimat partizanë që luftojnë
Janë bijt' e Shqipërisë që marrin hak.*

*(Kënga vazhdon me perde të mbyllur. Tingujt
përzihen me krismën e armëve dhe me thirrjet:
Para partizanë!)*

AKTI I KATËRT

Tabloja e katërt

Oborri i shtëpisë së Lim Gurës, si në aktin e parë. Shtëpia është djegur. Nga jashtë dëdëgjohen të shtëna armësh, që sa vijnë e rrallohen. Në oborr janë Limi, Tixhja, Agimi, Petriti, robër gjermanë e ballistë, partizanë që hyjnë e dalin, fshatarë.

AGIMI – Qëndresa e tyre u thye krejtësisht që në fillim, se sulmi u bë i shpejtë e i befasishëm. Po të mos na kishte goditur pas shpine Tosun beu, do t'i kishim zënë të gjithë robër.

HAIROJA – Domethënë, e zhveshi shpatën ai maskara. Po i tillë ka qenë ai tërë jetën. E ku është? Iku?

AGIMI – E kanë rrethuar në një zabel, xha Hajro, zor se shpëton. Do ta zemë të gjallë, po s'ia hoqi vetes.

LIMI – S'është nga ata burra, ai, që t'ia heqë vetes. Për të djegur e për të vrarë, po.

TIXHJA – Bir i nënës! Trimat e nënës!

LIMI – Lëri lotët tani. Mbahu, se s'ka lezet. Të është bërë yt bir kumandant.

TIXHJA – Po ai i vogli i nënës, ku është futur?

PETRITI – Benkoja tani vjen, nënë. Është rritur, është zgjatur, është bërë goxha djalë!

THOMAI – Shoku komandant, solla edhe këta robërit ballistë. Ç'të bëjmë me ta?

AGIMI – *(Njeh ballistët 2 e 3.)* Po ju?

BALLISTËT – *(Me një gojë)* Ne u arratisëm.

BALLISTI 2 – Luftuam edhe kundër gjermanëve, po pushkët na i morët. Kjo s'është e drejtë.

AGIMI – Kush i çarmatosi këta të dy?

THOMAI – Unë.

AGIMI – Po pse? S'i pe që luftonin kundër gjermanëve?

THOMAI – I pashë, o shoku komandant, i pashë. Po u pashë edhe shqiponjat në kapelë. S'i kanë hequr hequr akoma. Vetë i kanë fajet.

BALLISTI 2 – Ne u dorëzuan vullnetarisht. Se duhet ta dini që, nganjëherë njeriu, edhe kur përpiqet të bëjë mirë, gabon. Kështu ngjau me ne. Thënë se ballistët luftojnë për liri dhe shkuam pas tyre. Gabuam. Tani erdhëm në të drejtën. Na jepni armët dhe nga një yll e na pranoni partizanë.

AGIMI – Shoku Thoma, jepu armët dhe nga një yll.

THOMAI – Armët po, urdhëroni! *(Ua jep.)* Yje s'ka intendenca. Njëri të marrë yllin tim *(E shqep.)* dhe tjetri të Skënderit. *(Ia shqep nga kapela edhe atij dhe ua jep ish-ballistëve. Ata duan t'i heqin shqiponjat.)*

AGIMI – Mos i hiqni shqiponjat, mos i hiqni. Qepni yllin mbi to.

BALLISTËT 2 e 3 – Ju falemi nderit! Vdekje fashizmit!

AGIMI – Liri popullit! Thoma, merri në kompaninë e parë!

THOMAI – Si urdhëron! Ejani, shokë, me mua! *(Dalin të dy ish-ballistët e Thomai.)*

LIMI – *(Me vete.)* Sa mirë bërë, ore bir!

AGIMI – Po ju të tjerët. Ç'të bëjmë me ju? A e dini se keni bërë tradhti ndaj atdheut e popullit? *(Ballistët heshtin, kokulur. Pauzë.)*

BALLISTI 4 – U qorollisëm, si të verbër. Shtimë edhe mbi tanët e tanët mbi ne. Na i mori perëndia mendtë. Dëgjuam djallin! Jemi fajtorë!

AGIMI – E kuptoni gabimin e madh, apo jo?

DISA BALLISTË – E kuptojmë.

AGIMI – Edhe e pranoni?

BALLISTËT – E pranojmë.

AGIMI – Atëherë si t'ju quajmë ju?

DISA BALLISTË – Tradhtarë?

AGIMI – E ç'të bëjmë me ju?

BALLISTI 4 – Gjyq.

AGIMI – Si të quajmë ty? Nga je?

BALLISTI – Zeqo më quajmë. Jam nga Bregu.

AGIMI – Përse shkove me Tosun beun?

BALLISTI 4 – Më premtoi tokë, qe e dhen.

AGIMI – Të dha gjë?

BALLISTI 4 – Jo. Më tha se do t'i japë kur të shfarosen partizanët.

DISA BALLISTË – Edhe ne me këto llafe na gënjeu.

LIMI – Kur të pjellë mushka ua jep Tosun beu!

HAJROJA – A, ç'është ai more, ç'është ai! Do pjekur i gjallë në hell!

AGIMI – Dëgjoni, more të humbur. Patët fat që s'u vratë si ata shokët tuaj që mbetën ferrave. Edhe ne e kuptojmë që u kanë gënjyer, prandaj do t'ju lirojmë. Kush të dëshirojë le të vijë me ne. Po ta dini, po të shkoni më me Ballin e t'ju zëmë, plumbin kokës do t'jua japim! Shpërndahuni! Shkoni nëpër shtëpi e u thoni grave, fëmijëve e njerëzve tuaj se partizanët luftojnë për çlirimin e Shqipërisë, e jo njerëzit si Tosun beu e shokët e tij!

(Një pjesë e ballistëve dalin. Të tjerët qëndrojnë me dy mendje. Agimi u drejtohet robërve gjermanë. Midis tyre ka të plagosur me duar e kokë lidhur me fasha.) Oficerët tuaj janë përgjegjës për këtë gjakderdhje. Po edhe ju, ushtarë, s'jeni të larë. S'e shihni ku u katandisi Hitleri e nazizmi i tij. Largojini që këtej!

(Zëra ushtarësh.)

AGIMI – A, tani e zgjidhët gjuhën!... Mos kini merak. Nuk do t'ju pushkatojmë. Por do t'ju dërgojmë në thellësi të maleve, të punoni që të nxirrni bukën e

gojës që s'na mjafton as për vete, gjersa të përmbysim nazizmin e t'ju nisim në vendin tuaj. (Dy partizanë i vënë përpara e dalin së bashku me ta. Armët reshin. Nuk dëgjohet më asnjë krismë.)

NJË ZË GRUAJE – (Nga jashtë.) Oj, oi, Tosun beu na dogji! Tosun beu na vrau fëmijët! Vaj, vaj! Dii! moj Tixhezeza e shih Benkon tënd!

TIXHJA – Ç'është ky vaj? Kush qan kështu? Benko, Benko! (Del së bashku me disa fshatarë. Pauzë. Dëgjohet edhe vaji i Tixhes. Limi e Agimi vrapojnë gjer mbanë skenës dhe aty duken sikur ngrijnë. Hyn Liria me Benkon e gjakosur në krahë e shoqëruar nga partizanë e popull.)

AGIMI – Gjallë?

LIRIA – Është plagosur.

AGIMI – Rëndë?

LIRIA – Rëndë!

AGIMI – Benko! Benko! (E ulin. Mbi të përkulen Tixhja, Limi, Agimi e Liria.)

BENKOJA – (Me vështirësi.) E sheh? S'e mbrojta veten, o komandant!

AGIMI – A ke dhimbje, Benko?

BENKOJA – Jo... (Pauzë.) Komisare! Mbjaj mend kur më the se jeta do të bëhet e bukur...

LIRIA – S'të kam gënjyer, Benko. Të kam thënë: ki pak durim, sa t'i mundim armiqtë...

BENKOJA – Unë s'pata durim... s'më pritej sa të vinte ajo ditë... ...Ajo ditë e bukur, nënë!... (Benkoja mbaron. Heshtje. Partizanët heqin bustinat. Pauzë e gjatë.)

TIXHJA – O i bukuri i nënës! Të ka marrë plumbi mu në gji! Hallall qumështin!

LIMI – Mu në gji e mu në ballë, o trim i babait! (E ngrenë Benkon.)

TIXHJA – Është luftë, o xhan! S'kemi as kohë të të qajmë si duhet.

LIRIA – Benko, hakun do ta marrim!

TË GJITHË – Do ta marrim! (Partizanët zbrazin një bre-shëri dhe dalin së bashku me të vvarin. Dëgjohet kënga:

Po ngrihet një zë nga fundi i varrit
Si dielli kur shkrep e hapet mbi dhé:
— Hakmarrje, hakmarrje, në grykë barbarit,
Përpara, o popull, mbi të si rrufe!

Hakmarrje, rini!
Dëshmori thërret
Që ra për liri
Në truallin e vet!

Pas këngës, partizanë e fshatarë, hyjnë të heshtur.)

AGIMI — Si ndodhi? Si u vra? Ku?

LIRIA — Te zabeli. I shkoi Tosun beut fare pranë dhe i thirri: «Dorëzohu, more derr, se s'ke shpëtim!» «Kush je ti?» — e pyeti ai. «Xhebrail Emini, — iu përgjigj Benkoja, — kam ardhur të të marr shpirtin e të ta shpje në xhehenem!» Atëherë u zbraz automatiku. S'e kishte vënë re, që së bashku me Tosun beun, ishte edhe Latifi. Ai e vrau. Kur u turrëm ne, çdo gjë kishte marrë fund. E gjetëm mbi Latifin e vrrarë! Kurse beun e zumë të gjallë. Ja ku po e sjellin shokët. *(Hyjnë disa partizanë me Tosun beun. Fshatarët mezi përmbahen. Ngrënë grushtet për ta goditur. Partizanët mezi vënë rrugull e qetësi.)*

LIRIA — Ngrehu t'i bëjmë gjyqin!

AGIMI — Gjyqin le t'ia bëjnë fshatarët. Ja, ai më i vjetri i katundit. Është edhe kryetar i këshillit nacionalçlirimtar. Le ta gjykojë populli.

LIRIA — Mirë, shumë mirë! *(Tosun beut.)* Tradhtar! Ky plak e ka moshën për të qëndruar në shtëpi, pranë zjarrit. Por, me gjithë moshën e madhe, lufton edhe ai me fashistët e me tradhtarët. Kurse ti u bërë zagari i të huajit dhe tani duhet të japësh hlogari para gjyqit të popullit. *(Kryetarit të këshillit nacionalçlirimtar.)* Shoku kryetar, gjykojeni dhe jepini vendimin sipas krimeve që ka bërë.

KRYETARI — Tosun bej, jemi në luftë dhe gjyqi bëhet i shpejtë e i shkurtër. Të njohim se kush je e ç'krime

ke bërë, po, megjithatë, do të të gjykojmë sipas ligjeve të reja të Nacionalçlirimtares. Përgjigju: Përse shkove kundër popullit?

TOSUN BEU – Unë kundër popullit?! Unë s'kam shkuar kurrë kundër askujt.

KRYETARI – Mos u mundo të na hedhësh hi syve, se të njohim ç'gjellë je. Përse shkove kundër partizanëve?

TOSUN BEU – Më vraftë zoti, këtu ku jam, në kam shkuar kundër tyre. As me fjalë e as me mend s'kam shkuar.

KRYETARI – E rëndon veten më shumë duke gënjyer. Përse e dogje fshatin? Përse e shkretove? Pa shiko si e ke bërë! Përse vrave fshatarë, burra, fëmijë?

TOSUN BEU – Kurrën e kurrës? Ato i bënë ushtritë fashiste dhe naziste...

ËHIRRJE NGA POPULLI – Në plumb, të mallkuarin! Ma dogji fëmijën në zjarr duke e mbajtur varur nga këmbët. Oi, oi! Çfarë shëmtie është ky!

– Na ka shtypur e na ka pirë gjakun ky, i ati dhe i gjyshi, denbadaden!

Ta varim nga këmbët! –

Ta lyejm me benzinë e t'i vëmë shkrepësen!

KRYETARI – E dëgjon ç'thotë populli?

TOSUN BEU – Me gjithë mend do të më vrisni?

KRYETARI – Shqipëria pastrohet dhe populli forcohet, kur vret tradhtarët.

TOSUN BEU – Me gjithë mend e keni?...

KRYETARI – Po ç'kujtove, se do të falemi për ty akoma. Iku ajo kohë, bej!

TOSUN BEU – Falmëni e do të bëhem me Nacionalçlirimtaren, do të luftoj kundër të huajve, do të çliroj tërë krahinën, do t'ju jap tokat, bagëtinë, pyjet.

KRYETARI – Ç'na takon, e marrim vetë... Dhe ti s'mund të bëhesh me Nacionalçlirimtaren, se i ke lyer duart me gjak. Në votë: Kush është për pushkatim?

TË GJITHË – Në plumb! (Ngrenë duart.)

KRYETARI – Merrni qenin dhe mbaroni punë shpejt!

TOSUN BEU – Pse? Kështu do të vdes unë? Si qen?

KRYETARI – Si qen! (*Disa partizanë e tërheqin dhe dalin së bashku me të, të ndjekur nga disa fshatarë.*)

AGIMI – Vëllezër e shokë! Si partizanë të popullit ne po e kryejmë detyrën me nder e lavdi! Me Partinë Komuniste në krye, ne do të ecim gjithnjë përpara, do t'i mundim pushtuesit e tradhtarët dhe, me gjakun e dëshmorëve, mbi këto gërmadha që na la armiku, do të ndërtojmë Shqipërinë e lirë, Shqipërinë popullore!

KRYETARI – Rrofshin partizanët!

TË GJITHË – Urraaa! Urraaa! Urraaa!

(*Midis brohorimave dëgjohet kënga:*)

*Zëri pushkës me furi,
Po buçet sot anëmbanë,
Se luftojnë për liri
Shokët trima partizanë.)*

Perdja

Labinot, tetor 1944

**STINA
E KUQE.**

dramë

1974

Personazhet

BAKIU – kryetari i këshillit nacionalçlirimtar krahinor

METI – i biri, partizan

NERKA – gruaja e Metit

PANDI – student, i plagosur

PËLLUMBI – anëtar i këshillit nacionalçlirimtar

CETKA – Infermiere partizane, e fejuara e Pëllumbit

GJERGJI – anëtar i këshillit nacionalçlirimtar

DANIA – anëtar i këshillit nacionalçlirimtar

GJYSHI – anëtar i këshillit nacionalçlirimtar

GIYSHJA – e shoqja

ARISTIDHI – kujdestari i manastirit

KOSTAQI – tregtar i vogël

EARNISI – kolonel angez

XHEVDET FRASHËRI – komandant i Ballit Kombëtar

MURATI – ballist

HAJREDINI – ballist

MYLERI – kolonel gjerman

GRABNERI – ushtar gjerman

SHULCI – nënoficer gjerman

HERMANI – oficer gjerman

Të plagosur, partizanë, fshatarë, gjermanë, ballistë

PJESA E PARË

Tabloja e parë

Skena paraqet një manastir në një zonë malore të çliruar, të cilin partizanët e kanë kthyer në spital, në depo armësh, depo bereqeti, depo veshmbathjesh dhe në qendër të këshillit nacionalçlirimtar krahinor. Në plan të dytë, në të djathtë, ngrihet kambanorja. Hyrja e saj në formë harku e me disa shkallina në brendësi të ngjit lart në dritaren e tretë, që është kthyer në pikë vrojtimi. Në qendër të skenës është ndërtesa kryesore dykatëshe. Në katin e parë janë bodrumet që shërbenin dikur si stalla, tani janë kthyer në depo; më vonë gjermanët do ta përdorin si burg. Shkallët e drunjtja, që mbështeten mbi hyrjen kryesore të bodrumit, edhe kjo hyrje në formë harku, të shpien në katin e sipërm, në bujtinat, që janë kthyer në dhoma dhe për të plagosurit e për personelin që shërben. Në korridorin e gjatë; karakteristik për manastirët, duken tri dyer. Në fakt, vetëm dera e parë të çon në një dhomë të thjeshtë me dritare nga e majta, që vërshojnë jashtë godinës. Dhoma është e palyer, me mure të plasaritura. Në murin përballë bien në sy katër shkronja kapi-

tale V.F.L.P. të gërryera keq. Ka një krevat portativ, një tryezë, dy stola dhe një telefon të markës më të vjetër mbi tryezë. Dera e dytë dhe dera e tretë, që do të përdoren gjatë shfaqjes, të japin vetëm idenë e dhomave. Në sfond, midis kambanores dhe ndërtesës duket një pjesë fasade e kishës së vogël me derën karakteristike, kishë e kthyer në depo e vendbanim. Në të majtë të shkënës, jashtë mureve të manastirit, janë disa varre të braktisura, një pemë e madhe, gati e zhveshur, dhe në sfond malet e ashpra ngarkuar me re të zeza.

Është mëngjes herët. Mezi duket. Bie shi dhe herë-herë vetëtin. Në oborr është rojë Gjergji. Nga dritaret e dhomës së parë futet drita e zbehtë e agimit dhe mezi dallohen njerëzit që flenë, njëri në krevat e të tjerët në dysheme. Nga dera e kishës hyn Aristidhi.

ARISTIDHI – A ka gjë, Gjergji?

GJERGJI – Qetësi.

ARISTIDHI – Kur e more rojën?

GJERGJI – Kur filluan bubullimat dhe shiu.

ARISTIDHI – Thonë se gjermanët do të vijnë edhe në këto anë. Nuk dëgjove gjë zhurmë makinash?

GJERGJI – Sa mund të jetë ora?

ARISTIDHI – Yjet janë mbuluar nga retë. Po, ma thotë mendja, se po gdhin.

GJERGJI – Ti je si sahat, Aristidh. Kur ngopesh ti me gjumë, do të thotë se nata mori fund.

ARISTIDHI – Më parë flija më shumë dhe gjumin e bëja të rehatshëm. Tani shoh ëndrra të këqija. Tërë natën sonte më buçisnin veshët, dëgjoja zhurmë të thellë makinash dhe u zgjova shumë herë nga makthi. Ti nuk dëgjove gjë?

GJERGJI – Fle zbuluar, Aristidh. Mos fli zbuluar!

ARISTIDHI – Ke të drejtë. Kokën e vë në altar. Kam gurin e shenjtë në vend të jastëkut. Mbulohem vetëm me këtë pallto që kam veshur.

GJERGJI – S'ke ç'i bën! Kohë luftë!

ARISTIDHI – Do të durojmë... Domethënë, ti nuk dëgjove zhurmë makinash. Po gjer në ç'orë vazhdoi mbleja mbremë?

GJERGJI – Gjer pas mesnate. Vendosëm të dërgojmë Pëllumbin për bisedime. Të shohim ç'do të dalë. Mbase arrihet marrëveshja. Bashkimi bën fuqinë, thonë të moqmit. A ke zjarr?

ARISTIDHI – T'u ça hunda për duhan?

GJERGJI – Këtë farmak s'e vija në gojë më parë. Me të dalë partizan, e mësova.

ARISTIDHI – (*Shkrep çakmakun.*) Nga merak, ore çun, nga merak dhe hidhërimi... domethënë, nuk dëgjove zhurmë makinash. Më paskan bërë veshët. Po dal njëherë të shoh përreth manastirit.

GJERGJI – Mos i thuaj më manastir, Aristidh!

ARISTIDHI – Ka disa vjet që ky manastir më mban me bukë. S'i them dot ndryshe, ore çun. (*Del nga ana e kambanores. Gjergji duke thithur cigaren, del nga varret e braktisura. Në dhomë hyjnë rrezet e para të agimit. Aty janë Cetka, Pandi, Bakiu, Dania dhe gjyshi që fle ende në qoshe.*)

PANDI – (*Shtirë në krevat.*) Cetkë, më duket se u gdhi.

CETKA – Fli edhe pak! Ty të bën shumë mirë gjumi. (*I vë dorën në ballë.*) Ke temperaturë, Pandi. Sot do të rrih shtrirë. Ajri është tërë lagështi dhe bën ftohtë. Nuk të lejoj të ngrihesh.

PANDI – (*Duke hequr batanijen.*) Unë kam aq fuqi, sa të ngjitem vetë gjer te vendi i rojës...

CETKA – Prit! Mos bëj marrëzi! Po u tërhoqe zvarrë, mund të të hapen përsëri plagët.

DANIA – Mirë thotë Cetka, Pandi!

PANDI – Mërzitem kur rri shtrirë. Atje, të paktën, bëj një punë. Shoh me dylbi gjer përtej urës dhe vrojtoj çdo lëvizje. Po s'bëra gjë, mendjen do ta kem vetëm te këmbët, dhe kjo është e tmerrshme, më kuptoni? E tmerrshme! (*Vë në kokë kasketën e liceistit.*)

CETKA – Pije këtë aspirinë! Qetësohu njëherë! (*Pandi e pi.*)

- BAKIU – Mos e mërztini studentin. Le të bëjë si të dojë.
- PANDI – (Cetkës.) E dëgjon ç'thotë kryetari? Vetëm ai ka besim tek unë. Ju të tjerët s'vleni gjë!... Ç'pret? Zbato urdhrin!
- CETKA – Vishu mirë! Mbështillu me shall! (Ia vë shallin në qafë.) Vish edhe pallton se të grin era atje lart.
- BAKIU – (Cetkës.) Si është Nerka?
- CETKA – Pas mesnate u zgjua. Thashë se filloi. Po dhem-bjet e lanë shpejt. Tani është fare e qetë. Unë them se ajo s'e ka kohën. Ka harruar të numërojë. Me siguri, e ka nga tronditja.
- DANIA – Mirë si duron. Ajo doli nga flakët e shtëpisë dhe kaloi përmes plumbave. Qenka e fortë!
- GJYSHI – (Zgjohet.) Ngrysu-gdhihu! Ngrysu-gdhihu dhe lëmshka mbështillet. Përse fjaloseni? Këta drej veshë më janë vulosur fare!
- PANDI – Na paska ardhur një mysafir i ri sonte! Kush është ky?
- CETKA – Gjyshi.
- GJYSHI – Përse flisni?
- PANDI – I plagosur është?
- GJYSHI – S'më zë plumbi mua, po vete zë këta djem të rinj. (Pandit.) Si je?
- PANDI – Mirë, ç'ka, si njeri pa këmbë.
- GJYSHI – Kur humbet duart është keq. Pa këmbë bën si bën njeriu. Lufta i ka këto. Një nipçen tim nga fshati e zunë gjermanët, të plagosur rëndë, e lidhën me tel pas autobлиндës dhe e hoqën zvarrë nëpër xhade. E gjetëm të nesërmen, pa shpirt. Këmbët e shkulura në gjunjë ia kishin vënë jastëk nën kokë. (Pauzë.) Edhe qenë tallur, rrufjanët!
- CETKA – (Pandit.) Je gati? Hajde tani!
- PANDI – Ma jep kitarën. (Ia jep dhe e merr në krahë.)
- DANIA – Dale ta marr unë.
- CETKA – Është i lehtë.
- GJYSHI – Ku e shpie?
- CETKA – Çdo mëngjes e marr kështu dhe e ngjitem në kam-banore. Penxherja është me hekura. Pandi nxjerr

jashtë këmbët e prera mbi kupën e gjurit dhe tërë ditën rri aty rojë.

GJYSHI – Në kambanore?

PANDI – Në kambanore.

GJYSHI – Po pse s'thua, që je më i lartë nga gjithë njerëzit e botës. A shikon mirë?

PANDI – Shikoj.

GJYSHI – Edhe unë shikoj mirë. Po me veshët e kam keq. Shurdho fare! *(Cetka del në korridor me Pandin në krahë dhe fillon të zbresë shkallët.)*

BAKIU – *(Danes.)* Thuaji Pëllumbit të bëhet gati e të niset menjëherë. Apo lëre. Shkojmë së bashku. *(Gjyshi, Bakiu e Dania dalin në korridor dhe ecin drejt derës së tretë.)*

GJYSHI – Çupë e fortë! E ka gjë?

DANIA – Shok!

GJYSHI – I lumtë! Dhe ata rrufjanët shpifin se gjoja fle vëllai me motrën. T'ëmën e ç'biçimë njerëz!

DANIA – Kryetar! Drejt e te Xhevdet Frashëri do të vejë?

BAKIU – Qarkori kështu ka porositur. Do t'u bëjmë ballistëve edhe një thirrje për të luftuar gjermanët që po fillojnë një operacion të ri.

GJYSHI – Ngrini zërin, ore, se nuk ju dëgjoj! *(Dalin nga dera e tretë. Cetka kalon përmes oborrit me Pandin në krahë.)*

CETKA – E shëh sa ftohtë është?

PANDI – Ka kohën. Vieshtë e tretë. Prag dimri.

CETKA – Je shumë kokëfortë. Më mirë të mos dilje sot.

PANDI – E kam thënë: mua vetëm kryetar Bakiu më kupton. *(Arrijnë në kambanore. Biseda vazhdon gjatë ngjiftjes po nuk kuptohet. Pandi vendoset në dritaren me hekura.)*

CETKA – Drekën të ta sjell këtu?

PANDI – Si çdo ditë. Dhe më fal, Cetkë.

CETKA – Përse të të fal?

PANDI – Të mundova dhe të fyeva.

CETKA – Je mirë tani?

PANDI – Si në llozhën e kinema Majestikut. *(Pandi i bie kitarës. Cetka zbret shkallët, del nga kambanorja)*

dhe qëndron pak në mes të oborrit duke dëgjuar këngën e Pandit. Pëstaj shkon në dhomën e parë dhe rregullon shtratin e tij.)

PANDI – (Këndon.) Ulen retë, vrenjtet qielli sterë,
dhe ia tej nga mali, nis luft'e paprerë...
Në ditare rri e mjera nënë,
pret djalin e sai, që dëshmor ka rënë...

CETKA – (Me vete.) Ka mbetur gjysmë njeriu, po s'e jep veten... Sa bukur këndon!...

NERKA – (Hyn nga dera e dytë me kovë në dorë dhe ndalet te dera e dhomës së parë.) Me cilin flet kështu ti? Me vete flet?

CETKA – Shshsh! (I bën shenjë të heshtë.) Dëqjoie! Sa bukur!... (Pauzë.) E kisha parë vetëm një herë, vjet në dhjetor. Isha te porta e shtëpisë, me Pëllumbin. Atëherë porsa ishim fejuar. Qe mbrëmie. Pandi na u shfaq papritur e na lëshoi traktin në dorë. «Kjo është për ju» na tha... Dy muaj më parë, kur e sollën këtu pa këmbë, sa më pa, më pveti: «Ku jemi takuar ne të dy?» «S'e di» – i thashë. «Te porta e shtëpisë» – m'u përgjiaj. E pveti: «Si më mbajte mend?» «Ti ke një ftyrë që nuk harrohet», më tha. (Kënga ndërpritet. Dëgjoen vetëm tingujt e kitarës. Nerka e Cetka qëndrojnë para derës së dytë.)

NERKA – Ti vërtet ke një ftyrë që nuk harrohet.

CETKA – C'e ke këtë kovë?

NERKA – Po shkoj të miel dhentë.

CETKA – Ti s'duhet të bësh asnjë punë. Do të rri shtrirë e s'do të ngrihesh fare. Harrove ç'hoqe mbrëmë?

NERKA – Më vien turp të rri duarkrya.

CETKA – (I kap përparësen.) Dhe këtë cliroie! Mos e shtrëngo kështu! Mund të mbytësh fëmijën. Sa herë ta kam shpëruar?

NERKA – Më vjen turp. Kushedi ç'thonë njerëzit kur më shohin!

CETKA – Këtë fialë ke në gojë: turp, turp! Ç'turp ke bërë ti? Turp është aë je shtatzënë?

NERKA – Si nuk qenka turp. Ti je kaluar. Të jesh vetë, pa të shohësh.

CETKA – Budallaqe! Ti duhet të gëzohesh që do të bëhesh nënë. Ka gjë më të bukur se të bëhesh nënë? Unë do të çmendem nga gëzimi kur të vijë ajo ditë.

NERKA – Të isha në shtëpi, në kohë të tjera, ndryshe që. Bëja si bëja e i fshihesha syrit të botës. Edhe për të lindur, lindia më ndonjë vend të fshehtë. Po këtu janë gjithë këta. Dhe krejt të huaj. Si nuk qenka turp!

CETKA – E para e punës, s’jemi të huaj. E dyta: çliroje përparësen... çliroie, të them!

NERKA – Mos, Cetkë! Për kokën tënde, mos! Sa budallaqe qenke! Si mund të dal pa m’u skuqur faqja, me gjithë këtë...

CETKA – Atëherë, rri shtrirë e mos dil nga dhoma, giersa të vijë dita. (E shtyn në dhomë dhe ia mbyll me celës.)

NERKA – (Nga brenda.) Cetkë! Mos më mbyll me kyç! Mos bëj shaka! Hape!

CETKA – S’bëj hiç shaka. S’të lejoj të dalësh.

NERKA – (Nga brenda.) S’është e drejtë të më burgosësh kështu!

CETKA – Unë jam infermiere. Unë vendos për të sëmurët.

NERKA – (Nga brenda.) S’do të të dua më, ta dish, Cetkë!

CETKA – Mos më duaj!

NERKA – (Nga brenda.) Me gjithë mend e them. Hape!

CETKA – Sigurisht, ti vetëm Metin do.

NERKA – (Nga brenda.) Si s’ke turp që tallesh me mua kështu?!

CETKA – E ke kot që nxehesh, Nerkë. S’ke dobi nga këto fialë. Derën po ta hap, po nuk do të dalësh. (E hap dhe Nerka duket te pragu.) Dreqi e mori, jam apo s’jam infermiere në këtë spital partizan?

NERKA – Ç’infermiere je ti. Ti je studente. Shejtankë me hirë. Zihet njeriu me ty. Ti je aq e mirë, aq e mirë! Ja, po të bindem. Merre kovën dhe shko e mil dhentë! Jam e sigurt se tërë qumështin ke për ta derdhur.

CETKA – Të shohim... Po ti mos m’u zemëro. E bëj për të

mirën tënde. (E godet shoqen në shpatull me përkëdheli. Nerka del. Cetka ecën në korridor. Nga dera e tretë hyn Pëllumbi dhe e kap Cetkën nga gërshetat.)

PËLLUMBI – Mirëmëngjes!

CETKA – Më trembe!

PËLLUMBI – Nga unë trembesh?

CETKA – Më dole papandehur.

PËLLUMBI – Sa hije të kanë gërshetat!

CETKA – Mua s'më pëlqejnë. Më bezdisin. S'më del koha t'i pleks.

PËLLUMBI – Shiko, se mos i presësh.

CETKA – Vetëm për ty i mbaj.

PËLLUMBI – Ç'ishte gjithë ajo potere? Me cilin bisedoje?

CETKA – Me Nerkën.

PËLLUMBI – E ka keq, e shkreta grua. Është e re dhe e ka fëmijën e parë. Si thuhet në atë këngën tonë që këndon Pandi: «Bota zien, bota zien, shokët tanë kjo luftë po na i rrëmben».

CETKA – Ke të drejtë, Pëllumb. Megjithatë, çdo ditë e më tepër po i afrohemi qëllimit tonë.

PËLLUMBI – Çdo ditë ne shtohemi.

(Fillojnë të zbresin nga shkallët.)

CETKA – Pandi po i duron të gjitha. Edhe unë. Që të të bind, po shkoj të provoj si milen dhentë.

PËLLUMBI – Me sa duket, të paska lënë gjurmë «Mjeku i fshatit». E lexove?

CETKA – Dy herë.

PËLLUMBI – Në shtratin tim, nën jastëk, ke dhe një libër tjetër. «Zhvillimi ekonomik». Po pate qejf, lexoje edhe këtë. (I jep një libër. Ajo e shfleton.)

PANDI – (Nga kambanorja.) Gjergj! O Gjergj!

GJERGJI – (Hyn nga ana e varreve të braktisura.) Ç'do?

PANDI – (Nga kambanorja.) Këtej burimit duken dy veta të armatosur. Njëri është partizan. Tjetrin s'e dalloj dot. Është veshur me lëkurçe.

GJERGJI – Nga shkojnë?

PANDI – Po vijnë këtu.

GJERGJI – Po u dal përpara. (Del)

PËLLUMBI – Do të jetë ai oficeri anglez... Po bëhet një përpjekje tjetër për t'u bashkuar. Gjermanët janë bërë të tmerrshëm. Po na e vënë thikën në grykë. Sot nuk duhet ecur verbërisht. Këshilli krahinor nacionalçlirimtar, me urdhër të Qarkorit, më ngarkoi mua për bisedime me komandantin e trupave të Ballit Kombëtar.

CETKA – Me Xhevdet Frashërin?

PËLLUMBI – Ka ardhur koha që ata t'i lënë mënjanë pasionet e sëmura. Në këtë situatë, në emër të kauzës, të revolucionit, duhet vullnet i mirë, duhet gjakftohtësi, duhet bashkim.

CETKA – S'ma ha mendja se do t'ia dalësh mbanë me atë gjakpirës.

PËLLUMBI – Edhe unë këtë bindje kam. Por, po nuk u afruan me ne, ata do të zhyten në krime.

CETKA – Ti ke thënë se një gjë është e rëndësishme, të mbrojmë parimet tona.

PËLLUMBI – Në parime unë s'kam bërë kurrë ndonjë lëshim. Po kam shpresë se do ta bind Xhevdet Frashërin të heqë dorë nga marrëzitë, nga zemërimi e vëllavrasja. Gjermanët po vijnë. Është rasti më i mirë që ai të bashkohet me ne e t'u kthejë pushkën pushtuesve.

CETKA – Nuk besoj se ka për të ndryshuar gjë.

PËLLUMBI – Situata është shumë e nderë. Kemi informata se gjermanët janë nisur për këtu me trupa të shumta. Dyshojnë se këtu është Shtabi i Përgjithshëm. Me sa duket, nuk e dinë që Shtabi është në Panarit. Batalioni ynë është në Rrëzë. Mirëpo në shpinë të tij ndodhen trupat e Xhevdet Frashërit. E kupton? Batalioni gjendet midis dy zjarreve, gati i rrethuar. Unë do të bëj çmos që ta bind Xhevdet Frashërin që të mos qëllojë prapa krahëve.

CETKA – Me ç'kam dëgjuar për të, zor se do të ndryshojë mendje.

PËLLUMBI – Fundi, do të përdor autoritetin e familjes. Babai ka pasur lidhje të forta miqësore me të.

CETKA – Ti e di.

- PËLLUMBI – Unë do të bëj detyrën me sinqeritet.
- CETKA – Ty s'të ka munguar kurrë sinqeriteti. Po ki kujdes, Pëllumb! Të është ngarkuar një punë e vështirë e me përgjegjësi.
- PËLLUMBI – Mos ma rrit kaq shumë vlerën. Unë do të bëj atë që mund ta bëjnë të gjithë, bile edhe ti.
- CETKA – Unë? Unë mezi bëj punën e një infermiereje. Ku jam e zonja unë për gjë! As dhentë nuk i mjel dot. (*Del nga dera e bodrumit.*)
- PËLLUMBI – E megjithatë, ti je për mua më e mira... Më e mira. (*Hyjnë nga ana e kambanores Gjergji, Meti dhe koloneli anglez.*)
- PANDI – (*Nga kambanorja.*) Gjergj! Kush është ai?
- GJERGJI – Një kolonel anglez.
- PËLLUMBI – Mirë se vini! (*I jep dorën anglezit.*) Ju prisnim.
- GJERGJI – Ku do ta vendosim?
- PËLLUMBI – Te dhoma e tretë. (*Anglezit.*) U lodhët?
- BARNSI – Shumë.
- PËLLUMBI – (*Metit.*) Po ti, nga këto anë je?
- METI – Jam i biri i Bakiut.
- PËLLUMBI – I kryetarit? Mos je i shoqi i Nerkës, ti?
- METI – Po.
- (*Aristidhi hyn nga ana e kambanores dhe shkon me hap të shpejtë në kishë. Pas pak e shohim me një velenxë leshi, përshëndet anglezin, ngjit shkallët dhe del nga dera e tretë.*)
- METI – I ke parë ata të mitë?
- GJERGJI – Këtu janë... Nerkën e ke te dhoma e dytë.
- METI – U bënë nëntë muaj që s'i kemi parë.
- PËLLUMBI – (*Anglezit.*) Dëshironi gjë, zoti kolonel?
- BARNSI – Ju falem nderit! Tani për tani vetëm pak qetësi.
- PËLLUMBI – Si të dëshironi!
- BARNSI – Si i keni punët? Këtej a bie erë barut?
- PËLLUMBI – Sigurisht, përderisa luftohet.
- BARNSI – A lëvizin gjermanët?
- PËLLUMBI – Kështu flitet. Përgatiten për një operacion të madh.

BARNSI – Po nacionalistët?

PËLLUMBI – Vazhdojnë rrugën e tyre.

*(Koloneli, Pëllumbi e Gjergji dalin nga dera e tretë.
Meti ndalet para derës së dytë. Ngurron e pastaj
troket. Te pragu duket Nerka.)*

NERKA – Ti?!

METI – Nerkë!

NERKA – Ti je?

METI – Unë jam i tëri.

NERKA – Met... *(Futen të dy brenda.)*

PANDI – *(I bie kitarës dhe këndon.)* Ulen retë/ Vrenjtet
qielli sterë/ Dhe ja, tej nga mali/ Nis luftë e pa-
prerë...)

Perdja

Tabloja e dytë

I njëjti dekor. Është kohë e vrenjtur, pasdite vonë, afër mbrëmjes. Në manastir ka lëvizje të madhe. Nga dyert e ndryshme hyjnë e dalin të plagosurit. Shumica mbahen për krahu nga vajzat e djemtë që shërbejnë në spital. Disa ecin vetë. Njëri mezi çapitet me ndihmën e patericës. Një tjetër e mbajnë në barelë. Nga thellësitë e manastirit, nga bodrumet e nga kisha hyjnë e dalin partizanë e fshatarë të ngarkuar me armatime, me veshmbathje e bereqet. Lëvizjet në oborr janë të shpejta e të dendura. Dëgjohen urdhra të prerë, të shkëputur, copa bisedash të papërfunduara. Herë pas here nga larg vjen jehona e betejës. Në dhomën e parë janë Bakiu, gjyshi me të shoqen dhe Dania. Bie zilja e telefonit.

BAKIU – (Në telefon.) Po, unë jam kryetari... Presim korrierin, po ata janë afruar... Lufta dëgjohet gjer këtu... Si?... Alo! Bakulla, më dëgjon? Jemi në përfundim... Çdo gjë në rregull... Jo, jo. Ne nuk do të tërhiqemi. Do të veprojmë në ilegalitet. (Ngre zërin.) Do të veprojmë në ilegalitet... Oficerin anglez?... Tashti do ta nisim në Shtabin e Përgjithshëm... Si? Alo! Bakulla!... S'kemi informata. Po, sigurisht, s'ke si i thua ndryshe: tradhti... Mirë... mirë... Liri popullit! (Lë telefonin. Da-

nes.) Një pjesë e bereqetit t'u shpërndahet fshata-
rëve, pjesa tjetër dhe armët të dorëzohen te barakat,
në Bakull. Vëri në lëvizje njerëzit!

(Dania zbrat shkallët e zhduket midis njerëzve.)

GJYSHJA – Nga erdhi kjo tradhti, o zot?

GJYSHI – Mos shiko në qiell. Qielli është me re e me
shi. Zoti është në tokë. Edhe djalli në tokë është.
U morën vesh të dy e na tradhtuan.

GJYSHJA – Mos m'i bëj ditët më të zeza e më të hidhura
se ç'janë.

GJYSHI – Kjo është jeta tani, plakë. Do, s'do, do të
jetosh. Tundi kryqet.

GJYSHJA – Kush tjetër do të jetonte kështu në terr, në
llahtarë, në mes të zjarrit, të luftës dhe kaq gjatë?!

GJYSHI – E, moj grua! Çfarë s'jepet për lirinë! Gjith-
çka! Gjithçka!

GJYSHJA – Ikëm, Baki! Rri me shëndet! *(Ngarkohen.)*

BAKIU – Hajt, rruga e mbarë! Dania ka mbajtur një mu-
shkë për ju.

GJYSHJA – Po ajo, e zeza, si do t'ia bëjë?

BAKIU – Nisuni! Me të është Cetka.

*(Në korridor ndeshen me Aristidhin që përgjonte te
dera.)*

ARISTIDHI – Dale t'ju ndihmoj, o pleq të mjerë! Eh, ç'kohë
erdhën. Të këqija sa s'ka ku vete më! Për pleqtë
sidomos! Po s'mbaroi kjo luftë shpejt, do të kemi
mjerim të madh. As diellin s'kemi për të parë.

GJYSHJA – Ashtu të keqen!

GJYSHI – Shpejt a vonë, s'e kemi në dorë as ti, as unë.

ARISTIDHI – Zoti e ka në dorë. T'i dalim përpara e t'i
lutemi?

GJYSHI – Kujt?

ARISTIDHI – Atij... zotit!

GJYSHI – Je shumë i lehtë nga mendtë, Aristidh, i lehtë
si... ai që qëndron mbi ujë e s'mbytet.

ARISTIDHI – Jam me perëndinë dhe me ata që heqin të
zitë e ullirit. Kur shoh që derdhet gjak, dua ta
ndaloj, po s'më dëgjojnë. Po, pa më thoni, për ku
po niseni? Për në Shtabin e Përgjithshëm?

- GJYSHI – Na liro rrugën, Aristidh!
(Ngarkojnë plaçkat, zbresin shkallët dhe dalin të tre. Hyn Gjergji gati duke vrapuar, ngjit shkallët dhe shkon te dhoma e parë ku është Bakiu.)
- GJERGJI – Shoku kryetar, armiqtë e morën urën. Aty po bëhet qëndresa e fundit. Batalioni u godit nga të gjitha anët dhe mezi e çau rrethimin.
- BAKIU – Kaq thellë hyri armiku?! Si ndodhi kjo kështu, papritur, Gjergj?
- GJERGJI – Tradhtia vjen gjithmonë papritur, kryetar.
- BAKIU – Më trego, si ndodhi?
- GJERGJI – Shumë thjesht. Pëllumbi, pasi bisedoi me Xhevdet Frashërin dhe ra dakort që t'i biem gjermanit së bashku, u kap prej ballistëve në befasi.
- BAKIU – Po. Diçka e tillë duhet të ketë ndodhur. Ja ku është letra që më dërgoi mbrëmë Pëllumbi. Dëgjo ç'na shkruan: «Rashë dakord me Xhevdet Frashërin për pikën më të rëndësishme. Forcat e tij do të rreshtohen në krahun tonë të majtë dhe do t'i presin gjermanët me breshëri armësh. Kështu që krahët i kemi të siguruar. Po njoftoj edhe shtabin e batalionit... Të fala revolucionare... Pëllumbi!» Po. Kjo është një grackë e ballistëve. Me fjalë thanë se do të luftojnë kundër nazistëve. Kurse në të vërtetë u bashkuan me gjermanët dhe goditën forcat tona!
- GJERGJI – Pikërisht ashtu?
- BAKIU – Dhe Pëllumbin na e arrestuan... Kush e solli këtë lajm?
- GJERGJI – Një ballist, njëfarë Hajredini që është me Xhevdet Frashërin.
- BAKIU – Mos na e vrasin?
- GJERGJI – Ka mundësi edhe ta kenë pushkatuar. Kështu lajmëroi ai Hajredini.
- BAKIU – Tradhti! (Pauzë).
- GJERGJI – Kam sjellë bukën.
- BAKIU – Shpërndajua shokëve!
(Gjergji del. Bakiu lexon letrën pa zë. Cetka hyn me nxitim nga dera e dytë, zbret shkallët, vrapon

përmes oborrit dhe ngjitet në kambanore ku është Pandi.)

CETKA – E, Pandi, a sheh gjë?

PANDI – Me sa duket, e kapërcyen lumin. Tani luftojnë te kodrat. Duken zjarret. Po djegin fshatrat kriminelët!

CETKA – Ngrehu! Pothuaj të gjithë të plagosurit u larguan. S'është nevoja të qëndrosh më këtu.

PANDI – Mos më mundo, Cetkë. Unë i vdekur që i vdekur jam. Ky është vendimi im. Do t'i pres këtu.

CETKA – Kemi urdhër ta lëmë spitalin e të shkojmë në thellësi të krahinës.

PANDI – S'arrij dot i gjallë gjer atje.

CETKA – Ti ke ethe! Ngrehu, Pandi!

PANDI – Nuk mundem. (Nxjerr revolverin.) Ky është i vetmi mjet kundër tyre.

CETKA – Do vij të të marr kur të largohem edhe vetë.

PANDI – Nuk vij! Nuk vij!

(Cetka zbret nga kambanorja, kalon me shpejtësi oborrin, ngjit shkallët dy nga dy dhe kalon para derës së hapur.)

BAKIU – Cetkë!

CETKA – Urdhëro, shoku kryetar!

BAKIU – Si është ajo?

CETKA – Duhej të kishte lindur... Po...luftë. Mezi lindin gratë kur kërcet topi.

BAKIU – Atëherë, tërhiqeni! Hipeni në një mushkë dhe niseni me të tjerët!

CETKA – Kjo do të thotë ta vdesim me dorën tonë atë dhe fëmijën.

BAKIU – Tërhiqeni!

CETKA – Në asnjë mënyrë.

BAKIU – Nuk do ta lëmë në duart e gjermanëve.

CETKA – S'të kërkoj më shumë nga ç'mund të më japësh, kryetar, vetëm pak kohë.

(Cetka matet të dalë.)

BAKIU – Cetkë!...

CETKA – Urdhëro, shoku kryetar.

(Pauzë.)

BAKIU – Ik, ik!

CETKA – Do të më thoshe gjë?

BAKIU – Jo, jo.

(Cetka vrapon dhe del nga dera e dytë. Bakiu vështron në dritare, pi duhan i menduar. Nga ana e kambanores hyn Kostaqi. Ndeshet me Aristidhin.)

ARISTIDHI – Nga vjen kështu, Kostaq?

KOSTAQI – Shita ç'kisha për të shitur dhe erdha të kaloj natën në manastir. Udhët janë mbushur me të vrrarë. Është qelbur ajëri gjer në yje nga kufomat. Tani ata që luftojnë duhet të bëjnë gati qefinin dhe varrin.

ARISTIDHI – Nuk do të arrinte puna gjer këtu, po të kishin bërë paqe. Më mirë paqja, qoftë dhe e dobët, e keqe, sesa lufta e përleshja. Tani po vrasin njëri-tjetrin. Maskara. Edhe ata që do të shpëtojnë, do të jetojnë si të mallkuar. Edhe mua po më siset mëshira. Dhe e di përse? Ty të marrin me të mirë, të përkëdhelin, të hedhin hopa si fëmijë, të ngjitin në qiell. Ti hedh zdrëoka. S'dua, thua. Po kush je ti? Një hiçgjë! Ai goxha shtet, goxha ushtri, me pështymë të mbyt.

KOSTAQI – Qenke me gjermanët, ti, Aristidh, s'e dija.

ARISTIDHI – Unë jam me ata që vuajnë dhe, meqë të gjithë njerëzit vuajnë, do të thotë se jam me të gjithë. Po ti?

KOSTAQI – Unë s'e di mirë me cilin jam e çfarë jam. Po më duket se s'jam me njeri. Unë jam me veten time.

ARISTIDHI – Gabim. Asnjë njeri nuk fiton dot kur është i vetmuar.

KOSTAQI – Mbase ke të drejtë, po unë s'bëhem dot ndryshe nga ç'jam... Kam harruar fare, ç'ditë është sot?

ARISTIDHI – E diel.

KOSTAQI – Dita e kambanave.

ARISTIDHI – Kambanat e të dielat morën fund tani. Dhe, me sa shoh unë, s'ka për të pasur më as kambana,

as të diela. Do të ketë vetëm mjerim dhe sakatë,
si ai që rri rojë atje lart.

KOSTAQI – Më tmerron kur flet kështu.

ARISTIDHI – Gjithë kjo të vjen nga frika.

KOSTAQI – Nga frika?... Me siguri, nga frika. E ke gje-
tur, megjithëse është fjalë e neveritshme.

ARISTIDHI – Pa më thuaj, ç'bëhet andej nga erdhe?

KOSTAQI – Varfëri e madhe. Një qese me para shitet
një grusht kripë...

ARISTIDHI – S'të pyes për këtë. A pe forca partizane?

KOSTAQI – Sigurisht.

ARISTIDHI – Ku ishin dhe ç'forca ishin?

KOSTAQI – Në Protogur ishin dy batalione të Brigadës.

ARISTIDHI – Protogur...

KOSTAQI – Në Zallisht dy të tjera.

ARISTIDHI – Zallisht.

KOSTAQI – Në Bardhaj ka depo të mëdha, punishte,
infirmieri.

ARISTIDHI – Po për Shtabin a dëgjove gjë?

KOSTAQI – Cilin Shtab?

ARISTIDHI – Të Përgjithshmin.

KOSTAQI – Aristidh, ç'janë këto pyetje që më bën?
Ç'të duhet të dish se ku është Shtabi i Përgjith-
shëm.

ARISTIDHI – Na hyn në punë të dyve, Kostaq!

KOSTAQI – Thonë se është në Panarit.

ARISTIDHI – Shshsh! S'është më atje. Ka ikur. Mos more
vesh gjë se ku ka vajtur?

KOSTAQI – Jo.

PANDI – (Nga kambanorja.) Ç'bëni aty ju të dy? Pse
nuk ndihmoni shokët?

ARISTIDHI – Unë jam zbathur.

PANDI – Edhe Krishti zbathur ka qenë. Gjersa vuajti ai,
përse të mos vuash edhe ti?

ARISTIDHI – Mos u tall me zotin, Pandi!

KOSTAQI – Unë porsa erdha. Jam i këputur. Po, po
të jetë për të ndihmuar, ndihmoj. Jam edhe i tron-
ditur. Pashë gjithë ato fshatra të djegura, Bardhaj,
Gjonovoglin, Velipojën...

PANDI – I shoq edhe unë.

- KOSTAQI – Thonë se u vranë katërmbëdhjetë partizanë.
 PANDI – Sa?
 KOSTAQI – Katërmbëdhjetë! Katërmbëdhjetë!
 PANDI – Gëzohesh për fshatrat e djegura e për gjakun e vëllezërve të tu?
 KOSTAQI – Jo. Ti mos u nxeh. Edhe unë e dua lirinë.
 PANDI – Të njoh kush je. Lirinë ti e do për vete.
 KOSTAQI – Sigurisht.
 PANDI – Edhe franga ari do për vete, se pa to s'ka liri për ty. Ç'do gjë për vete ti, çdo gjë për vete.
 KOSTAQI – Sot, po s'u mendove për vete, të vjen vdekja.
 PANDI – Prandaj je gjysmë i vdekur ti.
 KOSTAQI – Po ti, përse mendon?
 PANDI – Për jetën.
 ARISTIDHI – Ti ke mbetur gjysmë njeriu, more çun?
 PANDI – E megjithatë, qëndroj më lart se ju të dy. Më shikoni sa lart jam? Ngrijeni kokën! Ngrijeni, sa t'ju këputet arrëza e qafës!
 ARISTIDHI – Më shtruar, more çun, më shtruar.
 KOSTAQI – Më bërë të vdekur, Pandi. Mos harro të më nderësh qiri mbi varr.
 PANDI – Do vij të bëj ujët e hollë.
 ARISTIDHI – Nuk është mirë kështu, Pandi!
 PANDI – Lini fjalët! Ndiqmoni shokët! Shpejt!
 (Aristidhi e Kostaqi shkojnë te hyrja e bodrumit ku ka një grumbull materialesh.)
 ARISTIDHI – E kisha fjalën se krimet, hiri, flakët, lufta, mund të ndalohen.
 KOSTAQI – Në ç'mënyrë?
 ARISTIDHI – Me të falur. Ja kështu! (Falet duke u përkulur.) Duhet të na vijë keq për atë që është i keq. Vetëm kështu, të gjunjëzuar, gjersa s'kemi vdekur, kemi mundësi të qëndrojmë gjallë.
 DANIA – (Hyn nga ana e bodrumit.) Kështu si ke qëndruar, Aristidh, helli të shkon drejtpërdrejt, nga goja në prapanicë.
 ARISTIDHI – Gojëndyrë!
 (Aristidhi e Kostaqi rrëmbejnë nga një thes e da-

lin në drejtim të varreve. Dania ngjit shkallët dhe kalon në dhomën e parë. Pas pak hyn edhe Gjergji.)

DANIA – Ç'thotë Cetka për nusen?

BAKIU – A dëgjuat gjë për Pëllumbin?

GJERGJI – S'ka asnjë lajm tjetër.

DANIA – Kryetar, si do t'ia bëjmë Nerkës? Mendon ti për nusen e tët biri apo jo?

BAKIU – Ngado fishkëllima plumbash dhe erë baruti. Po na vjen një dimër i egër. Më vjen keq për fëmijët, për gratë dhe për pleqtë e moçëm.

(Hyn Gjyshi duke marrë frymë me zor.)

GJYSHI – Hiç të mos të të vijë keq për pleqtë. Pleqtë mbahen.

BAKIU – Po ti, pse u ktheve?

GJYSHI – Nuk mund ta lë pushtetin në dorë të armikut.

GJERGJI – Do ta kesh vështirë, gjysh. Do të lëvizim natën.

GJYSHI – Me veshët jam keq, pa sytë më shohin edhe në errësirë. Kam qejf t'i dalë njëherë ballë për ballë Xhevdet beut... A u hoqën të gjithë?

BAKIU – Pak gjë ka mbetur.

GJYSHI – Anglezi iku?

DANIA – Jo, akoma.

GJYSHI – Ç'pret ai?! Po shkoj ta nxjerr! (Kalon korridorin dhe del nga dera e tretë. Dëgjohet një shpërthim predhe.)

PANDI – (Thërret nga kambanarja.) Shokë! Batalioni u grumbullua te kullat. Po shoh gjermanët!

(Dëgjohet klithma e një fëmije. Pauzë e gjatë. Hyn Cetka nga dera e dytë dhe kalon në dhomën e parë.)

CETKA – Nerka shpëtoi. Lindi... Tani mund ta tërhiqni, shoku kryetar (Pauzë.)

BAKIU – Më dukej sikur më solle pranverën. Të falemnderit, Cetkë!

CETKA – Të të rrojë!

DANIA – Me këmbë të mbarë, kryetar!

GJERGJI – Urime... do t'ia vëmë emrin Partizan.

CETKA – Është vajzë.

BAKIU – Atëherë, do ta quajmë Cetkë...

DANIA – Gjynah! Ka për të vuajtur, luftë.

BAKIU – Fëmijët duhen bërë edhe në kohë lufte, si bereqeti. Me mundime e me gjak, po duhen bërë se s'bën. Bëni gati mushkën! Hipeni Nerkën me fëmijën dhe niseni! (Kalon në korridor dhe del nga dera ku është Nerka i ndjekur nga Cetka. Gjergji zbriset shkallët me vrap dhe del duke thirrur.)

GJERGJI – Një mushkë!... Një mushkë!

(Pas tij del edhe Dania. Pauzë e gjatë. Skena fillon të errësohet. Në korridor hyjnë nga dhoma e dytë Meti dhe Nerka me fëmijën.)

METI – Ja dhe nga babai që kishe turp, shpëtove. Kurrë s'ia kam parë fytyrën kaq të çelur. Sado që u përmbajt, e tregoi gëzimin... Sa fjalëpakë që je. Ngrije kokën!

NERKA – Këtu ke ndërresat.

METI – Mos psherëti!

NERKA – Këtë s'kam për ta harruar kurrë! Ç'kam hequr! Dy net e mbuluar me djersë të ftohta! Gjithë ato dhimbje dhe gjithë këta njerëz! Turp! Turp!

METI – Kur më prenë njëherë rrugën ata qenat, më kërcënuan: «Ti ke dhe gruan me barrë...» E mirë, u thashë, po të jetë se do të vdes, do të vdes për atë që do të lindë.

NERKA – Për këtë? (Tregon fëmijën.)

METI – Unë s'pata turp. Ua thashë në sy. Dhe ishin armiq. Kurse ti je midis shoqeve e shokëve.

NERKA – Ti je burrë.

METI – E dëgjove babanë, ç'tha? «Ky fëmijë na solli pranverën!» Ky pikërisht ky! (Fëmija qan.) Pse çirresh bilbil? S'të pëlqen që linde në luftë? Të djegin hundët nga tymi i barutit? Hajt se do të mësohesh e s'do të qash më.

NERKA – S't'u çmalla. Më duket sikur s'të pashë fare. Të kërkoja me mend e s'të kujtoja. Ta kisha harruar fytyrën. Nëntë muaj s'janë pak. (Hyn në korridor Bakiu.)

- BAKIU – Hë? U bëtë gati? S't'u bë vonë ty? Mos të zënë ndonjë pritë te mulliri. Atje hap sytë! Gjej shtigjet më të sigurt. Është aleat e s'duhet të bjerë në duar të gjermanëve.
- METI – Më parë lë kokën time, baba.
- BAKIU – Në luftë mendja duhet të punojë më mirë se një sahat.
- METI – Luftë. Edhe do të vritemi.
- BAKIU – Sigurisht. Po s'kemi dalë maleve që të vritemi. Kemi dalë që t'i vrasim... Nisu, bijë! Merre këtë gunë, se nata është e ftohtë. Përcille!
(Meti e Nerka dalin. Në korridor hyn Çetka e përgatitur për rrugë.)
- CETKA – Më erdhi radha edhe mua, shoku kryetar. Të gjithë të plagosurit u tërhoqën në rregull. Për Nerkën mos ki merak... Po shkoj të marr Pandin. Më vjen keq që e lamë këtë vend. Në çdo skaj të tij kam një kujtim.
- BAKIU – Pas pak ditësh, do të kthehemi përsëri. Dhe nuk do ta lëmë më në duart e armikut.
- CETKA – Desha të pyes: Përse nuk erdhi Pëllumbi?
(Pauzë.) Mos ka qëndruar me shokët në batalion?
(Pauzë.) Pse s'përgjigjesh? I ka ndodhur gjë?
Mos është plagosur? Vrarë?
- BAKIU – Çetkë! Të kam si vajzën time. Po të flas hapur, se ti je e mirë dhe e fortë. Ti duhet ta ikuptoje edhe pa ta treguar unë.
- CETKA – Si?... Mos ka tradhtuar?... Mos ka kapitulluar?
Nuk është e mundur! Nuk është e mundur?
- BAKIU – Kurrë mos e mendo këtë. Pëllumbi ishte partizan i vërtetë.
- CETKA – Pse thua «ishte» kryetar. S'është më?
- BAKIU – Çetkë, bijë. Atë e zunë ballistët me tradhti, prandaj batalioni ra midis dy zjarresh dhe mezi doli nga rrethimi. Na u vranë gjithë ata shokë, na u dogjën fshatra, ngritëm të plagosurit nëpër shi e të ftohtë. Për të gjitha këto fajtor është Balli Kambëtar. Dhe për masakrat e tjera që do të ndodhin gjersa të rikthehemi këtu, fajtor është

Balli Kombëtar. Ai është fajtor edhe për Pëllumbin tënd.

CETKA – A rron? A është gjallë? Ku është?

BAKIU – *(Ia merr kokën në kraharonin e vet. Ia ledhaton.)*
Ai qe shok i mirë, Cetkë... i denjë për ne edhe për ty... Po ti e di që tradhtia i ka buzët me helm. Na e tradhtoi Balli... Ti je e fortë... Tani i more vesh të gjitha. Dhe nuk është mirë të qash!

CETKA – Nuk mund të qaj. S'kam lot. Vetëm ndiej një trishtim të madh dhe urrejtje.

BAKIU – Kjo është gjë e mirë. Shkojmë të ngremë Pandin.

CETKA – Atij i pëlqenin shumë gërshetat e mi. Ai donte që unë t'i mbaja tërë jetën. Dhe do t'i mbaj. *(Vrapon te Pandi në kambanore. Pas i shkon Bakiu.)*

BAKIU – Vajzë e mirë!... Vajzë e mirë! *(Ngjitet në kambanore. Në korridor nga dera e tretë hyn koloneli anglez Barns.)*

BARNSI – *(Me vete.)* Pamje e mjerueshme, pa asnjë shpresë. Domethënë ky është fundi. Derisa po dorëzohet dhe kjo qendër partizane, do të thotë se s'ka asnjë shpresë!... Ku shkuan gjithë ata njerëz të gjakosur? Ku shkuan gjithë ata të uritur që mezi qëndronin në këmbë dhe ajo grua që rënkoi dy net dhe lindi një fëmijë shtatanik e të sëmurë? Ku? I përpinë malet?

(Hyn Meti e pas tij Gjergji.)

Ja edhe shoqëruesi im, babai më i ri i Luftës së Dytë Botërore.

GJERGJI – *(Metit.)* Harrova të të jap racionin e bukës. Merre! *(I jep një copë bukë misri.)*

METI – Kujt i vete mendja për bukë. Më mirë të më jepje pak vaj për pushkën.

BARNSI – *(Me vete.)* Ky shoqëruesi im, me siguri, më mirë përdor thikën, se pushkën. Interesant është të dish ç'ndien ai tani që u bë baba, ndërsa gruan e fëmijën i degdisi zoti e di se iku... Hello, Met!

METI – *(Ngjitet në korridor.)* – Zoti Barns, duhet të nise-

mi menjëherë. (Futet në dhomën e parë dhe rregullohet teshat e veta.)

GJERGJI – (Ngjitet në korridor.) Shpejt, shpejt! Ndryshe ju kapin gjermanët dhe kaput! (Futet në dhomën e parë dhe heq telefonin.)

GJYSHI – (Hyn në korridor nga dera e tretë.) Ç'errësirë! Tëmënë, vetëm më lanë me këtë?! (Futet në dhomën e parë i ndjekur nga Barnsi.)

GJERGJI – Gjysh, ti vetë the se ujku mjegull do.

GJYSHI – Ujku, po jo unë.

(Të gjithë merren me përgatitjet e fundit. Hyjnë në dhomën e parë dhe Aristidhi me Kostaqin.)

PANDI – (Nga kambanorja.) Ja edhe shenja e gjelbër.

BAKIU – Kjo është për tërheqjen tonë të plotë. Praparoja e batalionit bëri shkëputjen me armikun. Tani gjermanët gjer këtu rrugën e kanë të lirë. Ngrehu!

PANDI – Sikur të më linit këtu?

BAKIU – Kjo do të më rëndonte në shpirt për tërë jetën. S'është e domosdoshme. Kur të kthehem, do të qëndrosh përsëri këtu. (E ngrenë dhe e zbresin nga kambanorja. Cetka e mban në krahë.)

PANDI – Ti, Cetkë, pse s'flet? (Pauzë.) Të vjen keq që po ikim?

CETKA – Po.

PANDI – Pëllumbin s'e pashë. Qëndroi në batalion?

CETKA – S'e di.

PANDI – Përse dridhesh? Ke ftohtë?

CETKA – S'e di.

(Cetka del me vrap me Pandin në krahë. Bakiu kontrollon përreth dhe shkon në dhomën e parë. Hyn edhe Dania.)

ARISTIDHI – Kini rrugë të gjatë për të bërë, zoti Barns. Me ç'na fali perëndia. Urdhëroni këto dy meshë, pakëz të forta, po safi miell as.

BARNSI – Unë përpiqem të shuaj vëllavrasjen. Po, me sa duket, kjo është në gjak të shqiptarit.

ARISTIDHI – Në ka vend në botë që i duhet bashkimi, jemi ne, po s'jemi të zotët për këtë.

BARNS – Edhe zoti Çurçill kështu thotë.

- GJYSHI – Kush është ky Shurshill?
 GJERGJI – I madhi i tyre.
 GJYSHI – Qoftë shëndoshë!
 BAKIU – Çurçilli mund të fjaloset përditë me mbretin Zog për bashkim, po ne duam vepra. Partia jonë thotë se në punët tona s'ka të drejtë të futë hundët as Çurçilli, as kryekomandanti juaj Uillon e askush tjetër, kushdo qoftë.
 BARNISI – Edhe këtë do t'ia transmetoj menjëherë gjeneralit Uillon, Kajros.
 DANIA – Ç'rrenjëdalë qenka ky!
 GJYSHI – Ah! Ç'më lanë veshët mua të varfrit! Nga këta do ta kem vdekjen.
 KOSTAQI – (*Aristidhit me zë të ulët.*) E mira e të mirave është të qëndrosh larg këtyre andrallave. Ç'kanë? Përse grinden?
 BAKIU – Hesht ti, lakuriq nate!
 KOSTAQI – Ç'ma vure këtë nofkë?! Unë kam emër. Më quajnë Kostaq dhe merrem me tregti të vogël: me kripë, vajguri, sheqer e defterë cigaresh.
 BAKIU – Sepse, kur e thirrën lakuriqin e natës kafshët, s'jam kafshë tha po zog. Dhe kur e thirrën zogjtë, s'jam zog, tha, po kafshë.
 BARNISI – Duhej bashkim. Duhej... një hije që t'ju mbronte...
 BAKIU – E ke fjalën për Ballin Kombëtar? Për Legalitetin? Ata s'kanë hije për vete. Ata janë tradhtia vetë.
 BARNISI – Mbase tani është e kotë çdo përpjekje. Tani erdhi fundi.
 GJYSHI – Ç'thotë, laneti, se s'dëgjoj?
 GJERGJI – Thotë se erdhi fundi i botës.
 BAKIU – Ti je ushtarak, zoti kolonel, dhe duhet të përkrahësh ata që luftojnë dhe jo ata që tradhtojnë, Xhevdet Frashërin me shokë. Ne nga ana jonë i bëmë përpjekjet e duhura për bashkim armësh, ata na tradhtuan. Ju i përkrahni...
 BARNISI – Kjo është një akuzë pa baza... Më duket sikur jam në xhungla. Po ju, a e kuptoni se është barbarizëm të vrasë vëllai vëllanë?

BAKIU – S'jemi vëllezër me tradhtarët.

BARNSI – Si lart, si këtu, na e keni prishur mendjen fare.
Kjo s'është luftë e drejtë.

GJYSHI – Kryetar! Thuaji në emër të këshillit nacional-çlirimtar ikrahinor, në i pëlqeftë lufta jonë, mirë, në mos, derën e ka hapur. Le të vejë te ballistët e te gjermanët.

BAKIU – Këtu ka një pushtet që vepron. Mua më kanë zgjedhur kryetar të tij. Ligjin e bëjmë ne... U vonuam. Nisemi!

METI – Zoti Barns, pàs meje!

BAKIU – Kujdes, Met!

METI – Mos ki merak, baba. Vdekje fashizmit, shokë!

TË GJITHË – Liri popullit!

(Meti e Barnsi dalin, të shoqëruar nga Kostaqi. Aristidhi përgjon bisedën e këshilltarëve.)

BAKIU – Situata është e rëndë, shokë! Do të veprojmë në ilegalitet. Nga këshilli kemi mbetur vetëm ne. Të tjerët u nisën me të plagosurit dhe për punë të tjera. Takimin do ta lëmë në pyllin e Bofjes. Shkojmë! *(Aristidhi, që ka përgjuar prapa derës, zbret shkallët me shpejtësi dhe së bashku me Kostaqin, që e pret afër bodrumit, zhduken si hije në drejtim të varrezave. Anëtarët e këshillit zbresin në oborr. Dëgjohen të shtëna armësh. Nga larg vjen reflektimi i flakëve.)*

DANIA – Po djegin gjithandej.

GJERGJI – Në ato zjarre do të digjen vetë.

GJYSHI – Gjergj! S'të kam pyetur. Ku është yt atë?
(Pauzë.) Po nënën gjallë e ke? *(Pauzë.)*

BAKIU – Është jetim.

GJYSHI – U matufepsa. S'bëhen pyetje të tilla në kohë luftime! *(Dalin. Pauzë e gjatë. Hyjnë Aristidhi dhe Kostaqi. Qëndrojnë te varrezat.)*

ARISTIDHI – Këtu është vakëf, mos ki frikë! Ku ka vakëf, s'ka të keqe, s'ka vrasje.

KOSTAQI – Vërtet thua? E kam dëgjuar këtë fjalë, po nuk besoj të jetë e vërtetë.

ARISTIDHI – Ku ka vafër, ka paqe, cicërma zogjsh dhe dashuri hyjnore... Po vijnë.

KOSTAQI – Ata ikin, këta vijnë.

ARISTIDHI – Kështu është krijuar kjo botë. Ca ikin, ca vijnë. Përse dridhesh?

KOSTAQI – S'e di. Unë po iki, Aristidh.

ARISTIDHI – Unë s'kam ku të vete.

KOSTAQI – Ti sikur the të shkojmë së bashku?

ARISTIDHI – S'e mbaj mend. E përse të shkojmë?

KOSTAQI – Se kemi një rrugë për të bërë. A më the se ne jemi dy gjysma që bëjmë një të tërë? A më the se unë jam ti, e ti je unë, ne jemi vëllezër!

ARISTIDHI – Të gjithë njerëzit e kësaj bote janë vëllezër! Pashë ndriçimin e një helmete. Po vijnë.

KOSTAQI – Unë ika, Aristidh! Larg andrallave. Më pret kripa, vajguri, sheqeri dhe defterët e cigareve. (Del.)

(Pauzë e gjatë. Ndriçim projektorësh që kryqëzohen e zhduken si vetëtima. Hyjnë ushtarët gjermanë Grabner dhe Herman dhe, pas tyre, Xhevdet Frashëri e ballisti Murat.)

HERMANI – Grabner! Më duket se atje dikush është.

GRABNERI – *(Thërret me gishtin në këmbëz të automatikut.)* Partizan? *(Aristidhi ngrihet më këmbë me qirinj të ndezur në të dy duart.)*

ARISTIDHI – Niks partizan!

MURATI – Kush je ti?

ARISTIDHI – Kujdestari i manastirit.

XHEVDETI – Aristidh, ti je?

ARISTIDHI – Unë.

XHEVDETI – Nacionalist.

GRABNERI – Hendehoh!

(Aristidhi ngre duart lart dhe shkon drejt gjermanëve e ballistëve.)

Perdja

Fund i pjesës së parë

PJESA E DYTË

Tabloja e tretë

I njëjti dekor. Të njëjtat objekte. Ballistët janë vendosur në katin e parë të manastirit. Gjermanët në bujtinat e katit të dytë. Pranë kambanores qëndron rojë një ballist, një korridor një gjerman. Në dhomën e parë janë Hermani dhe Grabneri. Koha është e vrenjtur, e zymtë.

GRABNERI – Zoti Herman! Më duket se nuk jemi rregulluar keq në këtë manastir. Koloneli Myler do të kënaqet.

HERMANI – Do të ishte më mirë sikur të kishim edhe gra.

GRABNERI – Keni të drejtë. A mund të pimë nga një gotë për gjininë femërore? (*Mbushin gotat, pinë. Nga ana e varreve hyn Shulci. Ka vënë përpara Bakiun, të lidhur. Shulci e shtyn dhe e fut në bodrum. Pastaj ngjit shkallët dhe kalon në dhomën e parë.*)

HERMANI – E kape?

SHULCI – Lavdi nacionalistëve dhe shenjtorëve! Kujdestari i Manastirit na informoi drejt. I kapëm te pylli i Bofjes. (*Lahet në muslluk.*)

- HERMANI – Këta janë fajtorë për mundimet tona, prandaj duhen asgjësuar. Ata na fyejnë dhe për mua armik numër një është ai që fyen njeriun, që ul dinjitetin tonë... Shulc! Para se të vijë këtu, ke qenë në Osvencim. Edhe atje, pasi kryeje veprimet ushtarake, laheshe si këtu?
- SHULCI – Gjithnjë më ka pëlqyer pastërtia. Mizën, për shembull, nuk mund ta shoh me sy.
- GRABNERI – Zhduk mikrobot, zoti Herman.
- SHULCI – Më drejt: zhduk mbeturinat e gjakut.
- HERMANI – Mirë bën. Është gjak i keq.
- SHULCI – *(Fshihet me peshqir.)* Po shkoj të mësoj.
- HERMANI – Mëso, gjimnazist! Detyra jote është të mësosh. Për të menduar janë të tjerët.
- SHULCI – E kam ngulitur këtë mendim në shkollën e fyhërve. Unë nuk urdhëroj. Unë vetëm zbatoj.
- GRABNERI – Kur do t'i jepni provimet e pjekurisë?
- SHULCI – Në fund të vitit. Kolonel Myleri më ka premtuar një leje të gjatë për krishtlindjet.
- HERMANI – Ç'lëndë përgatit tani?
- SHULCI – Humanizmin e Gëtes.
- HERMANI – Sukses!
- GRABNERI – Lum ju që do të shkoni në shtëpi!
(Të tre kalojnë në korridor dhe dalin duke qeshur nga ana e dhomës së dytë. Hyjnë Xhevdet Frashëri dhe disa ballistë.)
- XHEVDETI – Kuptojeni këtë. Lufta është luftë. Me grackën që i ngritëm Pëllumbit, ne i bëmë vendit një shërbim të madh. Pa këtë grackë, kjo kala komunistësh nuk merrej lehtë. Ne e kapëm atë me pabesi. Po në kohë lufte për të arritur qëllimin, të gjitha mjetet janë të mira, edhe pabesia.
(Hyjnë Murati, Hajredini dhe gjyshi.)
- GJYSHI – Më shpini tek i madhi juaj.
- MURATI – Tek ai do të të shpiem, mos ki merak. Ja ku është.
- XHEVDETI – Ç'e keni këtë?
- MURATI – Është pykë nga veshët. Jam shumë plak, thotë, s'di as si quhem.

XHEVDETI – Si quhesh, more?
 GJYSHI – Urdhëro?
 MURATI – Të pyet si quhesh.
 GJYSHI – Gjysh, më thonë.
 XHEVDETI – Hë, ç'do?
 GJYSHI – Zotrote je komandant i Ballit?
 XHEVDETI – Unë jam.
 GJYSHI – Mos je ti që arrestove nëntë veta, prindër,
 vëllezër e farefis, i shpure te kisha e Shën Tihanasit,
 shqeve derën, i fute brenda dhe i pushkatove në
 orën një e gjysmë të natës?
 XHEVDETI – Unë jam. Pse?
 GJYSHI – Mos ke qenë, zotrote, në shtëpinë e Fanit dy
 javë më parë?
 XHEVDETI – Kam qenë.
 GJYSHI – Ti je që hëngre e pive në shtëpinë e tij, i
 çnderove nusen e re, e cila u mbyt nga turpi në
 pus dhe pastaj e qëllave Fanin në kokë me revole?
 XHEVDETI – Pastaj! Ç'do të thuash me këto?
 GJYSHI – Dhe kur Fani ra pa shpirt mbi sofër, ti u ngrite,
 i dhe një shkelm dhe i the: «Ku e ke babanë, qen
 bir qeni?»
 XHEVDETI – E mirë...
 GJYSHI – Ti je?
 XHEVDETI – Unë.
 GJYSHI – Po ku je, more bej! Ka kaç kohë që të kërkoj!
 Ka kaç kohë që dua të takohem ballë për ballë
 me ty! Të kam kërkuar gjithandej, more pusht!
 MURATI – Ç'bën, derr! Do të të var! Na turpëroi koman-
 dantin!
 XHEVDETI – Njeriu që thotë të vërtetën nuk varet!
 Lëreni plakun! Duhet të mësohemi ta dëgjojmë atë
 që na urren. Lëshoje, Murat!
 GJYSHI – (Me vete.) A thua s'ka gjë tjetër në botë
 veç kupës me helm!
 XHEVDETI – Hajt, pakush! Mos qaj! I gjalli me të gja-
 llin, i vdekuri me të vdekurin.
 GJYSHI – Nga fjalët çakall, nga mendtë budallë.
 XHEVDETI – Ti a e di se unë jam i pasur?

- GJYSHI – Pasuria ta humb shpirtin. Sa më shumë të kesh, aq më tamahqar je dhe aq më shumë lyp.
Po burrëria s'blihet me para!
- MURATI – Ky është një copë gomari.
- GJYSHI – Sa më shumë të tregohet i ditur njeriu, aq më shumë kiji frikën.
- MURATI – Ç'thotë?! Më duket se u çmend.
- HAJREDINI – Pse s'mendon vetëm për vete... Domethënë, ti qenke Xhevdet Frashëri! Po vret shumë, bej!
- XHEVDETI – S'jam bej. Jemi vëllezër!
- GJYSHI – Po vret shumë, bej...
- XHEVDETI – E pastaj! Toka ka nevojë për pleh.
- GJYSHI – Pika-pika mbushet pusi. Populli është ngritur në këmbë.
- XHEVDETI – More, po kush je ti?
- GJYSHI – Unë jam ai babai i Fanit që zotrote ia rrëzove kokën në sofër. Unë jam vjehri i asaj nuses që e çnderove dhe ajo u mbyt në pus. Unë jam gjyshi, anëtari i këshillit... Me atë revole i ke vrarë njerëzit?
- XHEVDETI – Me këtë!
- GJYSHI – A ta shoh pak?
- XHEVDETI – *(Nxjerr revolverin.)* Shikoje! *(Pauzë. Gjyshi ia pështyn armën.)* Ja ç'do ti! *(E godet.)*
- HAJREDINI – Mos e ndyj dorën, bej.
- GJYSHI – *(Lëkundet.)* Më mbani, bre! Më mbani, bre, se rashë! Shqiptarë jeni... a ç'jeni?! Është turp të bjerë njeriu në gjunjë në moshën time. Është turp të goditet. Në kohë lufte njeriu vdes vetëm nga plumbi.
- HAJREDINI – *(E mban.)* Gjysh!
- XHEVDETI – Hajredin, lëshoje!
- HAJREDINI – Më vjen keq, më duket si gjyshi im! Edhe im gjysh është niëqind vjeç!
- XHEVDETI – Lëshoje! *(E godet.)*
- HAJREDINI – Mos harro, bej, nata e dimrit është e mbarsur. *(Gjyshi bie. Ngre kokën dhe pështyn Xhevdetin. Xhevdeti e tërheq zvarrë dhe e fut në bodrumin-burg. Ballistët kanë ngrirë nga tronditja.)*

XHEVDETI – Ç'më rrini si hunj! Pas meje!

(Del nga dera e kishës. E pason vetëm Murati. Hajredini del me vrap në drejtim tjetër. Pas pauzës së gjatë, ballistët dalin nga dera e kishës të menduar e të tronditur. Hyjnë në korridor Hermani, Shulci dhe Grabneri.)

HERMANI – Po mirë, Shulc, kur i futnit të burgosurit në kremator, a u tregonit të vërtetën?

SHULCI – U thoshim se do të hynin në banjë, për t'u dezinfektuar.

GRABNERI – Atëherë, me siguri, midis tyre s'ka pasur asnjë panik.

SHULCI – Ata ishin absolutisht të qetë.

GRABNERI – Dhe asnjeri nuk ofenduat, nuk rrahët, nuk torturuat si këtu?

SHULCI – Nuk ishte e nevojshme. Unë sillsha me mirësjellje. Hyja në barakën e karantinës, si në një mbrëmje ceremonie. I përshëndesja përzemërsisht: «Mirëdita, të dashur!» dhe thosha: «Ti, ti, ti edhe ti...» gjersa mbushej numri dyqind, treqind, pesëqind dhe vinin pas meje me qejf, sidomos ata që kishin temperaturë mbi dyzet.

HERMANI – A keni qenë kur u përdor fenoli?

SHULCI – Kam qenë që në kohën e benzinës. Ua bënim injeksionin në muskujt e zemrës. Po benzina nuk qe shumë praktike. Njerëzit mezi vdisnin pas tri katër orësh. Më vonë u shpik fenoli. Ai po, kishte rezultat të shkëlqyer. Vdekja vinte menjëherë.

HERMANI – Në krematorët e rinj, sa veta digjnit përnjëherësh?

SHULCI – Me qindra. Burra, gra, fëmijë...

GRABNERI – Edhe fëmijë?

SHULCI – Grabner, ti e di mirë që në kohë lufte të gjithë janë të rritur. Mos kam bërë ndonjë krim?

GRABNERI – Jo. M'u kujtuan katër fëmijët e mi.

HERMANI – Nuk di një hollësi: kush kushtonte më shtrenjtë, gazi apo fenoli?

SHULCI – Aty-aty. Një kilogram gaz kushtonte pesë marka. Me të mbytnim 250 veta. Në një kremator

të ri futnim 1000 kufoma, harxhonim katër kilogramë gaz, domethënë njëzet marka. Pra, me një markë asgjësonim 50 njerëz. S'ka ku të vejë më lirë.

HERMANI – Po vjen kolonel Myleri!

(Rojat, Grabneri dhe Shulci qëndrojnë gatitu. Hermani kalon në dhomë. Hyn kolonel Myleri. Nga dera e kishës hyn Xhevdeti dhe i del përpara.)

MYLERI – Rrugë më të keqe s'kam bërë në jetën time. Pa Rozinën do të isha dërrmuar fare. Më thoni, zoti Xhevdet, pas këtij mali, ç'ka më tej?

XHEVDETI – Male, zoti kolonel.

MYLERI – Po më tej?

XHEVDETI – Përsëri male.

MYLERI – Po më tej akoma?

XHEVDETI – Male gjithandej.

MYLERI – Nuk ju duket pak i mërzitshëm vendi juaj?

XHEVDETI – Jemi mësuar me të. Kështu na e ka falur zoti.

MYLERI – Manastiri s'qenka i keq, po është mbajtur keq. A ka vepra arti me vlerë?

XHEVDETI – Muret e kishës së vjetër janë plot me pikura, po unë s'jam marrë ndonjëherë me art dhe s'di t'i çmoj.

MYLERI – Do t'ju mësoj unë t'i vlerësoni... Donit të më thoshit gjë?

XHEVDETI – Të dërguarin e tyre e asgjësova...

MYLERI – Isha i sigurt për këtë. Megjithëse shpesh më mundon një pikëpyetje: gjer ku mund t'u besojmë shqiptarëve?

XHEVDETI – Shqiptarët s'janë të gjithë njëlloj, zoti kolonel!

MYLERI – Nuk e them për ju, zoti Xhevdet... Tani, dëgjoni porosinë e mia. Na duhen informata për Shtabin e Përgjithshëm, për qendrat e tjera komuniste, për dislokimin e forcave të tyre.

XHEVDETI – Si urdhëron! Do të bëjmë çmos e do ta zbulojmë edhe Shtabin e Përgjithshëm. Në Protogur

janë dy batalione të Brigadës. Në Zallisht dy të tjera. Në Bardhaj ka depo, punishte, infermieri.

MYLERI – Kam besim!

(Xhevdeti del nga ana e kishës. Myleri ngjitet në korridor dhe kalon në dhomën e parë, i ndjekur nga Hermani dhe Shulci.)

MYLERI – Si janë granatierët e mi? A kanë gjë për të pirë?

HERMANI – Rumin tonë.

(Shulci i mbush gotën dhe ia vë mbi tryezë.)

MYLERI – Më raportoni situatën!

HERMANI – Zona e manastirit u spastrua krejtësisht. Arrestimet vazhdojnë. Forcat tona dhe ato nacionale shtrihen në krejt krahinën...

MYLERI – Nuk e shihni se jeni shtrirë shumë? Sa herë kemi dështuar.

HERMANI – Këtu nuk e pranojnë luftën frontale. Ju e dini, her kolonel!

MYLERI – Ç'thotë oficeri anglez?

HERMANI – Kërkon të bisedojë vetëm me ju.

MYLERI – Po komunistët?

HERMANI – Nuk shihet as hija e tyre.

MYLERI – Të jemë objektivë. Nga çdo anë më vijnë lajme se granatierët e mi sulmohen në befasi. Në mënyrë të veçantë rrezikohen kolonat e autokolonat që transportojnë materiale e trupa për pikat e përhapjes. Pasiguria më e madhe është në këto rrugë malore. Ta hajë dreqi! Ky vend i mallkuar s'ka asnjë metër hekurudhë. *(Pi. Shulci ia mbush gotën përsëri.)* Ç'mendim keni, këto sulme të befasishme, janë të organizuara apo spontane?

HERMANI – Të peshuara e të përgatitura më së miri.

MYLERI – Atëherë mos thoni se nuk shihet as hija e tyre. Armët i marrin nga ne. Vishen me uniformat tona. Na vrasin me granatat tona. Sa kohë do të vazhdojë kjo gjendje? Forconi trupat e sigurimit. Përhapni rreth e rreth trupa specialë granatierësh dhe i ngarkoni rëndë me municion dhe ushqime.

HERMANI – Si urdhëron, her kolonel!

- MYLERI – Ç'thonë të arrestuarit?
- HERMANI – Nuk flasin.
- MYLERI – Asnjëri?
- HERMANI – Asnjëri.
- MYLERI – Shulci!
- SHULCI – Urdhëroni, her kolonel!
- MYLERI – Ju keni qenë në Osvencim. As me ju nuk e hapin gojën? (Shulci hesht.) Mirë. Do t'i bëj unë të flasin... Vini edhe një gotë mbi tryezë dhe sillni oficerin anglez. (Shulci vë gotën dhe kalon në korridor. Hermani nxjerr anglezin nga porta e e tretë dhe e fut në dhomë.)
- MYLERI – (Hermanit.) Dokumentet?
- HERMANI – (I jep dokumentet dhe armët e anglezit.) Urdhëroni!
- MYLERI – (Lexon.) Henri Barns, kolonel i Britanisë së Madhe.
- BARNSI – Jes!
- MYLERI – Uluni! (Barnsi ulet.) Ndërlidhës?
- BARNSI – Ndërmjetës.
- MYLERI – A s'kanë një kuptim këto fjalë?
- BARNSI – Në anglisht jo. Jam i dërguar si ndërmjetës nga Shtabi i Mesdheut me qendër në Kajro, nga gjeneral Uillsoni.
- MYLERI – Me Nacionalçlirimtaren?
- BARNSI – Edhe me nacionalistët.
- MYLERI – Tani e kuptoj ndryshimin e fjalëve. Tregoni, si ratë rob?
- BARNSI – Shtoja në Shtabin e Përgjithshëm...
- MYLERI – Në Shtabin e Përgjithshëm?! Domethënë, ju e dini se ku ndodhet shtabi?
- BARNSI – Jo. Nuk e di. E dinte shoqëruesi im.
- MYLERI – Si ndodhji që ratë në duart tona?
- BARNSI – Fati i keq i njeriut.
- MYLERI – U dorëzuat apo ju kapën?
- BARNSI – Besoj, ju kanë informuar me hollësi se u rrethova në një mulli dhe ngrita shaminë e bardhë.
- MYLERI – Përse e bëtë këtë?
- BARNSI – Qe fundi?

- MYLERI – Fundi juaj?
- BARNSI – Ju jeni ushtarak. Betejat kanë logjikën e tyre të rreptë.
- MYLERI – Domethënë, e pranoni që morët fund.
- BARNSI – Her kolonel! Kur humbet një betejë, s'do të thotë se humbi lufta.
- MYLERI – Ju anglezët e përdornin shpesh këtë mendim.
- BARNSI – Ai është një mendim i drejtë.
- MYLERI – Edhe kur dorëzoheni?
- BARNSI – Kjo s'ka rëndësi. Unë bëra të pamundurën.
- MYLERI – Herman! Na lini vetëm!
(*Hermani kalon në korridor.*)
- MYLERI – Tani jemi kokë më kokë. Pini! (*Pinë.*) Më thoni, ç'mendoni për komunistët?
- BARNSI – Ata, po, morën fund.
- MYLERI – Sipas të dhënave që kam, unë mendoj ndryshe.
- BARNSI – Askush s'ju ndalon të mendoni ndryshe. Mendimin tim e thashë. Dhe për këtë jam i sigurt.
- MYLERI – Ata vrasin granatierët e mi. Po fundi do t'u vijë nga ne.
- BARNSI – Dhe nga nacionalistët.
- MYLERI – I njoh. I kam në shërbim. Po ka një ndryshim: unë i hedh në luftë, ju i konservoni. Me sa duket, më shumë ju intereson e ardhmja e Shqipërisë.
- BARNSI – E ardhmja s'më intereson vetëm mua. Nesër, mbase, ata që sot janë armiq të tanë, mund të jenë aleatët tanë.
- MYLERI – Komunizmi o varroset sot, o kurrë!
- BARNSI – S'jemi profetë, po askush nuk mund të thotë se s'do të ketë luftë tjetër botërore.
- MYLERI – Mos harroni, se jemi në luftë me njëri-tjetrin. Dhe dijeni se ky vend do të jetë nën protektoratin tonë. Të dy jemi ushtarakë të një rangu, me një ndryshim: unë luftoj, ju jeni rob!
- BARNSI – E përsëris. Për mua kjo s'ka rëndësi. E imponoi situata.
- MYLERI – Këto janë armët tuaja? (*Kontrollon automatikun anglez.*) Qenka i papërdorur. Atëherë, a mund të

më thoni: Kush i vrau granatierët e mi te mulliri?

BARNSI – Ai që më shoqëronte.

MYLERI – Kush ishte ai?

BARNSI – Një komunist i thjeshtë.

MYLERI – Herman! (*Hyn Hermani.*) Më sillni partizanin dhe armatimin e tij.

HERMANI – Si urdhëron! (*Del.*)

MYLERI – Ju pëlqen muzika? (*Hap radion.*) Pini, zoti Barns! Keni rrugë të gjatë për të bërë! Do t'ju përcjellim që tani. (*Pinë. Hyn Hermani me armatimet dhe torbën e Metit.*)

MYLERI – (*Kontrollon torbën.*) Këtu ka vetëm një qepë dhe një copë gur.

BARNSI – Guri është bukë misri, buka e tyre e përjetshme.

MYLERI – (*Kontrollon pushkën.*) Pushkë e markës sonë. Cili nga ushtarët tanë do ta ketë pasur në fillim këtë pushkë?!... Përse nuk sillni partizanin?

HERMANI – Ai u gjend i vrarë, her kolonel.

MYLERI – Përse ka rezistuar kaq shumë?

BARNSI – Nuk donte të binte rob.

MYLERI – Domethënë, ata s'kanë marrë fund, zoti Barns. U vërtetuan fjalët e mia.

BARNSI – Ju lutem, shikoni revolverin tim.

MYLERI – (*E kontrollon revolverin.*) Ky revolver ka një plumb mangut. ...Përse?

BARNSI – Rrëshqita dhe m'u zbraz.

MYLERI – Doni të thoni aksidentalisht.

BARNSI – Po.

MYLERI – Shtitë mbi granatierët e mi?

BARNSI – Nuk duhet të keni as pikën e dyshimit.

MYLERI – Mos doni të thoni se keni qëlluar shoqëruesin?

BARNSI – Aksidentalisht!

(*Pauzë.*)

MYLERI – Herman!

HERMANI – Urdhëroni!

MYLERI – Merrni masa dhe niseni kolonelin Barns për Tiranë. Ia vlen barra qiranë 'ta këmbëjmë me robërit tanë.

HERMANI – Javol, her kolonel!

MYLERI – (I jep dorën.) Rrugë e mbarë, zoti Barns!

BARNSI – Faleminderit! (Nderon dhe del i shoqëruar nga Hermani. Myleri dëgjon muzikë. Pauzë e gjatë. Papritur mbyll radion dhe thërret.)

MYLERI – Shulc!

SHULCI – (Hyn.) Urdhëroni!

MYLERI – Do të më tregosh, para shpikjeve moderne, çfarë mjete ke përdorur në Osvencim kundër të internuarve?

SHULCI – Të ndryshme.

MYLERI – Sipas mendimit tënd, cili nga ata të ndryshmit ka qenë më me efekt.

SHULCI – Njëherë nxora nga baraka e karantinës të gjithë ata që mezi mbaheshin. I zhvesha në banjë lakuriq, i rreshtova dhe i detyrova të vraponin para meje. Mbaja po këtë shkop, një metër lart dhe i urdhërova ta kapërcenin këtë pengesë. Atë që s'e kapërceu, e vura te muri i zi i kampit dhe e pushkatova menjëherë. Atij që e kapërceu, i thashë: «Pa he, kërce edhe një herë!» Sigurisht, askush nuk kërceu për herë të dytë dhe të gjithë i vura te muri i zi, me duar mbi kokë e me shpinë kthyer nga unë.

MYLERI – Ti je një granatier me shpirt të lartë. Nuk i ke lënë njerëzit të vuajnë. Për krishtlindje ke një muaj leje. A të mjafton?

SHULCI – Po, her kolonel! Faleminderit!

MYLERI – Veproni edhe këtu kundër të arrestuarve me të njëjtin mjet! Dua patjetër të shtie në dorë Shtabin e Përgjithshëm.

SHULCI – Javol, her kolonel! (Del dhe shkon me vrap në bodrumin-burg.)

Perdja

Tabloja e katërt

I njëjti dekor. Është duke u gdhirë.

- ARISTIDHI – Hë, Murat, ka gjë?
MURATI – Këtej qetësi. Po diku u bë luftë.
ARISTIDHI – Kur e more rojën?
MURATI – Pa dalë Ylli i Sabahut.
ARISTIDHI – U bë luftë the? Ku vallë?
MURATI – Herë këtej, herë andej, s'e kuptoja mirë.
ARISTIDHI – Të kanë bërë veshët.
MURATI – Veshët i kam pizgë.
ARISTIDHI Unë s'kam dëgjuar gjë.
MURATI – Ku ndien ti! Ti bie dhe top!
ARISTIDHI – Jo, jo. Rri zgjuar. U bë luftë the?
MURATI – Po pra, kam frikë se mos çastisin këtu papritur.
Nuk u zihet besë atyre, të zënë si minjtë! Kështu e pësuam njëherë. U hodhëm nga penxheret siç ishim, vetëm me të mbathura.
ARISTIDHI – Vaj halli! Hap sytë, o trim! (Përgjon te dritarja e bodrumit. Të burgosurit janë zgjuar. Dëgjohen të shtëna armësh në thellësi.)
ARISTIDHI – (Te dritarja e bodrumit.) Si jeni, vëllezër? Si e ndieni veten? A keni uri? A keni etje?
GJYSHI – Kush është ai?
GJERGJI – Aristidhi.
BAKIU – Do të ishte mirë sikur nga xhinsi juaj të mos mbetej këmbë njeriu!

ARISTIDHI – Duroni edhe pak. Tani erdhi vërtet fundi.
DANIA – Shko i bjer kambanës, murg!

ARISTIDHI – I rashë sa u lodha! I rashë për Pëllumbin që u vra. I rashë për Metin e zi. Për të gjithë ata që u vranë i rashë. Po zoti s'dëgjon. Është shurdhuar. Prandaj po iki. Erdha t'ju jap lamtumirën e fundit. Ku do të vete, nuk e di. Po këtu s'qëndroj dot më. Këtu bie erë vdekje. Ndiej se do të më arrestojnë edhe mua. Ikën ata, erdhën këta. Tani po vijnë përsëri ata. Ikin vijnë, vijnë ikin dhe lënë prapa vdekjen. Merrini këto meshë të vjetra. Lamtumirë, vëllezër!

GJERGJI – Mbytu me gjithë meshët e tua me helm!

ARISTIDHI – Si të doni. I mbaj për vete. Rugën e kam të gjatë. Shumë të gjatë dhe të errët.

BAKIU – Sado të gjatë ta kesh rugën, përpara të pret vdekja, Aristidhi! (*Aristidhi zhduket nga dritarja.*)

GJERGJI – S'ishte më të. I ka hyrë frika.

GJYSHI – Çfarë the?

GJERGJI – I ka hyrë frika Aristidhit.

GJYSHI – Kush beson zotin ka frikë prej tij.

(*Pauzë.*)

(*Gjergji me Bakiun shikojnë nga dritarja.*)

BAKIU – S'ma merrte mendja se do të ndodhte kështu! Ngritëm njësitet e armatosura, siguruam popullin e bereqetin nëpër shpella e pyje, u lidhëm me shtabin partizan dhe papritur na zunë. Dy net duruam pa gjumë. Të kishim duruar edhe natën e tretë... Jo, përsëri do të na zinin. Apo i pata fajet unë, që s'i mbajta sytë hapur?! Tradhtari na e punoi. U binda se nuk u duhet zënë besë gjithë njerëzve. Nuk duhet. (*Pauzë.*)

GJYSHI – (*Përmendet.*) Ngrysu-gdhihu dhe lëmshi mbështillet...

GJERGJI – Erdhe në vete, gjysh?

GJYSHI – Pse? Ç'pata unë? Mua më grinë pleshtat. Ka me miliona.

DANIA – Këtu kanë ndenjor delet!

BAKIU – Si je?

- GJYSHI – (Me zë të ulët.) Afrohu këtu, kryetar.
- BAKIU – Po ty ç't'u desh që erdhe këtu si çjapi te kasapi?
- GJYSHI – (Me zë të ulët.) Edhe ti, kryetar, s'e kupton përse erdha?
- BAKIU – Boll' ishim. Ç't'u desh?
- GJYSHI – Nuk erdha vetëm për t'i pështyrë e për t'i fëlliqur beut revolen. Një rrugë e dy punë. (Shikon Kostaqin dhe i pëshpërit Bakiut diçka në vesh.)
- BAKIU – Vërtet?
- GJYSHI – Po, pra. Më dërguan shokët! S'kish kush ta bënte këtë punë më mirë se unë? Ai është spiun ballist.
- DANIA – Aristidhi?
- BAKIU – Shshsh! (Shikon Kostaqin.)
- GJYSHI – Ka bërë tradhti të lartë. U ka dhënë gjermanëve e ballistëve çdo sekret, ç'bëhet këtu, ç'forca ka, ku gjendet Shtabi, ku janë depot...
- GJERGJI – O, i poshtri, do mbytur në gjumë!
- BAKIU – Uleni zërin, se u zgjua tregtari.
- KOSTAQI – (Zgjohet.) Po mua ç'm'u desh të shisja kripë e defterë cigaresh në këto anë e në këto kohëra?! S'e kuptoj përse më arrestuan. Mirë ju, po me mua ç'patën? Unë s'jam ngatërruar me njeri.
- BAKIU – Edhe lakuriqët e natës një ditë vdesin.
- KOSTAQI – Kam emër unë. Më thonë Kostaq.
- GJYSHI – Lakuriqët e natës nuk vdesin, ngordhin.
- KOSTAQI – Ç'do të më pushkatojnë! O zot! Do të më pushkatojnë! Mirë ju, po unë, përse të shkoj bigariha? S'jam as plak, pesëdhjetë vjeç mbusha. Të vdesësh kot në këtë moshë.
- GJYSHI – Boll mendove për vdekjen, Kostaq. Sa je gjallë, përpiqu. Mendo për jetën.
- KOSTAQI – Ti që mendon për jetën, a mund të më thuash, se unë s'e di: ku fillon e ku mbaron ajo?
- GJYSHI – Jeta jote?
- KOSTAQI – Sigurisht, imja.
- GJYSHI – Në dyshek ka filluar dhe do të mbarojë te muri i zi. Po shpirtin s'do ta kesh të pastër si

ditën që linde! Ke bërë zullume, Kostaq. Dhe zullumet paguhen që në këtë jetë.

KOSTAQI – Ti tallësh, o plak. Unë dridhem, ti tallësh! Të gjithë talleni! Nuk dua të bisedoj me ju, nuk dua. *(Tërhiqet në thellësi të bodrumit.)*

(Hyn Shulci duke vërshëlyer lehtë, kalon korridorin, zbret shkallët dhe futet në bodrum.)

SHULCI – Çohuni!... *(Të burgosurit ngrihen ngadalë. I kontrollon një për një.)* Sot është dita e vdekjes... Ju thashë se po të heshtni, do t'ju pushkatojmë. Keni shkelur ligjin tonë ushtarak. Tani kam ardhur të zbatoj vendimin. Që të mos vuani, mirë ishte të përdorja fenol: Po këtu fenoli na mungon. *(Pauzë.)* E di që midis jush ka dhe ndonjë të pafajshëm...

KOSTAQI – Unë jam i pafajshëm. Unë jam krejtësisht i pafajshëm. Unë s'jam ngatërruar në këtë punë. Kam ndenjur mënjane. Jam marrë me tregti të vogël. Unë jam...

SHULCI – Pushoni!

KOSTAQI – Si urdhëron! Pushoj!

SHULCI – Të dimë kush je. I dimë punët e tua nën rrogoz. I pafajshëm! *(Pauzë.)* Megjithatë, nuk jemi vrasës. Po ju lëmë një mundësi shpëtimi. Meqë s'na treguat se ku gjendet Shtabi, dëgjoni mirë dhe shikoni këtë shkop. Po e mbaj në këtë lartësi... Kush e kapërcen, derën e ka hapur, është i lirë, le të kthehet në familje. Kush nuk e kapërcen, do ta pushkatojmë menjëherë te muri i zi. E qartë? E kuptuat, apo ta përsëris edhe një herë?

GJYSHI – Tallet me ne!

BAKIU – E ka zemrën në tabanin e këmbës dhe e shtyp me këpucët e tij.

SHULCI – E kuptuat! Atëherë fillojmë. Kush do të hidhet i pari? *(Pauzë.)* Ti, ti, apo ti? Nuk urdhëroj. Këtu është pa radhë. Le ta provojë kush të dojë. Hajde, filloni! *(Pauzë e gjatë.)*

KOSTAQI – Po hidhem unë...

SHULCI – Shumë mirë. Dikush duhet të fillojë... Hajde, ç'pret?

- KOSTAQI – Ja, tani. *(Matet shumë herë e më në fund vrapon. E kapërcen shkopin. Gëzohet.)*
- KOSTAQI – E kapërceva! E kapërceva!
- SHULCI – Bravo! Bravo!
- KOSTAQI – *(Të burgosurve.)* E kapërceva! E kapërceva!
E kapërceva! Shpëtova! Tani jam i lirë! I lirë!
- SHULCI – *(Kostaqit.)* I arrestuar! Pa hë! Kërce edhe një herë!
- KOSTAQI – Edhe një herë?... Unë? *(Tronditet.)*
- SHULCI – Po, po, ti!
- KOSTAQI – Unë?
- SHULCI – Ti!
- KOSTAQI – Si urdhëron! *(Pauzë.)*
- SHULCI – Ç'pret! Merr vull dhe hidhu! Është po ajo lartësi. Në rrugën që bën njëherë është lehtë të ecësh për të dytën herë. *(Kostaqi ngurron, pastaj vrapon, po shkopin nuk e kapërcen dot. Tmerrohet dhe shtang si i ngrirë.)*
- SHULCI – Ktheu nga dera!... Vëri duart mbi kokë!... Ec! *(Të arrestuarve.)* Tani ju vjen radha juve! *(Ë nxjerr Kostaqin prapa kishës. Dëgjohet një breshëri automatiku.)*
- GJYSHI – Gjermanoqenef! Gjete mish të ngordhur! *(Kolonel Myleri, më të dëgjuar breshërinë, ngrihet nga krevati dhe hap derën e dhomës.)*
- MYLERI – Ç'janë këto armë? Kush qëlloi?
- SHULCI – Unë, her kolonel! Po zbatoj urdhrin tuaj.
- MYLERI – Treguan gjë?
- SHULCI – Heshtin.
- MYLERI – Ndërprisni veprimin gjer në një urdhër të dytë dhe lajmëroni Xhevdet Frashërin të futë atje njeriun e vet!
- SHULCI – Javoll! *(Del. Bie telefoni.)*
- MYLERI – *(Në telefon.)* Shtabi i granatierëve... Kolonel Myleri!... Si?... Me forca të shumta?... Po ç'bëjnë granatierët e mi?... Rrezik rrethimi?!... Qëndroni me çdo kusht!... Po vij vetë! *(Lë telefonin. Duke u veshur.)* Grabner! Përgatisni Rozinën! Shpejt! Shpejt! Shokët tuaj atje po writen, ju mezi lëvizni! Herman!

Të vihet në gatishmëri luftarake gjithë manastiri!
(*Del duke u veshur në ecje e sipër. Grabneri dhe
Hermani vrapojnë duke u rënë bilbilave. Gjermanë
e ballistë vrapojnë nëpër manastir dhe dalin me
rrëmbim. Kur mbarojnë lëvizjet e ushtarëve, hyjnë
nga ana e kishës Xhevdeti e Aristidhi.*)

XHEVDETI – Si e ndien veten, Aristidh?

ARISTIDHI – Mirë. Dhe rrugën e shoh aq qartë, sa ju
shoh edhe ju.

XHEVDETI – Jam i bindur për këtë. Ata duan të jetojnë
si kafshë, megjithëse në përpiqemi t'i bëjmë nje-
rëz. Tani të erdhi radha. Ata s'flasin, po ti mund
t'i bësh të flasin. Duam të dimë ku ndodhet Shtabi
i Përgjithshëm. Me të zbuluar këtë, do të vij vetë
t'i pushkatoj. A ke çelës me vete? A ke armë?

ARISTIDHI – Si mund të rrijë Aristidhi pa çelësa e pa
armë në gjithë këtë manastir?
(*Xhevdeti e fut Aristidhin në bodrumin-burg dhe
del. Pauzë e gjatë.*)

GJYSHI – Më bëjnë sytë, apo është vërtet Aristidhi ynë ky?

GJERGJI – Ai është.

ARISTIDHI – Si jeni, shokë? Si je kryetar? (*Heshtje.*)
Gjergj?... Gjysh?... Jeni shurdhuar, apo nuk më
njihni? A ju thashë se do të më arestojnë. Ja,
më arestuan?

BAKIU – Ç'do këtu ti, Aristidh?

ARISTIDHI – Në burg asnjëri nuk shikon me këmbët e
veta. Dikush më kallëzoi, më zunë, siç ju zunë
edhe ju, dhe më sollën këtu.

BAKIU – Ku të zunë?

ARISTIDHI – Te mulliri, atje ku u vra yt bir.

GJERGJI – Meti? (*Pauzë.*)

ARISTIDHI – Nuk e dinit?! Më fal, kryetar, u shpejtova.
(*Pauzë.*)

BAKIU – Për një gjë ju lutem, shokë. Mos derdhni lot!
*Heq pallton që mban krahëve dhe ia hedh Gjerg-
jit.*) Vishe, se do të ftohesh! (*Pauzë. Aristidhit.*)
Dhe ti do të kishë bërë mirë të mos vije këtu.

ARISTIDHI – Më fal! Është e rëndë për prindin kur merr

vesh humbjen e djalit të tij të dytë. Po unë kujtova se ju e dinit.

BAKIU – Po ti përse erdhe këtu? Mos ke ardhur të na bindësh që të heqim dorë nga lufta?

ARISTIDHI – Kujtova se do të ishe më i durueshëm, kryetar.

BAKIU – Kush na bind se ty s'të kanë dërguar të tjerët?

ARISTIDHI – Kryetar! Të dija të fortë, dhe s'ma merrete mendja se nuk do t'i bëje ballë dhimbjes.

GJYSHI – Atë nuk e mposht dhimbja, po ti do të kishe bërë mirë të vije këtu i vdekur!

ARISTIDHI – Shokë të dashur! Unë s'po kuptoj përse po flisni. Pse nuk më pyesni ç'kam hequr, ç'kam vuajtur, ç'plagë kam?

GJYSHI – Je plagosur?

ARISTIDHI – Më keq akoma.

GJYSHI – Ku i ke plagët?

ARISTIDHI – Plagët e zemrës nuk duken, gjysh! S'qëndroj dot në këmbë.

GJYSHI – Ulu! Ulu!

(Aristidhi matet të ulet midis tyre.)

BAKIU – Jo këtu. Atje. Dhe na trego me hollësi si ke vepruar...

GJYSHI – Dhe si ia ke shitur shpirtin djallit.

ARISTIDHI – Gjysh! Ti s'je rrëmbyer kurrë në dhënie e mendimit.

GJYSHI – Ke të drejtë. Gjaku e nxeh njeriun.

BAKIU – Trego!

ARISTIDHI – Kam zbatuar vetëm urdhrat që më keni dhënë ju dhe shokët tuaj.

BAKIU – Aristidh, ne jemi pushtet i popullit dhe s'na gënjen dot. Ç'të shtyri që u bërë spiun i gjermanëve? A e di se me punën tënde të fëlliqur ke marrë më qafë gjithë ata njerëz dhe desh i vure zjarrin krahinës?!

ARISTIDHI – Shokë! Si mund të mendoni kështu?! Kështu mund të mendojë vetëm ai që dyshon! Hiqeni dyshimin! Jam shoku juaj! Ju kam dashur dhe ju dua! Ju kam shërbyer dhe lë kokën për ju! Ç'ju duhet dyshimi kur fshatarët po përvëlohen, kur

fëmijët po vdesin nga uria, kur shpellat janë mbushur me njerëz të mjeruar. Jeni pushtet dhe duhet të mendoni për shpëtimin e tyre, jo të dyshoni për shokët.

BAKIU – Tani, mjaft fole! Do të flasësh kur të pyesim dhe kur të ta jap unë fjalën.

ARISTIDHI – S'më besoni? Po pse unë kam besim te ju?

GJERGJI – Gënjen!

BAKIU – Ti s'ke besim as te ne, as te lufta jonë. Ti nuk i do fshatarët. Ti nuk e do popullin. Ti s'i ka dashur kurrë shokët. Ti je një spiun, një tradhtar.

ARISTIDHI – Nuk është e vërtetë! Ju betohem, për ideal!

GJERGJI – Ti s'ke ideal.

ARISTIDHI – Më dëgjoni mua...

DANIA – Më mirë ngordhim, sesa të të dëgjojmë ty.

ARISTIDHI – Shokë!

GJYSHI – Mos leh! Baltë e fëlliqur!

BAKIU – Njerëz si ti nuk e zbulojnë veten. E fshehin nën lëkurë gjersa vdesin... (U drejtohet gjyshit, Danes e Gjergjit.) Shokë! Ne jemi pushteti i kësaj krahine. Ne jemi përgjegjës për çdo gjë që ndodh këtu. Ne bëjmë ligjet e revolucionit dhe i zbatojmë.

ARISTIDHI – Ne jemi në burg. Ligjet i bëjnë të tjerët.

BAKIU – Pushteti i popullit është kudo. Këtë ti s'ke për ta kuptuar kurrë. Ti ke tradhtuar dhe tradhtia dënohet.

ARISTIDHI – Gjyq po më bëni? Ku jemi këtu, në gjyq?

BAKIU – Në gjyqin e popullit!

ARISTIDHI – Ne jemi të burgosur.

GJERGJI – Ne. Jo ti. Ti je para gjyqit të popullit.

ARISTIDHI – Vëllezër! Shokë të dashur. Mos më dënoni! E kuptoj, keni arsye të dyshoni. Po s'keni të drejtë të më urreni, e aq më pak, të më dënoni.

BAKIU – Ke gjë më për të thënë?

ARISTIDHI – Jo.

BAKIU – Kjo qe fjala jote e fundit... (U drejtohet shokëve.) Shokë! Ju pyes: ç'dënim t'i japim tradhtarit? (Pauzë e gjatë.)

GJYSHI – Me vdekje!

(Pauzë.)

DANIA – Me vdekje!

(Pauzë.)

GJERGJI – Me vdekje!

(Pauzë.)

TË ARRESTUARIT – *(Të gjithë përnjëherësh.)* Me vdekje!

BAKIU – Këshilli krahinor nacionalçlirimtar, i mbledhur në bodrumet e manastirit, në vjeshtën e tretë të vitit 1943, pasi shqyrtoi tradhtinë ndaj popullit e atdheut të qytetarit Aristidh Aristidhi, vendosi dënimin e tij me vdekje... Vendimi u zbatua në vend menjëherë!

(Të arrestuarit ndjekin Aristidhin, i cili i tmerruar troket në portë.)

ARISTIDHI – Jo!... Jo!... Jo!... *(Zëri i ndërpritet. Pauzë e gjatë. Dania e tërheq në thellësi të bodrumit. Pauzë.)*

DANIA – Kaq e pati! I gjeta dhe këtë turë me çelësa dhe një revolver.

Perdja

Tabloja e pestë

I njëjti dekor. Është e njëjta ditë. Rojat qëndrojnë në po ato vende. Në korridor janë roja Grabneri e Shulci.

GRABNERI – Fryn erë e fortë. Si duket, punët s'po shkojnë mirë. Sot paska një inat të madh në bark, koloneli ynë.

SHULCI – Kjo po i ndodh çdo ditë e më shpesh. Unë nuk do të dëshiroja të isha në vendin e tij.

GRABNERI – Na ka zvarrisur vazhdimisht maleve.

SHULCI – Ke qejf të shëtisësh në Kertnerstasse e në Ring me këpucë lustrafini, me papion në gurmaz e me kostum elegant?

GRABNERI – Dua të shoh fëmijët e mi...

SHULCI – Kujdes me këto fjalë, Grabner! Kolonel Myleri është dy herë më i madh se ne me moshë, fizikisht jep më shumë se ne së bashku.

GRABNERI – Fjalë artistike! Ai s'ka asnjë ngarkesë mbi kurriz. Të gjitha i mban mushka e tij, Rozina. Kurse unë thyhem më dysh nga ngarkesa e tërhiqem zvarrë... Kam katër fëmijë, Shulci!

SHULCI – Ç'të tha për atë që mbytën në burg?

GRABNERI – Na bëri përgjegjës ty dhe mua. «Ju, tha, duheni vënë te muri i zi.»

SHULCI – E përsërit shpesh këtë fjalë, kur është i zemëruar.

GRABNERI – Të thashë: fryn erë e fortë. Me sa duket, nuk jemi fort të sigurt në këto male...

(Pauzë. Gjergji e Bakiu shikojnë nga dritarja. Dania provon çelësat.)

GJERGJI – Ç'mbrëmje e kuqe! S'kam parë kurrë mbrëmje kaq të kuqe. Shiko si duket qielli? Sikur ka marrë flakë!

BAKIU – Është stina e tillë, o bir, stina e kuqe! *(Dëgjohen të shtëna armësh.)* I dëgjon armët? Luftohet fare pranë, diku përtej urës. I shoh gjermanët si janë alarmuar? Me sa duket, janë rrethuar. Kurse ballistët janë bërë erë. Kur ndiejnë rrezikun, ata zhduken menjëherë. Sonte partizanët i kemi këtu.

DANIA – U hap!... Shokë!.. U hap bodrumi!

BAKIU – Kujdes, djem, kujdes! Dil, Gjergj, ç'pret? Merr revolen e Aristidhit. *(Gjergji del dhe pas tij dalin të tjerët. Bodrumi errësohet krejt.)*

MYLERI – *(Kalon nga dhoma e tij në korridor.)* Ç'janë këto armë, Grabner?

GRABNERI – Nuk e di, her kolonel!

MYLERI – Shulc! Në ç'drejtim qëllojnë?

SHULCI – Më duket nga ura, her kolonel! Dhe pranë mureve të manastirit. *(Dëgjohen të shtëna, gjithandej.)*

MYLERI – *(Me vete.)* Kemi rënë në një kurth të papritur! Jemi rrethuar plotësisht! Ndiej erën e gjakut tonë. Edhe malet më duket sikur ecin kundër nesh... Shulc! Duhet të ikim nga ky vend. *(Shkon te varrezat.)* Këtu zoti dhe engjëjt, mund të na ndihmojnë përkohësisht. *(Dëgjohen të shtëna armësh më pranë.)* Dëshira për të jetuar nuk varet më as prej meje, as prej granatierëve, as prej komandës sime. *(Hyn Hermani.)*

HERMANI – Her kolonel, granatierët e lëshuan urën. Duhet të shpëputemi menjëherë nga vija e luftës, përndryshe, rrezik të asgjësohemi tërësisht.

MYLERI – Shpëputja nga armiku mund të bëhet vetëm kur të bjerë nata e plotë.

HERMANI – S'ndihen as nationalistët.

MYLERI – E kam thënë: gjer ku mund t'u besojmë shqiptarëve?!

HERMANI – Ballistët janë bërë urë për ne. Po tani, presioni është aq i madh, sa s'u zënë këmbët dhë. (Përkulet mbi një varr.)

MYLERI – Ç'bëni, Herman! Po dëgjoni bisedat e të vdekurve?

HERMANI – Të vdekurit as flasin, as pëshpërisin. Po këtu po zbuloj një gjë interesante. Këta janë varre të prindërve tanë të Luftës së Parë Botërore. Lexoni!

MYLERI – (Me vete.) Tani e kuptoj me hidhërim të madh gjendjen tonë të pashpresë!... Herman! Gjermanët kanë qenë gjithnjë ushtarë të mirë.

HERMANI – Nuk mund të jetë ndryshe, her kolonel!

MYLERI – Atëherë nisni përpara dhe hap rrugën me granata.

HERMANI – Ku vemi kështu?

MYLERI – Ende s'e ke kuptuar?... Në varr. (Errësim. Të shtëna armësh. Sokëllima lufte. Trumbeta thërret për sulm.) Shulc! Pushkatoji të arrestuarit. Hidhu dy granata.

SHULCI – Urdhëroni, her kolonel!

MYLERI – Si i le të të ikin të burgosurit?

SHULCI – Ka tradhti, her kolonel...

MYLERI – Ti do pushkatuar, Shulc! Laj gabimin! Çaj përpara me granata!

(Errësim. Të shtëna armësh. Trumpeta thërret për sulm. Dëgjohen sokëllimat e luftëtarëve: Para partizanë! Partizanë e popull mbushin oborrin, shkallët, korridorin. Në kambanore hipin Pandi e Cetka. Midis turmës janë Nerka me fëmijën në krah, këshilltarë, fytyra të njohura. Pranë Bakiut janë ish-të burgosurit e tjerë.)

BAKIU – Shokë! Ne s'u përkulëm përpara asgjëje. Asgjë s'na trembi, asnjë rrezik, as vdekja vetë. Ne s'pa-

tëm mëshirë as për pushtuesin e huaj, as për armikun e popullit. I shikoni dritat që vezullojnë gjithandej? I shikoni vëllezërit e gjakosur? Janë zjarret dhe gjaku, që e bënë këtë stinë të kuqe! Rroftë liria! Rroftshin partizanët e lavdishëm!
(Brohoritje. Grushtet e pushkët ngrihen lart.)

Perdja

**VAJZA
NGA FSHATI**

komedi

1953 .

Personazhet

VELI ÇERÇIZI – fshatar
FATIMEJA – e shoqja
LUMTOJA – e bija
XHELOJA – i nipi
TAZJA – e shoqja e Xhelos
DAUTI – fshatar
PALI – sekretar i byrosë së organizatës-bazë të Partisë
ZANA – punëtore
SELIMI – brigadier
KOSTA – normist
LENA – punëtore
ADEMI – drejtori i klubit

AKTI I PARË

Tabloja e parë

Oborri i një shtëpie fshati. Lumtoja tund me tundës.

DAUTI – Mirëmëngjes, Lumto!... Po tund?

LUMTOJA – Po tund, Daut, po tund.

DAUTI – Tunde, tunde... Më dërgoi nëneja të më japësh pak farë, se do të zërë kosin.

LUMTOJA – Ke enë?

DAUTI – Filxhankën. *(Ia jep.)* Të kam sjellë edhe këto...

LUMTOJA – Ç'janë këto?

DAUTI – Kumbulla.

LUMTOJA – *(E provon një kokërr.)* U, sa të tharta qenkan! S'u hëngërkan fare.

DAUTI – Po mua nëneja më ka thënë se çupave u pëlqejnë të thartat! ...Hipa te kumbulla e komshiut dhe mbusha xhepat. T'ia shpie Lumtos, mendova, se ajo i ha të thartat.

LUMTOJA – Janë të pabëra, Daut, dhe zeher fare. Ti s'i provove?

DAUTI – I provova dhe m'u mpinë dhëmbët. Thashë se më dolën me gjithë nofulla.

LUMTOJA – Po përse m'i solle mua?

DAUTI – Po nëneja, pra, thotë: Të thartat, për çupat!

LUMTOJA – A, nëneja!

DAUTI – Nëneja, për kokën e abait! Shpjerja Lumtos, tha, se i ha ajo.

LUMTOJA – Të falem nderit shumë! Po herë tjetër mos më sill.

DAUTI – Ç'ke ti, të sjell të ëmbla unë! Ka një mollcinkë ai komshiu, mjaltë e kaluar mjaltit.

LUMTOJA – Merre farën e kosit.

DAUTI – Pse?

LUMTOJA – Si pse? A ke ardhur për këtë?

DAUTI – U, iharrova. Mendje! Mendja bën kala, mendja bën hata!

LUMTOJA – Hajde, torollak, hajde!

DAUTI – Mirë e the, torollak... Turbullohem shumë kur rri vetëm me ty. Seç ma bën këtu në zemër, si një zilkë sahati, çërr çërr, çërr!

LUMTOJA – Nëneja të ka mësuar të flasësh kështu me mua?

DAUTI – Nëneja dhe abai dhe... zemra ime.

LUMTOJA – Zilka.

DAUTI – Po... Çërrr! Çërrr!... Aman, më qafsh, më trego a ishte mirë atje në aksion, në hekurudhë.

LUMTOJA – Shumë mirë ishte, Daut. Ti bëre gabim që s'erdhe.

DAUTI – S'më la nëneja...

LUMTOJA – Dhe abai...

DAUTI – Dhe abai, sigurisht. Oj, nga e di ti?

LUMTOJA – Zor i madh për ta kuptuar.

DAUTI – Dhe shkonit mirë, hë! Kishit miqësi të ngushtë me njëri-tjetrin! Punonit djem e vajza tok...

LUMTOJA – Ashtu është, Daut. Dhe po ta përsëris: bëre gabim që s'erdhe.

DAUTI – Po të vesh ti edhe një herë, mua më ke pas. Do të të ngjitem si rrodhe. Më plaçin sytë! Ja, do të shohësh. Le që, e mira e të mirave, është që ti tani të mos luash më nga fshati.

LUMTOJA – Pse?

DAUTI – Po se u rrite e s'ka lezet që vajza e rritur të bredhë fërc këtej, fërc andej. S'ka lezet as në

mbledhje të vesh. E mira e të mirave është të shtrohesh në shtëpi, të ndihmosh nënën dhe të përgatitesh...

LUMTOJA – Çfarë të përgatit?

DAUTI – Pajën... dhe... hë... te burri!... Ja, ta zëmë për shembull unë... zëre sikur... u martova, A-ha! S'lejoju unë jo aksione, jo mbledhje rinie, jo konferenca. Se ashtu fillojnë këto punë. Tëk aksioni, tëk mbledhja, tëk takimi, fyuuuu çupa iku!... Përpiqu ta sjellësh në brazdë, a-ha, laji duart! ...E more vesh? I them që bota ta dinë e të na njohin kush jemi.

LUMTOJA – Shih, shih! Paske mendime të bukura, ti, Daut.

DAUTI – Po ç'kujtove ti! Kam kokë këtu mbi supet unë, jo daulle. Dhe e kam plot. E sheh si ia bën? Dum-Dum!... Domethënë, «jam plot» thotë.

LUMTOJA – Jo, more?!...

DAUTI – Posi! Ja, dëgjoje me veshët e tu si ia bën. (*I bie kokës me grusht.*) Si qyp plot e përplot.

LUMTOJA – Jo, more?! Vërtet ashtu ia bën.

DAUTI – Posi! Ti mos shih shkollën. Unë vërtet e bëra një klasë katër vjet, po këtë e kam plot, sidomos me aritmetikë dhe me mendime që të pëlqejnë edhe ty. (*I afrohet dhe tenton t'i marrë dorën.*)

LUMTOJA – I k tani, se t'u bë vonë e të pret nëneja.

DAUTI – I ka, se iu ftoh edhe kosi, domethënë qumështi nënesë... Lumto, mos ki merak. Do të të sjell përsëri kumbulla që të bëjmë një çikë muhabet. A, ç'je një ti, ç'je një ti! Dhe thua se s'të pëlqejnë të thartat! (*Del.*)

LUMTOJA – Torollak i tëri! (*Merr tundësin.*) Torollak, torollak, po syrin ma ka vënë! Qyqja, s'e marr unë atë, sikur të vdes! (*Del. Hyjnë Veliu e Fatimeja që e kanë dëgjuar pas gardhit bisedën e të rinjve.*)

VELIU – I dëgjoje, grua? U hahet muhabeti. Mos kujto se unë jam ndonjë i mykur i kohës së Baba Gemos. E kam thënë, ata janë pjellë për njëri-tjetrin. E pe si i thoshte ai: «cërr, cërr!» Edhe ajo i përgjigjej: «zilka!» Ehu! Kanë ndryshuar kohët, grua. Rinia

e sotme merret vesh me gjuhën e zogjve, jo si ne, memecët e qëmoçëm.

FATIMEJA – Ore burrë, mos u nxito. Dhe mos u nxe! Më duket se të kanë lënë veshët. Ai ia bënte vërtet: «cërr, cërrr!». Po ajo jona e tallte më duket. I thosh «zilka» që në gjuhën e zogjve do të thotë: «lk, qërrohu!»

VELIU – Po «tund, tund» po «filxhanka», «po fara e kosit» çdo të thonë në gjuhën e zogjve? Kaq gjë s'e kupton?

FATIMEJA – Po kumbullat e tharta?

VELIU – Hë! Po kumbullat e tharta?

FATIMEJA – Po nëneja e abai?

VELIU – Po atij që iu mpinë dhëmbët... Po mendja hata e kala... Ahu! Janë të thella këto, valide. I thonë gjuhë zogjërishte!

FATIMEJA – Torollak!

VELIU – Kujt i thua torollak, ti, mua?

FATIMEJA – Lumtoja i tha atij.

VELIU – E pastaj? Në gjuhën zogjërishte torollak do të thotë... E di ti, moj, se ç'do të thotë?

FATIMEJA – Ku e di unë?

VELIU – A ç'je një ti, ç'je një ti! Po të thartat i harrove? Dëgjo këtu. Unë Zakos ia dhashë fjalën. Djalë më të mirë se Dautin, jot bijë s'ka ku gjen. Ta martojmë dhe shpejt, se ajo me atë kokë që ka, do të na turpërojë.

FATIMEJA – Zot je në këtë shtëpi dhe bëj si të duash, po më duket si e pamundur që çupa të pranojë për burrë atë torollak.

VELIU – Ta shpjegova se ç'do të thotë «torollak» në gjuhën zogjërishte. Tashti, bëji zë sat bije.

FATIMEJA – Mos u nxito, o burrë!

VELIU – Do ta thërrësësh, apo do një të thartë kokës!

FATIMEJA – (Thërret.) Lumto... Lumto, moj bijë!

LUMTOJA – (Duke hyrë.) Ç'do, nënë?

FATIMEJA – Të kërkon yt atë!

LUMTOJA – Përse?

- FATIMEJA – Do të të thotë ca gjëra të tharta. Po hap sytë! Kujdes e me mend!
- VELIU – Po hajde, moj çupë e babait.
- LUMTOJA – Urdhëro, baba!
- VELIU – Ulu këtu, pranë babait... Ashtu... U rrite, Lumto!
Që kur je kthyer nga aksioni, je rritur e më dukesh tjetër njeri! Të ka bërë mirë havaja e hekurudhës. Domosdo, domosdo, mirë do të të bënte.
- FATIMEJA – (Me vete.) Ç'ia sjell rrotull e rrotull. Thuaja troç!
- LUMTOJA – Ishim mirë atje, baba. Kishim gëzim, miqësi, dashuri, punë...
- VELIU – E di. Të tëra të mirat i kishit. Po prandaj të lejova të shkoje. Që të shihje botë me sytë e tu. Se babai vetëm ty të ka. Babai për ty është bërë copë, është sfilitur.
- LUMTOJA – E di. Të falem nderit! (E përqafton.)
- VELIU – A, sa mirë! Çfarë çupe kam unë! Engjëll! Engjëllushe?...
- FATIMEJA – A, ç'je një ti, ç'je një ti! E di mirë zogjërishten.
- VELIU – Tashti më thuaj, të mungon ndonjë gjë?
- LUMTOJA – Asgjë s'më mungon, baba.
- VELIU – Asgjë, asgjë?
- LUMTOJA – Asgjë.
- VELIU – Po pa mendohu një çikë, se mos të mungon gjë. Me siguri, të mungon diçka tashti që u rrite. Gjeje, ç'të mungon?
- LUMTOJA – Asgjë, baba.
- VELIU – Po, a e di ti, se unë brodha fshat më fshat, e s'gjeta dot më të mirë?
- LUMTOJA – Çfarë s'gjete?... Gomar?
- VELIU – Jo!
- LUMTOJA – Kalë?
- VELIU – Jo.
- LUMTOJA – Cjap?
- VELIU – S'e gjete.
- LUMTOJA – Dash?
- VELIU – Të lumtë! Të kam gjetur një dash me këmborë. Dautin e xha Zakes.

LUMTOJA – S'ta kuptoj këtë shaka, baba!

FATIMEJA – (Me vete.) E ç'ta dojë ajo Dautziun! Turshi ta vërë?

VELIU – Dëgjo këtu mirë. Ti u rrite. Të ka ardhur koha të bëhesh çift. Të gjithë zogjtë, kur rriten, bëhen çift! Dhe kam menduar për Dautin. Ai është djalë i mirë. Punon si ka. Familjen po ashtu, të mirë e ka. Me Luftën ishin të gjithë, si ne. Në një moshë jeni. Të dy të mirë jeni. Mbaroi kjo punë.

LUMTOJA – Baba!...

VELIU – S'dua llafe! E pat!

LUMTOJA – Po ai është fanatik...

VELIU – Një e një bëjnë dy. Grua, eja të gëzohesh edhe ti me ne! Që sot e tutje do të fillosh nga paja. Që sot e tutje s'ka më mbledhka e çy-çy-çy me çupat e me djemtë. Që sot e tutje je e fejuar. Këtë të xhuma do të kemi të shkelurat.

LUMTOJA – Baba, unë me të s'martohem. Ai është fanatik dhe i shëmtuar dhe shumë më i madh se unë... dhe i trashë nga mendja, torollak.

VELIU – O, ç'na the! Po pse, unë nuk isha fanatik? Isha, po jot ëmë më mori e s'tha gjë. Edhe i shëmtuar isha. S'ma sheh hundën që e kam sa një patëllxhan? Po jot ëmë s'tha asnjë fjalë për këtë derro hundë, u mësua dhe tani i duket e vogël. Edhe njëzet vjet më i madh se ajo isha. E ç'të keqe ka? Asgjë. Përkundrazi. U bëra për të edhe burrë edhe baba, domethënë, mësues. Dhe ja, tani, na shiko. Kemi ndonjë ndryshim? Unë plak, ajo plakë. Edhe unë i trashë isha nga mendja, torollak... A, jo, nga mendja isha i hollë. Tërë Çerçizajt kështu janë, të zgjuar. Foli, moj plakë!

FATIMEJA – Po, domosdo, si më ke munduar e si ma ke plasur shpirtin ti, nga të mos plakem! Ti më ke plakur, o i zi.

VELIU – Unë?! Unë të kam mbajtur këtu, në pëllëmbë të dorës, po nejse, të shkuara të harruara. Kështu do ta mbajë edhe Dauti i xha Zakes...

LUMTOJA – Baba, unë ta thashë mendimin. Ai s'më pëlqen... s'më pëlqen, xhanëm!

VELIU – Do të të pëlqejë më vonë. Ja ku e ke tët ëmë, pyete. Thuaji, moj grua, tregoi se si fillove të më pëlqesh e të më duash mua. Thuaja në vesh që të mos e dëgjoj unë.

LUMTOJA – Nënë, unë atë s'e marr, ta di se vdes.

FATIMEJA – Po s'ke se ç'bën, moj bijë e nënës. Këtë fat pate.

LUMTOJA – S'është punë fati. Unë atë s'e dua, dhe mbaroi.

FATIMEJA – Mos je pleksur me ndonjë tjetër, moj bijë? Thuaja nënës!

LUMTOJA – Përse më thua kështu, nënë? Po të kisha gjë, ty do të të tregoja menjëherë.

VELIU – S'kemi vajzë të tillë ne. E kemi të sjellshme, të urtë, të mençme. Asaj tani i vjen edhe pak zor, prandaj kundërshton. Fundja, është e bija e Veli Çerçizit dhe ka gjakun e tij, domethënë është ca zevzeke e ca noprane. E kemi ne Çerçizajt këtë të metë. Po ama, fjalën dysh prindërve s'ua bëjmë kurrë. Hajde të të përqafojë babai! Hajde të të urojë: të trashëgohesh!

LUMTOJA – Përqaфомë, po urimin mos e bëj. E ke kot.

VELIU – Kështu thua ti? Kot?

LUMTOJA – Kot.

FATIMEJA – Kot, o burrë, kot!

VELIU – Kot!... Po a ka burrë kjo shtëpi?... Ka, apo jo?

LUMTOJA – Unë nuk jam e marrë që të martohem me një copë mishi me dy sy, siç është djali i xha Zakes. Jua thashë: është fanatik, veç të tjerave, dhe s'e dua...

FATIMEJA – Po dale, moj çupë, si flet kështu?

LUMTOJA – Në e do ti, merre për vetë!

FATIMEJA – O, kjo lajthiti më duket!

VELIU – Epo dëgjoni. Mua më thonë Veli Çerçizi. Këtu jam unë zot dhe do të bëhet ajo që them unë. Pikë! Bëni ç'të doni! Hidhuni përpjetë! Mbytyni! Ti do të bëhesh grua e Dautit të xha Zakes!

LUMTOJA – Kurrë!... Kurrë!
(Hyn Xheloja. Thërret.)

- XHELOJA – O xha Veli!
- VELIU – Po ti ç'pëllet kështu, si gomar?
- XHELOJA – Të kanë ardhur mysafirë nga qyteti... Po nuk e marr vesh se kush pëllet.
- VELIU – Mysafirë nga qyteti?... Po le të urdhërojnë! Ku janë?...
- XHELOJA – Po ç'thërret kështu? Unë s'jam shurdh. Ja, sa të mbarojnë punë në këshill, do të ta zënë konakun.
- VELIU – Sa veta bëhen?
- XHELOJA – Katër. Tre djem e një vajzë.
- VELIU – I njohe?
- XHELOJA – S'ua kisha parë fytyrat ndonjëherë... Po allahile, ç'kishe që çirreshe ashtu? Vetë çirresh, mua më thua: pse pëllet?
- VELIU – Po ja, bisedonim për atë punën që di ti.
- XHELOJA – Hë, mbaroi?
- VELIU – Ç'të të them, o nip. Për mua është e mbaruar, po kundërshton jot kushërirë.
- XHELOJA – Po ç'bëhesh merak kur është e mbaruar për ty. Përdridhja kokën asaj.
- LUMTOJA – Sa kollaj!
- XHELOJA – Pse zor të duket, a? Pa shko e pyete time shoqe. Sa herë ia kam përdredhur qafën, ja kështu si të zogut. Jemi burra ne, s'jemi fustane e çitjane. Turp të kesh, që ia kthen fjalën babait!
- FATIMEJA – Mos e ndiz sherrin përsëri, o Xhelo, hë të lutet jengjeja, se mezi u platit.
- LUMTOJA – Turp të kesh ti, që sillesh me tët shoqe si ndonjë hoxhë i ndyrë!
- XHELOJA – Kushërirë! Mbylle atë të shkretë!
- LUMTOJA – Si, ore, i ke thënë se do ta mbulosh me çarçaf.
- XHELOJA – I kam thënë, e do ta mbuloj. Jemi burra ne, s'jemi fustane e çitjane! Unë iki ushtar sot. Si mund të dalë ajo zbuluar, kur s'e ka burrin në shtëpi, po në ushtri.
- LUMTOJA – Shiko se po e mbush kupën, Xhelo. Në mble-

- dhjet e rinisë s'e lë të vijë. Tani do ta mbulosh edhe me çarçaf. Të lumtë!
- XHELOJA – Se ç'bëj unë me gruan, është puna ime, dhe llogari s'i jap askujt.
- FATIMEJA – Tërë burrat një feçkë kanë!... More, Xhelo, lëre këtë muhabet, e më thuaj a u bërë gati për ushtri?
- XHELOJA – Po, moj teze, s'ma sheh kokën që e kam bërë si lajthi e qëruar. Do të nisem sot me ata shokët që kanë ardhur nga qyteti.
- FATIMEJA – Të vesh e të vish shëndoshë!
- XHELOJA – Faleminderit!
- VELIU – Ushtarllëku të hap sytë sot. S'është si qëmoti, që gomar vije e gomar ktheheshe. Mos na turpëro, o nip!
- XHELOJA – Ç'është ajo, xhaxha! Çerçizët s'kanë bërë kurrë turpe. (*Hyn Tazja me një çantë shpine.*) I sille, moj?
- TAZJA – Si urdhëron!
- XHELOJA – I vure të tëra? Mos harrove gjë?
- TAZJA – Jo.
- FATIMEJA – Si je, Taze?
- TAZJA – Të puth dorën, mirë, faleminderit!
- VELIU – Të të vejë Xheloja ushtar shëndoshë e mirë, moj nuse!
- TAZJA – Faleminderit!
- XHELOJA – Taze e ka emrin, taze është, e jo bajate. Apo jo, moj jengje?
- FATIMEJA – Ka gjetur tenxherja kapakun.
- XHELOJA – Mirë e the, tenxherja kapakun.
- LUMTOJA – Taze, po me gjithë mend do të mbuloresh me çarçaf?
- TAZJA – Do ai.
- LUMTOJA – Po ti ke qejf?
- TAZJA – Do ai.
- LUMTOJA – Më thuaj: ti a ke qejf?
- TAZJA – Do ai.
- XHELOJA – Ja kujt i thonë grua Taze, o jo bajate, si ti.
- FATIMEJA – Xhelo, mos ma shaj çupën.
- XHELOJA – Unë po e lëvdoj.

- LUMTOJA – Fanatik!
- XHELOJA – Ajo është puna ime.
(Hyjnë Pali, Zana, Selimi e Kosta.)
- PALI – A pret miq, Veli Çerçizi?
- VELIU – Bujrëm, urdhëroni! Dera e Çerçizëve është gjithnjë e hapur për miqtë!... Pa dale, cilin po shon kështu? Po ti, Pali, qenke!
- PALI – Unë, i tëri.
- VELIU – Përmbys ndonjë gjë, grua! Shpejt pak miell që ta lyejmë! (Përqafohen.) Që kur s'jemi parë?
- PALI – Që në kohë të luftës, kur punonim e luftonim së bashku.
- VELIU – Po. Që në kohë të luftës.
- PALI – Si je, nënë?
- FATIMEJA – O, sa qenke rritur, Pal i nënës! (Përqafohen.)
- PALI – Lumto! Si je ti? A e kujton ndonjëherë hekurudhën?
- LUMTOJA – Atë s'do ta harroj kurrë! (Përshëndeten.)
Zana, po ti si je?
- ZANA – Mirë! (Përqafohen.)
- LUMTOJA – Sa mirë bëtë që erdhët.
- ZANA – Na kanë dërguar si ekip fshatrave për punët e bujqësisë, për kolektivizimin. Kemi dy javë këtej. Sot do të kthehemi në qytet.
- VELIU – A, Zana, Zana? Si Zanë e vërtetë je! (E përqafohen.)
- PALI – Këta, ti xha Veli, nuk i njeh. Ky është Selimi, brigadier në fabrikën e tekstileve dhe ky tjetri Kosta, normist, po që merret edhe me muzikë. Qemanen s'e heq nga dora!
- VELIU – Qofshin shëndoshë! Si jeni, rini? (Përshëndetet.)
- SELIMI E KOSTA – Faleminderit, xhaxha!
- VELIU – Edhe këta ju s'i njihni. Ky është Xhehoja, im nip, djali i vëllait, dhe kjo Tazja, e shoqja. (Përshëndeten.)
- XHELOJA – Unë sot shkoj ushtar, o shokë. Gjer në qytet do të vij me ju.
- VELIU – Epo, urdhëroni! Po rrimë këtu përjashta, se brenda bën nxehtë!

(Gratë shtrojnë rrogozë e velenxa dhe i gostitin me pije.) Epo mirë se më erdhët! Të gëzuar ju paça të gjithëve! Të rroni e të përparoni! Parti u bëftë gjithë bota! (Pi gotën.)

PALI – Të lumtë goja, shoku Veli! Për të mira e me gëzime! (Pi.)

SELIMI – Gëzuar, xhaxha! Gëzuashi ju të tjerët! (Pi.)

KOSTA – Ushtar, udhëmbarë! Të vesh e të vish shëndoshë. (Pi.)

XHELOJA – Faleminderit! Me plot! (Pi.)

VELIU – E sheh atë qafë mali?... E mban mend?

PALI – E si mund ta harroj. Ti atje më shpëtove jetën.

VELIU – Ishe çunak, pa përvojë atëherë. Kurse tani...
Ku punon?

PALI – Në fabrikë.

KOSTA – E kemi sekretar të byrosë së organizatës së Partisë, xhaxha.

VELIU – Komisar, si në kohën e luftës. Shumë mirë!

PALI – Po si shkoni këtej? Vë re se nuk po bëni ndryshime të shpejta. Ngadalë ecni, xha Veli. Ngadalë!

VELIU – Fshat ne. I kemi rrënjët shumë të thella. Sa t'i gjesh, sa t'i lëvizësh, sa t'i shkulësh!... S'është lehtë.

PALI – Edhe e pamundur s'është, ama.

VELIU – Ashtu, xhanëm, ç'tha Partia e s'u bë, po çdo gjë do kohën e vet. Ja, p.sh., ky shoku Kostë, mund të ketë qejf të hajë rrush, po rrush s'ka tani. Tani ka mana. Urdhëroni, hani!

KOSTA – Xha Veli, unë s'dua rrush. Unë dua të bijën e rrushit.

VELIU – Ore, ushtar, po mbushja ore me raki, se i pihet djalit.

XHELOJA – Si urdhëroni! Tak-fak! Me të bijën e rrushit!

KOSTA – Gëzuar, o i zoti i shtëpisë! E paç shtëpinë plot me miq e me raki. (Pi.)

VELIU – Po s'më thatë, ç'u lodhët gjer këtej?

PALI – Për punët e bujqësisë, xha Veli, të kolektivizimit që ka ngecur në këto zona, për luftën kundër paragjyqimeve, besimeve të kota, fanatizmit, mosbe-

simit dhe mohimit të të drejtave të femrës. Me një fjalë, për agjitacion e propagandë. Sjellim fjalën e Partisë dhe mësojmë nga ju... Keq s'jeni, ka ca javashllëke, por ama me gruan nuk i keni mirë punët. Vazhdoni si qëmoti, fejesa në djep, fejesa me zor, martesë me interes, me para, me pleq. S'janë të mira këto, xha Veli! Apo e kam gabim?

VELIU – Ti e di. Unë me Partinë, gjithnjë.

PALI – S'them për ty, po për të tjerët. Jo për të gjithë, po për ata që janë vërtet të tillë, që shkojnë gjer atje, sa nuk i lejojnë gratë e vajzat të venë në mbledhje.

LUMTOJA – Si Xheloja, për shembull.

KOSTA – A? I tillë qenke ti, o ushtar?

XHELOJA – Është puna ime!

KOSTA – Shumë keq!

LUMTOJA – Ka edhe në sojin e Çerçizëve prindër që duan t'i martojnë vajzat me forcë, kundër dëshirës së tyre.

KOSTA – Shumë keq!

FATIMEJA – Lumto, kyçe!

VELIU – Na lini të bëjmë pak muhabet.

LUMTOJA – Dhe burrat ua gjejnë vajzave sipas midesë së tyre.

KOSTA – Keq!

PALI – Edhe vajzat duhet të luftojnë, të mos nënshtrohen, t'i mbrojnë të drejtat e tyre me zemër. E dini ç'bëri një malësore? Donin ta martonin me zor. E kërcënuan keq, po ajo iku drejt e në Tiranë, në Komitetin e Partisë dhe hyri në fabrikë. Mirë bëri? Në atë gjendje që ishte, mirë bëri. Më vonë u bindën edhe prindërit, hoqën dorë nga fejesa dhe u pajtuan. Me luftë në front të gjerë, ballazi e me krahëmarrje, zhduken këto zakone prapanike që na lënë pas. Apo jo, xha Veli!

VELIU – (Me vete.) Medet, ç'na gjet!

LUMTOJA – Ashtu them edhe unë. Nuk duhet të nënshtrohemi më!

- FATIMEJA – (Me vete.) Iu ngrit mendja kësaj! Vaj halli!
Po edhe atë Dautziun ç'ta dojë?
- ZANA – Ti, Lumto, besoj, i ke punët mirë me prindërit e tu.
- LUMTOJA – Shumë mirë, sidomos me babanë.
- PALI – Epo, domosdo, xha Veliu ka qenë partizan i orëve të para. I tillë është dhe i tillë do të mbetet.
- ZANA – Nuk duhet harruar edhe Lumtoja. Me punën e saj këmbëngulëse, ajo i ka bindur prindërit që të heqin dorë nga zakonet prapanike. Apo jo, xha Veli.
- VELIU – Ashtu, çupë e xhaxhait... Na ka bindur, posi... S'kemi më zakone të këqija... Epo, ndonjë mardha e vogël në na ka mbetur, do ta shkullim edhe atë, ja, me ndihmën tuaj.
- FATIMEJA – (Me vete.) A, ç'je një ti, ç'je një ti? E dredh!
- VELIU – Vetëm me atë malësoren, s'jam në një mendje. S'duhet të arratiset vajza nga shtëpia, se delen që ndahet nga vatha, e çan ujku.
- PALI – Ashtu është. Po kur ia sjellin në majë të hundës dhe e kërcënojnë dhe s'ka si të shpëtojë, mirë bën që shkon. Ajo nuk arratiset dhe nuk është e veçuar nga njerëzit. Shkon e kërkon ndihmë te Partia. S'është si delja që kërkon vetëm bar...
- VELIU – Po janë ca gjëra ama, që ti Pali s'mund t'i kuptosh, se je i ri, i pamartuar, pra, pa fëmijë. Po ti, more shoku Kostë, a je i martuar?
- KOSTA – Beqar jam, beqar do të mbetem.
- SELIMI – Beqarë jemi të katër!
- XHELOJA – Shyqyr që fole një fjalë ti, shoku Selim. Zërin e paske bilbil. A ia marrim njëherë?
- VELIU – Prit ti! Ka kush jep urdhër për këngë. Pra, beqarë, domethënë dhembën e fëmijës nuk mund ta keni. Të bëhi me fëmijë, sidomos me çupa, pa të shihni. Atëherë urdhëroni e të fjalosemi! Pa, kë-shtu, pa fëmijë si jeni ju, ne i themi «ku rafsha, mos u vrafsha!»
- PALI – Mbase ke të drejtë, xha Veli. Po mësimet e Partisë janë një për të gjithë, pleq e të rinj.

VELIU – Tashti merrjani! Do më bëhet qejfi!

KOSTA – Aman, o xhaxha, ta marrsha unë, se vdiqa për t'ia marrë njëherë! (I bie kitarës.) Është këngë e re. Dëgjoje, xha Veli! (Shokët e shoqërojnë.)

*Gufoni, oj gjokse rinore,
për nënën e dashur Parti,
me emrin e saj plot fitore
e ngritëm qytetin e ri.*

*Tezgjahet plot gaz po 'punojnë,
po endin gjithmonë pa pushim
dhe zemrat me to po këndojnë
për ty, o e shtrenjta Parti.*

VELIU – Ju lumtë, djem! Më kënaqët e më gëzuat. Hë, ore nip, kruaje zërin!

XHELOJA – S'ka kush ma mban, xhaxha.

FATIMEJA – Jot shoqe...

XHELOJA – Jeni në vete!

LUMTOJA – Hë, Taze! Ke zë të bukur ti dhe bukur këndon.

XHELOJA – Mbylle, moj atje!

PALI – Epo, përse folëm gjer tani?

XHELOJA – Epo, llafi llaf e puna punë...

PALI – Xhelo, më duket se qenke vërtet fanatik.

XHELOJA – Ajo është puna ime.

KOSTA – Hajde, se e gdhend ushtria atë.

XHELOJA – Edhe ajo është puna ime.

VELIU – Ama, ç'na çave kokën ti, me këtë «është puna ime». Sikur ne të tjerët, punët i kemi të kota. Të tëra punët tonat janë, apo jo, o shokë?

PALI – Drejt, xha Veli. Fjalë me mend!

XHELOJA – Po ç'ne, bre xhaxha! Pse më keqkupton! Edhe ne ashtu themi për Tazen. Edhe ti ashtu thua... për Lumton!

VELIU – Mbylle!

XHELOJA – E mbylla!

VELIU – Jo, more hajvan, hape!

XHELOJA – Si të thuash zotrote. Ja, e hapa.

VELIU – Javash se mos të hyjë ndonjë mizë. Merrja!

XHELOJA – (Këndon. Tazja ia pret, të tjerët mbajnë iso.
Fjalët janë krejt të kuptueshme.)

Gjeta, moj, gjeta
Një lajthi plot kokrra,
Mora, moj, mora,
Mora, çava njëzë.
Brenda, moj, brenda
Gjeta një thëllëzë.
Iku, moj, iku
Iku, mori malë,
Dhashë, moj, dhashë
Dot prapa s'i rashë!

TË GJITHË – Gëzuar! Si goja zemra! Rrofsh, o Xhelo
ushtari! Edhe ti, Taze! (Urime.)

KOSTA – Hajde, ore, hajde! Ç'bën populli, domethënë
dashnori! Çan një lajthi, brenda gjen një thëllëzë,
bën ta marrë, ajo fluturon dhe ai e lë... Jo. Unë
atë thëllëzë do ta ndiqja, ditë e natë, gjer në
fund të dynjasë, do ta zija, do t'i thosha: Të
dua për grua dhe... buzë më buzë! (Puth kitarën
duke parë Velin.)

VELIU – (Si me vete.) Hajde, normist, hajde!

KOSTA – Rrogën marr si normist, xhaxha. Po vetë jam
artist.

VELIU – Dukesh, bir i xhaxhait, dukesh! Rrofsh! Lum ata
që të kanë. (Vështron të bijën, i hedh një romuz.)
E? Ka dhe të tillë... që venë pas lajthive, lajthitin
pas lajthive...

XHELOJA – Xhaxha, pas lajthive të qëruara...

VELIU – Të qëruara, lëre mos e nga!

XHELOJA – Si koka ime. Pa shiko? (Heq kapelën, i del
koka e rruar.)

VELIU – Vëre kapën, more hajvan! Ti s'merr vesh ç'bëhet
këtu. Po ishallah, ajo ushtria t'i sjell mendtë në
vend.

PALI – Xha Veli, tani do të na falësh. Sot duhet të jemi

në qytet e të raportojmë për punën: ç'pamë,
ç'bëmë, ç'mësuam...

VELIU – Mirë, veç mos na nxirrni bojën!

PALI – Mos e thuaj atë fjalë.

VELIU – Gjithë me të mirë ti, o Pali, me të mirë e drejt në
xhenet. Kurse këtë Selimin e paske fjalëpakë.

PALI – Ka hallet e punës. Është brigadier. Ka dyzet vajza
punëtore.

VELIU – Jo, more! Unë një kam e më luajti nga mendtë.
(Përshëndeten e përqafohen.)

XHELOJA – Kujdes Tazen, xhaxha. Amanet ty ta lë.

VELIU – Hap sytë! Ushtria s'ka dredhira! Mos na turpëro!

XHELOJA – Ç' thua kështu, xhaxha!... Taze! Rri me shën-
det dhe ç'të kam thënë, vath në vesh.

TAZJA – Si urdhëron!

XHELOJA – S'ka «femrat në mbledhje» dhe ti oburra!

TAZJA – Si urdhëron!

VELIU – Udhë të mbarë, bir! Dilni, mos na harroni!

FATIMEJA – Udhembarë, Pali! Me ato që the ti, ia ngrite
mendjen Lumtos. (Dalin të gjithë. Hyn Dauti.)

DAUTI – Paskan pasur mysafirë. Qenkan ata punëtorët e
qytetit. Po vjen. (Hyn Lumtoja.) Lumto! Të kam sje-
llë nga ato... kumbullat... e tharta!

LUMTOJA – A, u thartofsh ti! Lipsu me gjithë to! Ik!
Ik! (Dauti del.) Po nguli këmbë babai, një ditë
edhe unë do të marr këtë rrugë.

Perdja

AKTI I DYTE

Tabloja e dytë

*Këndi i kuq i një reparti të fabrikës së tekstileve.
Janë Lumtoja e Zana.)*

LUMTOJA – Zana, dëgjo ç'më shkruajnë. (Lexon letrën.)
«E dashur bijë! Që atë ditë që krise e ike si e marrë, neve s'na hyn gjë prej gjëje në sy. Kemi zënë këndin dhe numërojmë ditët që na kanë mbetur. Se që do të vish, këtë e dimë, siç e dimë që Dauti do të bëhet burri yt. Na turpërove, moj cipëplatur. Po prapë të kemi bijë dhe të këshillojmë që të kthehesh në shtëpi...»

ZANA – Nuk heqin dorë akoma. Çudi.

LUMTOJA – Nëna është me mua, po babai ka kokë më vete. Ai ia shtiri në mend Dautit që të më rrëmbente. Ke parë ti! Dhe më erdhi torollaku në mes të natës për të më rrëmbyer.
(Hyn Pali.)

PALI – Ç'po bëni?

ZANA – Lumtoja ka marrë letër nga shtëpia.

PALI – Të shan përsëri xha Veliu?

ZANA – E shan dhe shpreson që Lumtoja do të kthehet për t'u martuar me atë Dautin e marrë.

PALI – Edhe kur isha unë, kështu më tha. Po, të jeni të sigurt, se një ditë edhe ai do të bindet që e ka gabim dhe do të kërkojë të falur.

LUMTOJA – Ke qejf ta dëgjosh letrën?

PALI – Po të mos ketë sekrete.

LUMTOJA – Jo, jo, s'ka. (Lexon letrën.) «Ato që na dërgove me shokun Pali, i morëm. Unë, nëna, e qepa fustanin. Kurse unë, yt atë, u gëzova për paratë. Po më shumë do të gëzohemi kur të kthehesh, se na e ke lënë shtëpinë bosh e na e ke nxirë jetën. Sumbull, sumbull, e tëra të zezat grumbull mbi kokën tonë ranë. Po të kthehesh, do ta zëmë sikur s'ke ikur fare.» (Lumtos i vjen rëndë të lexojë më tej Zana ia rrëmben letrën nga dora.)

ZANA – (Lexon.) «Dhe ai trimi Daut, të pret e të fal çdo gjë... Letrën e shkrova unë ush... ush...» S'e lexoj dot.

LUMTOJA – (Lexon.) «Ushtar Xheloja, që jam me leje pranë Tazes e që mësova shkrim në ushtri. Dëgjo, Lumto! Fjalët e xha Veliut futi në një vesh e nxirri nga tjetri. Të fala ushtarake Palit, Zanës, Selimit, Kostës dhe kokë më kokë të gjithëve, që t'u bënë motra e vëllezër. Ushtar Xheloja.»

ZANA – Xheloja? Është ai fanatiku që thoshte «Është puna ime»?

LUMTOJA – Ai është.

PALI – Fanatik ishte, po ushtria e ka zdrugitur. Sa mirë të këshillon! Zhvillohet jeta dhe njerëzit pasurohen shpirtërisht e mendërisht. Ç'ke që mendohesh, Lumto?

LUMTOJA – Më dhimbsen! Si dëgjon ç'shkruajnë? Ua kam lënë shtëpinë bosh dhe ua kam nxirë jetën.

PALI – Shtëpinë bosh ua ke lënë, vërtet, po jetën s'ua ke nxirë, përkundrazi...

LUMTOJA – Babai s'e kupton.

PALI – Do ta kuptojë një ditë. Kur t'u shkruash, bëju të fala edhe nga unë. U thuaj se muajin tjetër do të më kenë përsëri mysafir.

ZANA – Edhe nga unë. Mos harro! (Pauzë.)

PALI – A e dini që filatura po ua kalon. Po s'i zhdukët dobësitë, flamuri do t'i mbetet asaj.

ZANA – Do t'ia marrim, shoku Pali!

LUMTOJA – Garën do ta fitojmë ne, patjetër.

ZANA – Kemi dhënë fjalën para gjithë fabrikës.

PALI – Të shohim! (Shikon fletoren e shënimeve të Lumtos.) Lumto, pa na thuaj, çfarë dëmi sjell prishja e mekanizmave luftarakë në tezgjah?

LUMTOJA – Fluturon sovajka.

PALI – Po më?

LUMTOJA – Këputen fije të shumta, pëlhura nuk endet.

PALI – Cila është metoda më e mirë e lidhjes së nyjave?

ZANA – Ti po e pyet si në kurs.

LUMTOJA – Metoda e lidhjes kryq.

PALI – Pse?

LUMTOJA – Se nyja bëhet e vogël dhe fijet lidhen shpejt.

PALI – Sa pëlhura end në 8 orë një tezgjah?

LUMTOJA – 25 metra. Por, po të ketë shpejtësi, arrin gjer në 40 metra.

PALI – Meriton notën 5.

LUMTOJA – S'e mora vesh, Pali, pse m'i bëre këto pyetje?

PALI – Ja pse i bëra. Megjithëse këto i dini dhe i keni vënë në praktikë, brigada juaj është prapa.

LUMTOJA – Për këtë s'kam faj unë.

PALI – Mendoj se përgjegjësia bie mbi të gjithë.

ZANA – E pse mbi të gjithë?

PALI – Ju jeni një brigadë, një kolektiv. Njëri përgjigjet për të gjithë e të gjithë për një.

ZANA – Për brigadën le të përgjigjet Selimi, ai është brigadier.

PALI – Sigurisht, Selimi ka përgjegjësi kryesore. Por, po të mos e shikoni ju punën e njëri-tjetrit si punën tuaj, brigada ka për të mbetur prapa e s'ka për të qenë kurrë brigada e dalluar e kualitetit të fortë, siç është, p.sh., ajo e Qemalit.

ZANA – Qemali është i zoti.

PALI – Po brigadieri juaj, Selimi, a s'është i zoti?

ZANA – I zoti është, por për veten e tij. S'na ndihmon e punën s'di ta organizojë.

PALI – Ju kritikojeni.

LUMTOJA – Ta kritikojmë?! Të tjerët e kritikojnë por unë s'mundem.

PALI – Pse?

LUMTOJA – Selimi di shumë më tepër se unë.

PALI – Po a qabon?

LUMTOJA – Gabon.

PALI – Kritikojë, pra.

LUMTOJA – S'e di. Nuk mundem.

PALI – Lumto. Ti ke pak kohë në fabrikë, vjen nga fshati dhe të duket vetja sikur s'di, druhesh. Por kjo nuk është e mirë. Ju duhet të bëheni më guximtare, ashtu siç jeni me të vërtetë, ashtu siç u treguat kundër zakoneve prapanike dhe të kritikosh gabimet e shokëve, të tuat, të brigadierit dhe të cilitdo që nuk punon mirë. Dhe kini kujdes për kualitetin. Kur shikoni njerëz të veshur me tasha të bukura, mendoni se duhet të kenë duar të arta ato që endin.

LUMTOJA – Unë bëj çmos aë të nxjerr pëlhurë të mirë.

PALI – Endësja është artiste. S'ka gjë më të bukur se puna e saj. *(Shikon orën. Del. Pauzë.)*

LUMTOJA – *(Si me vete.)* Endësja është artiste. S'ka gjë më të bukur se puna e saj. *(Del.)*

SELIMI – *(Duke hyrë.)* Kështu nuk punohet. Do t'ia shtroj edhe një herë drejtorit, pse m'i sjellin mua kursantet?

ZANA – Ti njëherë mos thirr, se unë kam veshë e dëgjoj.

SELIMI – *(Me ironi.)* Mos thirr! Po plani?

ZANA – Panin do ta realizojmë.

SELIMI – Me se do ta realizojmë, me kursante?!

ZANA – Ti vetëm një kursante ke.

SELIMI – Mjafton ajo që të dalim të fundit.

ZANA – Ç'fjalos, Selim!

SELIMI – Ja kështu.

ZANA – Lumtoja ka katër muaj në prodhim dhe punon për bukuri. Po ti s'i njeh njerëzit dhe nuk i ndihmon.

SELIMI – Ashtu?! Po unë mbi kokë s'do t'i rrij Lumtos,
se nuk kam vetëm atë, kam një brigadë të tërë.

ZANA – Lumtoja i ka duart të arta. Por ti s'di ta çmosh.

SELIMI – Kritikë!?

ZANA – Hiç të mos të vijë rëndë.

SELIMI – Filluat përsëri me kritikata?! I keni fajet vetë e kritikoni të tjerët.

ZANA – Po ti ku e ke hallin që shfryn kështu kundër Lumtos?

SELIMI – Ku e kam hallin!? Lumtoja s'ka realizuar normën, ja ku e kam hallin.

ZANA – Si?

SELIMI – S'e ka realizuar.

ZANA – Kush tha?

SELIMI – Kosta ma tha, normisti.

ZANA – S'është e mundur! (Lumtoja hyn e tronditur, e dëshpëruar. Bie në kolltuk dhe mbulon fytyrën.)
Ç'ke, Lumto?!

SELIMI – Vetë e kanë fajin, dhe dëshpërohen.

ZANA – Ç'të ka ngjarë, Lumto?!

LUMTOJA – S'kam gjë.

ZANA – Ti je shumë e tronditur.

LUMTOJA – Më lër, më lër Zana!

ZANA – Ty të ka ngjarë diçka!

LUMTOJA – S'ta tregoj dot.

SELIMI – I vjen edhe rëndë ta thotë. Po hape gojën dhe fol, moj shoqe: nuk e plotësova normën, e mbaroi.

LUMTOJA – S'e kam te norma.

ZANA – Po ma trego mua, ç'ke?

LUMTOJA – M'u thye në tezgjah... meçiku.

SELIMI – Si the? T'u thye meçiku?!

ZANA – Mos thirr kështu, Selim!

SELIMI – Të mos thërres? A e dëgjon ç'thotë? Ka prishur makinën.

ZANA – Po si ndodhi kjo?

SELIMI – Ah! Kursante, kursante!

LUMTOJA – Mu thye... më doli dhe sovajka...

SELIMI – Sovajka?

LUMTOJA – Po.

SELIMI – Mos goditi njeri?
LUMTOJA – Jo, nuk goditi?
ZANA – Po si doli kjo sovajkë?
LUMTOJA – Nuk e di, çdo gjë ndodhi duke punuar.
SELIMI – Dy dëshpërimë: norma e paplotësuar dhe tezgjahu i prishur.
ZANA – S'do të ketë qenë në rregull mekanizmi luftarak.
SELIMI – Mekanizmi?! Për atë jam përgjegjës unë. S'i ka fajet mekanizmi. E kam kontrolluar. Fajet i ka vetë Lumtoja.
LUMTOJA – Nuk e di. Duke punuar u këputën fije të shumta, tezgjahu u ndal dhe sovajka fluturoi. E pastaj... (I merren mendtë.)
ZANA – Lumto! Lumto!
SELIMI – Ç'pati?
ZANA – Kjo ka diçka që s'e tregon. Ujë, sill pak ujë!
ZANA – Lumto!
LENA – (Duke hyrë.) Ç'ka ngjarë këtu?
SELIMI – S'e ndien veten mirë.
LENA – Lumtoja? Po ajo ishte mirë. S'më tha gjë kur e pyeta.
SELIMI – Çfarë e pyete?
LENA – Pse s'ju ka treguar?
SELIMI – Jo.
LENA – Ajo u godit nga sovajka.
SELIMI – Si?!
ZANA – Nga sovajka?!
SELIMI – Po ajo tha se sovajka s'goditi njeri.
LENA – E goditi në shpatull. Unë e pashë dhe e pyeta e trembur. M'u përgjigj: «Fare pak më goditi. Nuk më dhemb.»
ZANA – Lumto!
LUMTOJA – Se si m'u morën mendtë.
ZANA – Pi pak ujë! (I jep ujë, që sjell Selimi.)
ZANA – Të goditi shumë?
LUMTOJA – Pak. Këtu. (Vë dorën në shpatull.)
LENA – Po si s'më the mua?
SELIMI – E pse të ndodhin në brigadën time këto gjëra? Dreqi e mori!

LENA – (Selimit.) Gjithnjë grindesh ti, Selim.

SELIMI – Jo, moj Lenë, nuk është puna se grindem, po...

LENA – Më mirë hesht, se në këtë mes ti ke faj.

SELIMI – Mirë pra, po hesht, meqë dhe ti po më kritikon.

LENA – E lajmëruat ambulancën?

LUMTOJA – S'ka nevojë. Më kaloi. Jam mirë tani, Lenë, vetëm shikoni njëherë tezgjahun.

SELIMI – A është thyer krejt meçiku?

LUMTOJA – Nuk e vura re, se isha e turbulluar.

SELIMI – Po shkoj ta shoh.

LENA – Po vij dhe unë të të ndihmoj. (Dalin Selimi e Lena.)

ZANA – A je mirë tani?

LUMTOJA – Sikur s'më ka ndodhur gjë.

ZANA – Se mos më gënjesh, si më parë?

LUMTOJA – Jo. (Ngrihet.) Vetëm kam merak: pse m'u prish tezgjahu?

ZANA – Ti qetësohu njëherë. Pa punën e tezgjahut e zgjidhim. Unë mendoj se mekanizmi luftarak s'ka qenë e rregullt. Ti në këtë mes s'ke faj.

LUMTOJA – Po pse s'e kontrollova unë mekanizmin luftarak? E pyeta nja dy herë Selimin dhe ai më tha: mekanizmi është në rregull, vazhdo punën. Ku më gjeti mua kjo?

ZANA – Qetësohu, Lumto. Çdo gjë do të rregullohet. (Hyn Pali dhe pyet i shqetësuar.)

PALI – A janë të vërteta ato që dëgjova? Si je, Lumto?

LUMTOJA – S'kam gjë, shoku Pali.

ZANA – Të vërteta janë.

PALI – Kështu s'na ka ngjarë ndonjëherë. Të dalë so-vajka e të godasë punëtorin. Kjo ndodh nga pakujdesia, bile mund të them nga pakujdesia për tezgjahet, për njerëzit...

LUMTOJA – Shoku Pali!

PALI – Nuk mendoj se kjo ngjau nga pakujdesia jote, Lumto.

ZANA – Edhe unë në atë mendje jam.

PALI – Do të shkoj vetë në tezgjah për ta verifikuar. Po ti a je mirë tani?

LUMTOJA – Shumë mirë jam.

PALI – Para se të shoh tezgjahet, kam një pyetje për të bërë. (Tregon një copë beze të punuar keq.) Shikoni se ç'pëllhurë keni endur, skarco!

LUMTOJA – Kjo s'është puna ime.

ZANA – Dhe imja nuk është.

PALI – Por është e brigadës suaj. (Kërkon të shkojë, por kthehet.) Lumto, si është puna e normës që se ke realizuar?

ZANA – Sipas hesapit tonë ajo e ka tejkaluar.

PALI – Ashtu?!

LUMTOJA – Unë jam e sigurt për këtë.

PALI – Normisti më tha se Lumtoja e ka realizuar normën 90%.

ZANA – Si është e mundur? Çudi, se edhe Selimi kështu tha.

LUMTOJA – Vetëm në më janë tharë duart.

PALI – Kështu më tha, por do ta shohim. Sa për aksidentin e sotëm, do të interesohem vetë për të gjetur faktorin.

KOSTA – (Hyn nga e djathta me kitarë e me letra të shumta në duar.) Tungjatjetani!

LUMTOJA – Ja ku erdhi dhe Kosta. Kisha një punë me ty.

KOSTA – Të dëgjoj.

PALI – Po kitarën, ç'e ke marrë me vete që në mëngjes.

KOSTA – Unë një, kitara dy, jemi shokë të pandarë, shoku Pali. Ti e di. Ç'më pyet.

PALI – Edhe në orarin zyrtar?

KOSTA – Në orarin zyrtar jo, xhanëm, se s'më lë norma.

PALI – Po atëherë, pse e ke marrë me vete?

KOSTA – Po përgatitem për shëtitjen që do të bëjmë të dielën që vjen. Kam përgatitur ca numra specialë.

ZANA – Me të vërtetë, i bie bukur kitarës, ti, Kostë. Ku ke mësuar?

KOSTA – Unë jam muzikant.

PALI – Muzikant?!

KOSTA – Po.

PALI – Interesant. Dhe merresh me normat?!

KOSTA – Mbarova ushtrinë. Kërkova një punë që të më përshtatej, po s'gjeta. U futa këtu në fabrikë për-kohësisht, dhe ja, siç po më shihni, merrem me norma.

LUMTOJA – Kostë, sa e kam realizuar normën unë?

KOSTA – Tani s'më kujtohet.

PALI – A e ke për kollaj ta shohësh?

KOSTA – Po më duket se jua thashë mbrëmë, shoku Pali. Pa dale... (Lë kitarën, hap letrat, e shumta e kërkon). S'e gjej dot. Më janë ngatërruar, se janë shumë, të shkretat! (Këndon pa fjalë melodinë: «Tezgjahet plot gaz po punojnë»). E gjeta. Lumto Çerçizi. Ja ku është: 90⁰,0.

PALI – Mirë e paskam mbajtur ndër mend. Ja, pra?

LUMTOJA – Nuk është e vërtetë.

ZANA – Kosta e ka gabim.

KOSTA – Mua llogaritë s'më gënjejnë.

LUMTOJA – E unë them, e ke gabim.

ZANA – I ka bërë hesapet së prapi.

KOSTA – Ju mos më mësoni mua.

PALI – Ti shiko dhe një herë, Kostë, se kushedi, edhe mund të kesh gabuar. Këto shoqet kot nuk mund të ngulin këmbë.

KOSTA – Po unë i kam bërë një herë hesapet, s'do t'i bëj përsëri.

PALI – Mund të jesh ngatërruar.

ZANA – E ka ngatërruar kitara.

KOSTA – Kitara mua s'më ngatërron. Përkundrazi, më ndreq punë. Dhe mos ma shaj kitarën, se do të thuash në piknikun e së dielës bjери, por s'kam për t'i rënë.

ZANA – Mos ki keq, se nuk do të të lutem.

PALI – Mirë pra, shikoj dhe më njofto. Unë do të jem te tezgjahet. (Del.)

KOSTA – Çudi e madhe me ju! Edhe s'punoni si duhet, e

pastaj thoni: «I ka fajet normisti». (Flet me zë të hollë.)

LUMTOJA – Nga e di ti që s'punojmë ne?

KOSTA – Skarco keni qitur? E patë? Pali e kishte në dorë.

ZANA – Atë s'e kemi endur ne.

KOSTA – Po kush?

ZANA – Ti duhet ta dish.

KOSTA – Pse, të tëra ç'bëhen këtu në kombinat unë duhet t'i di?

ZANA – Këtë duhet ta dish.

LUMTOJA – Po kush e ka endur atë pëlhurë skarco?

KOSTA – Lena.

ZANA – E pra, Lena, dhe jo ne.

LUMTOJA – Ti i ke thënë Palit se e kam endur unë.

KOSTA – Pali vetë kontrolloi depot e më pyeti. Unë i thashë e ka endur brigada e Selimit. Ai më gjatë s'pyeti, se e shikon punën si brigadë e jo si ju, veç e veç. Pastaj Lena a s'është në brigadën tuaj?

LUMTOJA – Është!

KOSTA – Atëherë puna ka marrë fund. E ka endur brigada juaj. Mua s'më intereson se cili person, atë zgjidheni vetë.

ZANA – Ti zgjidh çështjen e normës.

KOSTA – Më lini rehat! Më duket se ka të drejtë Selimi që ankohet gjithmonë për ty.

LUMTOJA – Për Zanën?

KOSTA – Edhe për ty?

ZANA – Për Lumton?

KOSTA – Për të dyja. Më kanë sjellë, – thotë, – kursante në brigadë. E si të vejë puna mirë. Atyre, – thotë, – u këputen fijet një mijë herë e s'dinë t'i lidhin.

LUMTOJA – Akoma kursante na quan ai?

ZANA – Gabimet e veta kërkon t'ua lhedhë të tjerëve.

KOSTA – Selimi këtu është e sqarohuni me të. Mua më lini rehat, se kam punë. Shikoni gjithë këto letra. Duhet t'i mbaroj sot! Pale që na doli belaja e

normës sate. Megjithëse unë jam i bindur që hesapi është bërë drejt. E ku kontrollohen gjithë këto letra? Formulari nr. 1. E ku kontrollohet ky formular? As unë vetë nuk marr vesh se ç'kam shkruar këtu.

ZANA — Pse s'vete në zyrën tënde të punosh?

KOSTA — Po e pastrojnë. Pastaj edhe në këtë këndin e kuq s'është keq. Edhe prehesh edhe punon.

ZANA — Po shkoj të vishem. A të dhemb shpatulla, Lumto?

LUMTOJA — Jam mirë. Po vij edhe unë të shoh tezgjahun e të gjej Selimin. Do t'ia them të gjitha para fillimit të turnit.

KOSTA — Thuja, moj shoqe, thuaja, në t'i pranofte.

LUMTOJA — Ti shiko normën time, se Pali ta la detyrë. Dhe hap sytë se mos e nxjerrësh më pak se 100%. (Lumtoja e Zana dalin.)

KOSTA — (Vetëm.) Me këtë kokë që kam unë, edhe ajo ka për të ngjarë. (Merr kitarën e këndon, pasi është mërzhitur së pari letrat.)

*Gufoni, o gjokse rinore,
për nënën e dashur Parti,
me emrin e saj plot fitore
e ngritëm qytetin e ri.*

*Tezgjahet plot gaz po punojnë,
po endin gjithmonë pa pushim...*

(Lë kitarën.) Po unë ç'bëj? E lashë punën në mes e ia mora këngës. Norma, norma, ç't'ju bëj unë, moj norma, kur s'ju kam qejf? (Punon.)

SELIMI — (Hyn duke parë me druajtje.) Mirëdita!

KOSTA — Mirë se vjen! (Punon.)

SELIMI — Me se merresh?

KOSTA — Me normat, me se do merrem. (Punon.)

SELIMI — I ngatërron ti gjithnjë normat.

KOSTA — Është puna ime. (Duke punuar.) Më lër rehat

- se kam një punë me urgjencë, mos më fol se kur më flasin, s'punoj dot.
- SELIMI – (Ulet e lexon një revistë.) Kostë, o Kostë! (Shikon revistën.) Kostë more, a dëgjon?
- KOSTA – Po ç'ke, more, ç'ke? Mos më fol, të thashë!
- SELIMI – Dua një këshillë prej teje.
- KOSTA – (Duke punuar.) Unë s'jap këshilla. Më lër rehat. (Pauzë. Selimi lexon, Kosta shkruan.)
- SELIMI – Kostë!... O Kostë! Ti mund të më ndihmosh.
- KOSTA – (Hedh lapsin e kartat.) Nuk mundem!
- SELIMI – Mundesh.
- KOSTA – Unë i them s'mundem, ai gjene në të tijën! Si i ke hallet?
- SELIMI – S'di si ta bëj. S'më merr gjumi.
- KOSTA – Shko te doktori të të japë ilaçe.
- SELIMI – Ah, po s'ka ilaç për të, more shok, jooo!
- KOSTA – Si s'ka ilaç?
- SELIMI – S'ka.
- KOSTA – Për të gjitha sëmundjet ka ilaç. Vetëm për dashurinë s'ka ilaç
- SELIMI – Këtu ta kam.
- KOSTA – Mos je dashuruar?
- SELIMI – S'e di, por gjumi s'më zë.
- KOSTA – Atëherë, je dashuruar.
- SELIMI – Ashtu më duket.
- KOSTA – Me cilën?
- SELIMI – S'ta them dot.
- KOSTA – Atëherë, më lër rehat të punoj. (Punon. Pauzë.)
- SELIMI – Kostë! Nuk tallem. A ke dashuruar ndonjëherë?
- KOSTA – Si s'kam dashuruar? Kam dashur dhe me gjithë shpirt. E kisha të mirë, të bukur. Kishte një zë të ëmbël, që kur e dëgjoja më shkrinte. Vetëm se m'u shkatërrua.
- SELIMI – Si t'u shkatërrua?!
- KOSTA – U shkatërrua. Që prej asaj kohe s'ia kam dëgjuar më zërin e saj të ëmbël.
- SELIMI – S'të marr vesh, vdiq thuaj.
- KOSTA – Jo, more, u prish. Po kisha fizarmonikë të mirë, ama!

- SELIMI – Fizarmonikë? Unë s'të pyeta për fizarmonikën, unë të pyeta a ke dashuar njeri.
- KOSTA – Unë i dua të gjithë njerëzit.
- SELIMI – S'më kupton. Vajzë a ke dashuruar?
- KOSTA – Vajzë? Ua! Vajzë, kurrë në jetën time.
- SELIMI – E unë rashë këto kohët e fundit e s'më merr as gjumi.
- KOSTA – Jo. Unë me gjumin jam në rregull.
- SELIMI – S'di si t'ia bëj.
- KOSTA – Ajo është kollaj: thuaja!
- SELIMI – S'ia them dot. I bëj planet, vendos, po, me ta parë, më priten fjalët.
- KOSTA – S'qenke trim, Selim. Të isha unë do t'i thosha: Shoqe moj, moj shoqe. Më ke marrë zemrën. Ja, vëre dorën këtu. Zemra ime s'punon.
- SELIMI – Sa kollaj e bën ti, Kostë.
- KOSTA – Ose më mirë do t'i thosha: Shoqe. Zemrën ma ke prishur. Ja dëgjoje si punon, si tezgjah, si motor!
- SELIMI – Më duket se po tallesh. S'po më jep këshillë të mirë.
- KOSTA – Po ajo, a të do?
- SELIMI – S'e di!
- KOSTA – Atëherë gjysma e punës është e mbaruar. Mjafton që e do ti. Thuaji, po deshi, mbaron puna krejt.
- SELIMI – S'ia them dot!
- KOSTA – Cila është ajo?
- SELIMI – Veç mos i trego njeriu!
- KOSTA – Të jap fjalën e nderit.
- SELIMI – Lena.
- KOSTA – Lena? Po unë këtë e dija. E kam dëgjuar edhe nga të tjerët.
- SELIMI – Nga e kanë marrë vesh?
- KOSTA – Nga sytë e tu e të Lenës. Sytë e dashuruar janë të turbullt.
- SELIMI – Pse, ashtu janë edhe të mitë?
- KOSTA – Si lumi kur bie shiu. Dëgjo, Selim, thuaja

- hapur. Të dua, i thuaj, e mbaroi. Pa ty s'rroj dot, i thuaj. Ashtu si thënë të gjithë.
- SELIMI – Tani më ke dhënë këshillë të mirë.
- KOSTA – Edhe skarco i thuaj të mos qesë herë tjetër. Bobo, normat! Më le pa punë! Ja dhe Lena ku po vjen.
- SELIMI – Lena?!
- KOSTA – Ja ku duket në korridor. Thuaja. Po të lë vetëm. Bëju trim, guximtar, sokol bëju! *(Del duke lënë letrat mbi tryezë. Selimi thërret përsëri.)*
- SELIMI – Lena! *(Lena hyn.)*
- LENA – Ç'më do, brigadieri i fundit në fabrikë.
- SELIMI – Mos u tall, Lenë.
- LENA – Nuk tallem. Kështu thonë të gjithë. Selimi s'ka shpirt të keq, por s'di ta bëjë punën. Ja dhe tezgjahun e Lumtos nuk e ndreqe dot.
- SELIMI – Mos dëgjo botën. *(Pauzë.)* Lenë!... Lenë!
- LENA – Ç'do?
- SELIMI – Unë Lenë, kam vendosur të të them atë që s'ta thashë dot mbrëmë. Kam vendosur të të them se... sa... se sa vapë bën sot!
- LENA – Të zihet fryma. Këtë deshe të më thoshe dhe mbrëmë?
- SELIMI – Po! Këtë!... d.m.th. jo këtë. Po ulu, ulu të rrimë e të bisedojmë, se ka kohë gjersa të fillojmë nga puna. *(Ulen larg në kanape. Ai afrohet, edhe ajo gjithashtu! Shikohen në sy.)* Sa vapë bën!
- LENA – Shumë, shumë vapë bën! *(Pauzë. Shikohen përsëri.)*
- SELIMI – Lenë... *(Kërkon t'i shfaqë dashurinë.)* Të pëlqen vapa ty?
- LENA – Jo. S'më pëlqen.
- SELIMI – Kurse mua më pëlqen. *(Pauzë.)* Lenë! *(Pauzë. Shikohen.)* Edhe mua s'më pëlqen vapa! Si ti! Një karakter kemi. Vetëm se kur bën vapë e kur pi një gotë ujë të freskët, një okë dhjamë vë.
- LENA – Prandaj je ngjallur kështu.
- SELIMI – Jo, Lenë! Vetëm nga jashtë dukem i ngjallur, por në të vërtetë jam i sëmure.

LENA – I sëmurë?

SELIMI – Posi! Dhe i sëmurë rëndë. Vuaj, vuaj shumë.
Ja këtu e kam dhembjen. (Vë dorën në zemër.) Jam
i prekur nga të dy anët.

LENA – A ke qenë te mjeku?

SELIMI – Ç'ta dua mjekun, s'ka ç'i bën mjeku. Ja këtu
më dhemb.

LENA – Po ç'ke, Selim?

SELIMI – Më griu.

LENA – Kush?!

SELIMI – Si s'më kupton ti, moj shoqe! Po unë po ma-
rrosej. Po rroitem. Po çmendem.

LENA – Nga se po çmendesh, Selim?

SELIMI – Nga dashuria.

LENA – Nga se?

SELIMI – Lenë! (Ngrihet në këmbë.) Më në fund, *vondosa*.
Vëri një gur zembrës dhe dëgjo një lajm të pa-
pritur. Mos u hidhëro ti, mos u dëshpëro ti. Ja
që më zuri kjo e keqe. Lenë! Lenë! *Të ftoj që të*
jesh shoqja ime e jetës. Unë të dua, Lenë!... (Del
me vrap.)

LENA – (Ngrihet në këmbë.) Selim! Ç'më the ashtu, Se-
lim! Ç'më dëgjuan veshët? O, nëne! Më dashu-
ron. Po unë këtë e dija. (Vrapon në drejtim të de-
rës nga doli Selimi.) Selim! Selim! (Hyn Kosta i
habitur.)

KOSTA – Më duket se u zunë. Eh Selim, Selim, për asgjë
s'je i zoti. (Merr telefonin e kërkon klubin. Po
klubi është i zënë. Ulet në tryezë ku ka lënë letrat
e fillon të punojë. Pauzë.) Në majë të hundës ma-
ka sjellë ky formular. Të them të drejtën, s'di
as nga ta filloj, e as nga ta mbaroj. (Merr kitarën e i
bie.) Sa gjë e madhërishtme është muzika. Të men-
dosh vetëm 7 nota, do, re, mi, fa, sol, la, si. (I luan
notat në kitarë.) Po ç'ka bërë me këto Çajkovski,
Verdi, Bethoveni? Çudira! (Hyjnë Lumtoja e Zana.)

ZANA – A mos ishte Selimi këtu? Se e kërkuam e s'e
gjetëm dot.

LUMTOJA – E kontrollove normën?

- KOSTA – Dëgjo, Lumto. Pastaj bisedojmë për normat.
Muzika...
- LUMTOJA – Çudi me ty. Të pyes e pe apo jo? Ty s'të hanë as kohë shumë ato. Pastaj s'ke ndonjë gjë të madhe për të parë. Shumë pak.
- KOSTA – Është e vërtetë. Shumë pak janë. Shtatë nota, dhe gjithmonë çdo gjë në bazë është e paktë, po megjithatë me ato pak ne kemi bërë çudira!
- ZANA – Ky paska lajthitur!
- LUMTOJA – Ç'i them unë, ç'më thotë ai! Po lër muzikën, more Kostë, e shiko normat. Me muzikë le të merret Adem Hasani. Ai është drejtor i klubit dhe drejtues i korit.
- KOSTA – Sa bukur do të ishte sikur jeta të qe si një orkestër, ku çdo njeri të luante mirë e ndershmërisht veglën e vet (*I bie kitarës.*)
- ZANA – Hajde, Kostë, hajde!
- LUMTOJA – E di se me këtë moskokçarje thyen disiplinën e shtetit? Shoku Pali pret përgjigjen.
- KOSTA – Si the? Kam prishur disiplinën?
- ZANA – I ke ngatërruar të tëra punët.
- KOSTA – Dëgjo, Lumto, dëgjo, Zana, dëgjoni, shoqeni! Ju më kuptoni. A bëj unë për normist, unë që di notat, që kam mësuar për muzikë, që jam muzi-po më lënë të mbytem në statistika?
- LUMTOJA – Mjaft u talle!
- ZANA – Atë punë e di drejtorja. Ti ndoshta ke të drejtë. Po të jesh i bindur për këtë, shko kërkoje atje ku duhet. A do të gjesh të vërtetën? Kërkoje. Po tani duhet të kontrollosh normat.
- KOSTA – Keni hak, keni hak! (*Punon. Ato ulen në tryezë.*)
- LUMTOJA – Kemi kohë, a u shkruajmë letra prindërve?
- ZANA – U shkruajmë.
- LUMTOJA – Shkruajmë dhe presim Selimin.
- KOSTA – (*Zhytet në letrat e shumta gjithë dëshpërim.*) Uf, ç'formularë! Këtë formularin e ri nr. 1 s'e marr vesh hiç! (*Pauzë.*) Pa të pyes njëherë drejtorin e klubit, se ai u vjen hakut këtyre punëve të normave

dhe të llogarive. (*I bie telefonit.*) Alo! Klubi? Më jepni drejtorin... Drejtori? Adem, ti je, more? Shyqyr që të gjeta kaq shpejt se telefoni është gjithnjë i zënë. Jam në hall me ca formularë të rinj të normave. Më fal që të pyes kaq herë në ditë, por ja që s'marr vesh. Më akuzojnë se normën e Lumtos e kam llogaritur gabim. (*Shikon shoqet e flet me zë të ulët.*) E kam fjalën për formularin nr. 1. Si të shënohen normat këtu? (*Pauzë.*) Aj! Unë i kam bërë fare-fare për së prapi... I mora vesh tani. More, Adem! Kam dhe një gjë tjetër. Këto të dalat si shënohen? (*Pauzë.*) Ik, ore! Edhe këtu e paskam shkelur... Kuptoj, kuptoj. Jo, dale, se s'marr vesh gjë hiç. Si? Po. Po. Në rregull! Faleminderit! Hajt, tundatjeta!... Alo! Alo! Adem! Kam dhe një pyetje tjetër. Këto përqindjet si t'i nxjerr... E atë... o drejt! S'paskan qenë gjë hiç dhe unë i kam ngatërruar. Mirupafshim! Në mbrëmje do të vij nga klubi. (*Matet të lërë telefonin.*) Alo... Alo!!! Alo! Adem! Më fal edhe një pyetje. Ç'janë këto fjalë: nënlimit e zëra të posaçëm? Po... Ashtu? Drejt e mori. Do t'i harroj, se s'mbajta as shënim. (*Matet të lërë telefonin.*) Alo!... Alo! Mos e pri, moj shoqe, se s'kemi mbaruar. Një sahat, një sahat, ç'të bëjmë, kur jemi në punë zyrtare. Alo! Adem... Po ç'hyn ky i treti në muhabet! Alo. Po mbylle, more shok, telefonin! Ne e kemi zënë më parë. Adem. Si? S'ia mëson dot korit këngën? Po kjo është e thjeshtë, more Adem. Mblidh korin, mësoja notat dhe mbaroi... Po, po. Ke të drejtë. Harrova që ti s'i di notat. Megjithëse drejton klubin dhe korin... Ç'të ta them unë në telefon, s'mësohet kënga me telefon. Ja, dëgjoje refrenin: «Tezgjahet plot gaz po punojnë». Jo, jo, jo e ke false. Re, re, re, la, sol, la, sol. Tezgjahet plot gaz po punojnë, po endin gjithmonë pa pushim... Atëherë, dëgjo. Eja këtu në këndin e kuq, një rrugë e dy punë! Alo! Alo! Alo! na e prenë. (*Lë telefonin.*)

LUMTOJA – Paske zë të mirë, ti Kostë.

- KOSTA – Të thashë, që jam muzikant.
- LUMTOJA – Si muzikant? Ti je normist.
- KOSTA – Me punë shtetërore jam normist, po specialiteti im është muzika. Di notat mirë, kam bërë dhe ca shkollë muzike, kompozoj dhe vetë nga pak.
- LUMTOJA – Unë kujtova se ti talleshe.
- KOSTA – Po ju çfarë po shkruani kështu? Mos keni dhe ju hallin e Selimit? Mos doni dhe ju këshilla?
- ZANA – Pse? Çfarë këshillash i dhe Selimit?
- KOSTA – Janë sekrete.
- LUMTOJA – U shkrova prindërve. U thashë që jam mirë dhe e lumtur. U shkrova që të vijnë të më shohin. Dhe më në fund. U thashë se normisti ynë, shoku Kostë, më ka ngatërruar normën e ma ka prishur qejfin.
- KOSTA – Këtë të fundit hiqe, se s'është mirë. Do të mendojë xha Veliu keq edhe për mua. Prindërit e tu do të mendojnë se ka njerëz që ia prishin qejfin vajzës së tyre. Pastaj s'janë të vërteta ato që ke shkruar. Ja, tani vjen drejtori i klubit, se i di normat përbukuri. I kontrolloj me të dhe për dhjetë minuta ia dorëzoj shokut Pali.
- LUMTO – Meqë qenka kështu, mirë atëherë. *(Vajzat shkruajnë, Kosta punon. Hyn Selimi i gëzuar.)*
- LUMTO – Qenke në qejf, shoku Selim.
- ZANA – A janë në rregull makinat?
- SELIMI – Po.
- ZANA – S'kanë asnjë defekt?
- SELIMI – Po ti pse më pyet kështu?
- ZANA – Atëherë, na shkoftë puna mbarë. Vetëm t'i hapim sytë që t'i dorëzojmë në gjendje të mirë, kështu si po i marrim. Mbrëmë dy tezgjahe s'ishin në rregull.
- SELIMI – Ç't'u bëja unë? U prishën pesë minuta para se të mbaronte turni.
- LUMTOJA – Unë asnjëherë s'të kam kritikuar, shoku Selim se, të them të drejtën, jam druajtur, po sot, po të flas me zemër të hapur. Të mos të vijë rëndë. E para: ti s'di t'u bësh hyzmet makinave.

Sa herë dorëzon turnin, do të ketë ndonjë të metë në tezgjah.

SELIMI – Hyre dhe ti në vallen e të tjerëve! Po e di ti se çfarë punëtoresh kam unë? Të tëra pa eksperiencë, duke filluar që nga ti, megjithëse ti ndryshon një çikë. Një fije u këput, një orë rri sa ta lidhni. Po, po, sinjalet ngritur u rrinë, si flamurë!

LUMTOJA – Edhe mua po më ankohesh?

SELIMI – Domosdo, kur s'më kupton, do të ankohem.

LUMTOJA – Unë njerëzit që ankohen për çdo gjë e gjithnjë i kam zët, bëhen të mërzitshëm.

SELIMI – Qenka i mërzitshëm! Mua më ka hyrë plani në tru e më godet si çekan, ajo thotë qenka i mërzitshëm. A e di ç'do të thotë kur nuk realizon planin? Do të thotë, që tërë ditën të të buçasin trutë! Pse s'e realizon? Pse s'e realizon? Pse s'e realizon? E të dhemb koka, sikur ke hekur të skuqur në të.

KOSTA – Po këtu është puna, se s'mendon për planin si duhet, ti shok.

SELIMI – Ti nga plani s'merr erë, shiko normat.

KOSTA – Si, s'të pëlqejnë këshillat e mia, a?

SELIMI – Më lër rehat, se më dhemb koka.

ZANA – Njerëzve të mëdhenj, gjithnjë u dhemb koka.

SELIMI – Mos u tall me mua.

ZANA – Nuk tallem, kështu thonë.

SELIMI – Tallesh, edhe ti, edhe Lumtoja tallet, sikur të jem ndonjë dembel. Po unë gjithë ditën mbi makinat rri. Dhe të gjithë thonë: «Selimi është brigadier i keq, Selimi s'bën.» Po ja, më thoni, punoj unë apo s'punoj gjithë ditën? E shkoj unë kohën kot, apo jo?

LUMTOJA – Ti punon, po, me sa kam kuptuar unë, punon keq. Prandaj edhe koha të shkon kot.

SELIMI – Si?

ZANA – Të shkon kot.

SELIMI – Si?

KOSTA – Kot, o vëlla, kot. Të dyve kot na shkon.

- SELIMI – S'ju marr vesh ç'doni të thoni! E filluat kritikën për hiçgjë.
- LUMTOJA – Pali thotë se sot s'duhet vetëm të punosh, por duhet të punosh mirë, duhet të dish të punosh.
- SELIMI – E pse, unë s'di?
- LUMTOJA – S'di.
- SELIMI – Si?!
- ZANA – S'di, pra.
- KOSTA – S'di, o vëlla, s'di.
- SELIMI – Po ju do të më mësoni mua? Po si nuk ditkam unë, që kam gjithë këtë eksperiencë? Mos jam dembel unë? Mos jam budalla?
- LUMTOJA – Ti s'je as dembel, as budalla.
- SELIMI – Po atëherë?!
- LUMTOJA – Ke një të metë të madhe, Selim. Të ta them?
- SELIMI – Ç'do të thuash akoma?
- LUMTOJA – Nuk do të të vijë rëndë?
- SELIMI – Kam stomak të fortë, do ta duroj.
- LUMTOJA – Je kakapër ti, Selim.
- SELIMI – Si?
- LUMTOJA – Kakapër.
- SELIMI – S'e marr vesh këtë fjalë.
- KOSTA – Domethënë se, kur të kritikojnë, hidhesh, pip! Si gjell!
- SELIMI – Më keni marrë ters. Mirë nga të tjerët, po nga Lumtoja këtë s'e prisja.
- LUMTOJA – Unë nga të tjerët nuk do të ndahem. Ti edhe tani s'po e pranon kritikën. Pa mendo njëherë. A e di se brigada, jonë shkon në bisht të të tjerave për gabimet e tua.
- SELIMI – Mos harro se në brigadë kam edhe punëtorë të rinj, pastaj, makina janë, edhe prishen.
- LUMTOJA – Makinat janë të reja. Në po ato makina punon edhe brigada e Qemalit. Po ata e realizojnë normën 120% dhe janë brigadë e kualitetit të lartë.
- SELIMI – Edhe ne e nxjerrim të mirë kualitetin.
- KOSTA – Jo gjithnjë. Ja Lena, për shembull, ka qitur një leckë kësaj radhe që, lërë mos e nga, pe-pellashkë!

LUMTOJA – Po ta shisnim, s'do ta zinte njeri me dorë.
 Vetëm minjtë do të bënin qejf e do të thoshin:
 «M'i lumtë këtij shokut Selim që na dha këtë ushqim
 kaq të mirë.»

SELIMI – Eh! Mirë thonë: gratë kanë shejtanin në bark!
 LUMTOJA – Epo, jemi apo s'jemi me të drejta të bara-
 barta. (*Hyn drejtori i klubit .*)

ADEMI – S'e patë Kostën?
 KOSTA – O, Adem! Ja ku jam, more zot! Sa shpejt
 erdhe!

ADEMI – Më telefonove për punën tënde. Tani, ti më
 duhesh për punën time. Sonte kam provat e korit.
 Është ajo kënga e kombinatit. E kam me nota. Por
 notat unë s'i kuptoj. Të ma mësosh me veshë, të
 paktën, se do të turpërohem në piknik.

ZANA – Ku do ta bëjmë piknikun?
 ADEMI – Ja atje, në pyllin me pisha.
 KOSTA – Më parë do të shohim këtë normën e Lumtos,
 se mos e kam bërë gabim. E kërkon Pali tani.
 Sa për këngën, mos ki merak. Ta mësoj unë me-
 njëherë, megjithëse ti s'ke veshë për muzikë.

ADEMI – Mirë. Po ku do të punojmë? Këtu?
 KOSTA – Ikim, se këtu nuk u punuaka. Ky kënd i kuq
 është bërë sot sallë kritike. Shkojmë në zyrën time.

ADEMI – Ti, Selim, qenke pa qejf sot?
 KOSTA – Lëre mos i fol, se i kanë hipur xhindet.
 SELIMI – Ashtu? (*Kosta e Ademi dalin.*)

LUMTOJA – Ç'kisha për të thënë, t'i thashë. T'i thashë
 se më dhimbset puna, brigada, fabrika.

SELIMI – Mirë, mirë, do të shohim kush ka të drejtë.
 Pse them unë që vetëm të kritikoni dini.

ZANA – Pse?
 SELIMI – E dini vetë ju.
 LUMTOJA – Të kritikuaam për punën e brigadës dhe ti
 nxehesh.

SELIMI – E kush më kritikoi pa? Lumtoja, një vajzë nga
 fshati.

ZANA – Selim! Mos u anko se, që kur erdhi Lumtoja, kemi
 shkuar mirë me planin.

- SELIMI – Është shtuar dhe një faktor tjetër për mosrealizimin e tij. Ti e përkrah Lumton, se ka gjetur tenxherja kapakun.
- ZANA – S'ke të drejtë të flasësh në këtë mënyrë!
- SELIMI – Kritikoni! Kritikoni!
- LUMTOJA – Kritika është forcë. Kështu thotë Pali. Tani unë e kam kuptuar si duhet rëndësinë e saj.
- SELIMI – Në vend që të flisni kështu, më mirë bëni përpjekje që të realizoni normën. Pale që për ta tejkualuar, s'e tejkalon dot.
- LUMTOJA – Normën e kemi tejkualuar.
- SELIMI – Flasin statistikën. Vetëm 90% e ke realizuar.
- LUMTOJA – 90% e kam pasur përpara. Po tani jo.
- ZANA – Këtu janë bërë ngatërresa, po do të zgjidhen.
- SELIMI – Çdo gjë është e qartë si dielli, dhe s'ka asnjë ngatërresë.
- ZANA – Ashtu të duket ty.
- SELIMI – Ja, kështu! (Matet të dalë.)
- ZANA – Edhe një gjë. Pse i doli sovajka Lumtos?
- SELIMI – Se i ka fajet vetë.
- ZANA – I ke fajet ti, se s'e kishe kontrolluar mekanizmin luftarak?
- SELIMI – Unë?
- ZANA – Po ti.
- SELIMI – S'është e vërtetë. (Hyn Pali.)
- PALI – Pse thërrisni kështu?
- ZANA – Kritikojmë Selimin, po s'e pranon gabimin.
- SELIMI – S'kam bërë gabime që t'i pranoj.
- PALI – Gabimi është bërë qyrk dhe s'e ka veshur njeri. Por kjo është për të kaluarën. Tani ai që s'e pranon, do të gabojë edhe më rëndë. Gabime të tilla ka bërë shoku Selim.
- SELIMI – Unë?!
- PALI – Po, ti. (Nxjerr bezen e endur keq.) A nuk është turp për brigadën tuaj që të prodhojë pëlhurë të tillë? (Pauzë.) Për cilin prodhojmë ne? A do të na pëlqente të vishnim një leckë si kjo? Populli e do bezen të shumtë, të fortë e të bukur. Meriton të kritikohet ai brigadier që lejon të prodhohet

një plaçkë e tillë. Unë të pyes, shoku Selim: pse keni prodhuar kështu? (Pauzë.) S'të vjen mirë të përgjigjesh. Hesht? (E flak leckën mbi tryezë.)

SELIMI – Këtë muaj... Ka pasur... defekte në makina.

PALI – Pse ka pasur defekte? (Pauzë.) Pse i doli sovajka Lumtos?

SELIMI – Ajo, vetë... ka faj.

PALI – (Gjakxehtë.) Hesht, Selim. Nuk i ka hije të flasë kështu një anëtar i partie. Tezgjahun e kontrollova tani së bashku me inxhinierin. Të gjitha vidhat ishin të çliruara. Kush ka faj për këtë? Lumtoja?... Pse nuk përgjigjesh, kush ka faj? (Ndez një cigare. Pauzë. I jep dhe Selimit një cigare. Flet qetë.) Punëtorët i ke me duar të arta. Po të organizosh punën, po t'i ndreqësh tezgjahet shpejt dhe mirë, s'do të ketë skarco, s'do të ketë defekte, plani do të tejkalohet, brigada do të bëhet e dalluar dhe flamurin do t'ia marrë filaturës. (Hyjnë duke rendur Kosta me Ademin.)

KOSTA – Shoku Pali! Shoku Pali!

PALI – Ç'keni që vraponi kështu?

KOSTA – Suksese! Rekord!

ZANA – Çfarë suksesi?

PALI – Çfarë rekordi?

ADEMI – Shokë! Ne kontrolluam normat...

KOSTA – Dale, Adem. Puna jote mori fund. Për këtë të falënderoj. Tani ma lër fjalën mua, si normist që jam.

PALI – Flisni, ç'keni?

KOSTA – Në kontrollin e ri që u bëmë normave, unë dhe Ademi, rezulton një gabim dhe një sukses, ose, po të shprehem në gjuhën muzikore, kemi një do maxhor dhe një do minor. Gabimi është se shoqja Lumto Çerçizi nuk e ka realizuar normën 90⁰/₀. Dhe suksesi, sukses i madh për brigadën dhe për gjithë fabrikën, është se shoqja Lumto Çerçizi e ka realizuar normën me kualitet të lartë 130⁰/₀.

PALI – 130⁰/₀? Po ky është me të vërtetë sukses i madh.

TË GJITHË – Sukses! Sukses! (Bie sirena që lajmëron

fillimin e turnit. Të gjithë e urojnë Lumton. Zana e përqafton. Selimi, që ka ndenjtur mënjanë, i jep dorën Palit.)

SELIMI – Shoku Pali.... Ka të ngjarë që të kem gabuar...
Do të mendoj... Do të thellohem... Do të përpiqem...

ZANA – Së bashku Selim, të gjithë së bashku.

SELIMI – Po. Të gjithë së bashku.

PALI – Punëtorët tanë kanë duar të arta. Dhe tani, shokë, në punë. Sinjali na fton për suksese të tjera edhe më të mëdha. *(Dalin të gjithë të gëzuar. Kosta ia merr këngës: «Tezgjahet plot gaz po punojnë».)*

Perdja

AKTI I TRETË

Tabloja e tretë

*Pyll me pisha. Në sfond duken oxhakët e fabrikës.
Në skenë janë Kosta me kitarë dhe Ademi.*

ADEMI – Kur isha më i ri, Kostë, këngët i mësoja më shpejt. Edhe këndoja mirë. Po këto kohët e fundit kam humbur fare. Si duket më ka marrë në qafë zëri i dytë, se me atë zë kam kënduar gjithnjë.

KOSTA – Çfarë zë i dytë! Ti s'bën asnjë përpjekje për të mësuar notat. Si mund ta drejtosh korin ti. Je dhe drejtor klubi!

ADEMI – Epo të, mor Kostë, muzika këtej më hyn, këtej më del!

KOSTA – Dëgjoje për të fundit herë, se më s'do ta përsërit. (Këndon duke i rënë kitarës.) Më muzikale, më muzikale. Çliroje kravatën, që të dalë zëri.

*Gufoni, o gjokse rinore,
për nënën e dashur Parti,
me emrin e saj plot fitore
e ngritëm qytetin e ri.*

- ADEMI – (Këndon shumë keq.) Gufoni, o vajza rinore...
- KOSTA – Jo! Jo! false. Edhe fjalët s'i di. Çudi e madhe, edhe trung të ishe, do të kishte mësuar.
- ADEMI – S'kam veshë.
- KOSTA – S'ke as veshë, as zë, as gjë prej gjëje. Do-methënë, veshë ke, po i ke si të gomarit. Gomari pëllet. Edhe ti, gjithashtu.
- ADEMI – Po halli! Si do ta drejtoj korin?
- KOSTA – Kanë hak që s'të mblidhen punëtorët në kor. S'je për këtë punë.
- ADEMI – Ashtu si ti që s'je për normist. I ke ngatërruar punët, i ke bërë lesh e li.
- KOSTA – Ç'të bëj unë! Atë punë s'e kam qejf. Pas-taj shumë gjëra s'i kuptoj.
- ADEMI – S'i kupton? Po ja, more Kostë, sipas kolonave, parashikimet, angazhimet, realizimet, norma di-tore, norma mujore. (Vizatton përdhé me një shkop.)
- KOSTA – (U bie gjithë telave të kitarës.) Më lër rehat, se, të paktën, në këtë ditë pushimi, s'dua të mendoj për normat.
- ADEMI – Jo, Kostë, ti s'ke kujdes. Sa shpjegime të kam dhënë! Edhe gur të ishe, diçka do të kishe kuptuar.
- KOSTA – Për llogaritjen e normave s'kam talent.
- ADEMI – Po kështu si vepron, bën gabim të madh. Të kujtohet norma e Lumtos?
- KOSTA – Lëre. Ajo histori mori fund. More, më kujtove Lumton, s'e kush e kërkonte.
- ADEMI – E pashë me Zanën në pyll. Mblidhnin lule.
- KOSTA – Në klub asgjë s'ke bërë për të. Ajo theu nor-mat, u bë e dalluar, u shpall sulmuese.
- ADEMI – Ç'të bëja?
- KOSTA – Të paktën, një kënd me fotografitë e saj në punë, në shtëpi, në bibliotekë, në shoqëri, në fsha-tin ku ka lindur. Ose një konferencë të organizoje ku të fliste ajo për punën e të përhapte kështu për-vojën e saj...
- ADEMI – Sa të pjell mendja ty, bre Kostë. Po unë e

kam hallin gjetiu. Ma përsërit edhe një herë këngën.

KOSTA – O, jo, më s'e përsëris. Më ngjire.

ADEMI – Të lutem, Kostë, se turpërohem, sidomos sot që jemi në piknik e që unë duhet ta filloj gjithnjë i pari këngën.

KOSTA – Nuk mundem. Më ke lodhur. Ma ke sjellë shpirtin në majë të hundës.

ADEMI – Ashtu siç më ke lodhur edhe ti me normat. Po përsërite edhe një herë, pastaj s'dua më. (Kosta këndon «Gufoni, o gjokse rinore» e kur përsërit Ademi, zë veshët me dorë që të mos dëgjojë. Ndërkaq hyn Pali.)

PALI – Shumë keq këndon, Adem.

ADEMI – Jam ngjirur pak, se zërin s'e kam të keq.

PALI – Mos e patë Lumton? Më thanë se e kërkojnë.

ADEMI – Mblidhte lule në pyll me Zanën.

PALI – Ç'po bëni?

KOSTA – Po i mësoj një këngë Ademit, po më plasi dhe s'e mëson dot.

ADEMI – Ashtu si dhe ti që më nxore shpirtin, e s'kuptove si llogariten normat.

PALI – Domethënë, juve kështu i keni bërë punët gjer më sot? Bëni punën e njëri-tjetrit dhe jo atë që ju është ngarkuar.

KOSTA – Të themi të drejtën, ashtu kemi vepruar. Unë s'marr vesh nga llogaria e jam normist. Ky s'merr vesh nga muzika e është muzikant. Punën e tij e bëj unë. Punën time e bën ky.

ADEMI – Me të vërtetë, kështu është.

PALI – E shtrua çështjen tuaj. Që nesër të ndërroni vendet. Ti, Kostë, shkon drejtor i klubit dhe Ademi bëhet normist.

KOSTA – Si?! Mund të bëhet kjo?

PALI – Drejtoria e vendosi.

KOSTA – Domethënë, unë do të vete në klub, drejtor, e do të merrem me muzikë?

PALI – Po.

ADEMI – Dhe unë normist?

- PALI – Po.
- KOSTA – Adem!
- ADEMI – Kostë! (*Përqafohen.*)
- KOSTA – Më në fund, edhe kjo punë u zgjidh! Më lejoni, shoku Pali, t'ju përqafoj. (*E përqafohen.*)
- ADEMI – Shoku Pali, a mund t'i ndërrojmë vendet që sot? Vetëm për një arsye: që Kosta të drejtojë korin.
- PALI – Është vendosur dhe mund t'i ndërroni!
- KOSTA – Atëherë, dëgjo, Adem. Nesër, që në mëngjes, sabahile, të vish të të dorëzoi zyrën. Tani do të shihni se si do të vejë puna artistike e kulturore në fabrikë.
- ADEMI – Dhe llogaria e normave s'ka për të çaluar kurrë.
- KOSTA – Shkojmë t'u mësojmë shokëve këngën e tezgjaheve! (*Dalin duke kënduar. Prapa skene i thërret Ademit.*) – False! False!
- PALI – (*Me vete.*) Është mirë kur njerëzit gjejnë vendin e tyre në punë (*Del. Pauzë. Skena bosh. Hyn Lena me vrap. Pas saj Selimi.*)
- SELIMI – Lenë!... Lenë!
- LENA – Mos m'u afro!
- SELIMI – Tani kam të drejtë. Jemi të fejuar dhe ligji e lejon afrimin.
- LENA – Je i keq.
- SELIMI – S'është e vërtetë. Unë kam bërë autokritikë e ca nga ca po ndreqem.
- LENA – S'e ke bërë të plotë autokritikën. Gabimet që bën kundrejt meje, po i trash. Je akoma i sëmurë.
- SELIMI – Jo, Lenë! Jam i shëndoshë, si luan. Lenë! (*I afrohet.*)
- LENA – Mos m'u afro. Je i sëmurë akoma.
- SELIMI – S'të kuptoj!
- LENA – S'të vjen mirë, pa s'më kupton. Pse? S'e di unë? Ti mua s'më do.
- SELIMI – Mos e thuaj atë fjalë!
- LENA – Ti do dhe të tjerat.
- SELIMI – Ç'thua, Lenë? Të tjerat i dua si shoqe.
- LENA – Po Lumton?

SELIMI – Shiko ku e nxori!

LENA – Më parë s'e deshe as në brigadë. Kurse tani t'u bë goja Lumto.

SELIMI – E si të mos e dua Lumton?!

LENA – E sheh? Edhe në sy tim thua që e do! Je i keq! Je i keq!

SELIMI – Lenë! Mblidh mendjen. (Me vete.) Po kur s'ka asnjë ndryshim nga gratë e tjera? Si të gjitha edhe kjo, xheloze!

LENA – Nga e di ti se të gjitha gratë janë xheloze?

SELIMI – E kam lexuar në një libër.

LENA – Lëri ato! Ti s'lexon libra.

SELIMI – Mos u bëj fëmijë, Lenë. (Afrohet.)

LENA – Mos u afro! Ja dhe Lumtoja me Zanën. Këtej po vijnë. Po deshe, takoje...

SELIMI – Shiko ç'kohë e bukur sot. Sa keq që s'merremi vesh. Ajri, dielli, zogjtë, pylli, këngët e shokëve, ç'mrekulli! (Hyjnë Lumtoja e Zana duke mbledhur lule.)

SELIMI – Lumto, s'më tregove si e ndjeve veten kur hipe në tribunë.

LUMTOJA – Ajo ditë ka qenë e lumtur për mua. Më rrihte zemra, sikur donte të më dilte nga kraharori, kur fola në emër të atyre që u shpallën sulmuese. Më vjen çudi!

SELIMI – S'ka asgjë për t'u çuditur.

LUMTOJA – Më vjen çudi, që unë, një vajzë e humbur, rritur midis shkrepave, të arrij këtë ditë. Të nderohem nga të gjithë. Të shkruajnë gazetatat, të botojnë fotografinë time!

ZANA – Tek ne, kush punon, nderohet e gëzon.

LUMTOJA – Ke të drejtë, Zanë. Këtë e provova vetë.

SELIMI – Po brigadën, ama, e kemi të fortë.

LUMTOJA – E kemi, se kemi dhe brigadierin të tillë.

SELIMI – Ma bëre qejfin pa të drejtë. E kemi brigadën të fortë se janë punëtoret të tilla, me përjashtim të Lenës. (E shikon Lenën duke qeshur.)

LENA – Jo, Selim, të gjithë së bashku.

LUMTOJA – Shiko ç'lule e bukur. Si kadife. (E këput.)

SELIMI – E bukur vërtet, si ti.

LUMTOJA – E di ç'mendoj. Sikur të prodhonim basmë me një lule të tillë. Ja shikoni, të jetë e bardhë e mbi të këto lule. A s'është e bukur?

TË GJITHË – Shumë.

LUMTOJA – Ka hije një lino e tillë. Kur ta shohin do të thonë: m'u lumshin duart atyre që e kanë endur. T'ua tregojmë këtë lule shokëve të ngjyrosjes.

LENA – Ke lajme nga shtëpia, Lumto?

LUMTOJA – Më ka marrë malli.

LENA – S'i është mbushur mendja akoma babait që e ka gabim?

LUMTOJA – Jo. Po unë kam besim se më në fund do të më kuptojë.

ZANA – Kështu e bënë edhe prindërit e mi. Kundërshtuan e më shanë, më në fund, më thanë: «Na fal, moj bijë, bëmë gabim.» (*Qeshin. Pauzë. Lena e Selimi dalin.*)

ZANA – Sa djalë i mirë është!

LUMTOJA – Kush? Selimi? Vërtet.

ZANA – S'e thashë për Selimin.

LUMTOJA – Po për cilin?

ZANA – Për Palin.

LUMTOJA – E vërtetë, Zanë.

ZANA – I kupton njerëzit.

LUMTOJA – I do dhe i ndihmon. Për mua ka bërë shumë, s'do t'ia harroj. (*Mbledhin lule. Pauzë.*)

ZANA – Lumto, a ke ndër mend të martohesh?

LUMTOJA – Mos e thuaj atë fjalë.

ZANA – Pse?

LUMTOJA – Më vjen turp.

ZANA – Të vjen, s'të vjen, pa martuar s'do të rrish. Më sa mbeten laraskat pa bisht, aq mbeten dhe vajzat pa martuar.

LUMTOJA – Mos, Zanë!

ZANA – Si i ke punët me Palin?

LUMTOJA – S'kam gjë...

ZANA – Më ke shoqe, e s'më ke treguar.

LUMTOJA – E ke gabim, Zanë. Unë s'kam gjë. Asgjë s'kam biseduar me të përveç punës.

ZANA – Po zemrën, a e ke pyetur?

LUMTOJA – S'e di... Mos më fol për këto gjëra, Zanë! Më duket sikur kam malet mbi kokë, kur dëgjoj fjalën dashuri.

(Hyn Pali.)

PALI – Më në fund, ju gjeta. Ku qenki futur kështu?

ZANA – Po mbledhim lule.

PALI – Dikush të kërkon, Lumto.

LUMTOJA – Kush?

PALI – S'e pashë, po, më thanë, një fshatar.

LUMTOJA – Do të ketë sjellë ndonjë letër nga shtëpia.
(Dëgjohen këngë. Pauzë.)

ZANA – Sa ditë e bukur sot!

PALI – Tani të gjitha ditët janë të bukura. Shiko! Shiko ku ka mbirë lulja, në shkëmb. *(Zana del.)* Kush mund ta ndalë këtë forcë?

LUMTOJA – Asnjëri.

PALI – Ajo është e pavdekshme. *(Pauzë. Dëgjohen këngë.)*
Po Zana, ç'u bë?

LUMTOJA – Ja ku mbledh lule atje përtej. *(Pauzë.)*

PALI – Si vete me mësimë?

LUMTOJA – Përpiqem.

PALI – Mos e lësho librin nga dora. Libri, si uji, bën rrugë kudo. Mbaro kursin e regjistrohë në teknikum. Ti duhet të bëhesh mekanike.

LUMTOJA – Është majë e lartë ajo.

PALI – Me vullnet të gjitha majat arrihen.

LUMTOJA – Sa mirë sillesh me njerëzit, Pal. Ti do vetëm të mirën e tyre. I dua me gjithë shpirt, sidomos ata që punojnë më mirë, si ti *(E zë për krahu.)* Ti ke duar të arta. *(Hyjnë një grup i madh punëtorësh duke kënduar. I drejton Kosta. Midis tyre janë Selimi, Lena, Zana, Ademi. Këndojnë një këngë për punëtorinë, me melodi popullore.)*

LUMTOJA – Urime, Kostë, për punën e re! *(Kosta i jep dorën duke dirigjuar.)*

TË GJITHË – Urime, urime!

KOSTA – Ju falem nderit! Por urimet do të ishte mirë të m'i bënëit në klub, çdo natë, se pa punëtorët klubi është i vdekur.

SELIMI – Pa nisur mirë nga puna, fillove nga agjitacioni.

KOSTA – Eh, Selim, si nuk e kupton. Pa kulturë, pa muzikë e teatër nuk ndërtohet socializmi. Apo jo, shoku Pali?

PALI – Ke të drejtë.

KOSTA – Selimi këtë s'e kupton.

SELIMI – S'kam talent për kulturë.

KOSTA – E dëgjoni ç'thotë? S'kam talent për kulturë.
(E imiton. Qeshin.)

LENA – Domethënë, se është i sëmurë akoma.

ZANA – Si është i sëmurë?

LENA – Ka të meta. Nënleftëson kulturën. Autokritikën s'e ka bërë të plotë (Qeshin.)

KOSTA – Sa ngushtë e kupton kulturën dhe artin. (I bie në kokë me shkopin që dirigjon.)

SELIMI – Ngushtë, gjerë, më ndihmo me kitarë. Kush do të vijë me mua në valle? Hajdeni. (Këndon. Kosta shoqëron me kitarë, të tjerët me zë. Duke kënduar lozin valle.)

O ju shokë dhe ju shoqe,
i madh është numri jon,
kundër tiranisë fashiste
gjithë bota lufton.

Hajt të punojmë,
djersët le t'kullojnë
se ndërtojmë
Shqipërinë e re...

SELIMI – Ja, pra, se artin nuk e nënçmoj.

TË TJERËT – (Duartrokasin.) Të lumtë, Selim!

KOSTA – Je me të vërtetë talent.

PALI – A do ta bësh anëtar të grupit të valleve të fabrikës?

KOSTA – Të valleve e të korit, që sot.

PALI – Po mos harrosh shoqet?

KOSTA – Ato i harronte Adem Hasani, por unë jo. (Qeshin.)
Shokë! Harrova t'ju them, se një delegacion fshatarësh kërkon të takohet me Lumton.

LUMTO – Delegacion?

KOSTA – E pra, merre si të duash. Ca fshatarë duan të takohen me ty.

SELIMI – Është e vërtetë. Lumton e kërkon një burrë.

LUMTOJA – Cilët janë këta njerëz që më kërkojnë kaq shumë?

ZANA – E s'të gjejnë dot.

SELIMI – E takova. Ishte një fshatar. Kam ca fjalë, tha, me atë vajzën nga fshati, Lumto Çerçizin.

PALI – Ku e pe?

SELIMI – Te burimi.

PALI – Shkojmë Lumto, ta takojmë. Të shohim ç'të reja na sjell.

LUMTOJA – Shkojmë. (Dalin Lumtoja e Pali. Pas tyre dalin të gjithë duke kënduar të udhëhequr nga Kosta që dirigjon.)

SELIMI – Të kujtohet, Lenë, dita që u fejuam? Atë ditë brigada jonë për herë të parë tejkaloi planin. Ndenjëm në mbërmje gjer më dy pas mesnate. Të përcolla në shtëpi. Të kujtohet? «Më vjen keq që po ndahemi», më the, dhe më përcolle ti. Unë të thashë: «Shko fli se u bë vonë.» «S'ka gajle, – m'u përgjigje, – koha ka punën e vetë». Pastaj të përcolla unë ty gjer te dera e shtëpisë, pastaj ti mua, pastaj unë ty. E kështu gjersa u gdhí.

LENA – Po të nesërmen në punë u paraqitëm në kohën e duhur. (Del.)

SELIMI – Lenë! Lenë! (Duke dalë ndeshet ballë për ballë me Veliun që mban në dorë një gazetë.) Më fal... E, more shok, ti qenke? A e gjete Lumton?

VELIU – Jo.

SELIMI – Këtu ishte tani. Sa iku.

VELIU – Pyet njerin, s'e di, pyet tjetrin, s'e di, po s'humbi de. Njeriu s'është gjilpërë. Ku vajti?

SELIMI – Këtej pyllit, shkoi me një shok.

VELIU – Pyllit? Me një shok? Vetëm me një shok!?

- SELIMI – Ai një, dhe ajo, dy, d.m.th. vetëm. Po shkoj ta lajmëroj. *(Thërret.)* Lenë, prit më! *(Del.)*
- VELIU – S'marr vesh. *(Thërret.)* Moj grua! Pa na këtu, moj! Shiko, shiko ç'bën! Po lëre atë të shkretë thes, mjaft e hoqe pas! *(Pauzë, hyn Fatimeja me fustanin e ri që i ka dërguar Lumtoja.)* Dëgjo. Si do t'i themi kur të na pyesë pse kemi ardhur?
- FATIMEJA – T'i themi erdhëm sa për ta parë se na mori malli. Nesër do të ikim. Ajo do të na thotë rrini, dhe ne qëndrojmë.
- VELIU – Grua, s'ke gjë në torbë. Kështu do ta marrë vesh. Po më mirë t'i themi se jemi sëmurë e erdhëm të shihemi te heqimi.
- FATIMEJA – Mirë e mendove. Të mençur të kam, o burrë.
- VELIU – Rregulloje një çikë fustanin se të rri si thes. Kur të të shohë jot bijë të gëzohet, që ta ka dërguar kaq të mirë.
- FATIMEJA – Edhe ti me këtë këmishë... *(I afrohet dhe i mbërthen kopsat.)* S'di hiç ta mbash.
- VELIU – Hë, moj, edhe ti, se s'ka gjë.
- FATIMEJA – Si s'ka gjë?
- VELIU – Posi, u turpëruam!
- FATIMEJA – Sa herë të kam thënë që t'i mbërthesh të gjitha kopsat.
- VELIU – Po bën vapë, moj.
- FATIMEJA – Bën, s'bën. Edhe dielli sikur të bjerë mbi tokë, duhet t'i mbash të mbërthyer, ja kështu! Se këtu është qytet dhe të qeshin, s'është si në Guror.
- VELIU – Posi, u turpëruam. Po ushtari, moj ç'u bë?
- FATIMEJA – Mbeti prapa.
- VELIU – *(Thërret.)* Ooo Xhelooo!
- FATIMEJA – Shshshsh! Pupu, si thërret, si në mall!
- VELIU – Po në mal jemi, moj.
- FATIMEJA – S'ka lezet. Nuk është mirë. Pylli është plot. Do të thonë, kush thërret kështu? Veli Çerçizi, i ati i vajzës nga fshati, ai prapaniku!
- VELIU – Punë e madhe, u turpëruam!
(Hyn Xhevoja i veshur ushtar me të shoqen.)
- XHELOJA – Edhe këtu s'qenka?

- TAZJA – Unë thashë se e gjetët, kur thirri xha Veliu.
- FATIMEJA – S'është.
- VELIU – Këtu ishte po hyri në pyll. Të mos qe allavitur gruaja rrugës me atë dreq thes, do ta kishim takuar këtu.
- XHELOJA – U thashë ta linit thesin te fabrika.
- VELIU – Epo ja, s'deshi, ç't'i bëjmë?
- TAZEJA – Ama fambrikë ishte!
- FATIMEJA – Sa e madhe, si mall!
- VELIU – Tamam si në kinema që kemi parë? Po ç'e ka gjithë atë derr oxhak?
- XHELOJA – Të hyni brenda, pa të cuditi. T'u lozë telepeku i kokës. Këtu e ke pambuk, atje fije të trasha, atje fije të holla, atje më tej pëlhurë, matanë basmë me lloj-lloj najrash. Lëre mos e pyet. E të tëra këto i bëjnë nierëzit tanë.
- VELIU – Kaq u bëra, po s'ma ka marrë mendja se do të kishte te ne çudira të tilla.
(Hyn Ademi duke fotografuar vende të ndryshme në pyll.)
- FATIMEJA – Pyete, o Veli. se mos e ka parë.
- VELIU – (Fatimesë.) Prit. (Ademit.) O shok!
- ADEMI – C'doni?
- VELIU – Si je?
- ADEMI – Mirë, faleminderit! Po ju si jeni?
- VELIU – S'ka më mirë. Urdhëro të ndezim një duhan (I zaiat kutinë.)
- FATIMEJA – Mos, more burrë, se na turpërove. S'je në fshat që të... Këtu i thonë qytet.
- VELIU – Edhe këtu Shqipëri është, po rri, se duhani e hap muhabetin.
- ADEMI – (Nxierr paketën «Partizani».) Urdhëro. Ndize, xhaxha! Edhe ti, o shoku ushtar.
- XHELOJA – (Duke nderuar ushtarakisht.) Faleminderit!
(E ndez.)
- ADEMI – Nga vini?
- XHELOJA – Nga fshati.
- VELIU – Nga mali. Është një fshat andej, Guror i thonë.
- ADEMI – S'e kam dëgjuar ndonjëherë.

- XHELOJA – Ç'ta dëgjosh. I tëri shkëmb e gur është.
- ADEMI – Për punë keni ardhur këtu?
- FATIMEJA – Jo.
- VELIU – *(Vështron Fatimenë me bisht të syrit, me inat.)*
Po, or shok, për punë.
- XHELOJA – Kemi ardhur familisht. Kjo është gruaja ime. Ky është xhaxhai dhe kjo tetoja. Unë s'kam mbaruar akoma ushtrinë.
- ADEMI – Gëzohem!
- VELIU – *(Pahitet me gazetë në mënyrë që gazeta të bjerë në sy të Ademit.)* Një të keqe keni ju këtej, bën vapë. *(Bëhet gati të shkopsitet, po Fatimeja e godet me bërryl.)* E andej nga ne vetëm një të mirë ka, bën fresk.
- XHELOJA – Edhe këtu fresk është, xha Veli.
- ADEMI – Të sotmen e ke këtë gazetë?
- VELIU – Po, të sotmen.
- ADEMI – Ç'ka ndonjë të re?
- VELIU – Urdhëro, këndoje vetë. *(Ia jep.)*
- ADEMI – Qenka e javës së kaluar.
- VELIU – Epo, andej nga ne, vjen me vonesë.
- ADEMI – *(Duke parë gazetën.)* E shikoni këtë fotografi? Është Lumto Çerçizi.
- VELIU – Ashtu?
- ADEMI – Nderi i fabrikës sonë.
- VELIU – Po nga është kjo?
- ADEMI – Një vajzë nga fshati. Punon sa për pesë.
- XHELOJA – Mos më bëhesh dhe ti, moj Taze, nderi i fshatit.
- TAZJA – Ç'thua, Xhelo?
- ADEMI – Hiç mos u çudit. Jo ti që je e re, po edhe ti. *(Fatimesë.)* mund të bëhesh.
- FATIMEJA – Ç'fjalos, more djalë!... *(Qesh.)*
- ADEMI – Mësohesh. Ja, kjo shoqja jonë *(Tregon fotografinë në gazetë.)* ka ardhur nga fshati. Në fillim mezi punonte, copëtohej në punë e shumë pak jepte. Dëshpërohej, inatosej. Nganjëherë e zinte malli për shtëpinë, se ka lënë në fshat nënën dhe babanë, dy kokëshkretë që donin ta martonin me

një Daut, Daut, torollak. Dy budallenj, dy të marrë...
dy... si t'u them unë... (Veliu e Fatimeja shikohen
në sy, të habitur. Xhevoja qesh. Tazja zë gojën me
dorë.)

VELIU – Dy hajvanë, thuaj.

ADEMI – Tamam, dy kokëshkretë.

FATIMEJA – Sa prindër të këqij! (Fshin sytë.)

VELIU – Të marrë paskan qenë! (Fatimesë.) Pusho, mos
qaj.

XHELOJA – Hajde, o xha Veli hajde, i çuditshëm je!
(Qesh. Ademit.) S'e kanë kuptuar që vajza e tyre
është në rrugë të drejtë.

ADEMI – Ka mjaft njerëz kështu, që s'e kuptojnë. Po,
kjo (Tregon fotografinë në gazetë.) i ka nderuar.

VELIU – (Fatimesë.) Pusho të thonë!

ADEMI – Ç'ka që qan?

VELIU – I dhembin sytë.

XHELOJA – Çfarë sy i dhembin! Lumtoja është vajza e
tyre.

ADEMI – Si?

TAZEJA – E kanë çupë Lumton.

ADEMI – Lumto Çerçizin?

FATIMEJA – Është bija jonë.

ADEMI – Lumtoja? Kjo këtu? (Tregon gazetën.)

VELIU – (I tregon një fotografi që e ka nxjerrë nga
xhepi.) Po, ja ku e kam dhe resmen. Ka dalë në
punë e sipër.

ADEMI – (Shikon fotografinë.) Bija juaj?

VELIU – E tëra, ajo.

XHELOJA – Dhe ky është i ati, dhe kjo është e ëma.
Dhe ne, kushërinjtë e saj.

ADEMI – Më falni, për fjalën e rëndë që ju thashë. Më
jepni dorën e t'ju uroj që keni një vajzë të tillë.
(I zë për dore.) Unë jam Ademi, normist në fabrikë.
Sa mirë, kushedi se sa do të gëzohet Lumtoja.
Gjithnjë flet për ju. Ju ka përitur.

VELIU – Më në fund vendosëm të vijmë. Mezi na u
mbush koka. Dhe vendosëm atë ditë që pamë në

- gazetë resmen e saj. Është apo s'është ajo? S'u besonim syve. Pastaj i morëm vesh të gjitha.
- ADEMI – Meqë qenka puna kështu, më lejoni t'ju marr në fotografi.
- VELIU – Çfarë?
- ADEMI – Një fotografi, ju lutem, urdhëroni, rriini këtu!
- VELIU – Ç'thotë kështu, more Xhelo?
- XHELOJA – Resme, resme do na nxjerrë.
- VELIU – Aa! resme! E po kështu thuaj që ta marrim vesh. (Qëndrojnë për t'u marrë fotografi. Një fotografi tipike, ku njerëzit qëndrojnë drejt, si qirinjtë, me duar të shtrira ose përpara në bark, duke u munduar që të duken sa e sa më bukur. Ademi i fotografon, ndërsa ata, rrinë gjatë të pozuar.)
- ADEMI – Prisni një minutë, se jua sjell unë Lumton tani. (Del duke thirrur.) Lumto! Lumto! Të kanë ardhur prindërit. (Pas tij shkojnë edhe Xheloja me Tazen duke vrapuar.)
- FATIMEJA – Harrova thesin! (Shkon ta marrë.)
- VELIU – (E ndalon duke e zënë për krahësh.) Lëre, se s'ka kush ta merr. Të gjithë tanët janë.
- FATIMEJA – Po ç'më shtyn kështu edhe ti, sikur jam e vogël!
- VELIU – Hajde! Hajde!
(Hyjnë Lena dhe Selimi pa diktuar Veliun dhe Fatimenë.)
- LENA – Oj, ç'mrekulli! Sa i mirë je ti, Selim! (E përqafton.)
- SELIMI – Si më ka bërë natyra.
- FATIMEJA – Shikoji, burrë, shikoji.
- VELIU – (Tund kokën.) Jo mirë... E, të tjera kohë, të tjerë njerëz. Po ku e kam parë këtë djalë? Se ku e kam parë.
- LENA – Je me të vërtetë i mirë. Tani unë e kuptoj se kam gjetur tamam shokun e jetës!
- SELIMI – Lenë!
(Përqaftohen. Fatimeja e Veliu hapin sytë të habitur dhe u kthejnë kurrizin.)
- LUMTOJA – (Nga jashtë.) Erdha! Erdha!
- FATIMEJA – E njoh nga zëri. Çupa ime është.

- VELIU – Të dy e kemi, moj grua.
- FATIMEJA – Më rreh zemra! (*Hyjnë Lumtoja, Pali, Ademi, Xhehoja dhe Tazja.*)
- LUMTOJA – Prindërit e mi të dashur! (*Përqafohen fort.*)
Nënë! (*Veliut i bie stapi nga dora.*)
- FATIMEJA – Trimëresha e nënës!
- LUMTOJA – Baba!
- VELIU – Sa qenke rritur!
- LUMTOJA – Më në fund, erdhët.
- VELIU – Erdhëm, kokëshkretët, erdhëm.
- PALI – Mirë se erdhët!
- VELIU – Ou, Pali, partizani i parë i shtëpisë sime. (*E përqafohen.*)
- PALI – Isha i sigurt se nuk do ta bënit hasha vajzën tuaj. Ja, sa mirë, sa mirë! Apo keni ardhur t'i mbushni mendjen që të martohet me atë, si ia thonë emrin?...
- VELIU – S'ka më Daut! E prishëm fejesën! E drejta është me ju. Me ju dhe vetëm me ju.
- FATIMEJA – Tani e gjetëm edhe ne. Pak me vonesë, po e gjetëm.
- VELIU – Dhe mund të them: sumbull moj sumbull, të gjitha të mirat grumbull.
- XHELOJA – Dhe jo të zezat, siç ke thënë gjer më sot.
- VELIU – Të zezat i hodhëm prapa krahëve.
- XHELOJA – I çuditshëm je, o xha Veli. Ama shpirtin na e more, gjersa t'u mbush radakja.
- VELIU – Me mendtë e tua unë s'vete as gjer atje, ku thonë. Ç't'u bëj këtyre, Palit, Lumtos. Këta ma mbushën radaken. (*Hyjnë Zana e Kosta me një grup punëtorësh duke kënduar.*)
- ZANA – Erdhët të pajtoheni me vajzën?... Më në fund... (*Përqafohet.*)
- KOSTA – A më mbani mend?
- VELIU – Normisti.
- KOSTA – Ish-normist. Tani jo. Prezantohem: përgjegjësi i klubit, drejtor i kulturës dhe muzikant! (*Përqafohet. Pleqtë s'marrin vesh ç'tha.*)
- FATIMEJA – Edhe ti, Zanë, ke qenë te ne një herë:

- ZANA – Jo një herë, po disa herë. Sa herë që keni marrë letër nga Lumtoja... (Xhelos.) A, Xhelo prapaniku? «Është puna ime!»
- XHELOJA – Të lutem shoqe, mos më thuaj prapanik. Atë fjalë e urrej.
- LUUTOJA – I tillë ke qenë.
- XHELOJA – Sot s'të pyesin si ke qenë, po si je.
- LUMTOJA – A e lejon Tazen të vejë në mbledhje.
- XHELOJA – Ajo punë ka marrë fund. Në mbledhje e në aksione.
- LUMTOJA – Të lumtë, Xhelo! Të falënderoj edhe për letrat e për këshillat që më ke dërguar.
- XHELOJA – Po me të vjedhur mësova, unë i ziu, me të vjedhur.
- PALI – Ç'ke që rri i menduar, xha Veli?
- VELIU – Epo, kjo që bëra unë, s'është gjë e vogël. Ne pleqve, kur lajthitim ndonjëherë, mos na e vini re.
- PALI – Sido që të ndodhë, ju jeni prindërit tanë.
- LUMTOJA – Edhe ne, bijat tuaja.
- VELIU – Rrofshi e përparofshi!

(Kosta menjëherë drejton korin. Të gjithë këndojnë.)

FUNDI I KOMEDISË

PUBLICISTIKË

Redaktor

ALI DHRIMO

MENDIME NË PRAG TË KONGRESIT

Njëzet vjet jetë, tre kongrese, sa pak janë për një Partit! Po nuk matet pjekuria e urtësia e Partisë së Punës me vitet e saj. Njëzet vjet e tre kongrese do të thonë kapërcimi i më se një shekulli, përmbysja e plotë e një shoqërie të kalbur, mbyllje e plagëve të rënda që kullonin gjak në trupin e atdheut, dalja e popullit në dritën e diellit jetëdhënës...

Tani do të zhvillohet i katërti. Ai, ashtu si dhe kongreset e tjera, do të hapë një faqe të re të shkëlqyer të historisë. Partia dhe populli kanë festë më 13 shkurt, sepse parti e popull janë një. Partia e Punës është qëllimi i jetës sonë, puna e saj është puna jonë, fjala e saj është ligji ynë, hidhërimi i saj është hidhërimi ynë, gëzimi i saj është gëzimi ynë. Dhe kështu qëndron tani forca jonë e lumturia jonë, te ky beton i shtrënguar mirë me hekura: parti-popull!

Parti e popull! Thua këto fjalë e mendja shkon tek ata njëzet e tetë mijë shqiptarë, që ranë si heronj në revolucion dhe me gjakun e tyre bënë njësh Parti e popull. Thua këto fjalë e mendja shkon 17 vjet pas, kur ne derdhëm djersën çurkë mbi themelet e para të socializmit. Thua këto fjalë e sheh saksitë me lule në ballkonet e shtëpive të reja, sheh qytete e fshatra të reja, që s'dinë ç'është shfrytëzimi e prona private, qytete e fshatra pa xhami, pa kisha e pa mejhane, po me fabrikë, me klub e çerdhe, ku fëmijët shohin ëndrra të bukura. Thua Parti

e popull e mendon se ne s'jemi më pranë dritës të parë, pranë detit të palarë, pranë dijes së panxënë, pranë sofrës të pangrënë. Neve na ndrit tensioni i lartë, verojmë buzë Adriatikut e në liqenet e Lurës, mësojmë në universitetin imë të ri të botës dhe i bëjmë të dridhen imperialistët e revizionistët.

Parti e popull...

Ata që bënë revolucionin po thinjen. Atyre që lindën ditën e Çlirimit po u diris mustaqja. U rrit Partia! U rrit Shqipëria, u bënë zonjë! U rritëm ne, u bëmë burra! Dhe po rriten fëmijët tanë: një milion e gjashtëqind e njëzet e pesë mijë!

Ja ç'bëri Partia leniniste, drejtuar nga farkëtuesi i lumturisë popullore, Enver Hoxha, më njëzet vjet jetë e me tre kongrese, duke ndjekur me besnikëri të vetmen busull të drejtë të njerëzimit, marksizëm-leninizmin.

Kongresi i Katërt! Pesëvjeçari i tretë! Buletinet thonë se, me gjithë vranësirat, korrjet do të jenë të bollshme edhe në motet që do të vijnë. Zemra e popullit është plot shpresë e besim: Kongresi i Katërt e pesëvjeçari i ri do të sjellin gëzime të reja për ne e hidhërime të reja për tradhtarët e atdheut, për imperialistët e për tradhtarët e marksizmit. Kongresi i Katërt e pesëvjeçari i ri janë plot dritë e shkëlqim dhe domosdo do t'i verbojnë ata që janë mësuar të jetojnë vrimave e në errësirë. Vdekja brend nëpër botë e rreth kufijve tanë (andaj ne mbajmë çarkun ngrehur), por e nesërmja është jona, e nesërmja komuniste! Ne po e farkëtojmë atë me djersë e me këngë, me këngë e me djersë.

Sa e sa këngë të bukura kanë ngritur poetët e artistët tanë për Shqipërinë e lirë, për shqiptarin krenar, krijues e paqedashës, për Partinë kreshnikë!

Këngët t'i kemi falur ty, o nënë Parti!

Vendimet e Kongresit të Katërt do të jenë burim frymëzimi për veprimtarinë tonë krijuese. Ne do të shkruajmë për heronjtë e pesëvjeçarit të ri, duke u lidhur më ngushtë me popullin, me gëzimet e hidhërimet e tij. Ne do të shkrijmë jetën tonë për krijimin e veprave artistike të realizmit socialist, që t'i këndojnë popullit e Partisë. Lum-

turia e artistit tonë qëndron në punën që ai bën për popullin e për Partinë.

Sipas kalendarit, Kongresi çelet në mes të dimrit. Por, sipas motit shqiptar, ai çelet në fillim të pranverës. Mimosat ka kohë që lulëzojnë, dielli shndrit përmes re-ve, fryn erë e vakët. Kongresi e pranvera mbushin me gëzim zemrat tona të dëlira. Edhe në këtë Kongres, në këtë pranverë, ne do t'i dhurojmë Partisë pikturat tona plot diell e ngrohtësi shqiptare, vargjet që kemi shkruar me zjarrin e zemrës, këngët të frymëzuara nga dashuria e madhe.

Artin tonë dhe zemrat tona t'i kemi falur ty, o nënë Parti!

«Drita» 5 shkurt 1961

NË FENIKS, HORIZONTI I PASTËR!

Një njeri shfaqti dëshirën të lundronte me nëndetëse. E pyetën nëse e zinte deti dhe ai u përgjigj se kishte lundruar në dete e oqeanë, në furtunë e uragan, dhe vaporit s'e kishte zënë.

— S'dua t'ia di as nga nëndetësja, — tha ai me bindje.

I shpjeguan se kur të zhyteshin pesë metra, ai do të turbullohej, kur nëndetësja të zbriste njëzet metra, atij do t'i merreshin mendtë dhe kur të jepej urdhri për të depërtuar në thellësi të mëdha, patjetër ai do të nxirrte zorrët.

Filluan lundrimin dhe ndodhi tamam ashtu siç i kishin thënë. Ky njeri i deteve, kur dëgjoi urdhrin që anija të zhytej në thellësi të mëdha, nuk qëndroi dot në këmbë, u zverdh e u bë dyllë.

Po më e madhja është se kjo kishte qenë vetëm një provë. Nëndetësja nuk kishte luajtur fare nga vendi, ishte gjithnjë mbi ujë. Kuptohet lehtë se si i ka ardhur këtij njeriu, kur mori vesh të vërtetën...

Këtë ndodhi ma treguan detarët, kur më propozuan të lundroja me nëndetëse nën ujërat e detit tonë. Ai ishte kjo një ngjarje e vërtetë apo një anekdotë s'ka rëndësi. Puna është që ky tregim më bindi se unë nuk do të pësoja të njëjtën gjë në nëndetëse.

Gjer atëherë kisha udhëtuar me të gjitha mjetet: me kuaj e karrocë, me makina e tren, me vapor e aeroplan. Kisha hyrë edhe në thellësi të tokës, nëpër miniera. Po

në thellësi të detit jo. Dhe kuptohet gëzimi im i madh, kur më propozuan një lundrim të tillë. Të them të drejtën, nata m'u duk muaj, gjumin e bëra me hope, isha i shqetësuar. Prisja me padurim agimin e ditës. Nuk ishin kurioziteti dhe ekzotika ato që më ngjallën në shpirt ngazëllimin e shqetësimin. Të paktën, këto nuk ishin arsyet kryesore. Këtë gjendje të nderë shpirtërore ma krijoi mendimi se ne jemi bërë zotër të tokës sonë, zotër të qiellit tonë, zotër të detit e nëndetit tonë. Tokën ne e kemi pasur tonën gjithnjë, paçka se atë përkohësisht e kishin rrëmbyer pasanikët apo pushtuesit e huaj. Çdo pëllëmbë të saj shqiptari e ka ujitur me gjak brez pas brezi dhe e ka mbrojtur nga pushtuesit. Po si ta mbronim ne qiellin e kaltër e detin e kaltër? Më kujtohet maji i vitit 1943. Ne goditëm atëherë trupat fashiste në Leskovik. Na erdhi një aeroplan e na gjuajti nga lart me bomba e mitraloz. Një partizan, i zemëruar që s'kishte ç't'i bënte «zogut» prej hekuri, doli në mes të lëndinës, ngriti pushkën lart nga qielli e thirri: «Mos na gjuaj me «çokollata», more derr pe derri, po zbrit këtu, në ta mban, të shohësh nga ke dalë!» dhe nga inati e qëlloi me pushkë. Po plumbi, sigurisht, i shkoi kot. Nuk më kujtohet kush ishte ky partizan. Ndoshta u bë theror maleve, ndoshta është gjallë dhe aëndron tashti në drejtim të reaktivit. Po në mos ai, shokët e tij, janë bërë sot zotër të qiellit shqiptar dhe armikut nuk ia mban të shkelë hapësirat tona qiellore.

Edhe deti ynë ka qenë pa mbrojtje. Anijet grabitqare vinin e akostonin në bregun shqiptar, pa pyetur njeri, si në bregun e tyre. Ne s'kishim një mjet lundrues që t'ua thyente brinjët kryqëzorëve italianë më tridhjetenëntën. Detar ishte legjendari Mujo Ulqinaku, po ai i mbrojti ujërat tona jo nga deti e nga anija, po nga kalaja e Durrësit. Kurse sonte unë po mundohem të fle në kabinën e anijes moderne luftarake dhe pres me padurim agimin që të lundroj me nëndetësen shqiptare. Dhe mendoj:

«Ne jemi zotër të tokës sonë, zotër të qiellit tonë,

zotër të detit e nëndetit tonë.» Dhe ky mendim më ngazëllon e më lë pa gjumë!

Sado e gjatë që të jetë nata, vjen një kohë dhe terri i saj shkrihet dalëngadalë në bardhësinë e agimit. Dhe agimi erdhi. Ishte një mëngjes i bukur, i qetë e i qartë, mëngjes vere. Kur dielli u ngrit madhështor mbi majat e maleve dhe derdhi mbi det argjendin e ndritshëm dhe ngjyrat opale të tejdukshme, unë hipa në nëndetëse. Një minutë më vonë, anija prej çeliku u shkëput nga bregu dhe çau cipën e qetë të detit.

Ja, pra, unë lundroj me nëndetësen tonë. Jam bërë me krahë e më duket sikur do të fluturoj. Thith ajrin e freskët që vjen nga bregu e që bie erë rrëshirë, kundroj kaltërsinë e detit e të qiellit dhe sodis detarët që zbatojnë me shpejtësi urdhrat e komandës. Vështroj edhe malet e larta që janë mbuluar nga një tyl shumë i hollë mjegulle. Këto male ndër shekuj kanë qenë mburoja jonë. Stërgjyshërit, që në kohët më të lashta, për të mos iu nënshtruar armiqve të shumtë e të egër, kanë lënë brigjet e begatshme të detit dhe janë strehuar maleve. Në këto male gjëmoi pushka partizane dhe u varros një herë e përgjithmonë pushtuesi i huaj dhe tradhtia. Me të drejtë na kanë quajtur vend malor e malësorë. Pa shiko si radhiten njëri pas tjetrit: male, male, male dhe male!

Po unë lundroj me nëndetëse! Jam mbi urën e komandimit dhe pyes detarët se nga ç'vend janë. Dëgjoj përgjigjet e tyre: Nga Skrapari, nga Tepelena, nga Vithkuqi, nga Dukagjini. Po, edhe nga Dukagjini ka njerëz në nëndetësen tonë! Nga tërë krahinat malore ka detarë marina jonë e fuqishme. Shqiptari zbriti edhe nga malet në det dhe u bë zot i tij. Unë vështroj detin që të verbon me shkëlqimin e argjendtë. Ai shtrihet nga Shkodra gjer në Vrinë. Në ujërat e tij lundrojnë «Vlora», «Skënderbeu», «Partizani», «Iliria»... Në ujërat e tij vigjilon e fuqishmja flota jonë ushtarake! Det, det, det dhe det! Që nga Shkodra gjer në Vrinë shtrihen malet. Det e mal, mal e det. Shqipëria është malore! Shqipëria është edhe detare! Vendi im malor, vendi im detar, Shqipëri!

Çuditë kur marr vesh se unë, që s'i kam mbushur

të dyzetat, jam më i madhi me moshë. Shokët që më shoqërojnë, dy oficerë, dy ish-partizanë, njëri nga Pogrdeci e tjetri nga Skrapari, janë bërë detarë menjëherë pas Çlirimit. Po edhe ata janë më të rinj se unë. Të tjerët, që nga komandanti gjer te kuzhinieri i nëndetëses, janë fare të rinj. Ata s'kanë marrë pjesë në luftë. Atëherë kanë qenë fëmijë. Po lufta u ndriçoi atyre fëmijërinë. Rinia e tyre ka vetëm pak vjet që ka filluar: një rini plot ëndrra, plot pasione, plot shpresa, plot romantizëm. Dhe unë përpiqem të hyj në shpirtin e këtij brezi të ri që është bërë zot i detit, zot i nëndetëses...

Jepet komanda për zhytje dhe më ftojnë të largohem nga ura e të futem brenda. Vështroj për të fundit herë qiellin pa asnjë re, zbres nëpër shkallët e hekurta dhe më duket sikur po futem në një pus të thellë me mure prej hekuri. Një afsh i nxehtë, sikur të jem pranë grykës së ndonjë furre, më përplasat në fytyrë dhe, me të mbërritur në postin qendror të komandimit, trupi më mbulohet me djersë.

«Sigurisht atje lart ishte shumë më mirë, – mendova. – Ajri është i freskët, ngjyrat të mrekullueshme dhe mund të pije duhan, kurse këtu, xhehenemi vëtë», – po këtë mendim e fsheha menjëherë.

Nga jashtë nëndetësja duket e thjeshtë, si një barkë prej çeliku shumë e gjatë e shumë e ngushtë, me një mori dollapësh të vegjël rreth e rreth e me urë në mes, si oxhak vaporit. Asgjë më tepër veç kësaj bukurie të thjeshtë. Kurse këtu në barkun e saj, oh, këtu, s'je më në anije, po në një uzinë të ndërlikuar, në një labirint aparatësh që punojnë si sahat, këtu je në një ngushticë të nxehtë motorësh, tubash, telash, mikrofonash, timonësh, ruletash, silurqash..., të cilat, po s'e pate mendjen, të godasin keq në bërryla, në ballë, në gju, në tepe të kokës. S'ka interes të tregoj «plagët» që mora nga këto goditje, si njeri i pamësuar në një ambient të tillë. Kam parë shumë uzina e shumë torno precizioni, po më duket se nëndetësja ua kalon të gjithave. E them me bindje se s'ka ndërmarrje tjetër që të shfrytëzojë kaq shumë territorin e vet të punës si nëndetësja. Këtu duhet të

kalosh brinjazi e me kokë ulur. Dhe aparati më i përpiktë, si kudo, është njeriu, detari, i mbuluar me sumbulla të ndritshme djerse. Ai është shpirti e zemra që u jep jetë këtyre çeliqueve, bakëreve, alumineve, qelqëve, hekurave, telave... Pse të mos e them? E ndjeva veten keq nga vapa. U detyrova të zhvishesha si të tjerët, duke mbajtur vetëm të mbathurat. Oficer Beqiri më dha një copë beze. U fshiva me të. Pas pak bezja u bë qull, për ta shtrydhur dhe trupi u mbulua përsëri me djerse. Dhe përsëri më dhanë një copë beze të thatë e të pastër.

“Sigurisht atje lart ishte shumë më mirë”, – mendova përsëri duke indier vapën e mungesën e ajrit dhe duke marrë vesh se këtu temperatura ishte e madhe, pesëdhjetë gradë, aq sa, kur thonë, mund të piqej buka. Por, nëse kjo nxehtësi mua më jep dhimbje fizike, ajo, nëndetësve nuk ua pengon punën normale.

Jashtë mund të dëgjosh zhurmën e dizeleve, të shkuarës që ata formojnë në qiç, të valëve që përplasen në bordet. Mund të ndiesh edhe lëkundjet më të lehta të shpatullave të detit, mund të dëgjosh edhe bisedën e fshehtë e gazmore të dy detarëve. Kurse këtu, në bark të anijes, ka një heshtje të çuditshme: as zhurmë motori, as përplasje valësh, as lëkundje, as biseda të zjarra, tamam si në parajsë. E bëj këtë krahasim sipas zakonit, se nga parasja s’ka ardhur njeri, që t’i besojmë heshtjes së asaj bote të paqenë. Po këtu, e përsëris, ka një heshtje të çuditshme. Të gjithë qëndrojnë pranë aparateve shumë të ndërlikuara që unë s’i kuptoj, me gjithë dëshirën time të madhe për të mësuar diçka nga fshehtësitë e tyre. Me të drejtë, thuhet se pena e shkrimtarit s’ka të bëjë me aparatet, me motorët, me teknikën. Detyra e saj është njeriu. Prandaj unë po i lë mënjatë makineritë moderne, po merrem me gjënë më të çmuar: me njeriun, e në këtë rast, me vëllanë tim të gjakut, të një gjuhe, të një partie: me detarin shqiptar.

Më shumë se çdo gjë këtu dëgjon urdhra e përgjigjet për plotësimin e tyre. Më drejt është të thuhet se këtu dëgjon vetëm urdhra të shkurtër, të prerë, pa fjalë shumë, që jepen e merren nëpër gypat, do të thosha pa

ë tepruar, me shpejtësinë e rrufesë. Ato përhapen nga posti qendror i komandimit nëpër repartet dhe kthehen përsëri po të ky post brenda disa sekondash. Dhe nëndetësja zhytet si një qenie e gjallë e përhershme e detit. Më ftojnë të shoh me periskop. Ne jemi nën ujë, po me anën e këtij syri magjik unë shoh cipën e detit, bregun, horizontin, qiellin. Shoh dhe s'ngopem së pari bukurinë e mahnitshme të kësaj pjese ngjyra-ngjyra të atdheut tonë. Nëndetësja është duke u zhytur. Ja ku po mbulohet këtu me flluska të bardha uji, sikur buron aty poshtë një lumë i madh, i kulluar e shkumë-shkumë. Pakëz më tej shoh një anije të vogël të radit. Në urën e saj dalloj shokët e mi shkrimtarë Dhimitrin e Shevqetin, që kishin shfaqur dëshirën të shikonin zhytjen e nëndetësës. Tani ata nuk dallojnë gjë dhe anija e tyre po drejtohet për në bazë, kurse unë, që nga ky sy i fshehur që e ka majën atje lart disa centimetra mbi ujë, i shoh si në pëllëmbë të dorës.

Përsëri urdhra e raportime:

- U mbush ballasi kryesor...
- Kontrolli u bë, vërejtje s'ka...
- Në feniks, horizonti i pastër...

Unë shoh në periskop. Horizonti shqiptar është vërtet i pastër!...

Zhytëmi në thellësi të mëdha. Periskopi ulet dhe tashti çdo gjë që ka mbi det kontrollohet jo me anën e syrit, por me aparatet e brendshme, që janë më të përpikta se syri. Jepet alarm luftarak, kur anija arrin fundin e detit. Gypat e transmetimit buçasin:

- Gati për luftë!
- Gati për luftë!
- Gati për luftë!

Vështroj komandantin e nëndetësës, këtë tepelenas trupgjatë, flokëdredhur, syzi e hundëshqiponjë. Ai është shumë i qetë e shumë i sigurt, si ndonjë detar i moçëm, megjithëse s'ka asnjë muaj që ka marrë në dorë drejtimin e nëndetësës. Pranë tij qëndron një oficer që ka më shumë shkollë e më shumë përvojë. Ka ardhur për të parë, për të ndihmuar dhe unë vë re se ai është i kë-

naqur nga komandanti i ri. Këtë kënaqësi e gëzim e shprehin sytë e tij të bukur, rinorë, të qeshur. Duket sikur thotë: «Nëndetësja është në duar të sigurta!»

Kisha menduar t'i krahasoja detarët me detin në tallaz. Po ky krahasim nuk do të ishte i drejtë, të paktën për nëndetësit. Ja ku i kam të gjithë para syve. Kaloj nëpër repartet e ndryshme. Të gjithë janë të qetë, gjakftohtë, të butë, si poetë e jo si luftëtarë. Gjakftohtësia është një nga karakteristikat kryesore të këtyre djemve të rinj që kalojnë më të shumtën e kohës midis këtyre aparateve e makinerive të ndërlikuara, ku është thënë fjala e fundit e teknikës. Ndoshta nuk i shkon kjo gjakftohtësi moshës së tyre të re. Po ky është fakt. Të gjithë janë zhveshur. Mbi lëkurën ngjyrë bronzi vezullojnë rrëkezat e djersës. Dhe nganjëherë më duket sikur gjithë këto gjokse rinore e të fuqishme bashkohen në një trup të vetëm, vigan. Dhe kështu është në të vërtetë. Kompaktësia e kolektiviteti janë edhe këto karakteristika të detarëve tanë. Ndoshta më shumë se në çdo vend tjetër këtu njeriu ndien të zbatohet parulla jonë: Të gjithë për një, një për të gjithë! Dhe të gjithë së bashku, gati në çdo kohë, për të mbrojtur atdheun tonë të shtrenjtë!

Në nëndetëse ajri është i paktë, nxehtësia shumë e lartë, puna e lodhshme dhe e vështirë. Mbas një lundrimi pak a shumë të gjatë, ekuipazhi duhet të pushojë për të ripërtërirë energjitë. Ndodh nganjëherë që, në lundrime të gjata, njerëzit të dobësohen fizikisht dhe të humbin në peshë. Në raste të tilla ekuipazhi duhet të zëvendësohet përkohësisht. Me një fjalë, duhen kuadro rezervë. Dhe këta kuadro përgatiten këtu. Unë pashë në çdo post luftarak, përveç detarëve, që tashmë janë bërë zotër të teknikës, shumë «nxënës» të rinj, që përvetësojnë me durim fshehtësitë e teknikës dhe të artit luftarak modern. Dhe janë sypishë, kanë mendje të ndritur dhe një etje të çuditshme për dije këta çunakë njëzetvjeçarë. Unë i shoh tek përqendrohen mbi aparatet e përpikta, «mësuesit» e tyre me besim ua lënë t'i manovrojnë dhe ata me besim i drejtojnë. Etja për të mësuar sa më shumë, për të përvetësuar shkencën e kulturën edhe kjo

është një karakteristikë e këtij brezi të ri që lindi e u rrit në pushtetin tonë popullor.

Etje për dije, për shkencë, për kulturë, për art! Sa përpjekje, ëndrra, dëshira e gëzime fshihen në 'këtë frazë! Na kanë përbuzur, na kanë quajtur «të errët» e të «egër», epitete që i dëgjon ende në gojën e armiqve. Dhe s'kanë pasur kurrë besim se një ditë do të përparojmë, do të zbresim nga malet, do të ndërtojmë uzina e hidrocentrale, do të sjellim lumturinë e dijen në çdo oborr shtëpie dhe do ta mbrojmë atdheun me «reaktivë» e «nëndetëse». Por kjo ditë erdhi. U shembën paragjykimet, u shembën padrejtësitë. Shqiptari hapi të gjitha dritaret e dijes dhe me hap revolucionar po pushton majat e shkencës, të kulturës e të artit.

Nëndetësja manovron si ndonjë peshk gjigant në thellësitë e detit. Urdhrat venë e vijnë, djersët kullojnë. Në postin qendror, një djalë i ri me sy bojë qielli, është përqendruar i tëri përpara gypave të një aparati. Ai merr nga të gjitha repartet plotësimin e urdhrave, bën llogaritë me përpikëri, si një makinë elektronike, ia transmeton shpejt komandës me zërin e tij të qetë e tingëllues. Ka ardhur 7 vjet më parë, me opinga, nga një fshat i Vlorës. Mbaroi shërbimin ushtarak në det, u bë motorist. Deti e bëri për vete një herë e përgjithmonë. U gradua oficer dhe tashti është, si të thuash, shpirti i nëndetëses. Është inxhinieri mekanik i saj. E pyes për jetën e tij, për ëndrrën e tij, për familjen e tij. Ai përgjigjet shkurt, si ushtarak, po me një buzëqeshje të çiltër që ndokush mund të mendojë se nuk i shkon ushtarakut. Por e thashë se këta detarë u ngjajnë shumë poetëve. Dhe kjo buzëqeshje e çiltër është dëshmia më e saktë dhe më e mirë që tregon se ata janë të lumtur në det dhe në tokë.

Fola për oficerin që ka ardhur për të dhënë përvojën e tij në nëndetësen tonë. Ai ka kryer akademi ushtarake. Por ja që një diplomë është pak për të. Ai ka ëndrrat e tij rinore. Dhe një nga këto ëndrra është etja për dije, për t'u bërë më i zoti, më i aftë për popullin e për Partinë. Prandaj ai vazhdon universitetin tonë, me korres-

pondencë, vitin e tretë, në Fakultetin e Matematikës. Ndoshta pas disa vjetësh, edhe dy diploma do të jenë pak për të dhe s'është çudi që ta shohim këtë oficer duke dhënë provimet e shtetit në ndonjë fakultet tjetër të universitetit tonë. S'është çudi! Këto janë pasionet e zjarra të brezit të ri që po rritet nën qiejt e kaltër, të pastër e të ngrohtë të Republikës sonë.

Ndoshta fola shumë vetëm për oficerët, prandaj po rikthehem te detarët «pa grada», te nëndetësit e thjeshtë. Janë vërtet pa grada këta detarë, po ata kanë pothuajse të gjithë një gradë të madhe, pa të cilën as që mund të vësh këmbën në labirintet e nëndetësës. E kjo gradë është kultura e arsimit i tyre profesional.

Ja ku është detari Deti. Ç'mbiemër të bukur ka! Deti! Sikur ta dinin stërgjyshërit e tij, kur vinin këtë mbiemër që nipçja i tyre i largët do të zbriste një ditë nga malësitë e ashpra në detin tonë të butë. E gjejmë detar Detin me libra nëpër duar.

— Këtij s'i rrinë duart rehat, — thotë një oficer.

Dhe marinari përgjigjet po me atë qetësi që i karakterizon nëndetësit.

— Kur ka mundësi, përse të mos bëjë njeriu dy punë? Përse ta lëmë kohën të iki?!

E shkrova shpejt e shpejt në fletoren e shënimeve këtë përgjigje. Dhe tani që po mundohem t'i rreshtoj mendimet që më ngjallën bashkatdhetarët e mi të detit dhe puna e tyre, mbeta te kjo përgjigje kuptimplote duke e përsëritur vazhdimisht: «Përse ta lëmë kohën të iki?!»

Po, i dashur Det! Nuk duhet ta lëmë kohën të ikë. Ajo është koha jonë, ajo punon për ne, për të ardhmen tonë, për lumturinë tonë, për socializmin!

Detarët janë të gëzuar që kanë midis tyre një shkrimtar dhe duan ta shfrytëzojnë këtë rast. Duan të dinë përse nuk shkruhen letërsi e këngë të bukura për marinarët. Bisedojmë për traditat tona detare që nga koha e ilirëve, gjer te Miauli e te Haxhi Aliaj, shpella madhështore e të cilit është diku në brigjet tona dhe bustin e të cilit e ka derdhur një skulptor i ri. Një detar më afro-

'het me druajtje dhe më jep një copë letër. Është vjersha e tij e parë, kushtuar shokut të tij: sinjalistit...

Ja edhe një nga mrekullitë e shumta të Partisë sonë të shtrenjtë: Shqiptari, kudo që shërben, me hap revolucionar pushton majat e larta të kulturës.

Dhe tashti që i erdhi fundi lundrimit tonë, se u dha urdhri që anija të dalë mbi det, unë kaloj edhe një herë nëpër reparte. Vështroj përsëri me miratim shokët e mi: Sy rinorë, ballë të çiltër pa rrudha, trupa të fuqishëm ngjyrë bronzi dhe djersë. Djersë në fytyrë, djersë në krahë, djersë mbi dyshtemenë prej çeliku, djersë në kraharorë. Dhe në këta kraharorë më duket sikur shoh zemra të zjarra që rrahin njësoj e që digjen falkë nga dashuria për popullin, për atdheun, për Partinë! Po. Unë i ndiej këto zemra të detarëve tanë që digjen nga dashuria...

Dhe nëndetësja fillon të ngrihet lart. Dhe mbi të gjithë dëgjoj një zë të fortë:

— Në feniks, horizonti i pastër!

Anija me kurrizin e saj të çeliktë çan cipën e qetë të Jonit dhe ia tregon trupin e saj të thjeshtë e të bukur diellit që është më të perënduar. Dalim edhe ne, po nga ajo grykë pusi që hymë në mëngjes therët... Deti, në këtë pasdite të vonë, flakërin nga ngjyrat. Ajri na le-dhaton gjokset e nxehura. Dhe horizonti është i pastër, i kulluar, pa mjegull.

Oficeri shoqërues më jep një cigare. Merr frymë thellë, sytë i shkëlqejnë, pëshpërit i lumtur:

— Mësim shembullor!

Unë mendoj:

— Flota është në duar të sigurta. Ajo vigjilon, prandaj edhe ujërat tona janë të qeta.

Dhe përsëris me zë të lartë këtë frazë që m'u ngul në shpirt:

— Në feniks, horizonti i pastër!

— Në feniks, horizonti i pastër.

«Luftëtari», 17 shtator 1961

MREKULLIA E SHTATË E BOTËS

Vietnamezët thonë me të drejtë se mrekullia e shtatë e botës është gjiri i detit Ha Long. Natyra ka derdhur këtu pa kufi bukuritë e saj, ajo ka mbjellë në det me dorën e saj misterioze tre mijë ishuj fantastikë. Dhe siç thuren legjenda për çdo gjë fantastike, ashtu është thurur një legjendë edhe për këtë gji deti të mahnitshëm. Dhe legjenda thotë: «Piratët sulmonin natë e ditë brigjet e Ha Longut, digjnin kasollet prej bambuje, rrëmbenin pasuritë dhe vrisnin vietnamezët e qetë. Atëherë zoti i madh, për ta mbrojtur këtë vend të varfër nga mizoritë, dërgoi një dragua, më të fuqishmin dragua. Dhe dragoi nga goja e tij lëshoi në gjirin e detit tri mijë perla të çmueshme që janë tri mijë ishujt e Ha Longut!»

Kur lundron përmes këtyre ishujve të duket sikur je në një botë përrallore që nuk është në gjendje ta krijojë as fantazia më e zhvilluar. Detarët që kam pranë më shpjegojnë nganjëherë:

– Shikoni me kujdes. Ai ishull është si flutur, ai tjetri si grua e shtrirë në rërën e artë, në bregdet, me fytyrë nga dielli, ata të dy që bashkohen vetëm në majë, janë të dashuruar e puthen përjetësisht...

Po ne më shumë heshtim sesa bisedojmë. Kjo panoramë magjike, me ishuj të blertë e ndjell vetvetiu heshtjen. Heshtin gjiret e panumërt me faqe të përzhitura nga erërat e krijura e nga rrezet e zjarra që përvëlojnë edhe në dhjetor, heshtin valët lozonjare, heshtin peshka-

tarët në varkat e tyre me vela. Heshtim edhe ne në varkën tonë. Një ndjenjë e ëmbël, si nektar, derdhet në dejtë e mi, kur shoh këto perla të vërteta të natyrës, atë dragua mirëbërës që «zbrer nga qielli» e krijon për sytë e lodhur të njerëzve e për shpirtin e tyre të drobitur këtë mrekulli tërë ngjyra e tërë aromë.

Varka jonë rrëshqet mbi ujërat e qeta opale e plot reflekse, futet nëpër ngushticat e ishujve vocërrakë, lë prapa forma shkëmbinjsh që të kujtojnë përrallat e gjy-sheve dhe na zbulon përpara bukuri të tjera misterioze. Dhe sa më shumë i afrohem bregut të detit, aq më shumë kam qejf të thërres:

«Ha Long! Ha Long! Ç'dorë të ka qëndisur me këtë nur magjiplotë!?»

Kur dalim në breg, përsëri heshtim për një kohë të gjatë duke vështruar nga larg me miratim ishujt e pa-numërt të veshur me tylin e jargavantë të muzgut.

Dhe a mund të ketë lumturi më të madhe sesa të jesh njëzetvjeç e të martohesh me një vajzë të bukur në një mbrëmje të tillë të jargavantë, në këto brigje të blerta tropikale, në këtë gji deti me tre mijë ishuj?

Në Ha Long kishte njerëz të tillë.

Atë natë bëhej një dasmë. Martohej i riu njëzetvjeçar Çan Van Tjap me punëtoren Ngyen Ti Lënj. Disa ditë më parë, kur isha në Hanoi, poetesha Vandaj, si grua e kaluar në moshë, më pat treguar diçka për martesat e aëmoçme. Ligjet e këtyre martesave kishin qenë të tmerr-shme. Vajzat shiteshin si kafshët, i martonin 13, 10 e 7 vjeçe, i fejonin bile që në bark të nënës. Në këtë drejtim, megjithëse me Vietnamin na ndajnë mijëra e mijëra kilometra, mjaft zakone të së kaluarës i paskëshim pasur të përbashkëta.

Kur mora vesh se atë natë në Ha Long bëhej një dasmë, shkova me gjithë zemër. Në dasma shkrintari mund të mësojë shumë gjëra interesante, e, pse jo, mund të zbulojë edhe shumë anë të psikoloqjisë së një populli. Buzë detit takova disa plaka aë shkonin edhe ato në dasmë. Në duar mbanin kuti të bukura ngjyer me lak, të mbushura me bonbone shumëngjyrëshe.

«Meqë venë edhe plakat, — mendova, — do të shoh, me sa duket, edhe ndonjë gjë karakteristike nga e kaluara. Sigurisht, meqë janë kaq shumë plaka, s'ka se si dasma të jetë pa ngjyrë.»

Po, me të hyrë në sallën e madhe të një klubi plot dritë, plot tryeza, lule e njerëz, me një podium për të mbajtur fjalime, u binda se dasma nuk bëhej si qëmoti. Dukej sheshit se ishte një dasmë e kohës, me zakone të reja, me muzikë moderne.

Sidoqoftë, unë nuk u gabova. Dasma vietnameze ishte tërë ngjyra...

Më pritën si një mik të vyer, më ulën pranë plakave, sikur të më kishin kënduar në ballë dëshirën time, më gostitën me duhan, me çaj e me karamеле.

— Në dasmat tona nuk pinë alkool, — më tha një djalë i ri, të cilit i ndriste fytyra nga lumturia.

— Ky është dhëndri ynë, minatori i qymyqurit Çan Van Tjap dhe vajza përkundrejt tij është nusja Ngvien Ti Lënj, — më shpjegoi një i ri tjetër që vinte rrotull nëpër sallë duke ftuar njerëzit për t'u ulur.

Nusja ishte shumë e re, si edhe dhëndri. Ajo nuk ishte veshur me të bardha, si te ne. Ngjyra e bardhë është shenjë zie në Vietnam. Fustani i nusërisë është një fustan prej mëndafshi në ngjyrën e trëndafilin të çelur. Syzeza nuse, me atë fustan rozë, me ata flokë të ndritshëm sikur i kishte larë me manket¹⁾, me vështrimin e qeshur e të druajtur, dukej midis shoqeve si më e bukura e luleve. Të gjithë flisnin, vetëm ajo heshte. Buzëqeshte e turpëruar, shkëlqente nga lumturia dhe heshte. Prapa kurrizit të saj, në mur, varej një pëllumb i madh, i bardhë, prerë prej kartoni. Nën pëllumb kishin shkruar me kujdes dy herë fjalën «lumturi».

Dhëndri ishte më i çelur. Dukej se nuk ishte i zoti t'i mbulonte në njëfarë mënyre gëzimin e lumturinë. Ata shkrepnin në sytë e tij si bajame, në buzët e mbushura ngjyrë kafeje, në ballin pa rrudha. Prapa kurrizit të tij,

1) Fruta e një peme të madhe nga familja e mimozave.

në mur, lexoj këto fjalë, të shkruara edhe ato bukur e me kujdes: «Ta gëzoni lumturinë, por mos harroni edhe detyrën!»

Dhe ja, dasma filloi. E çeli një burrë në moshë. Ai foli pa letër, si një orator i mësuar. Më thanë se ai ishte përfaqësuesi i dhëndrit dhe bëri biografinë e djalit. I lavdëroi punën, i mburri bukurinë po nuk la pa thënë edhe të metat e dhëndrit. Pastaj foli një tjetër, përfaqësuesi i nuses, edhe ai pa letër, edhe ai si orator i vërtetë, edhe ai lavdëroi vajzën, bukurinë e saj, duart e saj të arta, dashurinë e saj për nierëzit. Të ftuarit qeshnin e ndërprisnin, e duartrokisnin kurse unë kërkova të më përkthenin parullën tjetër që ishte vendosur prapa podiumit. Ma shpjeguan: «Nëse burri e gruaja janë gjithnjë dakord, ata mund të thajnë edhe detin.»

Pas fjalimeve zhurma u shtua. Filluan këngët e vallet, të vjetrat e të rejat. Vetëm unë edhe plakat nuk luajtëm nga vendi. Ato ishin veshur me mëndafsh të zi, me ca shami të lidhura në kokë, siç i lidhin kurveleshaset tona, bënë muhabet të shtruar, shikonin me kureshtje rininë që shpërthente në këngët e vallet dhe përtypeshin, përtypeshin vazhdimisht. Mbi tryezë kishin vënë kutitë e bukura ngjyer me llak, mbushur me bombone shumëngjyrëshe dhe gostitnin me to niëra-tjetrën. Bombone të çuditshme! Rinia nuk i hante këto bombone, kurse plakat i përtypnin me qejf të madh, duke mbyllur sytë përgjysmë nga kënaqësia. I pashë me vëmendje gojët e tyre të skuqura flakë nga lëngu i këtyre bomboneve. Pashë edhe dhëmbët e tyre të zinj sterrë, po nga ky lëng. Dhe aty mora vesh se këto «bombone» të çuditshme kishin një histori më vete, kishin edhe leqëndën e tyre. Plakave, grave të kaluara në moshë, bile edhe ndonjë të reje fshatare u kisha parë dhëmbë të tillë krejt të zinj. Po kujtoja se mos i kishin të zinj nga natyra. Kurse puna qenkësh ndryshe! Dhëmbët i bënë vetë të zinj që t'u forcoheshin, po më shumë që t'u bëheshin të bukur, si perla të zeza.

Plaka që kisha pranë e vuri re habinë time. Duke u përtypur, mbylli sytë përgjysmë e më tha:

– Dëgjo se ç'thotë kënga për këta dhëmbë të zinj:

fusha, male e pyje, gjersa mbërriti buzë një lumi të thellë e të rrëmbyeshëm. I lodhur nga rruga e gjatë, i dobësuar nga uria, i vrarë nga dëshpërimi, ai qau me lot të hidhur për vëllanë dhe u mbyt në këtë lumë.

Engjëjt që i dinë mirë vuajtjet dhe gëzimet e njerëzve, e panë Langin të vdekur nga dashuria dhe e kthyen në një shkëmb të lartë.

Tani u kujtua për vëllanë kur iu shuan zjarret e para të dashurisë. Dhe asnjëri nuk mundi t'i tregonte se ku ndodhej i vëllai që po ia përvëlonte shpirtin me mungesën e tij. Atëherë ai e la gruan në gjumë dhe u nis ta kërkonte nëpër fusha, male e pyje, gjersa mbërriti te një shkëmb i lartë buzë një lumi të rrëmbyeshëm. I lodhur nga rruga e gjatë, i dobësuar nga uria, i vrarë nga dëshpërimi, ai mezi u ngjiti në majë të atij shkëmbi gëlqeror dhe në majë të atij shkëmbi dha shpirt. Engjëjt e kthyen në një palmë të bukur, të drejtë e me blerim shekullor.

Gruaja e re nuk mundi të jetonte pa Tanin, prandaj u nis edhe ajo ta kërkonte. E lodhur nga rruga e gjatë, nga vetmia e dëshpërimi ajo mbërriti po tek ai vend ku kishin vdekur vëllezërit, hipi mbi shkëmbin gëlqeror, pushtoi palmen dhe, pa arritur në majë të saj, vdiq. Dhe engjëjt e kthyen në frutë të kësaj palme.

Dhe kështu vdiqën këta heronj, vdiqën për dashurinë e njëri-tjetrit.

Në atë kohë, një plak i mençur e mirëbërës, i prekur nga kjo ngjarje, ndërtoi për nder të tyre një tempull kushtuar dashurisë së vëllezërve dhe besnikërisë së gruas.

Po në atë kohë bëri një thatësi të rëndë e paparë në Vietnam dhe vetëm palma me frutat e saj majë atij shkëmbi gëlqeror nuk u tha. Mbreti Hung-Vuong shkoi për ta parë në ishte e vërtetë kjo mrekulli. Kur mbërriti, mbeti me gojë hapët. I etur për ujë, ai këputi një fletë e një frutë nga palma dhe i përtypi. Ndjeu një kënaqësi të madhe dhe trupi iu freskua menjëherë. Kurse nga goja i pikoi mbi gëlqere një lëng i kuq flakë...»

Dhe ja, që nga ajo kohë përdoren në Vietnam këto «bonbone» të çuditshme, gatuar prej fletëve të palmës tropikale, prej frutave të saj e prej gëlqeres, që plakat

kanë shtruar mbi tryezat e dasmës në kutitë e tyre të bukura të lyera me llak.

Ne e ndërpreme bisedën për të parë çiftin e ri që kërcente vetëm. Plaka «ime» mbuloi mjekrëzën me pëllëmbë dhe ra në ëndërrime. Nuk ua ndau sytë të rinjve dhe, kur ata mbaruan vallen gazmore, psherëtiu e më tha:

– Ata janë me të vërtetë të lumtur. Kurse fati ynë ka qenë i hidhur. Pa dëgjoji këto këngë të rinisë sonë! – dhe filloi të këndonte me zë të përmallshëm, me ca nota të ulëta, sikur lutej, sikur vajtonte atë gëzim të vogël të rinisë së saj që nuk kthehet më. Nganjëherë zëri i saj dridhej si një ngashërim i thellë dhe të këpuste shpirtin:

*S'kam fat në dashuri! S'jam e lumtur
me burrin plak!*

*Kur dal më pyesin: është babai apo
burri?*

Ta them, më dhemb zemra.

Është detyrimi i jetës së brendshme.

S'është burri im.

U martova trembëdhjetëvjeçe

Dhe kur mbusha tetëmbëdhjetë bëra

pesë fëmijë.

Kur dal, më marrin për vajzë të re,

Kurse në shtëpi kam pesë fëmijë...

Por këngët që këndonte rinia në atë sallë, nuk ishin të tilla. Ato mbanin në dejtë e tyre të tendosur gjakun dhe zjarrin e moshës së re.

Këndonin vajzat:

Në më do, më thuaj,

*Në s'më do, ma thuaj një herë e
mirë.*

*Përse të jesh as i qartë, as i
turbullt*

Si qulli me goca deti e të më copëtosh

zembrën?

la prisnin djemtë:

*Kjo vajzë i ka faqet krejt të
trëndafilta.
Ju s'po martoheni akoma, ç'prisni
atëherë?
Në ditët e gjata dhoma është e
vetmuar,
Koka e re do të mbulohet shumë
shpejt me flokë të bardhë...*

Dhe përsëri vajzat:

*Guri ronitet po zemra kurrë,
Do të shkosh të vrasësh armikun,
Zemra ime pret, të qëndron
besnike...*

Gjuha vietnameze është shumë e pasur në intonacione. Kur flasim, sidomos gratë, të duket sikur këndojnë zogjtë e bukur tropikalë pranë ndonjë burimi që gurgullon në thellësi të xhunglës. Kjo gjuhë e lashtë aziatike që tingëllon si muzikë, gjen shprehjen e vet më mirë se kudo në poezi, e cila, për karakterin e saj, në Vietnam, më duket se është më shumë një gjini muzikore sesa letrare. Veshi im i pamësuar, nuk e kapte dot metrikën e këtyre këngëve. Si duket, metrika e tyre bazohej mbi intonacionet e shumta të gjuhës, e cila është monosilabike. Në Hanoi u njoha më gjerë me këto këngë popullore dhe nuk u çudita për karakterin e tyre enciklopedik, sepse ato janë krijuar gjatë shekujve dhe pasurohen edhe në ditët tona. Në frymëzimin e tyre, në formën e tyre specifike, në thjeshtësinë e tyre prej pak vargjesh, zakonisht gjashtë e tetë, ato janë tipike vietnameze. Prandaj mjaft poetë të dëgjuar të kohës së sotme vazhdojnë të shkruajnë sipas këtij stili të vjetër, por jo të vjetruar.

Duke dëgjuar këngë të tilla në një dasmë të thjeshtë vietnameze, m'u duk sikur një dorë e mirë ngriti qoshen e një perdeje dhe më zbuloi një pjesë të Vietnamit, atë

pjesë që ka të bëjë me jetën e tij intime, me ndjenjat e tij, me zakonet e tij, me dashurinë e tij për njerëzit e për natyrën që e rrethon.

E lashë dasmën në kulmin e saj. Kur dola nga klubi, zërat e gëzuar çanin qiellin plot yj dhe gjirin me tre mijë ishuj. Ecja buzë detit i ledhatuar nga aroma e Ha Longut, nga legjendat e tij dhe nga këngët e tij. Edhe kur mbërrita në hotelin e rrethuar me palma, edhe kur u shtriva në krevatin e mbuluar me tyl, për një kohë të gjatë m'u duk sikur dëgjoja këngë e legjenda, legjenda e këngë për këtë mrekulli të shtatë të botës.

Legjenda e këngë për hidhërimet e gëzimet e vietnamezëve!

Këngë për lumturinë e minatorit Çan Van Tjap dhe të nuses së re Ngyen Ti Lënj!

«Drita», 25 shkurt 1962

DASHURIA

Kan Gjon Rima erdhi në Phenian aty nga mesi i nëntorit për të marrë pjesë në një konferencë të gruas. Ajo s'kishte asgjë të veçantë që të mund ta dalloje nga të tjerat. Ishte një grua e thjeshtë dhe e zakonshme koreane. Po kishte një zemër të madhe e të dëlirë...

Tregimi për këtë grua koreane zë fill në kohën e luftës patriotike, atëherë kur imperialistët amerikanë po mundoheshin të vinin në zbatim planin e shtabit të Mak-Arturit për pushtimin e Koresë Veriore dhe kur «shkençetari» amerikan Mirk përgatiti mjetet për luftën bakteorologjike.

Lufta kishte gati dy vjet që kishte filluar. Koreja, e gërryer nga tunelet e nga bombat, ishte ngjyer e tëra me gjak. Paraleli 38 ishte bërë një varr i vërtetë për armiqet.

Në këtë kohë të ashpër, në një spital të nëndheshëm pranë frontit, sollën të plagosurin Pak Çan Su dhe e futën menjëherë në sallën e operacionit! Ushtari thërriste dhimbshëm: «Më lini të shkoj në front!» Mjeku nxirrte me durim copëzat e bombës që kishin hyrë thellë në tërë trupin e ushtarit, ndërsa infermierja e re Kan Gjon

Rima vështronte të plagosurin dhe mendonte për të:
«Ç'njeri me vullnet!»

Pas një jave i plagosuri e ndjeu veten më mirë, por papritur humbi dritën e syve. Nuk e dallonte më ditën nga nata.

— A thua s'kam për të parë më? — e pyeste ai me dëshpërim infermierën e re, e cila i qëndronte pranë shtratit. Natën ai nuk flinte. Nuk flinte edhe Kan Gjon Rima. Ditën fillonte një bisedë e përzemërt për të ardhmen. Ushtari mendonte të bëhej inxhinier, vajza mendonte të kthehej në Jug, të gjente prindërit e të hynte në fabrikë. Një mëngjes ajo i vuri termometrën, ai buzëqeshi e tha:

— Kam parë ëndërr sikur isha në front e me një të shtënë të automatikut vrava dymbëdhjetë amerikanë. Pastaj më doli teknikumi, ku mësoja dhe fusha e sportit. Loznim futboll. Unë kisha numrin tetë dhe futa një qol fluturimthi... Më pëlajen shumë kjo ëndërr, Kan Gjon Rimë. Pas lufte dua të bëhem inxhinier mekanik. Vetëm nuk di, a do të shoh më... Ti më the se është mëngjes, kurse mua më duket natë.

Vajza u prek nga ato fjalë.

«Ç'të bëj për këtë njeri që ka një zjarr të tillë jete?» — mendoi ajo duke i ndërruar plagët ushtarit.

Dhe shkoi fill të mjeku e i tha:

— Merrni sytë e mi, doktor, dhe kthejani dritën!

— S'ka nevojë, — u përrijaj mieku, — do ta dërgojmë në orapavijë dhe do ta shërojmë.

Po ajo e dinte mirë se ushtari Pak Çon Su do të mbetei i verbër për tërë jetën. Prandaj ajithnjë mendonte:

«Ç'të bëj më tepër për këtë njeri?»

Nganiëherë ajo e morri për krahu, e nxirrte nga tuneli dhe e shëtiste nëpër pyll. Një ditë, duke shëtitur, ai e pyeti pa të keq:

— Kan Gjon Rimë, a thua do të gjej një njeri që ta kem shok në jetë?

Ajo mezi iu përgjijaj:

— Koreja ka shumë njerëz të mirë, Pak Çon Su!

Në spitalet e frontit të plagosurit rëndë, që nuk mund

t'i shërojnë dot, i dërgojnë në prapavijë. Do ta dërgonin edhe ushtarin e verbër Pak Çon Su. Me gjithë kundërshtimet e tij, i hipën në makinë. Shoferi ndezi motorin. Infermierja e re doli me vrap nga tuneli duke thirrur:

– Një minutë, prisni një minutë!

Ushtari i plagosur e njohu nga zëri dhe nxori fytyrën në dritare:

– Kan Gjon Rimë! Kan Gjon Rimë! – thirri ai.

Vajza iu afrua dhe i zgjati dorën:

– Udhë e mbarë, Pak! – i tha me zë të dridhur dhe e skuqur nga emocioni.

Ushtari ndjeu në pëllëmbë të tij një copëz letër. Në atë copëz letër ajo i kishte shkruar ato që nuk mundi t'ia thoshte dot me gojë.

– Rri me shëndet, Kan Gjon Rimë! – tha ai dhe makina u nis e u fsheh menjëherë në pyll.

Ajo i shkruante:

I dashur Pak! Do të vijë dita, kur ti do të shërohesh. Nëse do njeri që të të bëhet sy (megjithëse nuk e di nëse do të kesh nevojë për të, mbasi ti do të shohësh përsëri dritë) dhe, në qoftë se nuk gjen njeri më të mirë se unë, më lajmëro, unë do të vij. Do të pres gjithmonë përgjigjen tënde. Kan Gjon Rima.

Por ai nuk iu përgjigj. Nuk iu përgjigj sepse e donte shumë infermierën e re.

Topat e rëndë heshtën. Heshtën gjësimet e aeroplanëve. Amerikanët spërkatën me benzinë koreanët e i dogjën nëpër pogromet. Vetëm në Phenian, që kishte 400 mijë banorë, hodhën 420 mijë tonë bomba, përdorën shpikjen bakterieologjike të Mirkut, dërguan në front kanadezë, francezë, tajlandezë, sulmuan 431 herë lartësinë strategjike 1211, lanë më shumë se një milion ushtarë të vrarë e të plagosur dhe, megjithëkëtë, u gjunjëzuan.

U gjunjëzuan, topat e rëndë heshtën. Koreja e përgjakur doli fitimtare. Po ushtari i verbër Pak Çon Su, edhe pasi mbaroi lufta, nuk iu përgjigj infermierës së re, sepse nuk donte ta rëndonte atë për tërë jetën.

Dhe kështu kaluan vite...

Kan Gjon Rima, si iu mbyllën edhe asaj plagët që mori në luftë, filloi të kërkonte ushtarin e verbër. Kur mbërriti në një spital, i thanë se një ushtar i tillë kishte qenë me të vërtetë aty, por katër muaj më parë e kishin tërhequr dhe e kishin shpënë në Jangsi. Dhe kur mbërriti në Jangesi, i thanë se e kishin shpënë në sanatoriumin e të verbërve në brigjet e Detit të Verdhë, 800 kilometra larg. Dhe ajo udhëtoi në këmbë dy mijë li, në mes të dimrit, duke kapërcyer malet me borë dhe lumenjtë e ngrirë.

— Kush jeni, ku dhe përse keni ardhur gjer këtu në këmbë? — e pyeti drejtori i sanatoriumit, i habitur.

— Ka kohë që kërkoj një ushtar dhe më thanë se ai ndodhet këtu.

— Si e quajnë?

— Pak Çon Su.

— Mos jeni ju infermierja Kan Gjon Rima? — e pyeti drejtori, duke pritur me ankth përgjigjen e saj.

— Po. Unë jam...

— Edhe ai këtu është, — tha drejtori i çmendur nga gëzimi. — Ju jeni një vajzë e vërtetë koreane. A dëshironi të punoni këtu për të qenë pranë Pakut?

— Sikur të ma bënit këtë të mirë...

— Po me kusht që tani për tani të mos i thoni Pakut se kush jeni, se do të dëshpërohen të verbrit e tjerë. Ejani ta gjejmë.

E gjetën Pak Çon Sunë atje ku ai rrinte gjithnjë në mot të mirë, në hijen e një pisehe, buzë Detit të Verdhë. Vajza me ta parë desh e thirri me emër. Zemra iu drodh, kur zuri dorën e tij.

— Pak, — tha drejtori — që sot e tutje juve do t'ju shërbejë infermierja e re.

Vajza ia lëshoi dorën e tha me mbytkë në fyt:

— Për çdo nevojë që të keni, më kërkonti, mua, Pak!

— Ju falemnderit! — u përgjigj ai dhe ndjeu në zemër se kishte përpara një njeri të afërt e të dashur.

Dhe zemra nuk gënjen kurrë...

Çdo mëngjes ajo e merrte ushtarin për krahu dhe e

shpinte te hija e pishës, i tregonte të rejat e ditës, i lexonte gazetat. Ai e dëgjonte me vëmendje dhe shpesh thoshte me vete:

«Sa shumë ngjasin zërat!»

Po. Zemra nuk të gënjen kurrë. Një ditë, pasi mbaroi shfaqja e amatorëve, ata shkuan përsëri te hija e pishës. Paku nxori nga xhepi një copëz letër dhe, duke ia dhënë i tha:

– Lexoje, të lutem. – Vajza e mori, e hapi dhe u drodh. Njohu shkrimin e vet dhe nuk guxoi ta lexonte. Paku vazhdoi: – Ka kohë që është shkruar. Janë shuar shkronjat.

Ajo filloi të qante. Ushtari ia shtrëngoi dorën dhe përmendi emrin e saj.

– Unë jam! – belbëzoi vajza me dënesë.

Pas një jave ata ikën nga sanatoriumi dhe bënë dasmën. Në krye të vitit të katërt, bënë fëmijën e tretë. Dhe filloi kështu jeta familjare. Po një jetë jo e zakonshme. Kan Gjon Rima merrej më shumë me të shoqin, sesa me fëmijët. Ëndrra e tij për t'u bërë inxhinier mekanik ishte shuar një herë e përgjithmonë. Një ëndërr të re përkëdhelte tani ushtari i çmobilizuar dhe i verbër, ëndrrën për t'u bërë mjek popullor. Kan Gjon Rima i qe lutur një mjeku popullor që t'ia mësonte profesionin e tij edhe Pakut...

– Megjithëse jam plak, do të bëj ç'është e mundur për këtë djalë e për ty, – i tha mjeku dhe që nga ai çast ai shkoi te Paku dhe dalëngadalë ia mësoi të fshehtat e mjekësisë popullore. Kur ishte kohë e keqe, kur binte shi e borë, vinte vetëm Kan Gjon Rima te mjeku plak. Me durim të madh ajo mësonte të fshehtat e mjekësisë, vinte në punë, rregullonte fëmijët dhe me orë të tëra i shpjegonte të shoqit ato që kishte mësuar. Pas katër vjetësh studimi këmbëngulës, ai provoi gjilpërat e para. Mori në dorë lepurin që i kishte sjellë e shoqja dhe për një kohë të gjatë hezitoi.

– Filloi, Pak – i tha ajo.

– Fillo, – e këshilloi edhe mjeku plak.

– Më vjen keq, – tha i verbri duke kërkuar diçka me

mollëzat e gishtave nëpër qimet e buta të kafshës që dridhej.

— Ti ke qenë në luftë, ke vrarë njerëz e të vjen keq për një lepur! — u habit mjeku.

— Kam vrarë amerikanë. Ata janë armiq e duhen vrarë, — u përgjigj Paku dhe shtoi duke qeshur: — Kurse ky lepurush është paqësor.

...Kaluan vite dhe i verbri u bë mjek i dëgjuar popullor...

Aty nga mesi i nëntorit unë pashë në rrugët e Pheni-
anit të ri një burrë me syze të zeza që ecte i mbështetur
në krahun e një gruaje. Ishin ata, mjeku popullor dhe
punëtorja e dalluar e uzinës. Kan Gjon Rima kishte
ardhur në kryeqytetin e lirë për të marrë pjesë në kon-
ferencën kombëtare të gruas. Ajo s'kishte asgjë të veçantë
që të mund ta dalloje nga të tjerat. Ishte një grua e
thjeshtë dhe e zakonshme koreane. Po kishte një zemër
të madhe e të dëlirë...

1962

NJERËZIT DHE MALET

Në vendet e ngrohta janë skuqur qershitë, po piqet gruri dhe pranvera po mbaron. Kurse në malësitë e Oparit ajo porsa ka ardhur. Kudo gjen manushaqe në pyjet me boriga, livadhet bien erë mjaltë nga lulet e verdha, mollët janë plot lule të bardha dhe gjethi i ri porsa ka lëshuar bisqe. Maja e Ostrovicës, Qafa e Gjarprit dhe Qafa e Beçit mbajnë dëborë dhe njerëzit ende nuk e kanë ihequr mirë shajakun nga supet.

Por pranvera ka lulëzuar. Dhe në këtë pranverë unë bëra një rrugë të gjatë nga pyjet me boriga të Gjonmadhit, Lavdarit, Voskopojës, Shipskës e Krushovës gjer në kurorat e ashpra, mbuluar me bush, të Gjergjevicës e përtej, ku rrjedh lumi i rrëmbyer i Çemerricës, ku ngrihet si xhungël pylli i Qelidhonit, ku arrijnë gjer te retë majat mbuluar me ahishte të Bofjes e të Shkëmbit të Bardhë të Misrasit.

Gati tridhjetë fshatra janë shpërndarë nëpër qafat, rrëzë pyjeve e përrrenjve, nëpër brinjat e maleve, majë shkëmbinjve e midis brigjeve në këto dy lokalitete malore. Nuk duken si fshatra, por si kala që u bëjnë ballë rresheve të kohës, stuhive dhe armiqve.

Njëzet vjet më parë këto fshatra ishin vërtet kala! Kushedi sa herë u dogj Voskopoja e lashtë nga italianët, gjermanët e tradhtarët. U rrafshua Gjonmadhi, u shkretua Krushova, Shipska, u përvëlua Lavdari. U bënë shkumb e hi luadhet, bagëtia, pyjet, u pushkatuan në masë njerë-

zit. Por prapë fshatrat ngriheshin nga pluhuri e hiri dhe bëheshin kala. Këtu u krijuan çetat e para të Riza Kodhelit, Asllan Gurës, Agush Gjergjeviçës. Këtu u ushqyen e gjetën strehë batalionet partizane. Asnjë fshat nuk na mbylli derën, asnjë fshat nuk na la në ngricë në netët e ftohta të dimrit. Dhe këtu lanë jetën mijëra ushtarë të huaj, kockat e të cilëve po i mbledhin tani gjeneralët e përtejdetit.

«Po të kujtosh të kaluarën e vendit tonë, të merr të qarët...» – kështu e kanë filluar gjonomadhasit historikun e fshatit të tyre, që e kanë vënë në sallën e leximit. Dhe kështu mund ta fillonin edhe Gjonbabasi e Gurmujasi, edhe Lekasi e Xerja, edhe Osoja e Tudasi, edhe Karbanjozi e fshatrat fare të voala si Punëmira, Denasi, Poponiva, Misrasi – tërë malësia e Oparit. Këtu më parë thoshin se hante pula gurë. Buka siurohej mesatarisht vetëm për një ose dy muaj. Për një kafshatë bukë njerëzit linin fshatin e merrnin arratinë. Bridhnin nëpër Shqipëri. Po punë s'kishte dhe atëherë shkonin në mërgim, në vende të huaja, shkonin të rinj larg mëmëdheut e gjirit të ngrohtë të familjes dhe nuk ktheheshin më, ose, edhe kur ktheheshin, vinin pleq, të drobitur e të rrasakapur. Veç Voskopiës e Lavdarit, nuk kishte shkollë gjetiu. Kishin mësuar të lexonin me të vjedhur vetëm dhjetë për qind e burrave, dhe asnjë grua. Sëmundiet e rrezikshme bënin kerdinë në të vjetër e në të rinj. Varfëria rrinte pezull si pëlhurat e merimangave mbi trarët e nxirë të shtëpive pa tavan, mbi rroqozët e postiqet, ku kërcisnin dhëmbët kalamaitë, miu binte në magje e thyente kokën shajakët s'kishte ku t'i zinte aeni, mungonin dyshekët, jorganët, ilaçet e sapuni, miza fuste kudo miliona mikrobe me këmbët e krahët e saj të fëlliqur dhe, nuk është turp ta themi, morri të çante. Varfëria sjell grindje e krime. Naa urrejtia ndaj jetës së mjeruar, shpesh njerëzit humbisnin gjykimin, ziheshin fshat me fshat për një vijë uji e për një mezhde, mazrekasit vrisnin brozdoveçarët e anasjelltas. Mëria shekullore, e mbledhur nga uria e mjerimi si një plagë në shpirt, nuk binte mbi agallarët e pasanikët e qytetit, që bënin pallë mbi shpa-

tullat e kërrusura të oparakut. Këtë mëri njerëzit e varfër e zbraznin padrejtësisht mbi njëri-tjetrin, gjersa doli Partia dhe i dha asaj drejtimin e vërtetë.

Ndoshta mund të ketë të rinj që nuk i dinë këto plagë të së kaluarës. I riu mësohet shpejt me atë që ka pranë, me bukën, shkollat e kooperativën, me xhadenë e re e me dyqanin e fshatit, me elektrikun e me dashin merinos, me bursën e shtetit e me birrën e Korçës dhe i duket se kështu ka qenë gjithmonë. Dhe, kur dëgjon për mjerimin e së kaluarës, i duket si një ëndërr apo si një përrallë e pabesueshme. Por nuk duhet të harrojmë kurrë të kaluarën, sado e hidhur që të ketë qenë. Ajo është historia jonë. Ta kujtojmë atë për të kuptuar madhësitinë e kohës që jetojmë, ta kujtojmë që të zbulojmë të ardhmen tonë të ndritur.

* * *

Tetëmbëdhjetë vjet më parë kam shkruar për mjerimin e varfërinë çnjerëzore që sundonte në Gjergjevicë. Atëherë dikush nuk më kuptoi e m'u zemërua. Dikush më akuzoi për «natyralizëm». Por unë shkrova vetëm të vërtetën, të vërtetën lakuriqe e të hidhur. Edhe sot unë po shkruaj për Gjergjevicën, po shkruaj të vërtetën lakuriqe, por jo më të hidhur. Gjergjevicarët kanë qenë punëtorë të zotë, trima e mikpritës. Asgjë nuk ka humbur nga këto veti. Ata kanë humbur vetëm ato për të cilat s'kanë pasur kurrë nevojë: varfërinë dhe padijen. I kanë varrosur këto një herë e përgjithmonë në gërxhet e tyre tërë thepa. Më pritën te përroi, më të hyrë të fshatit, nxënësit e shkollës. Te ky përrua i rrëmbyer në Operacionin e Dimrit gjermanët vranë një nuse të re që mbante në gji vajzën e saj motake. Një ditë e një natë qëndroi vogëlushja me lot të ngrirë mbi trupin e s'ëmës, duke u munduar të thithte qumështin bërë akull. Nëna vdiq, vajza sivjet do të votojë për herë të parë. Te ky përrua kapërcyen Shabani, Hamiti, Kajmaku, Saloja e Ahmeti, kapërcyen me armët ngjeshur, shkuan partizanë e ranë dëshmorë. Për ta mjeshtrit gjergjevicarë

kanë ngritur një lapidar në mes të fshatit. Te ky përrua, vjet, fëmijët luanin me një bombë që e kishin gjetur në shkurret. Luanin, por bomba plasi dhe ata u vranë, ashtu siç u vranë edhe tre vogëlushë të tjerë të një barku në Shipskë. Te ky përrua më pritën vëllezërit dhe motrat e tyre të vegjël, shkollarët e Gjergjevicës me tufa lule mali nëpër duar, të larë e të ndërruar, të mbathur e të veshur me kostume e fustane kombëtare shumëngjyrëshe, si lule në pranverë. Ata recituan vjersha, kënduan këngë. Ishin 34 nxënës me mësuesin e tyre, 34 nxënës në shkrepat ish-analfabete të Gjergjevicës.

Hyra në fshat e u takova me gjergjevicarët. «Jo, — thashë me vete, — kjo s'është Gjergjevica, këta s'janë gjergjevicarët që kam njohur unë 18 vjet më parë. Këta janë njerëzit e rinj që kanë hapur sytë, që kanë shkundur pluhurin e varfërisë nga zhelet e tyre, që kanë bukë në hambar për tërë vitin, që kanë lyer muret me gëlqere, që kanë fshirë rrugët e fshatit.» Radiot me vajguri përhapin në Gjergjevicë lajmet e Tiranës dhe këngët e Shqipërisë. Shkova në shtëpi të ish-partizanit Gano. Kisha qenë edhe në kohë të luftës tek ai. Atëherë shtrihesha mbi rrogozë si tërë familja, duke vështuar trarët e zinj e duke kërcitur dhëmbët. Tani çdo gjë është zbardhur në shtëpi të Ganos. Tavani ndriçon, ndriçojnë muret, ndriçojnë pirunët, pjatat e gotat e birrës. Shtrihem rehat mbi dyshekun prej pambuku dhe vështroj qilimin e bukur të Korçës që ka mbuluar dyshemenë e odës së madhe. Ganoja tregon një histori nga lufta partizane dhe, duke qeshur, heq me gishta tapat e shisheve të birrës. S'i ka gishta, por darë ato duar të fuqishme, që kanë ndërtuar kushedi sa mure fabrikash e shtëpish në tërë Republikën. Birra e ftohtë rrjedh në gurmaz. Birrë piva në Gjonomadh, në Lavdar, në Shipskë, në Krushovë.

Më kujtohet koha e luftës, më kujtohet Limi, i cili, sa herë largoheshim nga Gjergjevica, hidhte gurë prapa kraheve e bënte magji për të mos u kthyer më në këtë vend. Limi nuk është më, po sikur të ishte gjallë e të vinte tani në Gjergjevicë, nuk do të hidhte më gurë, po do të kërkonte të kthehej sa më shpejt në këtë vend të rilindur.

Tetëmbëdhjetë vjet për historinë e një populli janë sa të hapësh e të mbyllësh sytë. Po për malësinë, për tërë Shqipërinë, këta tetëmbëdhjetë vjet liri janë një shekull, e ndoshta më shumë.

Në Gjonomadh, përballë sallës së leximit, në një shesh të vogël shtruar me kalldrëm, është vendosur një pllakë përkujtimore për pesë fshatarë që u pushkatuan nga fashistët italianë në korrik të vitit 1943. Pushkatuan edhe gjermanët 12 të tjerë më të hyrë të fshatit. Kurse Demiraliu, Xheveti e Sabadini ranë dëshmorë duke luftuar në batalionet partizane, ku merrnin pjesë 39 djem të fshatit. Por e kisha fjalën të pllaka përkujtimore në mes të fshatit. Fashistët i futën burrat në xhami, i torturuan, pesë prej tyre i pushkatuan, pastaj më vonë rrahën me top fshatin dhe u vunë zjarrin të 119 shtëpive. Qëndrova përpara këtij lapidari dhe fillova të shënoj emrat e dëshmorëve.

— Ky është babai im! — më tha një djalë, kur shkrova emrin e Mendu Bardhit. — Më ka lënë dymuajsh!

Lapsi m'u drodh mbi fletore, ktheva kokën dhe pashë djalosin, veshur me tuta e me kasketë.

— Sa vjeç je?

— Sivjet votoj për herë të parë, — u përgjigj ai. Ishte tërë shëndet, me ca sy të gjallë dhe, siç mësova më vonë, një nga djemtë më punëtorë të fshatit.

Ja, pra, ky djalosh është rritur jetim. Është rritur së bashku me fshatin e tij. Fëmijërinë e kaloi pa strehë, se tërë fshati ishte përvëlur. Kur në i vumë përpara gjermanët dhe robërit i futëm në xhami, ai nuk ka marrë vesh gjë, se flinte në pyllin me boriga. Edhe për shtëpitë e reja që u ndërtuan, ai nuk mban mend gjë. Por ai u rrit dhe hyri në shkollën që u hap për herë të parë. Kur mbushi 13-vjeç, fshati u bë kooperativë, hapi sallën e leximit, çeli 800 dymëmë tokë të re, vuri rrush për herë të parë, mbollti dy mijë rrënjë mollë, ndërtoi 7 stalla për blegtorinë, futi dyshekun e jorganin nëpër shtëpitë, ndërsa zögjtë shtuan foletë mbi gërmadhat e xhamisë. Në fshat nuk kalonte dot qerrja. Por kooperativistët çanë vjet një

shkëmb, çanë edhe një tjetër, edhe një të tretë dhe hapën rrugën që lidh tokat me fshatin. Për herë të parë kaloi në këtë rrugë qerrja. Po kaloi edhe traktori, edhe kombajna. Unë kisha kaluar dikur në këtë rrugë. Ishte një monopati, ku mund të thyjeje këmbët nga pakujdesia. Tani rruga është e shtruar. Po ta dërgosh këtë lajm në gazetë, ndoshta ndonjë redaktori që është mësuar me fushat e me asfaltet, nuk do t'i bënte përshtypje. Por po të vinte e të shihte me sytë e tij se si është çarë kjo rrugë përmes shkëmbit, do ta botonte lajmin me titull të madh e në një vend të dukshëm.

Xha Limi është plak 92-vjeçar dhe kazmën s'e heq nga dora. E gjeta duke rregulluar çakëllin e kopshtit. Kush thotë në moshën 50-ose 60-vjeçare se u plak e s'është më i zoti i punës, le të vijë e të marrë shembull nga xha Limi. Të ka bërë qilizmë në një rrëpirë që të merren mendtë, kur e vështron. Edhe agronom po të isha, nuk do të besoja se mund të merret prodhim në atë rrëpirë.

Por xha Limi ka hapur vresht, ka mbjellë mollë.

— Nuk i kam për vete, nuk shartoj për vete, po për fëmijët, për popullin, — thotë ai. Dhe për çudi, bebëzat e syve nuk i ka të shuara, por i vetëtijnë si bebëzat e një të riu.

Më tregoi se kur ishte 76 vjeç, shkoi i pari vullnetar në hekurudhë dhe tërhoqi pas 16 të rinj.

— Oburrani, punoni, lëroni, mbillni! — u thërret atyre që na kanë rrethuar. — Punojnë dynjaja për vatën, bëjnë topa e aeroplanë për ta fituar. Ju e keni vatanin të lirë. Punoni e hapni sytë.

Të rinjtë, si të rinj që janë, e ngacmojnë. Plaku nuk zemërohet. Ka një humor të hollë që i del nga thellësia e shpirtit. Ka humorin e popullit tonë që nuk ia plak zemrën.

— Të më gjejnë një plakë, mirë do të bëjnë, — qesh ai, — por më mirë të më përgatisni një sëndyqkë. Ajo është plaka ime.

U binda edhe një herë se puna nuk e plak njeriun. Puna është burimi i shëndetit, i forcës, i begatisë dhe i gëzimit.

Ka edhe një plakë tjetër në Gjonmadh, edhe ajo është 90 e ca vjeçe. E quajnë Shaqe. Edhe ajo punon dhe hahet me të rejat. Njëqind ditë pune fut në shtëpi. Edhe ajo humorin e ka në majë të gjuhës.

— Vetëm me sytë s'jam mirë, — më thotë. — Ditën shoh, por natën më erren e s'dalloj gjë.

Më ka rënë rasti të shoh ndonjë të ri turivarur e buzëlëshuar, të mërzitur nga puna, nga jeta. Sa fatkeq është ky i ri! Do ta këshilloja të vinte në Gjonmadh, të takohej me këta njerëz. Atëherë do ta kuptonte se sa i gabuar është dhe ndoshta do të hynte përsëri në gjirin gazmor të jetës.

Voskopoja është qendër lokaliteti. Ajo është ngritur mbi gërmadhat dhe në rreth e mbajnë si kooperativën më të mirë malore. Gjer në qiell i ka vajtur tymi e flaka Voskopojës në kohën e luftës. U bombardua, u rrah me top, u dogj kushedi sa herë. U prishën çezmat e saj të ftohta, u rrënuar Shën-Prodhomi i famshëm, u dëmtuan rëndë kishat e saj të shumta e të moçme. Voskopoja është një vend i lashtë historik. Në shekullin e 18-të fama e saj kapërcente kufijtë e atdheut, jo vetëm për klimën e shëndetshme, por edhe për zhvillimin e saj të lartë kulturor. Këtu kishte akademi, kishte një shtypshkronjë që zinte vendin e dytë në Ballkan për nga madhësia, afresket e kishave dhe qdhendjet në dru të habitin edhe sot me ngjyrat, vizatimet dhe kompozicionin e tyre. Nën tokë Voskopoja mban thesare të vjera të kulturës sonë të lashtë. Shumë pak janë bërë gërmime, për të mos thënë hiç fare. Diku këtu bien shumë rrufe. Thonë se e tërheq plumbi i shtypshkronjës. Një punëtor nga Tudasi, duke punuar me kazmë, gjeti një kapak ungjilli prej argjendi lyer me flori. Ky kapak i vyer është punuar me mjeshtëri të rrallë nga artistët voskopojarë në vitin 1756.

Voskopoja ka dritë elektrike, ka shkollë 7-vjeçare, ka shtëpitë e pushimit për të rriturit e për pionierët, të cilat i shtojnë gjallërinë në verë dhe i japin fshatit pamjen e qytetit. Radiot buçasin mbrëmjeve. Pleqtë që shkrinë çdo gjë për Luftën Nacionalçlirimtare, janë vënë në krye të vendit, çmohen e nderohen. Të rinjtë drejtojnë me

zotësi kooperativën dhe fëmijët flenë të qetë nëpër krevatkat e tyre...

Flenë të qetë se për ta luftoi tërë Voskopoja, Voskopoja kështjellë partizane, Voskopoja flamur lirie, Voskopoja shembull i jetës së re në malësi!

Ishim mbledhur për zgjedhjet e reja në kinemanë e madhe moderne, që ka përpara një kopsht tërë lule, rrethuar me harqe e kolona. Aty, në radhën e parë, rrinte Tankë Shkodrani.

— Unë kam sjellë e para nga Korça flamurin partizan, me yll, drapër e çekan, — më tha ajo. — E kisha fshehur në brez. Te postblloku më ndaluan... «Edhe ti, plakë, më duket se ngatërrohesh me ata të malit», — më tha një milic. «Më vjen keq, — i thashë, — që je shqiptar. Të ishte italian, s'më hante merak», — dhe u shtrova në muhabet me të. Por vetes i thashë: «Ik, moj Tankë, se do merresh më qafë!»

E solla flamurin e Partisë dhe ua dhashë partizanëve...

Atë flamur e kam parë edhe unë ditën e parë, kur dola malit dhe erdha drejt e në Voskopojë. — E shtrëngonte fort një partizan i ri dhe me këndonim këngët e reja partizane. Me atë flamur çamë përpara dhe i mundëm armiqtë. Por unë e dija që e kishte sjellë voskopojarja Tankë Shkodrani, e cila tani, pas 20 vjetësh, më shtrëngon dorën, më përqafton me mall e sytë i mbushen me lot...

Vështroja rreth e rreth Voskopojës dhe kujtimet e djallërisë vërshonin njëri pas tjetrit. Në jug janë majat e larta të Kullave të Gjergjevicës. Aty më ka rënë i vrarë në duar një shok. Në veri janë pyjet e dendura me boriga dhe mbi ta Shipska në mes të blerimit të livadheve. Gjatë rrugës për në Shipskë kam marrë vesh se mbeta pa baba. Pas luadheve të Dautit është Krushova, me ata burra të qetë e trima, që nuk u tundën asnjëherë nga besa që i dhanë Partisë. Tani, gjer afër Shipskës shkova me makinë nga rruga e re. Edhe nga Krushova zbrita me kamion nga rruga e re. Në Shipskë, iku për ndriçim përdorej më shumë pisha se gazi, ka central elektrik. Krushova është ndërtuar pothuaj në majë

mali, atje ku ngrenë folenë shqiponjat. Gjysmë viti qëndron këtu dëbora. Toka është e paktë dhe e varfër. Prandaj disa familje janë shpërngulur me kohë në ferma e në kombinatë. Ata që mbetën, ngritën kooperativën dhe kryetari i saj nuk ankohet kurrë, megjithëse ka përpara shumë vështirësi. Por jeta e re ka vërshuar në Krushovë, është ngritur shkolla, në dyqan mund të blesh çdo gjë që ke nevojë dhe nëpër shtëpitë, në muret e të cilave qëndrojnë varur pushkët, mund të hash mirë e të flesh rehat në dyshek.

Pushkët! Unë i pashë ato në supet e në shtëpitë e fshatarëve dhe në qoshen e shkollës së Brozdovecit, por krismën e tyre nuk e dëgjova asnjëherë.

— S'kemi grindje e hasmëria si qëmoti, — më thanë? — Pushkët nuk i mbajmë për të trembur njerëzit. I kemi për armiq të.

Në ditarin që kam mbajtur gjatë luftës, më datën 2 dhjetor 1943, midis të tjerave, kam shkruar edhe këto fjalë: «Brozdoveci me Mazrekën janë në hasmëri prej kohësh, janë vrarë njëri tjetër dhe kushedi ku do të mbarojë...»

Ua lexova këto në Brozdovec. U dukej si një ëndërr e hidhur, të cilën e kishin harruar prej kohësh. Të rinjtë s'dinin gjë dhe habiteshin me ato që u lexova. Por edhe unë isha gabuar atëherë, kur shkrova: «Kushedi ku do të mbarojë.» Kjo hasmëri është varrosur përgjithmonë. Partia i edukoi njerëzit, i vëllazëroi fshatrat dhe i çliroi nga një ankth i madh e i tmerrshëm, siç ishin hasmëria e vëllavrasja për një mezhde.

Në këtë zonë të Oparit njerëzit janë më shumë punëtorë se bujq, ose më drejt është të thuhet se janë edhe punëtorë edhe bujq, edhe blegtorë. Në këto anë «zoti» i ka hedhur pa llogari shkëmbinjtë e gurët. Toka leroset dhe shkatërron arat, kullotat, shtëpitë. Burrat e djemtë e Gurmujasit, Shkozanjit, Gjonbabisit, Marjanit, Lekasit, Xerjes etj. kanë qenë të detyruar të bredhin nëpër Shqipëri, duke ndërtuar kalldrëme e shtëpi. Do t'i gjesh në fshat ndonjë muaj në pranverë për të mbjellë e po kaq në vjeshtë për të korrur. Muajt e tjerë punojnë

anëmbanë Shqipërisë, që nga Konispoli e gjer në Shkodër. Ata kanë edhe një gjuhë të tyre, një argo, që e kanë shpikur edhe atë nga nevoja. Vinin grupe-grupe për të ndërtuar një shtëpi dhe, që të mos i kuptonte njeri hallet dhe «marifetet» e tyre, flisnin atë gjuhë që e quajnë purishte. Për ata i thonë ustait.

Me gjithë tërmetet dhe erozionet, malet nuk kanë luajtur nga vendi. Qafa e Gjarprit, ku kanë gjetur vdekjen qindra gjenmanë nga brigadat tona partizane, është ajo që ishte, e përpjetë, thikë, tërë ahishte e lajthi. Edhe Qafa e Beçit qëndron e paepur, duke mbështjellë në gjirin e saj furtunat e kobshme të dimrit dhe tufat e mëdha të shqerrava gjatë verës. Ostrovica, sipas zakonit të vjetër, s'e heq nga kurrizi gunën e bardhë prej dëbore, po s'kaloi qershori. Edhe Qelidhoni, që të rrëmben mendtë, kur je në majë të tij, qëndron si një shqiponjë e ngurosur lart në qiell, duke vështruar lumin që rrjedh në këmbët e tij. Qelidhoni hesht, sikur vazhdon të mbajë zë për nënë Xhemilen, e cila, kur armiqtë i pushkatuan djalin e saj të vetëm, mbylli sytë e u hodh nga kjo majë e thepisur!

Malet s'kanë luajtur nga vendi. Por njerëzit, të fortë si këto male, kanë ndryshuar.

Idetë e Partisë, idetë e jetës së re socialiste kanë zënë rrënjë në shpirtin e malësorëve. Tetë vjet më parë N. Kreka u caktua infermier në Mazrekë, por fshati e përcolli me marifet, duke mos i thënë hapur se s'ia kishte nevojën.

Tani mazrekasit kritikojnë ndihmësmjekun e Lavidarit, që u vete shumë rrallë, dhe kërkojnë me këmbëngulje që të ngrihet një ambulancë e të ketë një mami. Të tjerët kërkojnë shkollë shtatëvjeçare, të mesme, kërkojnë dinamo për dritë elektrike, kërkojnë rruqë automobilistike e autobus. Arshini nga Lekasi është i kaluar në moshë, por hoxhën nuk e beson më.

— S'ia heq më kapelën, — thotë ai. — Doktorin më shëron e jo hoxha. Iku ajo kohë. Vetëm Partinë i besojmë...

Dhe fjala Parti është skalitur në zemër të maleve dhe në zemër të njerëzve. Unë u ndodha në këto zona në

pragun e zgjedhjeve. Lulet e livadhet dhe degëzat e çelura të pemëve ishin mbledhur nga duart e njoma të nxënësve për Partinë. Për shëndetin e Partisë fillonte dollia. Për të ishin këngët.

*Rrofsh, o komandanti ynë,
doli fjala që na the!...*

Kudo e këndonin këtë këngë labe, sikur njerëzit këtu të ishin lebër vërtet.

*Prapa këtij mali një kumbull gërquinjë,
Rroftë Enver Hoxha që fitoi lirinë!...*

këndonin gratë livadheve duke tundur shaminë, këndonin çobanët e kooperuar dhe kënga e tyre përhapej në faqet e Ostrovicës.

Një pionier i klasës së tretë nga Lekasi recitoi para fshatarëve vjershën e tij që e ka botuar te «Pionieri» «E dua Partinë». Kurse një partizan i vjetër që mban ende pushkën krahut, Dervish Kreka, vështroon me miratim te muri i shtëpisë së tij dhe thotë me krenari:

– Këtu ka kaluar në kohën e luftës Shtabi i Përgjithshëm me shokun Enver Hoxha në krye.

Fjala Parti është skalitur në zemër të njerëzve. Kudo që të vesh – te sheshi i fshatit, në vatrën e kulturës, në stanet, në shkollë, në shtëpi, te burimi i ftohtë – do të dëgjosh këtë urim që del nga thellësia e shpirtit të malësorëve:

– Parti u bëftë gjithë bota!

Voskopojë-Opar, maj 1962

NJËZET VJET ME SHKRONJA TË ARTA

29 Nëntori i 1944-ës – data e kuqe më e rëndësishme e historisë sonë! 29 Nëntori i 1944-ës – sinteza e luftërave shekullore të popullit tonë, e sakrificave dhe e mundësive, e lotëve dhe e hidhërimeve!

29 Nëntori – triumfi i revolucionit popullor!

29 Nëntori – ditëlindja e Shqipërisë së Re!

Kaluan 20 vjet, njëri më i lavdishëm se tjetri, njëri më i vështirë se tjetri dhe mëma Shqipëri doli nga zjarret e furtunat, e pamposhtshme krenare, socialiste. Prandaj të gjithë ne, sot më 29 Nëntor 1946, jemi zgjuar me një gëzim të madh në shpirt e me një lot të kulluar në sy; e ndiejmë veten të përkundur në krahët e lumturisë, të përkundur nga mendime të qarta fisnike e nga ndjenja të holla prej poeti. Të gjithë e ndiejmë veten sot mendimtarë e ëndërrues. Dhe sa naive do të ishte sikur të na quanin sentimentalë!

Kaluan 20 vjet, njëri më i lavdishëm se tjetri!

E ç'ishim ne një çerek shekulli më parë? Sa hidhur na vjen që ta themi! Ne ishim një vend i shtypur e i harruar, ku sundonte padrejtësia e plotë, kënetat, errësira. Ishim vendi më i varfër e më i prapambetur i Evropës, vendi ku sa e sa nëna i lindën fëmijët e tyre në pyll e në arë, ku sa e sa baballarë humbën rrugëve të kurbetit të mallkuar, ku sa e sa jetë u fikën burgjeve zogolliane, ku kokrra e misrit ishte një kokërr dhimbje, mjërimi, kafshatë që s'kapërdihet, jeta – një burg i vër-

tetë. Dhe ja ku e humbëm edhe pavarësinë kombëtare që populli e kishte fituar më 28 Nëntor 1912, pas pesë shekujsh robërie të rëndë, pas pesëqind vjetësh theorie, lufte e gjaku. Imperialistët fashistë pllakosën në vendin tonë dhe na hodhën lakun në fyt. Shqipërinë e lidhën me vargonjtë e skallavërisë, me nyja, si nyja gordiane. Po pikërisht në këtë kohë doli më në fund nga gjiri i Shqipërisë dora e fortë e trime, Partia e komunistëve, që i dha popullit besim e shpresë, që i dha zjarr urrejtjes së tij shekullorë dhe që e mësoi ta presë një herë e përgjithmonë nyjën e pazgjidhshme gordiane.

Në flakët e para të revolucionit u hodhën dhe u bënë fli bijtë më të mirë të Shqipërisë, komunistët. Shembullin e tyre e ndoqi gjithë populli. Ditë edhe natë, fashistëve, nazistëve e tradhtarëve, u digjej toka nën këmbë. Mijëra ilegalë vepronin nëpër qytete, digjnin fashiot, ndërprisnin komunikacionin, vrisnin spiunë, organizonin popullin. 70 mijë partizanë e partizane, të drejtuar nga Partia, nga komandanti i urtë, largpamës e sypatrembur Enver Hoxha, me flamur të kuq në duar, me një torbë me fishekë e një dyfek, u derdhën si një stuhi e pandalshme mbi bajonetat e fashistëve, mbi topat, fortinat e tanket armike, mbi bejlerët e borgjezët e vendit. Malet u bënë kala, rrugët barrikada, shtëpitë prita, ku gjenin vdekjen e sigurt pushtuesit e tradhtarët. 28 mijë vëllezër e motra ranë në fushat e betejës. Mijëra të tjerë u gjymtuan. Shumë fshatra u përpinë nga flakët e zjarrit. Toka u shkrumbua. Kjo ishte një epike e vërtetë legjendare që do të shkruhet në histori me shkronja të mëdha. Aty u dukën më së miri karakteristikat tradicionale të popullit tonë, si dhe vetitë e reja morale që kaliti Partia në zemrën e tij: trimëria, heroizmi, shpirti i sakrificës, dashuria për atdheun, si dhe fryma internacionaliste, besimi në forcat e veta, në fitoren e sigurt të revolucionit socialist dhe në të ardhmen e ndritur socialiste.

Më kujtohen vitet e para pas Çlirimit. Partizanët shkelnin nëpër qytet me opinga lope. Lumenjtë i kalonim me anë të trapeve, se urat ishin hedhur në erë. S'kishim farë për të mbjellë, s'kishim bukë të hanim, ishim të

lekosur dhe shumë familje kishin për dyshek tokën e zezë e për jorgan qiellin e lartë. Rreth kufijve sillëshin armiqtë imperialistë si qen të tërbuar. Por revolucioni e kishte nxjerrë tani më popullin nga errësira në jetë. Revolucioni nxori në pah energjinë e pashtershme të popullit. Dhe kjo energji bëri e vazhdon të bëjë në Shqipëri mrekulli. Ne pothuaj çdo gjë e filluam nga hiçi. Atë që feudoborgjezia s'e bëri dot për një çerek shekulli, ne e bëmë brenda vitit. Atë që prodhonte industria më 1938, ne e prodhuam për dy javë. Ne bëmë që të shushurijnë valët e liqeneve të reja, që të vërtiten turbina nga ujërat e Matit dhe së shpejti edhe nga valët e Bistricës. Ne u ramë maleve me grusht dhe shtruam rrugë e hekurudha, nxorëm hekur, krom, naftë. Me mijëra e mijëra metra basmë endin kombinatet. Qindra apartamente hapin dyert e tyre për njerëzit. Ne i dhamë shpirt metalit dhe në qiell drejtuam armaturat me këmbë prej hekuri, ngulur mbi shkëmbinj.

Nuk është vështirë t'i marrësh me mend ato që janë realizuar gjatë një periudhe kaq të shkurtër historike. Të mbahet fryma nga emocioni dhe të mbushen sytë me lot, po me lot gëzimi, kur mendon se ç'punë titanike bëri populli për të futur tërë jetën në rrymën e socializmit. Kudo që të hedhësh vështrimin, kudo që të vesh, në Tiranën legjendare, në Jug e në Veri, gjer te ai fshati që ndoshta s'i ka dalë ndonjëherë emri në gazetë, kudo sheh fuqinë kreshnike të këtij populli që ka tashti në duart e veta detin e qiellin, fushat, malet dhe thesarët e nëntokës.

E pra, 20 vjet më parë ne ishim të panxënë e të pangrënë, të palarë e të paparë. 20 vjet më parë s'ishin këto fabrika e këto qytete, këto shkolla e hidrocentrale, 20 vjet më parë edhe lumenjtë rridhnin ndryshe! U bënë kaq shumë shndërrime të thella ekonomike, shoqërore e kulturore, sa Shqipëria nuk njihet më. Në zjarrin e betejave të mëdha për çlirimin e atdheut, për ndërtimin e socializmit dhe për mbrojtjen e fitoreve revolucionare, Partia formoi dhe kaliti njeriun me shkronjë të madhe, njeriun e ri me ide të reja komuniste, me virtyte të larta morale, i cili me aftësi dhe talent, me vull, entuziazëm e ndërgjegje të

pastër socialiste, ndërton dhe mbron socializmin. Ky njeri i ri revolucionar është garancia më e madhe për fitore të reja në përvjetorët e ardhshëm.

Për edukimin e këtij njeriu, një rol të madh kanë luajtur edhe letërsia e artet tona të realizmit socialist, të cilat, duke pasur vazhdimisht kujdesin atëror të Partisë, janë zhvilluar e kanë ecur përpara krah për krah me gjithë sektorët e jetës sonë. Ato kanë hyrë në fazën e pjekurisë artistike e ideologjike. Duke përqafuar metodën e realizmit socialist, që lindi nga vetë kushtet e zhvillimit historik të vendit tonë, ne krijuam një varg romanesh, poemash, dramash, pikturash, skulpturash e operash, të cilat janë një ushqim i shëndetshëm shpirtëror për popullin. Veprat më të mira artistike, që janë pasojë e futjes sonë më thellë në proceset e jetës, kanë edukuar njeriun e ri me ideale të larta partie, ato i kanë thurur lavdi ndërtuesit të socializmit, i kanë bërë atij thirrje për heroizma të reja në emër të së ardhmes së ndritur dhe i kanë sjellë kënaqësi të vërtetë estetike. Populli dhe Partia — ja kush na ka frymëzuar gjithnjë në punën tonë krijuese. Ata na kanë dhënë forca për krijimin e veprave me të vërtetë të mira e të bukura. Si bij të dalë nga gjiri i popullit, shkrimtarët dhe artistët kanë qenë dhe do të jenë gjithmonë pranë tij, shprehës të interesave shpirtërore dhe të ideve socialiste që frymëzojnë popullin. Edhe ne vijmë në këtë jubile me duar plot, me një letërsi e art thellësisht popullor, të partishëm, revolucionar. Dhe kjo dëshmon se e kemi kryer, dhe në të ardhmen do ta kryejmë edhe më mirë, misionin e lartë që na ka ngarkuar Partia: të jemi inxhinierë të shpirtit shqiptar!

Shumë erëra fryjnë e shumë furtuna shpërthyen mbi vendin tonë gjatë këtij njëzetvjeçari. Po Shqipëria asnjëherë nuk e vrenjti ballin. Ajo e mbajti dhe e mban lart e të kthjellët si drita e diellit, edhe në ditët e vështira të luftës me imperializmin e revizionizmin. Me nerva të çeliktë, me urtësi e largpamje, me duar të forta si beton, me timonieren Parti në krye, Republika Popullore e Shqipërisë, i pastroi gjithnjë nga qiejt retë e zeza armike dhe emri i saj shkëlqeu me tërë vezullimet, si vesa e

pashkelur mëngjesore. Në brigjet e Adriatikut ajo qëndron e fuqishme, e paprekshme dhe e lulëzuar. Fytyrën ia ka kthyer diellit që ta shohë tërë bota. Dhe bota ka njëzet vjet që e vështron. Armiqtë e urrejnë dhe verbohen nga vezullimi, nga forca, nga zjarri i së vërtetës që ajo mban në gji. Miqtë e ʒmojnë, e nderojnë, gëzohen dhe frymëzohen prej saj. Shqipëria është vendi që mbron me zjarr revolucionin, socializmin, pastërtinë e ideve marksiste-leniniste. Duke shpalosur flamurin e madh të idealeve të komunizmit, e pajisur me shpirtin luftarak, ajo demaskon imperialistët e egër dhe revizionistët dredhacakë, si armiq të popujve, të lirisë së vërtetë, si armiq të atdheut tonë të dashur.

Partia ishte ajo që na mësoi të ngjitemi kaq lart majave të vështira të socializmit, në ato maja, të cilat shohin të parat rrezet e diellit. Partia na mësoi të dallojmë të vërtetën, edhe kur e veshin me mjegull të dendur. Ajo na mësoi të shquajmë gënjeshtren, edhe kur vishet me ar. Ajo i dha fuqi të dobët, ajo na dha dorën e na ngriti në këmbë, kur ndonjëherë ramë pa dashje. Nga drita e saj vezulluese, jeta del para nesh e ndritshme, optimiste, madhështore. Ajo na ka drejtuar e na drejton me ngrohësinë e zemrës së madhe, me forcën e arsyes e të vullnetit, me përvojën e saj, me thirrjet e saj, me të ritë e saj. Prandaj nga thellësia e shpirtit të çdo shqiptari jehojnë sot këto fjalë mirënjohjeje e dashurie të pakufishme.

— Të faleminderit, Parti e dashur!...

Lindja gjithmonë vjen me dhimbje. Të mëdha ishin dhimbjet e lindjes së shoqërisë sonë socialiste. Por kjo shoqëri lindi, u rrit, u bë 20-vjeçare dhe nuk do të vdesë kurrë. E ardhmja është e saj. E ardhmja është jona! Ne jemi të lumtur dhe kemi të drejtë të krenohemi, sepse në këtë cep të Ballkanit, ku mbretëronte nata, e shporrëm egërsinë kapitaliste, që na kishte mbytur në gjak, dhe hodhëm themelet e çelikut të jetës së re socialiste. Kjo jetë s'ka për t'u shuar kurrë. E ardhmja është e saj! E ardhmja është jona!

Ne, si shkrimtarë e artistë, ndoshta më shumë se të tjerët, ndiejmë poezinë e kohës sonë. Ne jemi të lumtur që jetojmë në këtë kohë. Ne jemi krenarë që, krah për krah me popullin, punojmë në këtë kohë. Për të ne luftuam me armë e me penë. Për të ne krijuam këngë me gjakun e zemrës. Ato buçasin si një himn madhështor për popullin tonë të mrekullueshëm...

Kaluan 20 vjet të lavdishëm e të vështirë, 20 vjet që do të shkruhen në histori me shkronja të arta. Këto ishin vite prove, luftime, kalitjeje, fitoresh. Këto ishin vite luftërash betejash. Ne e dimë se na mbetet akoma shumë për të bërë. Ne e dimë se përpara na presin punë të mëdha, beteja të mëdha, vështirësi të tjera. Brezi që do të sulmojë për fitoret e reja, u rrit i shëndoshë, gazmor, trim e punëtor. Po edhe ne nuk jemi plakur, shokë! Në kokë na kanë dalë thinjat e bardha. Po në shpirtin tonë s'kemi asnjë thinjë. Në sy po mbajmë syze, po përpara shikojmë shumë larg, me sy rinorë. Shikojmë si në pëllëmbë të dorës të ardhmen tonë, përvjetorët e tjerë komunistë, për të cilët do të punojmë me hoves, ritmet, energjinë e mençurinë e njëzetvjetorit të parë të Çlirimit. Do të punojmë edhe më mirë, edhe më shumë, të ndriçuar gjithnjë nga rrezet e arta të marksizëm-leninizmit, nga e urta, largpamësja dhe e pagabueshmja Partia e Punës e Shqipërisë.

«Drita», 29 Nëntor 1964

DUKE SHFLETUAR DITARIN E LUFTËS

Kam përpara ditarët e mi të luftës. Sa herë që më nevojitet t'i hap, më dridhen duart lehtë nga emocioni, më mbahet fryma dhe shpesh (e përse ta fsheh?) më mbushen sytë me lot. Koha ka bërë punën e vet të pamëshirshme: shumë radhë janë fshirë, shumë fletë janë shqyer e mezi lexohen. Por koha nuk ka mundur të zhdukë njollat e gjakut, me të cilat janë spërkatur ditarët e mi të luftës. Dhe është gjak dëshmor...

Ditari fillon më 8 nëntor të vitit 1941, me dëshmorin e parë të Korçës, komunistin Koci Bako, i cili ra në krye të demonstratës antifashiste po në këtë datë, dhe vazhdon me dëshmorët e tjerë, me shokët tanë Kiço Greçon e Midhi Kostanin, të cilët morën pjesë në djegien e zyrave të Fashios dhe u vranë në sheshet e qytetit, me Demir Progrin e Zef Markun, me Todin e vogël e Skënder Çaçin, me Çelikon, Xhevitin, Jonuzin, Stillon, Nezirin, Xhaferrin... me dhjetëra e dhjetëra të tjerë, edhe me atin tim, edhe me Lirinë, edhe me Thimaq Ndonin... O, po ku numërohen në një artikull gjithë shokët e mi që u hodhën në luftërat e reja dhe për fitore ranë fli!

Shfletoj ditarin e përgjakur dhe para meje kalojnë vitet e zjarrit, vitet heroike dhe njerëzit që u hodhën në këtë zjarr me thirrjen e Partisë Komuniste. Dikush la nënën e babanë, dikush gruan e fëmijët, dikush çekanin a dhitë, dikush nxënësit e librat e hapur mbi bankën e shkollës dhe të gjithë së bashku hodhën në sup dyfeqet e

vjetra e shkuan të mbronin e të shpëtonin Shqipërinë e robëruar, shkuan të binin fli për fitoren mbi armiqtë, për Shqipërinë që i kishte mëkuar me qumështin e dashurisë së saj.

Shfletoj ditarin e përgjakur dhe sjell ndër mend se si shumë nga këta shokë ranë para syve tanë, në një pritë, në një llogore. Shumë të tjerëve, së bashku me luftëtarët e përzhitur nga zjarret e luftës, u kam hedhur mbi varr një grusht dhé, u kam kënduar mbi varr këngën e hakmarrjes dhe u kam dhënë lamtumirën e fundit duke nderuar me grusht e duke zbratur maliherin. Shumë të tjerëve u kam ndier frymëmarrjen e fundit, u kam dëgjuar në heshtje fjalën e fundit. Që në djep nëna shqiptare u kishte dhënë atyre, bashkë me qumështin e saj, trimërinë për vdekien, dashurinë për atdheun, urrejtjen për armiqtë. Partia u dha flatrat dhe besimin në fitore. Dhe ata ranë me këtë besim e lëshuan rrënjë të thella në tokën tonë e në zemrën e popullit dhe askush e asgjë nuk mund t'i shkulë, as armiqtë e pabesë e të egër, as stuhitë, as shekujt.

Shfletoj ditarin e përgjakur dhe ja ku më del komisari Skënder Çaçi. Ai nuk fliste dot, pasi plumbat e kishin marrë në fytyrë. Ai fliste vetëm duke tundur gishtin. «I dërrmuam... i mundëm... fituam» — shkruante ai në ajër me grushtin e tij. Kur po jepte frymën e fundit, me sy mbyllur e me shpejtësi, shkroi në një copë letër vetëm fjalët: «Rroftë Shqipëria! Rroftë Partia Komuniste!»...

Shfletoj ditarin e përgjakur dhe më del përpara mitralieri tetëmbëdhjetëvjeçar Thimaq Ndoni. Luftonim në Piskupat. Ai u godit rëndë në kokë dhe vdiq pas njëzet e katër orësh. Vendi ishte i keq, tërë gurë, gurët e ronitur në Boalës. Unë i vura nën kokë çantën time dhe gjaku i tij bëri vazhdë në ditarët e mi. Mitralieri i ri vdiq në heshtje, por me gjakun e tij më duket sikur ka shkruar në këta ditarë fjalët «Shqipëria! Partia!»... Këto ishin fjalët e fundit të shokëve tanë dëshmorë, edhe kur ata u goditën keq e nuk mundën t'i shqiptonin...

Shfletoj ditarin dhe shoh batalionin tonë të radhitur në heshtje para nënës së dëshmorit Xhevit Goskova. Ajo

ishte një nënë shqiptare, që di t'i vërë zemrës një gur të rëndë në çaste hidhërimi. E kishte marrë vesh lajmin, na nderoi me grusht dhe krenare përsëriti dy herë vetëm këto fjalë: «Rrofshi! Përparofshi! Shqipërinë e fitofshi!».

Çna duhej ne më shumë se ky urim i nënës së për-
vuajtur shqiptare, që dilte nga thellësia e shpirtit të saj!

Dhe ne rrojtem, përparuam, Shqipërinë e fituam dhe do ta gëzojnë jetë e mot brezat që do të vijnë pas nesh. Sepse lart, në qiellin tonë të kulluar, ndriçojnë si diej dëshmorët tanë dhe i japin dritë Shqipërisë socialiste. Ata janë kthyer tani në male e lapidarë që mbrojnë kufijtë e Republikës nga imperialistët e revizionistët. Ata janë kthyer në qytete, në pallate, në uzina, shkolla e kooperativa. Ata janë kthyer në furra, në të cilat ne të gjallët shkrijmë shpirtin tonë dhe bëhemi të fortë e të pathyeshëm si çeliku. Ata janë kthyer në poemë e simfoni të jetës sonë të re...

Shfletoj ditarin dhe më duket sikur shfletoj shekujt. Dhe këta shekujt e historisë sonë janë mbushur me dëshmorë e me martirë. Kaq të shumtë janë bijtë e bijat e Shqipërisë që kanë rënë në fushat e betejës, sa çdo ditë e viteve mund të quhet «Dita e dëshmorëve». Shqipëria është vetë si një ditar i madh, i madh sa kufijtë e saj, një ditar i përgjakur, ku mbi çdo gur është skalitur emri plot tingull i një dëshmori!...

Më 5 Maj, në këtë ditë heshtjeje të therorisë shekullore të popullit tonë, Shqipërisë i pikon zemra ajak për bijtë e saj që s'janë më, por edhe sytë i shndrisin nga drita e pashueshme socialiste. E drejtuar nga Partia, me Enverin në krye, ajo ka njëzet viet që jeton e lirë dhe që e mban ballin lart, krenar e të papërlyer. Partia, që e di mirë se amanetin e dëshmorëve s'e tret dheu, shikon si në pëllëmbë të dorës rrugën që kemi për të bërë drejt ndërtimit të plotë të socializmit. Këtë rrugë ëndërruan shokët tanë të rënë. Kush e sheh atë qartë, ai fiton gjithnjë. Këtë rrugë shohim ne edhe më 5 Maj. Prandaj edhe pionierët bëjnë rojë nderi te lapidarët, të heshtur e të menduar, si burra të pjekur...

Ka kaluar pothuaj një çerek shekulli nga koha kur unë

fillova të mbaja këta ditarë të luftës. Atëherë isha i ri, tani kam filluar të thinjem. Por shokët që lamë në luftë, kanë mbetur në mendjen dhe në zemrën tonë të gjallë e të rinj. Dhe gjithnjë të gjallë e të rinj do të mbeten ata në mendje dhe në zemrën e popullit e të Partisë...

Po i mbyll ditarët e mi të luftës me duart që më dridhen lehtë nga emocioni, me sy të përlotur dhe me një mendim të qartë se edhe ne që luftuam së bashku me ta në një llogore e që kemi filluar të thinjemi, po ta kërkojnë Atdheun dhe Partia, do të rrëmbejmë përsëri armët e lara, «ndër lufta të reja kemi m'u ndeshë – dhe për fitore kem' me ra fli».

«Zëri i popullit», 5 Maj 1965

MENDIME PARA DITËS SË POEZISË

U mësuam me festat e racionalizatorëve, të minatorëve e të naftëtarëve. U mësuam me Muajin e të Rejave, me Muajin e Letërsisë. Tashti po mësohemi edhe me Ditën e Poezisë. Këto janë festat për të nderuar njerëzit e ditëve tona që janë në pararojën e ndërtimit të socializmit. Në këtë pararojë bëjnë pjesë edhe poetët tanë, vargjet, poezia, kënga, gjithë arti ynë i ri. Në këtë pararojë bëjnë pjesë edhe klasikët tanë të mëdhenj, Naimi, De Rada, Çajupi, Noli, Mjeda, Migjeni, megjithëse ata as që e ëndërruan Muajin e Letërsisë dhe Ditën e Poezisë.

Disa ditë më parë isha në plazhin e Durrësit. Mijëra e mijëra të rinj kishin dalë në punë vullnetare dhe pas-tronin bregun nga leshteriku. Midis zhaurimës së gëzuar të rinisë e të valëve të detit, pashë një nxënës shkolle që tërhiqte thesin me leshterikë dhe u recitonte shokëve vullnetarë, në mënyrë krejt spontane, vargje të Naimit. Unë u emocionova dhe m'u kujtua romantiku Lamartin, i cili i shkroi De Radës se në këto brigje lindi poezia dhe aty do të rikthehet.

«Në këto brigje lindi poezia!» Poeti ka thënë një të vërtetë të madhe për poezinë. Këtë poezi e gjejmë tek eposi i Gjergj Elez Alisë. Këtë e gjejmë te vargjet populllore aq të fuqishme, të freskëta e të larmishme, sa të vjen keq që nuk janë shfrytëzuar gjer në fund, sa të pikon në zemër kur nganjëherë lexon vjersha të ftohta e pa emocion që nuk janë mbrujtur me këtë natyrë të

bukur e të habitshme të poezisë sonë popullore, me këtë natyrë shumëgjyreshe e aq muzikore e të ëmbël të gjuhës sonë. Këtë poezi e gjejmë te klasikët tanë të mëdhenj, te mjeshtret tanë të përkryer, të cilët rrugën e përjetësisë e çanë duke kaluar nga poezia popullore. Jeta e këtyre titanëve që janë perla në kurorën e poezisë sonë, ka qenë e rëndë, si një burg. Nganjëherë ajo ka qenë më e rëndë se burgu, krejt e padurueshme, si vetë jeta e popullit të robëruar. Por në asnjë varg ata nuk psherëtinë pa shpresë e të gjuhëzuar. Me burrëri shqiptare ata kapërcyen mallin zhuritës të të mërguarit, lodhjen fizike e mendore, hidhërimin. Të gjithë ata ia kushtuan jetën dhe punën poetike Shqipërisë, ëndrrave të saj, luftës së saj për çlirim. Ata i falën atdheut të robëruar zemrën dhe poezinë. Kjo zemër e madhe dhe kjo poezi e madhe ngjallën te populli e te poetët pasardhës admirimin, ndërrimin, besimin dhe dëshirën për t'u bërë si ata e për të jetuar si ata. Ky ishte fati i tyre i madh, i dëshiruar nga të gjithë ne: Të jesh ushtar që lufton për popullin dhe për gjithë njerëzimin. Ata mbetën përgjithnjë buka jonë e përditshme.

Dhe poezia jonë, krenare për këto tradita të shkëlqyera, eci në rrugën patriotike, demokratike e revolucionare të të parëve tanë. Dhe eci pa ngurrim e me pasion. Me thirrjen e parë të Partisë, që në ditën që Partia lindi, kjo poezi buçiti në vargjet e Jakovës e të Metos, të Varfit e të Musarajt, të Siliqit, të Çaçit e të poetëve të tjerë. Ajo shtrëngoi grushtet, shfreu hakmarrjen e popullit dhe u bë jehonë e fuqishme e kushtrimit të Partisë.

Këtu tek ne ka pasur poezi në çdo dallgë, që ka rrahur shkëmbinjtë. Poezi ka pasur në çdo shteg mali, ku rrinin në pritë komitet e partizanët. S'u ka munguar poezia as shtëpive pa çati, as lotëve të nënës, as fshatarëve që bridhnin qyteteve për një kokërr misër, as punëtorëve që shtrëngonin grushtet, as intelektualëve që endeshin rrugëve me shpresa të humbura, as maleve hijerënda, as fushave të mbytura nga ujërat e amullta, as pushkës.

Po megjithëkëtë poezia u rikthye në këto brigje. Ajo erdhi së bashku me flladin e lirisë. Klasikët tanë i kë-

duan atdheut të robëruar. Dhe me ç'dashuri i kënduan?! A s'kanë të drejtë poetët tanë, njëqind herë të drejtë, t'i këndojnë me frymëzim Shqipërisë së lirë socialiste? A s'kanë njëqind herë të drejtë t'i këndojnë ata Pranverës së madhe, Maleve që mendohen, Devollit, Myzeqesë së rilindur, tërë Shqipërisë që po industrializohet, që u kolektivizua, që po ia ndërron faqen fshatit, që ka rritur një njeri të ri me tipare e moral socialist? Dhe poetët tanë, që nga më i moçmi e gjer te maturantët, kanë krijuar e po krijojnë vepra të frymëzuara poetike, ku pasqyrohet njeriu i kohës sonë, njeriu me shkronjë të madhe që ndërton Shqipërinë e re. Këtë e dëshmon krijimtaria njëzetvjeçare. Këtë e dëshmon krijimtaria e viteve të fundit, vëllimet, ciklet, poezitë e vargjet ku vendin kryesor e zë romantika e ditëve tona dhe e Luftës Nacionalçlirimtare, e zë tema e ndërtimit të jetës së re, e përparimit të gjith-anshëm ekonomik e kulturor të vendit, e luftës heroike të një populli të vogël, të cilit s'iu tremb syri as para armikut më të egër e më të madh të njerëzimit, imperia-lizmit amerikan e revizionizmit modern. Sot ne krenohemi me të drejtë për lulëzimin e poezisë sonë.

Po më shumë na gëzon lexuesi i letërsisë e i poezisë sonë.

Javën e kaluar isha në Korçë me dy shokë të mitë të penës. Rreth njëqind pyetje na bënë lexuesit tanë të rinj punëtorë e shkollarë. Duhet ta themi se na vunë në pozitë të vështirë. Ne u bindëm edhe një herë se niveli i tyre artistik e kulturor është rritur shumë. Lexuesit tanë janë bërë me të drejtë mjaft kënkues dhe me kalimin e ditëve e të viteve do të bëhen përherë e më kërkues. Dhe kjo kërkesë e ligjshme estetike e kulturore e amatorëve të panumërt të poezisë e të letërsisë sonë, i bën poetët e shkrimtarët tanë të jenë më kërkues ndaj vetes, i fut ata në mendime të thella për të forcuar përmbajtjen ideore dhe formën artistike të veprave letrare.

Po edhe në çastin e festës, në Ditën e Poezisë, që porsa ka filluar të bëhet një traditë e bukur, duhet të themi se poetët, ashtu si gjithë artistët tanë, kanë përpara shumë detyra të mëdha që ende s'i kanë plotësuar

gjer në fund, për arsye objektive e subjektive. Lexuesit tanë kërkojnë nga gjithë poetët një poezi sa më realiste, dinamike e të gjallë, me figura të përkryera artistike që të pasqyrojnë shpërthimin e energjive revolucionare të popullit tonë, njerëzit tanë që kaluan përmes zjarreve të luftës e u kalitën në ndërtimin e veprave socialiste, këta njerëz me duar tërë kallo e me mendje të ndritur që janë zotër të Shqipërisë së sotme e të Shqipërisë së ardhme. Ky hero që ndërton, ky hero i punës fizike e mendore, i kalitur nga Partia, ky hero, që në fund të fundit është populli e Shqipëria – ja ku qëndron poezia e vërtetë e poetëve të talentuar! Nuk e bëjnë poezinë vajzat e braktisura, fletët e venitura, trishtimet e vockla mikroborgjeze që janë tipike për artin shabllon mikroborgjez e që janë krejt në kundërshtim me shpirtin heroik, luftarak, të ndritur e optimist të popullit të lirë e të poetit të realizmit socialist. Nuk e bëjnë poezinë të ashtuquajturat tema të përjetshme për dashurinë, për skutat e shpirtit të dërrmuar, për pesimizmin e pashpresë, për përpjekjet e kota për një jetë më të mirë, për humbjen e lumturisë personale si për humbjen e gjithë botës, për sentimentalizmin, romantizmin e vjetruar e meskinitetin. Nuk e bëjnë poezinë imitimet shabllone të poetëve të ashtuquajtur modernë, vrap pas kësaj mode, ose retorizmi e bombasticiteti. Të gjitha këto e ndrydhin zhvillimin poetik, pengojnë krijimin e individualitetit dhe ndikojnë për keq në edukimin e lexuesve. Shpesh lexojmë poezi që na lënë të ftohtë e nuk na prekin. Në këto raste, poeti, i cili nuk është nisur nga interesat artistike, nuk arrin të komunikojë me lexuesit dhe lexuesi mbetet indiferent, pa asnjë mbresë, si përpara një boshllëku. Ka edhe poetë, të cilët nganjëherë, pa u menduar, në poezitë e tyre japin figurën e vetvetes, duke harruar se, nëpërmjet un-it të tyre poetik, ata duhet të pasqyrojnë mendimet dhe ndjenjat e popullit. Në këto raste kemi të bëjmë me një poet të shkëputur nga realiteti i kohës, nga jeta e vullshme e dinamike, nga kërkesat e lexuesve.

Sigurisht, në pjesën më të madhe, këto të meta vijnë nga vështirësitë e rritjes së poezisë. Por nuk duhet të

mbyllim sytë as nga ndikimet e dëmshme të letërsisë moderne dekadente.

Jemi në ditën e festës së poezisë sonë dhe nuk është e përshtatshme që, në një ditë gazmore të përmendim hidhërimet. Por ja që gjatë viteve të luftës e të lirisë u mësua të shohim pa frikë çdo të metë që na pengon të ecim përpara. Ne s'kemi frikë nga të metat. Ne i shohim ato në sy me optimizëm, i luftojmë dhe çajmë përpara me guxim e me besim.

Por, me gjithë të metat e gabimet, poezia jonë, ashtu si gjithë letërsia, si gjithë jeta jonë, është optimiste e revolucionare. Poezia jonë i këndon jetës së re, njeriut të ri, triumfit të tij për çdo gjë të prapambetur e konservatore. Ajo pasqyron me besnikëri e në mënyrë të lartë artistike dukuritë e kohës socialiste e të heronjve të kësaj kohe. Në dejtë e saj ka hyrë gjaku i talenteve të reja. Me këtë gjak poezia përtërihet nga viti në vit, siç përtërihet tërë shoqëria jonë që ecën përpara drejt socializmit me vrull e shpirt gjithnjë të ri. Edhe më të mëdha do të jenë sukseset e saj, nëse tërë poetët do të ngulin këmbë më shumë për të njohur jetën dhe njerëzit e kohës sonë të lavdishme, nëse poetët e rinj do të studiojnë në mënyrë kritike thesarin poetik të klasikëve tanë e botërorë.

Poezia, si tërë letërsia e arti, sa më të thella t'i ketë rrënjët në tokën shqiptare e në popullin shqiptar, aq më të gjata e ka jetën e saj. Ky është mësimi i madh që na jep Partia. Kjo është poezia me pushkë krahut, veshur me kominoshet e punës, e përcëlluar nga dielli dhe e mbushur me aromat e fushave, të maleve, të nëntokës e të deteve shqiptare. Kjo është poezia kushtrim, barut, djersë e besim të patundur në të ardhmen komuniste të gjithë botës dhe të popullit tonë heroik që udhëhiqet me largpamje nga Partia e Punës.

Ky besim nuk i ka munguar poezisë sonë as edhe në kohët e errëta të së kaluarës. Jo më kot poeti, që në atë kohë, ka kënduar:

*Lumtënia asht e jona!
Lumtënia asht e jona!*

«Drita», 23 maj 1965

MIDIS UGAREVE E BRAZDAVE

Kur këndojnë gjelat e parë, Suten e ke në këmbë. Ai ishte i pari që prish në mëngjes herët qetësinë e rrugëve të heshtura të lagjes së Hijës dhe i fundit që lë punën. Nuk ka ndodhur gjer më sot që ndokush tjetër të ketë vajtur në brigadë para tij.

Sutja është një njeri i thjeshtë e i zakonshëm, i hollë e i thatë, si fusharakët. Lapardhaja e Morava e njohin mirë.

Në të parë duket shumë i qetë. Flet pak e rrallë. Kur e kritikon, të shikon në sy, hesht dhe të duket sikur kritika s'i bën përshtypje. Po në të vërtetë ai është i shqetësuar, gjithnjë është i shqetësuar për punën, për njerëzit, për prodhimin, për kritikën që i bëhen. Në fushatat e mëdha bëhet copë, s'e zë gjumi. Punët e mëdha të një brigade me 120 veta e me 140 hektarë tokë s'ka se si të mos krijojnë shqetësime të mëdha, vështirësi, telashe, pagjumësi. Duhet të jesh njeri i fortë që t'u bësh ballë e të dalësh imbanë.

Suten e gjen gjithmonë atje ku janë forcat, midis njerëzve, nëpër ugare. Net të tëra i kalon në bokset e pambukut, në hangarët, në kopicat me kashtë, në shtëpitë e anëtarëve. Në shtëpi të vet janë mësuar me këtë regjim. S'bëhen merak as e shoqja, as fëmijët, as i ati.

Ditë e natë zemra e mendja e tij rreh për shtimin e drithërave, të pambukut, duhanit, për zbukurimin e bregoreve me brezare, ullinj e vreshta, për ta bërë jetën më të begatshme e më të këndshme.

Prandaj Suten e duan, e çmojnë, e dëgjojnë dhe e kanë zgjedhur brigadier trembëdhjetë vjet me radhë. E kanë zgjedhur në kryesi të kooperativës. E propozuan edhe sivjet këshilltar popullor.

Keq e kanë me të vetëm dembelët, llafazanët dhe ata që kanë në shpirt ndjenjën e pështirë të pronës private. Me ta Sutja sillet ashpër. Dembelëve u shkon drejt e në dhomën e gjumit dhe u heq jorganin. Kur vijnë vonë në punë, herën e parë vetëm i këshillon. Të dytën i kthen nga kanë ardhur. Të tretën bën mbledhjen e brigadës dhe aty vlojnë kritikak shoqërore, të rrepta, të thëna troç. Më ashpër ai sillet me njerëzit e vet, me farefisin, me vëllanë, me të birin. Atyre s'u fal asgjë.

Por sa i rreptë është ai kundër gabimeve, të metave e fajeve, aq i dashur, i sjellshëm, i dhimbshëm, është me pleqtë, me gratë shtatzëna, me punëtorët e mirë e pa hile.

Një të diel të prillit të këtij viti, ai punoi tërë ditën me traktor dhe mbolli pambuk. Në orën 8 të mbrëmjes e lajmëruan se shoku që do zëvendësonte ishte sëmurrur. Sutja mendoi të lajmëronte zëvendësin, shtëpia e të cilit ishte aty pranë.

— Të punoj edhe nja dy orë, pastaj i bëj zë atij, — tha me vete dhe hipi në traktor.

Frynte era e Elbasanit dhe qielli ishte pus i errët. Sutja, në dritën e fenerit, kontrollonte farën që derdhej me gypat e hynte në tokën e shkrifët e të butë si kadife. Nganjëherë trazonte farën me dorë. Ndiante kënaqësi nga kokrrat që i rrëshqisnin nëpër gishtërinj si qenie të gjalla. Fara ishte e mirë. Edhe toka ishte e ardhur, e kulluar. Pambuku në një tokë të tillë mbin shpejt.

«Vetëm shi të mos ketë», — pëshpëriti me vete dhe vështroi lart errësirën e pafund.

Në mesnatë iu kujtua zëvendësi. Do të shkonte për ta lajmëruar. Ndihej i këputur. Ishte ngritur që në orën katër dhe gjithë ditën nuk kishte pushuar. Edhe drekën e kishte ngrënë shpejt e shpejt, së bashku me traktoristin, në hijen e traktorit.

«Do t'i bëj zë», — pëshpëriti, po aty për aty ndërroi

mendim. I erdhi keq ta zgjonte shokun nga gjumi. Me siguri, edhe ai kishte punuar gjer vonë dhe ishte lodhur. Zëvendësi është djalë punëtor, i drejtë, i ndershëm, ta pish në kupë.

«Le të flejë!» – pëshpëriti.

Dhe e gdhiu natën mbi traktor.

Në mëngjes anëtarët e brigadës shikonin me dashuri e mirënjohje sytë e Sutës të skuqur nga pagjumësia, vetullat e tij të trasha me një gisht pluhur dhe përpiqeshin t'i zbatonin mirë e shpejt udhëzimet e tij.

Si ndau forcat, u kthye për në shtëpi. Do të shkonte të shtrihej ndonjë orë dhe të hante një kafshatë bukë. Buzë lumit pyeti një shokun e tij:

– Ç'tha radioja. Si do të jetë koha?

– Po t'i dalë fjala, kemi shi, o Sute.

– Shi!? – ia bëri Sutja dhe i mbetën sytë në qiellin e ngarkuar me re. Iu duk sikur pika të imëta vese i lagën qepallat:

– Bëju zë nga shtëpia të ma dërgojnë bukën në Sheganet, – i tha shokut dhe u kthye. Me hapin e tij të shkurtër e gjithnjë të shpejtë, shkoi andej nga ishin forcat e brigadës, nga buçisnin traktorët, duke thënë me vete:

«Duhet ta mbjellim pambukun para se të fillojnë shirat.»

Dhe shirat filluan, por brigada e tretë, me brigadier Suten, e kishte mbjellë edhe dynimin e fundit.

* * *

Në prill ranë shira të dendura, temperatura u ul, toka u rëndua shumë dhe pambuku nuk bëri përpjetë. Ishte rrezik të prishej e të fillonte puna nga e para. Përsëri shqetësim e trazira për brigadierin! Përsëri net pa gjumë! Suten e shikoje pa gdhirë në mes të arave, të menduar, të zymtë, të zemëruar me vetveten. Asnjëri s'dukej kund kaq herët në lagjen e Hijes. Vetëm ai, ulur me bisht mbanë Belikes, gërryente me thonj koren një gisht

të trashë të tokës. Nën atë kore pambuku flinte. Nën atë kore pambukut po i zihej fryma, po vyshkej. Ajo kore ia copëtonte gishtat dhe shpirtin brigadierit.

Kur grumbullohen forcat, ai i mbledh mbi ledh e i pyet se ç'mendim kanë e ç'duhet të bëjnë. Mendimet janë të ndryshme, të shumta. Ata që parandiejnë punën e vështirë dhe që rendin pas ditës së punës, ia presin shkurt: «Fut traktorin, ktheje dhe mbille përsëri.» Ata që s'kanë aq besim, i thonë: «Fut një herë lesën e hekurt.» Të tjerët, ata që janë punëtorë me zemër të pastër, siç është edhe brigadieri, ata që pinë ujë gjithnjë te burimi i pashtershëm i mençurisë popullore, siç bën edhe brigadieri, thonë me besim: «Ta thyejmë koren e ta heqim me duar!»

Sutja është me këta. Pa humbur kohë, secili mori një brazdë. Më shumë se njëqind veta u ulën më bisht, nisën të thyenin koren dhe të ecin ashtu më bisht, pas brazdës. Ara është e madhe. Brazda një mijë e dyqind metra e gjatë, aq sa s'e arrin syrin. Por ajo shkurtohej, gjithnjë shkurtohej, dalëngadalë. Dhe ata nuk iu shqitën gjersa u err fare e gjersa ia dolën në krye gjithë arës. Midis tyre punonte edhe Sutja. Sytë e tij u gjallëruan. Në fytyrën e tij u end, më në fund, një buzëqeshje kënaqësie, kur nën koren e trashë pa kërcyellin delikat të pambukut.

S'kaluan as pesë ditë dhe bima çatisi përpjetë. Nga brazdat e hapura me thonj u ngritën rreshtat e gjelbër, të drejtë, si rreshta ushtarësh. Njerëzit që kalojnë andej shohin gjelbërimin dhe thonë të gëzuar:

— E siguruam pambukun!

Dhe në tërë kooperativën hapet lajmi:

— Mbiu edhe në Beliket!

— Edhe në Mesremë!

— Edhe në Puset!

Ndërsa Sutja shikon që nga ledhi dhe thotë:

— Puna!... Puna!... Nuk i thonë kot Parti e Punës! Ajo të jep besim edhe forcë!

Dhe kështu rrjedhin ditët e netët e Sutës, kështu ka-

lon jeta e tij, midis ugareve e brazdave, në diell e vranësira, midis shqetësimeve të mëdha, midis njerëzve, pranë kazmës e tokës së dashur!

* * *

Këtë pranverë brigada mori një nismë të re: u vendos norma kolektive. Për habitinë e të gjithëve, Sutja u ngrit e tha:

— A nuk është më mirë sikur brigadieri e normisti të mos kenë asnjë ditë fikse? T'i nxjerrim edhe ne ditët me punë, si ju të gjithë?

Filluan ta thumbonin:

— Ore qyq, të janë tharë trutë!

— A lumëmadh, lumëmadh! I bie së mirës me këmbë!

— Si u drejtuaka pa shpërblim?!

Brigadieri ngulte këmbë:

— Dëgjoni, shokë! Kështu është më mirë. Do të jem gjithnjë në punë me ju. Do ta ndiejmë veten të gjithë zot të tokës, të bukës.

— S'ke për t'ia dalë mbanë! Kush do të të paguajë për mbledhjet që bën në kryesi e gjetkë?

— Mbledhje bëni edhe ju, po s'u paguan njeri, — i ndërpriste Sutja. — Dëgjoni! Kam vënë re se nganjëherë kam dhënë porosi që nuk kanë qenë të drejta. Tashti që do të punoj si ju, s'do t'i bëj më këto gabime. Veç kësaj, ne kështu fitojmë shumë. Mbi të gjitha: pastrojmë ndër-gjegjen...

Më në fund u ngrit një i ri:

— Ky është qëndrim revolucionar. M'i lumtë Sutes! Unë jam me të.

U ngritën të tjerë e thanë:

— Ti po heq dorë nga shpërblimi, po ne s'të lëmë në baltë. Do të të ndihmojmë! Apo jo, shokë?

Në hangarin ku zhvillohej mbledhja, shpërthyen brohoritjet.

Dhe që nga një prilli brigada punon me normë kolektive, me brigadier e normist Suten, i cili s'merr asnjë shpërblim për punën drejtuese.

Në brigadë ndihet thellë fryma revolucionare. Lindën nisma të reja. Punët i kanë vënë përpara dhe janë më mirë se kurdoherë e se gjithë brigadat e tjera. Anëtarët e saj kanë filluar ta ndiejnë thellë se janë ata zotër të tokës, të bukës. Sutja u thotë shpesh.

– Tashti jemi të tërë brigadierë!

Dhe këta 120 «brigadierë» atë mëngjes të bukur të një prillit iu qepën kodrës më të hyrë të Lapardhasë dhe bënë terraca. Njerëzit që kalonin në rrugën kryesore, qëndronin një copë herë, vinin pëllëmbën në ballë si strehë dhe pyesnin me habi:

– Ç'është kështu?!

– Normë kolektive. Brigadier pa shpërblim...

Dhe shtonin me miratim, duke soditur:

– M'u lumtë të gjithëve!

– M'i lumtë edhe Sutes!

– Ky është qëndrim prej komunisti!

Pati edhe ndonjë llafazan e dembel nga ata që u tremben vështirësive, të cilët varën buzët e dërdëllisën:

– Ç'na gjeti me këtë njeri! Po na merr më qafë! Na la pa shpërblim...

Ndonjë që e ka mëri, lhapu fjalë se Sutja i bën këto për t'u dukur, për të shitur mend. Po Sutja s'është i tillë. As që mund të jetë. Kur ndodh që e lavdërojnë, ai pyet i druajtur: «Po ç'kam bërë unë më shumë se të tjerët? Asgjë s'kam bërë.» – Dhe i vjen turp që e lavdërojnë.

* * *

Sutja është një nga ata njerëzit e shumtë që ne i shohim përditë e ndoshta s'i vëmë re, sepse ata janë të heshtur e pa bujë dhe sepse nuk qëndrojmë gjithnjë pranë tyre. Është një nga ata njerëzit e pararojës që ka kalitur Partia, puna dhe mençuria shekullore e popullit. I tillë është njeriu i thjeshtë i fshatit tonë, të cilin kudo e thërresin shkurt: Sute!

«Drita», 28 maj 1967

NJË LAPIDAR PËR DY SHOKË

Në Devoll është një fshat me emrin Trestenik. Ai e ka kthyer fytyrën nga lind dielli. Dhe është shumë pranë kufirit. E ndan vetëm një përrua me shkurre të dendura, përfund të cilit rrjedh një lumë i vogël. Nga kufiri i huaj fshati duket si në pëllëmbë të dorës, po trestenikasisit punojnë të qetë tokat e tyre të bukura dhe armët i mbajnë të vajisura. Dielli kur lind, lëshon rrezet e para në kulmin e lapidarit që ngrihet në qendër të fshatit para zyrave të kooperativës. Këtë lapidar e kanë ngritur trestenikasisit për dy djemtë e tyre dëshmorë: Syveri Hoxhalliun dhe Ramadan Medollin.

Ishin shokë të ngushtë fëmijërie këta djem të varfër. Kishin lindur në një vit, më 1926. Së bashku bënë tre vjet shkollë fillore, së bashku kullotën bagëtinë, së bashku dolën partizanë në moshë fare të re, dhe së bashku e kanë tani lapidarin në mes të fshatit.

Ishin vite zie, errësire e varfërie të regjimit të Zogut, kur ata të dy, ende të vegjël, punuan hyzmeqarë nëpër dyert e botës. Ishin vite zjarri, baruti e mjerimi të pushtimit fashist, kur ata të dy, megjithëse të këputur nga varfëria, së bashku me anëtarët e tjerë më të rritur të familjes, nuk u gënjen nga lajkat e armiqve dhe nuk pranuan të vishnin këmishën e zezë fashiste për një copë rrogë. Në atë kohë, këta djem ende të rinj, këta djem që s'u kishte dërsur ende mustaqja, rrëmbyen armët e u bashkuan me partizanët e batalionit «Fuat Babani» dhe

më vonë me Brigadën XV. Dhe ecën së bashku nëpër rrugët e vështira partizane, pinë së bashku nga një matare, u mbuluan së bashku me një kapotë, luftuan së bashku në një llogore e në një pritë dhe së bashku e kanë tani lapidarin në mes të Trestenikut.

Po vdekjet i patën të ndryshme. Ramadani u vra në Luftën Nacionalclirimtare. Rrëzë Rajcës, aty ku mbaron fusha e Domosdovës edhe fillon e përpjeta e Qafës së Thanës, buzë xhadesë automobilistike, është vendosur një gur i skalitur. Pikërsht aty u vra Ramadan Medolli. Mbi gur është qdhendur emri i tij. Ai ishte në sulm. Dhe përkrah tij ishte shoku i përhershëm i fëmijërisë. Është e madhe dhimbja, kur të vritet shoku më i ngushtë. Të duket sikur të zhduket gjysma e zemrës. Pikërisht mbi varrin e shokut të tij të dashur, Syveriu zbrazti automatikun dhe u betua se do t'ia merrte hakun, siç dinë ta marrin hakun devollinjhtë.

Brigada XV vazhdoi marshimin luftarak. Midis Librazhdit e Qukësit ajo futi në pritë autokolonën gjermane. Syveriu, partizani i kompanisë I të batalionit I, që kishte lënë shokun e fëmijërisë rrëzë Rajcës, doli i pari me automatik në xhade. Dhe shokët e tij tregojnë se ai luftoi në këmbë, me trimëri të rrallë, vrau ata që s'dorëzoheshin, çarmatosi ata që ngrinin duart. Brigada atë ditë e shkatërroi autokolonën, makinat i mbuloi flaka, gjermanët ranë rob arupe-grupe.

Edhe për një betejë tjetër, në Qafë të Thanës, shokët tregojnë se Syveriu që ishte në pritën pararojë, mbajti në një kohë me skuadrën e vet gjithë peshën e zjarrit dhe nuk i leioi gjermanët të çanin përpara apo t'u merrnin krahët. E mbajti djali nga Devolli betimin që bëri mbi trupin e shokut të vvarë.

Ishin shokë të pandarë dhe ranë në betejë. Ramadani u vra rrëzë Rajcës, Syveriu u vra pesë vjet më vonë, në Trestenikun e tij, në provokacionet e qushtit të vitit 1949, tek ai vendi që i thonë Vakëf, nën fshat, ku kanë ngritur një lapidar të thjeshtë.

Kishte ardhur me leje nga kufiri i rrethit të Shkodrës, ku shërbente si nënoficer, tashmë komunist e djalë i pjekur,

megjithëse s'kishte mbushur të njëzet e tre vjetët. Bënte, pas kaq vjetësh, lejen e tij të zakonshme në gjirin e familjes, në gjirin e fshatit të dashur. Ditën merrej me punë, ndihmonte shokët nëpër ara; natën mblidhej me ta, kujtonin luftën, kujtonin shokët e vrarë, kujtonin Ramadanin.

Por natët e kthjellëta e të ngrohta të atij gushti nuk ishin të qeta. Armiqtë po ngrinin kurthe. Një natë Syveriu vuri veshin e dëgjoji uturima të shurdhra, si rrjedha të nëndheshme, që era i sillte që përtej kufirit. Andej lëvrinin, andej përgatiteshin me siguri, andej po fillonin diçka të kobshme. Syveriu nuk e zinte gjumi. E si mund të flinte ai, luftëtar i regjur, kur kufiri ishte i shqetësuar? U ngrit, u vesh dhe ngjeshi revolverin në këllëf. Armë të tjera s'kishte. Automatikun dhe bombat i kishte në repartin e vet, shumë larg, në Shkodër. Kishte vetëm një revolver e ca plumba rezervë. Doli nga shtëpia dhe hodhi sytë nga kufiri. Zhurmat, në natën e kthjellët e plot yje, dëgjoheshin më të qarta. Ato vinin që përtej lumit të fshatit. Përpara ia pengonin pamjen pemët e ngarkuara me kokrra. Hipi mbi një çakëll, po ai që i ulët e s'mundi të shihte që. Atëherë u kujtua të ngjitej në xhami. Kur u afrua, dëgjoji që e thirrën nga prapa:

— Kush je ti?

— Syveriu. Po ti? Mos je oficeri i zbulimit?

— Unë jam.

— Të njoha nga zëri, — i tha Syveriu dhe u ngjiten të dy në minare.

Që andej diçka dukej. Ata ia ngulën vështrimin natës dhe nëpër errësirë dalluan tek-tuk drita të zbehta, të lëvizshme, që hapeshin e shuheshin menjëherë.

— Me siguri po përgatiten të futen në tokën tonë, — tha Syveriu.

— S'ka asnjë dyshim, — tha oficeri. — Kemi vënë në gatishmëri postën.

— Duhet të lajmërojmë vullnetarët e armatosur, — tha Syveriu duke zbritur nga xhamia.

— Dërgova njerëz për këtë punë. Po forcat i kemi të pakta. Duhet të mbahemi gjersa të vijnë repartet e ushtrisë.

— Trestenikun ata s'do ta shkelin kurrë, — tha Syveriu dhe nxori revolverin nga këllëfi. — Unë po zbres nën fshat. Është një vend i përshtatshëm.

— Atje po të dërgoj një skuadër, — tha oficeri dhe u zhduk në errësirë.

Syveriu bëri tatëpjetë, në drejtim të përroit. Ecte me hapja të shpejtë e të lehtë, duke shtrënguar revolverin në dorë. Përsëriste me vete:

«Ata Trestenikun s'do ta shkelin kurrë! Ata Trestenikun s'do ta shkelin kurrë!»

Arriti te vendi, rregulloi një pozicion me gurë dhe vuri veshin në tokën e ftohtë. Zhurmat dëgjoheshin qartë, zhurmë të thella makinash e armësh të rënda. Ja edhe zhurmat e hapave e të gurëve që rrokulliseshin. Ata po vinin. Prapa e anash tij zuri vend skuadra e rojave të kufirit. Pak më lart, nën shtëpitë e fshatit, zunë pozicione vullnetarët e tjerë.

Kishte kaluar mesi i natës, kur në pjesë të tjera të kufirit, majtas e djathtas Syveriut, filluan shpërthimet e armëve. Një predhë topi vërsëlleu mbi kokën e tij dhe plasi diku brenda në fshat. Predha të tjera filluan të shpërthenin gjithandej. Kërciti edhe një mitraloz.

«Tani do të dalin», — mendoi Syveriu dhe kaloi kot në ballë revolverin e vet.

Katër ushtarë të huaj po vinin drejt tij me hap të shpejtë, gjysmë të kërrusur. Njëri prej tyre mbante në sup një mitraloz. Atë mori në shenjë Syveriu. Kur ushtarët e tjerë qëlluan kot me armë, Syveriu u thirri shokëve të vet:

— Tashti bjeruni, qenave!

Dhe zbraz revolverin. Ushtari me mitraloz u përkul mbrapa, — sikur e tërhoqi pasha e armës së tij të rëndë.

Mitralierit i shkuan në ndihmë dy ushtarë për ta tërhequr, i treti bëri zjarr të dendur me automatik për t'i mbrojtur. Por rojat e kufirit dhe vullnetarët i kishin vënë në shenjë. Një minutë më vonë të katër mbetën të vrarë. Edhe një skuadër tjetër me ushtarë të huaj që u përpoq të sulmonte, u gozhdua në vend. Atëherë u dendësuan qitjet me artileri e me mitraloza të rëndë. Një

predhë ra në një plevicë me kashtë. Kashta mori zjarr e Trosteniku u ndriçua nga flakët. Dy predha hodhën në erë një plevicë tjetër, ahurin dhe hangarin, ku ishte makina shirëse. Plevica dhe ahuri ishin të familjes së Syveriut. Ky i pa flakët që kishin mbuluar shtëpinë e tha:

– Vetëm këta të mos shkelin në Trostenik.

Dhe nuk e shkelën fshatin e Syveriut. Armiqtë u hodhën këtej lumit, mundën të arrinin nën fshat, po atje u gozhduan e s'bën dot asnjë hap përpara. Atje ishte Syveriu.

Qëndroi ai me atë skuadër të rojave të kufirit, gjersa u gdh. Armiqtë ndërmorën edhe një sulm tjetër, kur po binte dielli. Syveriu kishte mbetur vetëm me pak plumba. Tyta e revolverit ishte e nxehtë. Kur rrezet e diellit i ranë drejtpërdrejt në sy, tha me zë:

– Qëndroni, o shokë! Ky është sulmi i fundit që do t'i bëjmë ballë vetë. Vini veshin e dëgjoni. Po na vijnë ndihmat. Po vjen ushtria...

Sulmi që i furishëm nga ana e armiqve. U ndez qielli e toka. Te një kodër, midis shkurreve, ata vendosën një mitraloz. Mitralozi e kishte si në pëllëmbë të dorës atë copëz vend që mbronte Syveriu. Këtë e vuri re një vullnetar pak i kaluar në moshë. Në kohën që krisi mitralozi, ai i thirri nënoficerit që kishte ardhur me leje të zakonshme në fshatin e tij:

– O Syveri, merr hendekun e hajde lart, se je zbuluar. Të mbrojmë ne...

Syveriu e dëgjoi dhe e kuptoi që ishte në rrezik. Po atë çast ai pa dy ushtarë armiq, të cilët, të nxitur nga mitralozi që i mbronte, u hodhën përpara drejt tij. Ishin shumë afër njëri-tjetrit. Pistoleta u zgjat drejt tyre. Dy plumba rrëzuan të vdekur të parin. I dyti u ngjesh për tokë, u bë njësh me të. Po toka ishte e zbuluar. «S'është toka e tij që ta mbulojë e ta mbrojë», – mendoi Syveriu. E dinte që i kishin mbetur edhe katër plumba. Qëlloi edhe dy herë. Si duket, plumbi i dytë e kapi ushtarin, sepse ai u rrokullis, u mundua të ngruhej në gjunjë dhe pastaj ra përmbys. Syveriu dyshoi dhe e qëlloi edhe me një plumb. Ai e dinte mirë që i kishte mbetur vetëm një

plumb. Kishte numëruar sa herë kishte zbrazur dhe e dinte që i kishin mbetur plumbi i fundit.

«Tani do të vijë pararoja e ushtrisë sonë», – tha.

Mitralozi, si duket, e zbuloi dhe iu qep. Gurët u bënë copë para syve të tij. Llogorja u shkatërrua.

Nga çakëlli i thirri përsëri vullnetari i kaluar në moshë, me zë më të ashpër më ngulmues.

– O Syveri, merr hendekun e hajde lart!...

Syveriu u tërhoq zvarrë nën zjarrin e plumbave. Vullnetarët qëlluan në drejtim të mitralozit. Mitralozi heshti për një çast. Syveriu iu afrua hendekut. Edhe pak, edhe dy metra, edhe një metër, edhe gjysmë metri... Po nuk arriti dot...

Mbi atë njeri të armatosur vetëm me një pistoletë e me një plumb u derdhën tërë armët e armikut, pushkët, pistoletat, mitralozat, bombat. Derdhej urrejtja e verbër e provokatorëve që kujtonin se, po ta vrisnin atë, shtegu do të mbetej i hapur e ata do të hynin në fshat.

Po Trestenikun nuk e shkelën. Nuk e shkelën, ashtu si përsëriste Syveriu gjatë betejës. Në atë çast që ai mori plagët e para, u dha pararoja e reparteve ushtarake. Armiqtë e harruan Syveriu. Ata mendonin për kokën e tyre. Lanë tokat tona, zbritën poshtë fshatit, në përrua, në lumë. Atëherë vullnetarët, kufitarët, ushtarët që porsa mbërritën, shkuan te Syveriu. E gjetën pa jetë, me revolverin në dorë, tytë e të cilit, ishte ende e nxehtë. Dhe në gojë kishte vetëm një plumb dhe revolveri ishte pa sigurecë...

Dhe Tresteniku nuk ra në duart e armiqve!

...Ishin dy shokë nga i njëjti fshat i Devollit. Njëri, Ramadani, u vra në luftën partizane për të çliruar Shqipërinë. Tjetri, Syveriu, u vra në fshatin e vet Trestenik, për të mbrojtur Shqipërinë.

I pari ra në Kodoshesh, rrëzë Rajcës, dhe atje ka një gur për kujtimin e tij.

Tjetri ra në fund të fshatit të vet, dhe atje ka një gur për kujtimin e tij.

Dhe të dy së bashku kanë një lapidar të lartë në mes të Trestenikut...

«Zëri i rinisë», 21 mars 1973

«FEJESË PËR MUA NUK KA... JAM NË NDJEKJE...»

Ky ishte mendimi i një djali fare të ri nga Vashtëmia e Korçës. Kur i tha këto fjalë, Qazimi nuk ishte ende tetëmbëdhjetëvjeç. Kishte shkuar me leje në fshatin e vet, që shtrihet sa të hanë sytë para e prapa, majtas e djathtas, tejmbanë ish-kënetës së tmerrshme të Maliqit...

I pëlqenin fëmijët. Kur vinte me leje në Vashtëmi, kohën më të madhe e kalonte me ta. Dilte edhe arave, prashiste misrin e panxharin, djersinte duke punuar nëpër baltën e fushës, vinte nëpër mbledhje e thoshte tjalën e tij të drejtë e të sinqertë për të lënë mënjanë thashethemet, fodullëkun, dembellëkun e për t'iu vënë punëve më gjongël, për t'u bashkuar në kooperativë si mësonte Partia dhe Enveri.

Po i pëlqenin Qazimit fëmijët. Ishte me leje dhe kishte të drejtë ta kalonte kohën ku të dëshironte. Dhe ai rrinte me fëmijët, me katër-,pesë- e dhjetvjeçarët, luante me ta, si të ishte vetë fëmijë, me cingla, luftash, me hajdutë e diversantë.

Ata që e shikonin habiteshin. Habiteshin edhe të afërmit e tij. Habitej vëllai i madh, habitej nëna e tij. Jo nëna e vërtetë, po njerka. Nëna e kishte lënë të vogël fare. S'kishte mbushur një vjeç, kur atë e treti malarja e kënetës dhe Qazimi mbeti jetim. Po njerka u bë nënë. Dhe kjo nënë e dytë, e plakur tani, që s'di t'i

ndajë barqet, që e donte si bijtë e vet, rri në krahun tim, puth fotografinë e Qazimit e mezi thotë:

— E kisha të urtë dhe, gjersa u vra, luante me fëmijët!

Po. Ai i donte shumë fëmijët. Dhe u gjendën njerëz, të cilët, kur e panë të merrej me vocërrakët këmbëzbuthur të Vashtëmisë, thanë me mosbesim: «Qazimi është ende fëmijë.»

Vetëm nënë Neslies, kur ai erdhi për herë të fundit në fshat, e e puthi në faqet me push, iu duk i rritur djali e i tha:

«Tashti duhet të martohesh, o bir!»

Por ai e kundërshtoi.

«Fejesë për mua nuk ka akoma, moj nënë. Kushedi si bëhet puna? Unë jam në ndjekje.»

Ai ishte gjithnjë në ndjekje të kriminelëve, keqbërësve, hajdutëve e diversantëve. Kur e pyetën njëherë shokët me shaka se që kur ishte në ndjekje, Qazimi u përgjigj:

«Që kur e kisha mbiemrin Kupe.»

Familja e tij vërtet e kishte mbiemrin Kupe. Po që kur u shpërngul nga Lavdari i Korçës dhe u vendos në Vashtëmi, aty nga vitet tridhjetë, mori mbiemrin Çami, siç quhej ajo lagje e Vashtëmisë. Edhe ai në dokumentet zyrtare njihet tashti me emrin e mbiemrin Qazim Çami, i datëlindjes 1927, megjithëse ka edhe një mbiemër tjetër, Pone. Po ç'rëndësi kanë këta mbiemra?! Ky shkrim flet për Qazimin që lindi në vitin 1927 dhe jetoi vetëm njëzet vjet!

Ai ishte një partizan i vogël i çlirimit e një ushtar i madh i mbrojtjes. Kur ishte i vogël, s'kishte kohë të mësonte. Jetimi në fshatrat tona, edhe kur binte në duart e buta e të dhimbsura të një gruaje si Neslia, për shumë rrethana të ndërlikuara e të hidhura, nuk mund të fillonte e të vazhdonte shkollën.

Prindërit ishin punëtorë, po të varfër. I ati i tij, mendoi se mund të rregulloheshin po të dërgonin një nip përtej detit, në Australi. Po s'kishin si ta dërgonin, duheshin florinj, duhej navloja. Atëherë me shpresë të zhgënjyer për të gjetur navllon, shitën shtëpi e bagëti e tokë e mbetën në ditë të hallit. Nipi iku e s'u kthye.

S'dihet edhe sot në është gjallë a vdekur. Po dihet mirë një gjë: Familja e Qazimit u kthye e tëra në hyzmeqarë. Hyzmeqar i përbuzur, i neveritur u rrit edhe Qazimi, ky djalë i urtë, pa fjalë, i mbyllur në vetvete, që rrinte e luante veç me fëmijët.

Ka një vend në Vashtëmi, i vetmi vend me shkurre e plepa, andej nga veriu, ku mbarojnë kufijtë e fshatit. Shkonte shpesh Qazimi në atë farë pylli për t'u çlodhur, për të ëndërruar. Porsa kishte mbushur të shtatëmbëdhjetat, kur tek ai pyll ai vendosi t'i linte lopët e botës të kullosnin azat e të merrte malet. I kishte dëgjuar ilegalët që flisnin kundër fashizmit e tradhtarëve. I kishte parë partizanët. I kishte shpërndarë ata nëpër konakët. I kishte dëgjuar krismat e tyre në Zvezdë, në Maliq, në Kolanec dhe vendosi aty, tek ai pyll me plepa, ku vijnë e ulen mbrëmjeve të verës turtujt dhe ku fshihen dimrit lepujt, që të merrte malet e të bashkohej me partizanët.

Ishte shkurti i vitit 1944, kur ai, duke çarë borën, liucën e baltën e fushës, shkoi te partizanët. Ishte pikërisht nata e dy shkurtit, kur ai, fare i ri, shtatëmbëdhjetëvjeçar, arriti Brigadën tonë IV në malet e Gorës.

Dhe sa mbërriti në brigadë, u pagëzua me luftë. E mbaj mend edhe sot që ka kaluar çerëku i shekullit. Ishte një djalosh i imët, me buzë të holla tërë vullnet, me flokë të lëpirë e me ca vetulla të ulura shumë mbi sy, që i jepnin fytyrës rinore e të vuajtur një rreptësi, një pakënaqësi dhe bile një egërsi të jashtme. Kur u nisëm për të shkatërruar pozitat e gjermanëve e të Ballit në Lozhan, ai djalë i vogël, i turpshëm e i heshtur u hodh nga të parët në sulm...

E pashë nga larg në Zvezdë, kur u mbulua me gurë nga shpërthimi i predhave.

Pastaj më humbi nga sytë disa muaj dhe m'u shfaq përsëri në Picar të Kolonjës. Kishte mbetur i rrethuar e i shkëputur nga vërshimi i Operacionit të Qershorit për pesëmbëdhjetë ditë. Ishte bërë më i vogël sesa ishte në të vërtetë.

Atëherë mendova të shkruaja një vjershë, vjershën me titull:

O i vogël, o i madh, o partizan.

Pastaj në sulmet drejt Veriut më humbi përsëri. Dhe përsëri pas disa muajsh, kur luftonim për çlirimin e Tiranës, e pashë në Kashar. Kishte dalë për mrekulli nga një pritë gjermane. Kishte dalë duke luftuar së bashku me shokun e tij. Shokut i qe bërë kapota vrima-vrima nga plumbat. Edhe majën e kapelës, përmbi yll, e kishte të shpuar, kurse Qazimi ishte plagosur.

Ai shkoi në spital e ne çliruam Tiranën. Qazimin nuk e pashë më. Nuk e dija që pas Çlirimit atë e zgjodhën si djalë të mirë për repartet e ndjekjes.

Qazimi punonte në burgun e Elbasanit. Në burg ishin futur tërë fashistët, tradhtarët, kriminelët dhe horrat e rrethit. Po ata e kishin bërë për vete gardianin e natës. Qazimi, që kishte nuhatur diçka, ecte atë natë përmes korridorit të ngushtë. Dhe papritur një tullë e rëndë e goditi në kokë.

— Ndihmë! Mos i lejoni kriminelët të dalin! — thirri ai dhe i ra të fikët. Dhe burgu u mbyll e asnjë kriminel nuk doli.

Po në atë kohë ai u caktua të ndiqte kriminelët e tjerë që kishin mbetur maleve e të tjerë që vinin përtej kufijve. Diktuan Hamit Matjanin, njërin nga kriminelët më të rrezikshëm. Ishte fundi i marsit, fundi i muajit me shira e me mjegulla. Përmes mjegullave që mbulonin lehtë kodrat e Cërrikut e të Paprit, atë ditë të hënë të marsit. Qazimi dalloj diversantët. Shefi i tij urdhëroi që shokët të fillonin zjarrin e të hidheshin në sulm. Dhe u hodhën të tërë në sulm. Midis tyre ishte një djalë që porsa kishte mbushur të njëzetat. E ky djalë ishte nga Fusha e Korçës, nga Vashtëmia, dhe emrin e kishte Qazim Çami, a Qazim Kupe, a Qazim Pone...

Po ç'rëndësi ka mbiemri i një djali njëzetvjeçar?! Të gjithë filluan betejën. Ra shoku i tij, Koço Brisku, ra një tjetër shok i tij, edhe një tjetër... Qazimi nuk e mori vesh sa shokë u vranë. Ai e dinte se para tij ishte një kapo-bandë, një njeri i egër që s'kapej dot, një kriminel, i pashoq që urrente Shqipërinë, i quajtur Hamit Matjani.

Dhe u hodh Qazimi drejt urës, drejt vdekjes, drejt fitores...

Dhe atë pasdite të së hënës së marsit, në një anë të urës gjetën atë, Qazimin tonë të ri, të shpuar nga plumbat...

Dy ditë më vonë, ditën e mërkurë, Qazimin e sollën në Vashtëmi. Kishte dalë ta priste tërë fshati. Në krye e rreth varrit të hapur ishin fëmijët. Ata i hodhën të parët grushtin me dhé. Ata ia mbuluan varrin me lule. Dhe pranë varrit rrinte nënë Neslia, njerka që e donte si nënë.

Dhe kjo njerka e dhembtur, akoma edhe sot përsërit fjalët e Qazimit që tingëllojnë si një amanet:
«Fejesë për mua nuk ka... Jam në ndjekje...»

«Drita», 18 mars 1973

NJË VULLNETAR DEVOLLI

Ishin katër vëllezër në fshatin Vërlen të Devollit. Ishin katër djemtë e Xhaferit këta, djemtë e Xhaferit që vuante për kafshatën e gojës. Të katër u lidhën me Partinë, të katër luftuan edhe pas Çlirimit, duke ndjekur keqbërësit, kriminelët dhe diversantët. Po ky shkrim do të bëjë fjalë vetëm për njërin vëlla, për Njaziun, që u vra në përpjekje me diversantët, më 2 korrik të vitit 1951.

Siç tregon ish-përgjegjësi i grupit të bashkëpunimit vullnetar të Vërlenit, Njaziu ishte një devolli, si tërë devollinjtë, trim e këngëtar e me ca duar të mëdha si putrat e ariut, që i thanin për punë e për pushkë. Në kohën e luftës, ende fare i ri, ishte korrier i shtabeve partizane, bënte pjesë në njësitin guerril të Vërlenit, ndante trakte, priste e përcillte partizanë e ilegalë dhe ruante tërë lëvizjet që bënin armiqtë atyre anëve. Kur kapitulloi Italia, ai shkoi në Biliisht dhe i vuri përpara italianët. Kur gjermanët dogjën spitalin e Bradvicës, ai, së bashku me shokët, shkoi në ndihmë të partizanëve. Ku kërciste lufta, ku kërkohet e ku s'kërkohej ndihma e njësiteve, Njaziu rrëmbente pushkën dhe me shpejtësinë e erës shkonte nëpër prita, ku linin kokën armiqtë e tradhtarët.

Dhe vazhdoi të rrinte nëpër prita edhe pas Çlirimit, me ditë e me net e me javë, se diversantët ishin të egër, dinakë e të pabesë, jo më pak se fashistët e nazistët. Dhe vazhdoi shumë herë të ndeshej me ta fytyfyt, të ndiente

rrezikun e vdekjes dhe gëzimet e fitores. Për një kohë qëndroi në sektorin e Vloçishtit të fermës së Maliqit, me detyrën e ruajtësit të objekteve ekonomike. Por toka e ashpër, brigjet dhe pyjet e dendura të Vërlenit të tij e tërhiqnin vazhdimisht. Kishte marrë vesh se në ato toka, në ato brigje e pyje, bridhte një bandë e rrezikshme me një kapobandë edhe më të rrezikshme. Shumë kurthe i ishin ngritur atij kriminelit, por ai ishte dinak si dhelpra dhe u shpëtonte kurtheve. Kishte lidhje të fshehta me fa-refisin e tij dhe u bënte bisht rrethimeve. Ishte vërtet shumë i rrezikshëm. Kishte vrarë një polic, kishte vrarë një oficer dhe kishte bërë një krim të tmerrshëm e të përbindshëm: i kishte prerë kokën ndaj të gdhirë një sekretari të këshillit të fshatit.

Njaziu la Vloçishtin dhe shkoi në Vërlen, në fshatin e tij, për të gjetur, së bashku me shokët, gjurmët e kriminelit të përbindshëm.

Dhe më në fund ranë në këto gjurmë. U zunë prita rreth fshatit nga Hoçishti, nga Grapshi e Bardhi. Përgjegjësi i grupit të bashkëpunimit vullnetar lajmëroi anëtarët e grupit. Njaziu ishte në shtëpi, çmallej me nënën që porsa i kishte ardhur nga Korça për të ndihmuar nusen shtatzënë. E shoqja ishte në të nëntin dhe pritej të lindte dita ditës. Po Njaziu, me t'u lajmëruar, rrëmbeu armët dhe shkoi në pritë. Bënë katër prita në katër drejtime, duke i mbyllur mirë shtigjet e fshatit nga mund të vinin diversantët. Pritën nga ora tetë e mbrëmjes e gjersa u gdhi, pa këmbyer një fjalë, pa u kollitur, pa ndezur një duhan, tërë sy e veshë, me armët gati në duar. Po diversantët nuk erdhën.

— Do të vijnë, — tha Njaziu natën e dytë. — Hapni sytë mos ju zërë gjumi e ju kalojnë!

— Do të vijnë, — tha natën e tretë.

— Do të vijnë, — tha natën e katërt.

— Do të vijnë, — tha edhe natën e gjashtëmbëdhjetë.

Gjashtëmbëdhjetë net ata qëndruan nëpër prita. Gjashtëmbëdhjetë net nuk fjetën, nuk thanë një fjalë, nuk pinë një cigare duhan. Njaziu ngulte sytë në natën e kthjellët të beharit, dëgjonte bulkthit e qenët që lehnin

dhe nuk mendonte se gruaja e tij, atje në shtëpi, ishte gati më të lindur.

«U bënë gjashtëmbëdhjetë net, — mendoi, — si nuk erdhën një herë ta përpiqim? Mos na ka tradhtuar njeri?!»

Dhe i shkoi mendja te vjehri i kapobandës, që ishte një kulak i Vërrenit. Atë kulak e gjurmonin shokët dita ditës. Po ç'kishte dashur kulaku atë ditë në zyrat e kryesisë së kooperativës? Kishte shkruar atje që në mëngjes dhe kishte kërkuar që ta caktonin në punë, kur djemtë brenda bisedonin për pritrat që do të z'nin. Njaziut i hyri dyshimi. Mendoi i mërzhitur e i zemëruar:

«Me siguri, ai i ka nuhatur pritrat tonal!»

Po s'pati kohë të mendonte më gjatë. «Bulkthi që këndonte diku pranë tij e ndërpreu këngën menjëherë, sikur e shtypi njeri me këmbë. U dëgjua një fëshfërimë e lehtë gjethi, dhe, në kohën që Njaziu u dha shenjë shokëve të pritës, u zbraz një automatik dhe një pushkë. Shtinë flakë më flakë automatiku e pushka. Nëpër errësirë feksën flakët e armëve dhe u dukën siluetat e pesë diversantëve, larg njëri-tjetrit. Vraponin gjysmë të përkulur, bëheshin nganjëherë njësh me tokën dhe zhdukeshin nëpër pyll...

Me të dëgjuar automatikun, e mora vesh që ishin diversantët, — më tregon ish-përgjegjësi tani që kanë kaluar njëzet e një vjet nga ajo natë. — Ne kishim vetëm pushkë. U vunë në alarm edhe tri pritrat e tjera. I qëlluam. I ndoqëm. Ata ikën të shpartalluar. Të nesërmen fëmijët që kullosnin bagëtinë në pyll, gjetën një çantë. E kishin hedhur ata. Pas ca ditësh, njëri prej tyre e la lëkurën në Pilur. Më vonë u vra edhe kapobanda, krimineli me damkë. — Po atë natë u vra Njaziu, — vazhdon plaku. — Na u vra në pritë atje te kumbulla e te çakëlli, — dhe bëri me dorë në dritare si për të treguar pritën. Pas pak shtoi: — Unë nuk e mora vesh menjëherë. Kujtova se ai do të kishte shkruar në shtëpi. Kur vajta atje, e shoqja porsa kishte lindur djalë. E ëma qe gëzuar.

— A erdhi Njaziu? — e pyeta.

Ajo s'm'u përgjigj. Vuri fëmijën në djep e më pyeti:

- Ç'qenë ato armë?
- U përpoqëm me diversantët, - i thashë.
Ajo parandjeu diçka, se vuri dorën në zemër.
- Po të jetë vrrarë, - tha, - të birit që lindi sonte,
do t'ia vëmë emrin Njazi.
Dhe ashtu ia vunë, Njazi.

«Drita», 18 mars 1973

LARTËSITË

Disa vjet më parë, kur e shikoje fushën e Bradasheshit nga Kërraba, syri nuk të ndalej asgjëkund. Një mjegull e hollë dhe e hirtë shtrihej tërë drithma e fërgëllime gjer përtej horizonteve dhe nuk pipëtinte asgjë. Kërraba, me kreshtat e saj shumë të pjerrëta e të larta, dukej si një gjigant. Kurse tani ka ndodhur një mrekulli. Sigurisht, këtu ka pjesën e vet edhe zhgënjimi i të parit. Po ky është realitet: Kërraba është zvogëluar, ka humbur lartësinë. Kombinati metalurgjik, me madhësinë e tij, me dritat e hijet që luhaten ditë e natë, sikur e ka eklipsuar malin, e ka bërë të duket përmes korpuseve gjigante metalike, si një bregore... Kërraba është ulur! Bradasheshi është lartësuar! Dhe ky nuk është një krahasim për të zbukuruar gjuhën.

Këtu çdo gjë është shndërruar, çdo gjë është në lëvizje të përherëshme, në gjallëri: njerëzit, makinat, toka, nëntoka, ajri e qielli i çarë e i përflakur nga peizazhi metalik. Do të kalojnë edhe disa vjet, çdo gjë do të marrë formën e vet përfundimtare, ëndrra do të bëhet realitet: do të prodhohet çeliku shqiptar nga shkrirësit shqiptarë! Kjo e ardhme është kaq pranë, sa mund ta prekësh me dorë. Atëherë gjithë madhështia e këtyre ditëve do t'i përkasë së djeshmes heroike.

Toka e Bradasheshit shkëlqen këtë mëngjes pranvere, jo nga vesa, po nga numri i pafund i objekteve, si shkëlqejnë në të katër anët e atdheut mrekullitë që kanë krijuar bijtë e bijat e Shqipërisë. Këto janë bukuritë socialiste që lulëzojnë në horizontin tonë të kthjellët. Këto janë ëndrrat më të guximshme, të cilave u dha krahë Partia...

Që në mëngjes herët Elbasani gumëzhin nga urbanët që shpiten punëtorët në kantieret e ndryshme të metalurgjikut. Edhe treni i ngarkuar me punëtorë e përshëndet këtë mëngjes me fishkëllimat gazmore. Qindra e qindra punëtorë, në grupe e në vargane gjarpëruese, me hap të lehtë e me pamje fisnike, shpejtojnë drejt objekteve. Ndërtuesit e montatorët punojnë me ngulm, në mënyrë që aty para mbarimit të vitit të përfundojnë linjën e gizës, fazën e parë të Kombinatit. Ata kanë ardhur pothuaj nga të gjitha anët e Shqipërisë: nga Tirana e Durrësi, nga Korça e Dibra, nga Fieri e Gjirokastra, nga Berati, Lushnja e Laçi. Ka heronj që kanë punuar në shumë vepra. Këta janë veteranët e njohur dhe fotografatë e tyre të zmadhuara zbukurojnë stendat. Ka shumë të tjerë, emrat e të cilëve nuk njihen nga opinioni i gjerë e që këtu, në Komitetin e Partisë e në Drejtorinë e Kombinatit i quajmë thjesht: «heronj të heshtur». Ka gjithashtu qindra e qindra të tjerë, të rinj e të reja, që gërshetojnë mësimin me praktikën. Këta, moshë mesatare e të cilëve nuk i kapërcen të njëzet vjetët, do të marrin në dorëzim metalurgjikun. Janë shkriërsit, derdhësit, teknologët, formuesit, kompresoristët, ventilatoristët, ajërngruhtësit, komanduesit e furnaltës, kipistët, vinçierët... Ata përgatitën kryesisht në metalurgjik, po edhe në shkollat e Elbasanit e në uzinat e Tiranës. I shoh tek ecin me atë hapin e lehtë. Fytyrat e tyre të reja e pa asnjë rrudhë shprehin vulinet, vendosmëri e siguri. Megjithatë, ndihet në to njëfarë shqetësimi. Po afron afati që ata të marrin në dorëzim repartet e fazës së parë. Kanë mbetur vetëm gjashtë muaj. Pastaj... pastaj janë ata që do të shkrijnë gizën, janë ata që do të përgjigjen. A do t'ia dalin mbanë?! Dhe janë aty të rinj! Ky nuk është mosbesim. Ky është shqetësim

i përkohshëm ndaj provës së parë. Tregojnë se sa mosbesim ka shprehur një specialist nga vendet perëndimore, kur ndërtohej një nga veprat e mëdha të pesëvjeçarit të katërt. Ai mendonte me skepticizëm se kolektivi i ri njëzetvjeçar që do të merrte në dorëzim veprën, nuk do të ishte kurrësi në gjendje ta drejtonte e ta shfrytëzonte, sepse një gjë e tillë nuk kishte ndodhur në asnjë vend të botës. Por u gabua rëndë skeptiku i huaj. Vetëm kur i pa vajzat e djemtë njëzetvjeçarë të nxirrnin prodhimin e parë, u mahnit. Sigurisht që u pendua për mosbesimin. Po çfarë nuk bën bindja në forcat e veta, vullneti për të mësuar, zgjuarsia e vendosmëria e pashembullt e rinisë sonë! Çfarë nuk bën bindja dhe besnikëria e saj në vijën e drejtë e largpamëse të Partisë dhe në mësimet dritëdhënëse të shokut Enver?! Është kjo vijë, janë këto mësimë që frymëzojnë kolektivin e madh për heroizëm, që ia kalisin mendjen e shpirtin, që e bëjnë zot të vetes e të kombinatit metalurgjik.

Të gjithë këta së bashku, që janë ngritur herët këtë mëngjes pranvere e shpejtojnë të arrijnë sa më parë postet e punës e shkollat, janë ngadhënjimtarët e kohës sonë heroike!

Një nga urbanët është mbushur me fëmijë të një shkollë ushtrimore dhe merr rrugën për në kombinat. Duket sikur është plot me zogj. Janë të gëzuar e të bukur si kjo pranverë industriale dhe nga dritaret e autobusit përhapet valë-valë kënga e tyre kumbuese:

...Se montator e kam unë babanë...
...Kantier më kantier...!

Era e lehtë që zbret nga Kërraba i shtyn tingujt në drejtim të metalurgjikut. Mbi korpusin metalik të repartit

të çelikut nga maja më e lartë e tij, aty ku rreh palët flamuri, një saldator duket sikur i përshëndet fëmijët me tufa shkëndijash. Ç'ëndërrojnë vallë qytetarët e vegjël të Republikës në këtë mëngjes të ri duke parë atje lart shkëndijat e zjarra ngjyrë vjollcë?! Në ç'brigje e lartësi të reja i shpie fantazia e kaltër fëmijërore?! Me siguri, ata prekin me duart ende të vogla të ardhmen e ndritur... Kënga në autobus është shumë e fuqishme. Mezi ua dëgjoj fjalët fëmijëve që kam pranë.

– Saldator! – i përgjigjet Qazimi i vogël pyetjes sime dhe sytë i nxjerrin shkëndija si të saldatriçeve.

– Shkrirës! – thotë Vasili.

– Kipiste! – thotë një vajzë me gërsheta.

– E ç'do të thotë, kipiste? – e pyes.

Unë habitem me shpjegimin e përpiktë që i bën ajo fjalës së re. Motra e saj e madhe përgatitet për t'u bërë e tillë.

Flasin për mjeshtëritë që do të ushtrojnë kur të rriten. Ka qenë një kohë, kur shpesh i drejtonin fëmijët, me gojë e me shkrime, drejt mjeshtërive «të zgjedhura». I pyeste «ç'do të bëheni kur të rriteni?» e të përgjigjeshin «doktor», «artist», «inxhinier», «profesor»... Ka pasur edhe mjaft vjersha të tilla. I edukonim në mënyrë të njëanshme. Por koha ka bërë të sajën. Tani sytë e këtyre nxënësve të vegjël shohin edhe nga mjeshtëritë e tjera, që janë edhe ato «të zgjedhura» dhe përsëri i rrëmben kënga:

...Se montator e kam unë babanë...

...Kantier më kantier...!

Ora është nëntë e mëngjesit dhe dielli djeg e verbon. Nën këtë diell të nxehtë, mbi kapriatat shumë të larta të uzinës së çelikut, punon brigada e konstruksioneve të larta. Këtu ka nga ata «heronjtë e heshtur», për të cilët na folën me krenari në Komitetin e Partisë të Kombinatis. Të njëmbëdhjetë anëtarët e saj janë atje lart. Me një vinç të kalibrit të madh ngrenë konstruksione të rënda dhe i saldojnë. Saldojnë që të gjithë njëherësh. Kupa e kal-

tër e qiellit mbushet me shkëndija. Ato derdhen valë-valë si çërka të shkëlqyera. Shokët e Kinostudios që xhirojnë poshtë, dhe ne, një grup shkrimtarësh e piktorësh, entuziazmohemi nga pamja magjepsëse. Regjisoria u thotë diçka punëtorëve me zë të lartë. Po ata s'e dëgjojnë. I ka përpirë puna. Ajo ngre zërin në kupë të qiellit, po zëri i saj nuk arrin dot gjer atje lart, shumë lart, në kulmin e uzinës, ku saldojnë punëtorët të kapërthyer nëpër hekura. Atëherë ajo detyrohet të ngjitet vetë... T'i përgëzojë. Në traversën më të lartë, aty ku është vendosur flamuri, shkon e vjen me hap të sigurt brigadieri, duke mbajtur drejt trupin e shkurtër e të ngjeshur. Të njëjtën gjë bën edhe një punëtor tjetër. Ky e ka lidhur litarin për mesi dhe shkon e vjen nëpër kapriatat e hekurta që duken si rrjetë peshkatarësh, ulet e ngjitet e i kapërcen si ndonjë ketër. Nganjëherë vrapon mbi ato me hap të sigurt, sikur është në ndonjë pistë vrapimi. Të gjithë janë të zhdërvjellët, të lehtë e të shpejtë. Këtu lindin frymëzime të mahnitshme që nuk mund t'i arrijë kurrë as fantazia më e zhdërvjellët. Çfarë poeme! Çfarë simfonie mund të dilte me temën: «Lartësitë»!

Nga toka, kombinati, megjithëse tanimë ka marrë formë, të duket si një labirint. Po kur je në një nga këto lartësi, si kjo ku punon brigada e «heronjve të heshtur», atëherë e sheh qartë krejt formën e tij të mahnitshme. Kryq e tërthor shtrihen rrugët e gjera, mbi të cilat janë vendosur nga aksionistët e rinj kilometrat e parë të hekurudhës së gjatë prej disa kilometrash. Nga korpuset e shumta ngrihet një zhurmë e fortë dhe e pandërprerë që e përpjnjë lartësinë. Heshtja ndehet vetëm në kreshtat e Kërrabës. Duket sikur gjelbërimi i përjetshëm i ullishtave i përpjin të gjithë tingujt e mprehtë metalikë. Diku nxin furnnalta. Diku, si sy të lagur ngjyrë smeraldi, shndri-sin rezervuarët. Diku lodrojnë avujt dhe gjithçka të gëzon syrin. Nga këto lartësi, uzinat, kantieret, korpuset, tubat e çeliktë, makineritë ende të ambalazuara në arka të mëdha që presin radhën për t'u montuar, çdo gjë rreth e rrotull, në mijëra e mijëra metra me një mori ngjyrash, duket si një mozaik vigan e i përkryer. Këtë

mozaik të harmonishëm që shtrihet sa të ha syri në fushën e Bradasheshit, e kanë bërë me mendje të ndritur, me djersën e ballit, me nerva e muskuj të tendosur, sipas një plani të përpiktë, me vullnet të paepur njerëzit tanë, punëtorët tanë, teknikët dhe inxhinierët tanë! Të duket sikur gjithçka, fusha e dikurshme, Zaranika, Shkumbini, Kërraba, ullishtat shekullore, kanë rënë krejt nën sundimin e këtij vigani të ri. Dhe ata që e kanë bërë këtë mrekulli kanë të drejtë të krenohen me lartësinë e fushës së Bradasheshit!

Kjo është nga brigadat pararojë të metalurgjikut, Brigadier i saj s'i ka mbushur ende të dyzetat. Është nga Dukagjini. E ka filluar punën në ndërtim që në moshën 16-vjeçare, atëherë kur në krahinën e tij vinin ende rrotull bandat e diversantëve e të kriminelëve të luftës dhe kur Dukagjini as ishte kolektivizuar e as ishte elektrifikuar, po bënte luftë e punë të rëndë për të shfarosur diversantët e për të dalë nga varfëria shekullore. Dhe filloi Zakja të bridhte kantier më kantier. Dhe ashtu si rriteshin shkallë-shkallë lartësitë e ndërtimeve, ashtu u rrit edhe ai shpirtërisht. E filloi punën hidrocentraleve, në Shkopet, në «Karl Marks», në Bistricë. U rrit me hidrocentrale. Nuk i trembej punës së vështirë e të përditshme. Puna kishte gjetur të zotin. Ai gëzohej kur nga mëngjesi e gjer në mbrëmje ngrinte, po me këtë brigadë, shtyllat e tensionit të lartë 17-tonëshe e 50-tonëshe. U rrit ai dhe shokët e brigadës së bashku me këto dy shtylla. Po t'i mbledhësh të gjitha ato që ka ngritur brigada, bëhet një pyll i vërtetë prej hekuri. I ngritën ato nga Laçi në Shkodër, nga Elbasani në Korçë e gjer në Drenovë, ku ai u njoh me një montatore të re, Nadirenë, vajzë nga Lezhani i Gorës. Zemrat e punëtorëve kuptohen kurdoherë lehtë midis tyre dhe janë kurdoherë plot me

dashuri të heshtur për shoku-shokun. Ata u martuan dhe nga kjo dashuri montatorësh lindën fëmijë. Dhe ndërsa fëmijët rriteshin e rriten në Laçin industrial, ata të dy me shokët e brigadës ngritën të tjera shtylla të tensionit të lartë në veri të atdheut, nga Rubiku në Fushë-Arrëz, nga Fushë-Arrëzi në Fierzë, nga Fierza në Kukës, nga Vau i Dejës në Elbasan, nga Shkodra në Velipojë... dhe më një shkurt të këtij viti iu përgjigjën thirrjes së Partisë dhe erdhën në kombinatin metalurgjik të njëmbëdhjetë.

Ja shtrëngoju dorën brigadier Zakes dhe mendja më vete te tregimi i Anastas Kondos: «Njeriu që propozoj për hero». 22 vjet i ka rënë Shqipërisë rreth e rrotull nga Jugu në Veri e nga Lindja në Perëndim, duke mbjellë grykave, shkrepave e majë maleve pyllin e shtyllave elektrike që shpunë kudo dritën e Partisë! 22 vjet! A nuk është edhe ky brigadier një hero i kohës sonë me zemër të madhe e të pastër?! Ai është një nga ata mijëra «heronj të heshtur» që kalit Partia.

Njëherë, tregon brigadieri, kur montonin shtyllat në Korçë, temperatura u ul papritur. Bëri cikmë. U këput kavoja. Ai ra nga lart dhe pati thyerje në trup... E shtrinë shokët në tokën e ngrirë, ashtu siç shtrinin partizanët e plagosur në tokën e shkelur nga armiqtë. Një muajt e gjysmë qëndroi në spital... Pastaj përsëri majë shtyllave, majë më majë, gjithnjë drejt lartësive...

— Kur erdhëm në metalurgjik, nuk e dinim mirë ç'punë do të bënim këtu, — vazhdon të tregojë ai, i rrethuar nga shokët e brigadës dhe nga ne. — Na pyetën: «Ku keni punuar?» «Në shtyllat e tensionit të lartë», u përgjigjëm.

Ai që na pyeti, ishte njeri me përvojë, k'shte kohë që punonte në metalurgjik, prandaj mblodhi supet e na tha: «S'e bëni dot!»

Megjithatë, ne iu vumë punës. Ja morëm dorën shpejt. Ishim mësuar me lartësitë dhe puna na u duk grurë në krahasim me punët e mëparshme. Vendosi më të mirë bëjmë asnjë mungesë dhe s'kemi bërë asnjë. Vendosi më të shfrytëzojmë 480-minutëshin dhe e shfrytëzojmë si duhet. Prandaj në këta tre muajt transportuam e mon-

tuam dyqind tonë konstruksione metalike... dhe mbajmë atje lart flamurin e garave!

Zakja është shumë i gëzuar këtë mëngjes. Fytyrën zeshkane me vetulla të trasha e ka të çiltër dhe shpirtin të lehtë. Në sytë e zinj e të shkëlqyer ninëzat duken si vatra prushi. Këtë pamje të bukur e fisnike ta jep vetëm puna e ndershme.

Djemtë e mirë e të thjeshtë të brigadës kanë një shprehje krenare në të ecur, në gjeste, në të folur. Edhe këtë krenari ta jep vetëm puna e ndershme për të mirën e popullit e të socializmit. Janë të gjithë nga Veriu, veç së shoqes së brigadierit. Njëri është nga Treshi i Lezhës. Për të brigadieri thotë thjesht: «Është specialist i mirë!». Tjetri është nga Golloborda, martuar edhe ai me një vajzë nga Maliqi i Korçës, kur shtegtonte si montator pas shtyllave të larta. Edhe për të brigadieri thotë thjesht diçka të mirë, ndërsa ai vetë na tregon me mall për të birin dyvjeçar, sepse kishte kohë që s'kishte qenë në Laç, në familje. Përgatitej të shkonte atë të shtunë.

Më i riu, ai që vraponte nganjëherë majë kapriatave, pa u lidhur me litar (kjo s'duhet lejuar) është dibran, nga Kalaja e Dodës.

Ka dy muaj që s'ka qenë në familje. Do të shkojë në gusht dhe na fton edhe ne.

— E pse në gusht? — e pyesim.

— Do të marthem, — thotë me një shprehje gëzimi në buzë.

Aty janë edhe tri vajza të reja, dy nga Cërriku e një nga Elbasani. Vazhdojnë shkollën profesionale dhe punojnë në këtë brigadë për t'u bërë saldatore. Edhe nga puna e tyre brigadieri është i kënaqur. Edhe për to thotë diçka ku nuk mungon fjala e thjeshtë dhe e bukur «mirë».

Brigada lë punën për të shkuar në mensë. Po për një kohë të gjatë, si një familje, vazhdon bisedën në hijen që lëshon korpusi i lartë metalik. Pastaj dikush bën një shaka dhe papritur dëgjohet fort e qeshura e montatorëve me një kumbim shumë të qartë.

Dikush më jep gazetën «Shkumbini», ku faqja e katërt

është mbushur me krijime të letrarëve metalurgë. Një poet i ri ia ka kushtuar vjershën montatorit nga malësia që erdhi me një çifteli e që në sy kishte këngë dhe që me tingujt e tyre solli në metalurgji borën e maleve, aromën e bjeshkëve, buzëqeshjen e alpeve, ngrohtësinë e tokës, freskinë e jetës dhe ëndrrën e të rënëve. Kjo vjershë sikur është shkruar pikërisht për Zaken dhe brigadën e tij të konstruksioneve të larta. Po duhet shtuar se ata sollën këto jo vetëm me këmbë, po në radhë të parë me punën e ndershme komuniste.

Më venë sytë te vargjet e bukura të një poeti metalurg. Mendoj se ato janë shumë të përshtatshme për të mbyllur këtë përshkrim:

*Metalurgji!
Në pyetshin fëmijët
Si e hodhe kaq shpejt shtatin?
U thuaj:*

*«Baballarët tuaj
Kështu e hidhnin hapin!»*

«Nëntori» nr. 7, 1975

VAZHDIMËSI BREZASH

Kushdo që kalon në këto anë, pasi kapërcen Burrelin e Plan-Bardhin, me të dalë te Qafa e Buallit, do të ndiejë emocione të thella dhe, përmes parafytyrimit të gjallë, do të kujtojë luftërat që janë zhvilluar në këtë fushë midis malesh të rrepta, me emrin legjendar Vajkal. Do të parafytyrojë Skënderbeun dhe heronjtë e tij që mundën osmanllinjtë dhe gjunjëzuan me turp tradhtinë, malësorët që u përleshën fytafyt me të huajt e bejlerët, kasollet e grunajat e djegura, gratë trime që «ormisnin» luftëtarët, partizanët që asgjësuan pushtuesit e rinj dhe trimat që ranë e që s'harrohen kurrë. Tani në këtë fushë betejash legjendare me emrin Vajkal jetojnë e punojnë njerëz të lirë e të lumtur. Të rinjtë e Fushë-Çidhnës u hodhën të parët për hapjen e kanalit të gjatë ujitës të Setës. U bashkuan me ta ata të Zall-Dardhës e të Muhurit për të futur nën ujë edhe 300 hektarë tokë. Tetë mijë e pesëqind fshatarë, nxënës, minatorë, arsimtarë, ushtarakë nga Bulqiza e Shupëza, nga Zërqani, Maqellara e Peshkopia iu qepën Vajkalit, pak kohë më parë filluan bonifikimin e tij, do ta drenazhojnë përfundimisht me tuba qeramike dhe të 120 hektarët do t'i qëndisin si xhubletë.

Ecën nëpër këtë rrugë të asfaltuar dhe, duke hyrë në qytezën e minatorëve të Bulqizës, zemra të dridhet nga emocionet e bukura. Sipas një arsimtari patriot gati 90-vjeçar, që ka bredhur me libra e fletore nën shtetull pothuaj tërë vendin, Bulqiza ka qenë më e prapambetura në tërë

Shqipërinë. Aty, me sa duket, Korabi ka zbratur në shekuj erërat e tij të ftohta. Aty mjerimi e skamja kishin shtratin e vet. Tani rreth gjysma e banorëve të moshave të ndryshme ndjekin shkollat e ditës e të natës. Partia tokën e nëntokën që tiranët e pangopur ua shitën varfërisë dhe të huajve, ua shkëputi nga duart grykësve, u hapi një hendek të pakapërcyeshëm mjerimit, ligatinave, erërave e vdekjes. Kjo ishte një luftë e madhe, me sakrifica të mëdha, me lumenj djerse e gjaku. Kështu lindi Bulqiza, qyteza e minatorëve si një lule midis luleve të shumta të vendit tonë dikur të varfër e të shkatërruar. Kështu lindën dhe u rritën brezat e minatorëve që nga Baftjari e gjer te Kaloshi. Kështu gjithçka u bë jona, fusha e Vajkalit, kooperativat, galeritë e minierës, qielli, toka dhe kromi që nxjerrim nga thellësitë e pasura të nëntokës sonë. Prandaj, kur vjen këtej, edhe në Vajkalin legjendar, edhe në atë shkëmb të bardhë me majën mbulluar me pisha, edhe në një fije bari, edhe në kopenë e re me dhi të Shabanit, bariut 18-vjeçar që shkon delegat në Kongresin e 7-të të Rinisë, edhe në sytë e asaj Fatmirës të klasës së 8-të që vjen të këshillohet me mësuesen e re për një problem artimetike, kudo gjen lirinë dhe jetën e vërtetë. Liria dhe lumturia i ka rrënjët në zemrat e të gjithë bulqizakëve. Këtu ai qali i Skënderbeut që i dha emrin vendit Vajkal ecën e ecën revan e pa u ndalur drejt jetës, drejt agimeve të reja më të lumtura: Bulqizakët mbrojnë me punë e djersë nderin e shqiptarit. Të gjithë, burra e gra, minatorë e kooperativistë, nxënës e mësuese të reja që kanë ardhur nga Tirana për të bërë stazhin, gra të forta me zemër, të rinj e të moshuar të gjithë brezat, pasurojnë livadhet e kromin, i mbajnë plumbat në gushë të armëve për çdo të keqe, ngado që të vijë. I bëjnë të gjitha këto se duan Shqipërinë, Partinë, Enver Hoxhën, jetën e vërtetë revolucionare dhe sepse urrejnë me gjithë shpirt armiqtë, vdekjen dhe hijet e ftohta që mbjellin ata. Partia i ka ndezur zemrat e bulqizakëve me zjarrin e saj të krenarisë shqiptare, të mosnështrimit, të zbrapsjes të çdo armiku e të thyerjes së çdo bllokade.

Ja, gati 30 vjet më parë, në këto anë u përhap një fjalë e re: Krom! Ishte viti 1948 kur Partia dërgoi njerëzit të zbulonin nën mal. Ishin njëzet e ca minatorë mirditorë. Me ta, nga të parët u bashkua edhe pesjaku nga Maqellara, dibrani i parë, Baftjari. Ishte i ri, i fortë, i pamësuar, po me urrejtjen e gjyshërve e të stërgjyshërve që kishin punuar për bejlerët. Hyri për herë të parë nën dhe. Po aty, midis thellësive, errësirave e thesarit, ai ndjeu jo vetëm jehonën e këmbëve e të potkonjve që rrihnin gjatë shekujve Vajkalin, po edhe fjalët e ngruhta të udhëheqësit, që për minatorët të interesohemi konkretisht si nëna për fëmijën e vet.

Si nëna për fëmijën e vet u kujdes Partia për ta dhe Baftjari, pas tre vjetësh punë, më 1951 u bë komunist. Ai e ndjeu në shpirt se interesi i popullit e i Partisë e do që komunisti minator të rrijë e të punojë në minierë, sepse miniera ka rëndësi të madhe në ekonominë e popullit. Siç thotë një fjalë popullore, aty ku kalli këmbët, aty i ranë dhëmbët. E gjeta në një nga këto ditët e shtatorit, kur zakonisht Korabi dërgon në Bulqizë për herë të parë erërat e ftohta. Po veterani i minierës ishte tërë energji. I nxinte balli i gjerë, pak i rrudhosur, i shkëlqenin sytë dhe i shkëlqenin edhe dhëmbët e bardhë. Bënte stërvitjen me çetat vullnetare. E bënte në atë fushën e Vajkalit plot legjenda heroike.

— Kam stërvitje, — tha kur shokët e Partisë i treguan që unë vija nga gazeta «Drita» për një skicë. Ka shumë minatorë këtu, për të cilët mund të shkruhen libra.

Po. Ka minatorë për të cilët mund dhe duhet të shkruhen libra, tregime, reportazhe, romane, poema. Letërsia jonë ka çarë rrugë të reja, të bukura. Ka vënë në qendër heronjtë e socializmit, partizanët legjendarë, punëtorët, kooperativistët, intelektualët popullorë, gruan e emancipuar, rininë revolucionare. Ajo ka shumë suksese. Por për minatorët ka bërë pak. Një roman të denjë s'e kemi ende për ata që përbëjnë thelbin e klasës sonë punëtore... Dhe më theri diçka në zemër!

Më në fund Baftjari u ul në tryezë dhe me vështrimin nga fusha e Vajkalit ku në rresht, si partizanët, me armët në krah, po ecte çeta vullnetare me gra, vajza, djem e burra, tha si i pezmatuar:

– Nuk rri dot shumë, more shokë!

– Pse, o Baftjar? – e pyeti sekretari i Partisë.

– Dita e fundit. Nxjerrim përfundimet. Dhjetë ditë luftarake. S'rri dot. Secili duhet të jetë në vendin e vet.

Dhe në ballin e tij të gjerë u thelluan rrudhat.

Ai, si gjithë njerëzit e thjeshtë dhe heronjtë që ka kalitur Partia, nuk tha asnjë fjalë për veten. Këtë e lexon në çdo reportazh. S'kanë shterpësi gazetarët. Nuk flasin heronjtë. Ata janë njerëz të thjeshtë, shumë më të thjeshtë se ndonjë që bën diçka në jetë e mburret. Ata i urrejnë mburravecët. Nga shokët e vet mora vesh se Baftjar Fida është Hero i Punës Socialiste.

– Si u bërë hero? – e pyeta duke ecur në rrugën kryesore të Bulqizës.

– Më bëri puna dhe Partia. Puna. Puna për të mirën e popullit, – tha si i zënë ngushtë dhe asnjë fjalë më tepër.

Shokët e tij më treguan se Baftjari, pasi punoi gati 30 vjet në minierë, në korrik të këtij viti doli në pension. Po ai nuk e ndiente veten në pension. Minatori i ditëve të para të kromit në Bulqizë rrit tani me kujdes Partie pesë fëmijët e tij, dy nga të cilët i ka ushtarë dhe dy të tjerët punëtorë në minierë. Rrit edhe ata, minatorët e rinj. Për të kaluarën flet më shumë, kujton si në ethe prindët e farefisin që vuanin si bujq te bejlerët. Kujton përsëri si në ethe ditët e para, kur hyri nën tokë e ku armiqtë i thoshin se «po hynte në varr nga s'kishte për të dalë kurrë». Dhe qesh duke shtuar se tani pas 30 vjetësh e ka pak më të vështirë të punojë mbi tokë se nën tokë.

– Është më mirë atje. Ka të fshehta atje, ka xehavhire atje. Njësoj është xhanëm, po atje ka ca gjëra që më pëlqejnë më shumë se mbi tokë, është kromi atje që çan bllokadën!

Ecim nëpër rrugën kryesore të Bulqizës në të dy dhe një çun i ri, Kaloshi nga Omezhi, duke pritur të vijë fotoreporterit që ka shkuar në kërkim të një bariu delegat të Kongresit të 7-të të Rinisë në bjeshkët e Shupenzës. Kjo vonesë e tij na jep dorë të njihemi më mirë me Bulqizën, me muzeun e saj që po e përgatit një mësues i apasionuar dhe që do të inaugurohet në shkurt, në 30-vjetorin e minierës, me mësueset e reja që kanë ardhur nga Tirana plot frymëzime për edukimin e çunave e të cucave bulqizake.

Po fjalën e kemi të heronjtë që kaliti Partia, te minator Baftjari. Ai është një nga njerëzit që interesohet sot, duke qenë në pension, më shumë për shkollat e mesme profesionale të minierës dhe për të mesmen bujaësore, për ata që mësojnë në shkollat e ditës e të natës, për kurset e kualifikimit, për mënyrat si të shfrytëzohet më racionalisht zona e kromit, ku ka punuar ai.

Një ish-inxhinier i ri, tani drejtor i shkollës së Bulqizës, më tregoi se si i dha njëherë Baftjarit në hartë zonën e përparimit në minierë. Po Baftjari e kuptoi se skica ishte e gabuar. I tha inxhinierit:

— Po sikur të ecim jo sipas kësaj harte, ç'bëhet? Të ecim sipas përvojës sonë, times e të minatorëve?

— Mirë, — tha inxhinieri, po shkoj ta ndryshoj skicën.

Baftjari ia preu:

— S'ka nevojë. Po herë tjetër mos e përsërit këtë gabim, se na batis miniera.

Kështu flasin për Heroin e Punës Socialiste edhe inxhinierët me universitet, edhe shokët e tij minatorë, edhe ata që drejtojnë sot Komitetin e Partisë të Bulqizës, edhe ata trashëgimtarët e tij, si Kaloshi të cilëve u la stafetën... Ky është një djalë i ri e plot shëndet, flokë-shkurtër, syzi dhe i bukur, me një golf të kuq e të trashë që mezi i mbulon qafën e gjatë. Mua më bëri përshtypje moshja e Kaloshit. I fortë, i heshtur dhe i bukur si ai! Kur Baftjari hyri në Parti, Kaloshi lindi. Ishte viti 1951. Po Kaloshi ishte fëmija i shtatë. Këto nënat

tona të bukura janë burim i Shqipërisë. Është vështirë të lindësh t'i mbash gjallë, t'i edukosh 12 fëmijë. Të gjithë ata kanë fatin e tyre në këtë vend që i pret fëmijët në pëllëmbë të dorës dhe i mban në familjen shqiptare edhe më mirë se zogu zogjtë e tij në fole. Më i madhi lindi kur lindi Partia. Më i vogli është 13 vjeç. Të gjithë, 7 vëllezër e 5 motra, rrugët i kanë të hapura, të lulëzuara. Janë rrugët e Partisë. Një vëlla punon në fabrikën e pasurimit të bakrit e është komunist. Dhe ky i shtati, Kaloshi, erdhi i pari në minierë. Edhe ky, si Baftjari, hyri atje nën dhé, dhe herën e parë tha: «ku jam e ku vete»? Po Baftjari e shokët e tij i thanë thjesht. «Je minator! Je nën dhé! Vete në komunizëm!» E ndihmuan. Ia hoqën atë pabesinë e errësirës e të nëntokës. Dhe Kaloshi është sot minator si qindra djem bulqizakë. Prindërit dhe familjet i ka atje, në Omezh përtej Bulqizës e përtej Shupenzës. I do fort, punon për ta e për popullin, po s'vete dot çdo mbrëmje që të çmallet, punon me tre turne dhe, veç kësaj, vazhdon shkollën e natës, atë që s'mundi ta bëjë dot mjeshtri i tij Baftjari, disa vjet më parë, se porsa kishin dalë nga lufta e ishin të këputur e të varfër.

Kaloshi fjalëpak më flet për vështirësitë e fillimit si minator dhe shton i lehtësuar.

— Minierën e kam të dashur!

Të dy brezat, kur hynë në minierë për herë të parë, ndienë në shpirt njëfarë druajtje. Kaloshi tha thjesht.

E rëndë ishte. Po më vonë u mësova, e kuptova se ky nuk ishte vetëm ambientim me galeritë, me gjysmerrësirën, me tavanet e ulëta. Ishte dashuria për thesarët, për kromin tonë, ishte dashuria për popullin, për Partinë, për fushat e malet.

Baftjari i dëgjon këto fjalë. Balli i tij çrrudhohet. Brezat lidhen me preokupime pa fjalë të zhurmshme.

— Ku jeni tani, Kalosh? Kam qenë 10 ditë në stërviçje. C'bëni atje në galeri?

— Ecim, mjeshtër, sipas porosive të tua, të inxhinierëve e të teknikëve.

— A keni ajër?

– Më shumë se këtu.

– Po mirë, o Kalosh. Po më gëzon!

Ata, Baftjari, Heroi i Punës Socialiste, dhe Kaloshi janë lidhur si malet, si brezat, shpatull më shpatull. Dhe kur janë kështu askush nuk mund t'i thyejë. Vajkalin kush e theu? Torviollin kush e theu? Dibrën kush e theu? Partizanët kush i theu? Askush! Aq më tepër sot që me Partinë në ballë çajmë përpara.

* * *

Largohemi nga Bulqiza afër mbrëmjes. Çdo gjë, era e fortë, malet me thepa, Vajkali, njerëzit, makinat, më duket sikur thërresin:

– Kromi çan bllokadën.

Dhe më del parasysh Baftjari, ata shokët e tij të vitit 1948 që filluan të parët punën në minierë, ata Kaloshët e rinj që mbajnë nesër Kongresin e tyre të 7-të, mbi supet e njoma të të cilëve ka rënë barra e rëndë e ndërtimit të socializmit e të komunizmit. Kujtoj Kaloshin dhe në shpirt më tingëllon kënga e luftës:

Rini, rini! Përpara ti!...

«Drita», 25 shtator 1977

DJEMTË E MIRË TË FIERZËS

Kam disa kohë që jetoj këtu, në thellësi të maleve, këtu ku bashkohen përjetësisht dy lumenjtë e zhurmshëm, Drini e Valbona, këtu mes punëtorëve, jam plot përshtypje, të bukura, plot emocione ngazëllyese, plot mendime fisnike dhe ndiej në shpirt një gëzim të madh. Këto forca, këto energji të reja, këtë përtëritje rinore të zemrës m'i falin, në radhë të parë, njerëzit e lirë, këta punëtorë, teknikë e inxhinierë të fuqishëm, të mirë, të gëzuar e të urtë. Me duart e tyre të hekurta dhe me ballin e lëruar nga mendimi i ndritur, i tundin këto male gjigante e të heshtura, ua lidhin supet me beton e fije çeliku, u veshin rrobën e klasës punëtoare. Ata, pak vjet më parë, iu ngjitën këtyre maleve me projektet e hartuara vetë, me makineri, me libra, pistoleta, dinamit, turbina, sollën këtu socializmin, — filluan të dërtojnë hidrocentralin e Fierzës me kapacitet 500 mijë KW, me një digë 166 m të lartë, prej 8 milionë m³ materiale inerte, gurë, argjil, zhavorr e filtër. Diga me kreshtat ngjan me një kështjellë të re, lindur në malet e lashta, në malet-kështjella.

I rrethuar prej tyre, mbi këtë digë, ku nuk rresht puna të 24 orët, takoj një mikun tim të vjetër, «një zog shtegtar», siç quhen tani montatorët. I them me mall:

— Sa kohë u bënë që s'jemi takuar? Mirë thonë, mali me malin s'takohen, kurse njeriu me njeriun po!

— Jo, — ma ktheu ai duke qeshur, dhe si hap krahët e

fortë, më thotë: — Pa shiko! Tani edhe mali me malin takohen!

Unë shoh shpatullat e Drinit më të djathtë e më të majtë të tij. Aty fillojnë krahët e tij të fuqishëm, lidhur fort nëpër pyje me beton e hekur. Ata janë bashkuar tanimë, është bashkuar mali me mal, dhe ia kanë ndaluar jelet e bardha Drinit plak. Diga duket si një fre i madh që ia kanë vënë në gojë një përbindëshi të ujshëm. Sigurisht, Drini u tërbua shumë disa herë, u egërsua dretdharaku, mblodhi fuqitë shekullore dhe i flaku mbi njerëzit. Po njerëzit ishin më të fortë, ata u futën në vërshimet e tij të akullta, ia shpuan barkun me tunele, qëndruan në ujërat e tij ditë e net dhjetori e shkurti, dhe i thanë qetë-qetë. «Këtej!». Dhe e kthyen në ditë.

* * *

Një karvan i pasosur makinash të tonazheve të rënda nga 20-32-tonëshe, karvan, që arrin gjer 8 km i gjatë, shkon e vjen të 24 orët nga gurorja te diga. Gurorja ruan gjurmët e shpërthimeve të fuqishme që dhanë miliona tonë gurë. Tani po përgatitet një shpërthim tjetër edhe më i madh, prej të cilit do të nxirren njëherësh mbi gjysmë milioni metra kub gurë. Në gji të malit janë minatorët. Në zemrën e tij po vendosin eksploziv. Liqeni ka arritur tani thellësisht 70 metra. Do të vejë 120 m. Diga duhet të ngrihet më lart, më lart, dhe pastaj ndërtoesit e saj do të shkruajnë majë maleve me gjerdanë elektrikë, vargjet e këngës përherë të re:

Internacionale
Do të jetë bota e re!

* * *

Shkenca, që kur ka lindur e gjer sot, e ka habitur dhe e ka mrekulluar parafytyrimin e njeriut. «Ç'gëzim është të jetosh?» — thërrisnin dijetarët përparimtarë qindra vjet

më parë. «Sa e çuditshme është kjo kohë që jetojmë!» – shkruanin të tjerët. «Gjyshërit dhe stërgjyshërit, nuk kanë ndier në 100 vjet atë që ndiejmë ne në 10 vjet», – entuziazmohen poetët.

Po ne ç'duhet të themi, ne që tre dhjetëvjeçarë e ca më parë ishim vendi më i prapambetur në Evropë? Atëherë në Shqipëri kishte vetëm një hidrocentral të vogël në Vithkuq të Korçës, me 620 KW dhe disa motorë të vegjël Diezel, në qytetet kryesore, gjithë fshatrat ndriçohehin me dritën e kandilit e të pishës. Menjëherë pas Çlirimit u ndërtua hidrocentrali «Lenin» me 5000 KW, pastaj gjerdanit të dritave iu shtuan hidrocentralet «Karl Marks», «Frederik Engels», Bistrica e Vau i Dejës. Tani, nga 5000 KW, po ndërtohet gjiganti i Fierzës me 500 000 KW. Ky është sot hapi gjigant i Shqipërisë socialiste!

Sot shkenca ka hyrë edhe në këto male të rrepta. Në duart e njerëzve tanë ajo po ngjitet lart e më lart, duke bërë çudira në rrugën e vet. Ajo gjallëron e shndërron. Këto ditë në Fierzë u zhvillua një sesion shkencor. U mbajtën 15 kumtesa nga inxhinierë, teknikë, punëtorë. Po, edhe nga punëtorë! Ai, shofer Meti, që transporton peshat e rënda me tri makina të lidhura njëra me tjetrën dhe me një rimorkio që ka 64 goma, nuk mund të bënte asgjë pa iu referuar shkencës. Pa llogaritje nuk mund të transportohen peshat prej qindra tonësh në këto rrugë malore, tërë të përpjeta e të tatëpjeta, tërë kthesa të forta, buzë të cilave janë honet e thella të greminave. Pa njohur shkencën, ata vinçierët e sallës së makinave, Pavli e Abedini, nuk mund ta vendosnin me përpikëri shumë të lartë rotorin prej 400 tonësh. Një gabim i vogël, një llogaritje paksa e gabuar dhe... ja katastrofa! Jo, s'ka asnjë katastrofë! Është shkenca në veprim, është njeriu ynë i ri që e përvetëson dhe e drejton këtë shkencë, njeriu që shpeshherë, shkencëtarë «mendjendritur» të botës, nuk e kanë parasysh ose e harrojnë, kur merren me shpikjet e tyre. Jo, këtu në Fierzën e Shqipërisë socialiste, njeriu është mbi të gjitha. Ata nga fatet vetjake janë hedhur tek e përgjithshmja shoqërore e shkencore. Këta punëtorë, teknikë e inxhinierë shqiptarë që ndeshen me

shkencën më të lartë të ndërtimit të hidrocentraleve, mendojnë për fatet e vendit të tyre, për Shqipërinë si edhe për gjithë njerëzimin. Ata, duke lënë këtu në Fierzë emrin e tyre të mirë mbi gurë, tunele, beton e çelik, kanë në buzë këngën e bukur të jetës, për të ardhmen e botës, për socializmin. Ata lënë këtu një nga dëshmitë e unitetit të madh të popullit tonë, se për ndërtimin e tij ka derdhur djersë e mund e tërë Shqipëria. Atyre u ndriçon rrugën shkenca më konsekuente: marksizëm-leninizmi ngadhënjimtar, që zbaton me konsekuencë Partia e Punës me shokun Enver Hoxha në krye.

* * *

Ne e kemi çmuar gjithmonë ndihmën internacionaliste, si shprehje të solidaritetit ndërkombëtar të popujve që luftojnë për liri, për paqe, për përmbysjen e zgjedhës së kapitalit, për socializëm. Këtu në Fierzë, ashtu si kudo në Shqipëri, punëtorët janë prekur shumë nga solidariteti ndërkombëtar i qindra e qindra organizatave e individëve revolucionarë përparimtarë nga tërë bota. Janë prekur shumë edhe nga letra e punëtorit francez, mura-torit Grandmugin, i cili në shenjë solidariteti komunist, shpreh gatishmërinë për të ardhur në Shqipëri për të punuar së bashku me punëtorët tanë. Janë prekur dhe janë indinjuar nga veprimet e synimet e mbrapshta e djallëzore, antishqiptare e antinjerëzore të udhëheqjes revizioniste kineze. Djemtë e Fierzës janë mjeshtër e shkuar mjeshtërve. Ata nuk mund të duronin të huajt që s'kishin asnjë besim te teknikët e inxhinierët e talentuar të Fierzës, që përpiqeshin t'u mbanin sekret «të fshehtat» e shkencës për objekte që i kishin projektuar vetë shqiptarët dhe që kështu, duke i përbuzur me megalomani superfuqie shtetet e vogla, të rrihnin gjoksin e të thoshin: «Ja, e bëmë ne! Pa ne ju s'bëni dot kurrjë! Ne jemi qielli e toka! Ne! ne! ne!» – Por djemtë e mirë të Fierzës, revolucionarë, të zot, të kulturuar e të talentuar, zbatonin me përpikëri shkencën, teknikën e për-

paruar, u bënin ballë me sukses vërsimit të ujërave e të mosbesimit, lidhnin vetë çdo gjë në nënstacion e në panela, dhe kur u njohëm me Letrën e KQ të PPSH e të Qeverisë sonë drejtuar KQ të PK e të Qeverisë Kineze, iu vunë punës me forca të përtërira, ngritën cilësinë e saj dhe shtuan ritmet. Inxhinierë, teknikë, punëtorë të specialiteteve të ndryshme u erdhën shokëve të tyre në ndihmë. Mithali që është edhe një nga projektuesit e hidrocentralit, djalë i thjeshtë i talentuar nisët në punë në orën 6 të mëngjesit e kthehet në orët e vona të natës. «Është një situatë e tillë, – thotë ai – që duhet punuar shumë, jo thjesht si specialist, por si patriot. O sot, o kurrë, që t'i tregojmë kujtdo se Fierzën e projektuaam dhe e ndërtaam vetë, ashtu siç ndërtojmë socializmin me forcat tonal!»

Dhe ç'po ndodh tani? Kanë shpërthyer energji të para. Shoferët e makinave të rënda, Thanasi, Xheladini, Piloja, Nikolla, Vehbiu, Aliu, Vlashi, që bënin 10-12 rrugë në turn, po bëjnë tani edhe 20. Minatorët Seiti, Nazmiu, Rexha, Zefi, Frroku, Sadiku, Ahmeti etj. po bëjnë nga dy plane në turn. Fjalimi i shokut Enver Hoxha në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik të Shqipërisë, si dhe Thirrja e Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik të Shqipërisë kanë ngritur në një shkallë akoma më të lartë mobilizimin revolucionar dhe ndjenjën e përgjegjësisë të të gjithë kolektivit të madh të hidrocentralit për përfundimin e tij para afatit.

Djemtë e Fierzës kanë interesa të larta politike, ideologjike, profesionale e kulturore. Janë të kualifikuar në teknikë, janë të apasionuar pas letërsisë, kinematografisë, muzikës. Bëjnë biseda shumë të gjalla për letërsinë. Thonë se letërsia i drejtohet njeriut ndjek zhvillimin shpirtëror të tij. U pëlqejnë veçanërisht tablotë e gjera, siç është jeta e Fierzës, përgjithësimet filozofike dhe jo fotografimet e çastit. Drejtori i parkut të madh, shofer Andrea me gjithë shofer Nikollën, na këshillojnë që të shkruajmë për njerëzit e Fierzës, për bukurinë e punës, dhe vepra të jetë jo vetëm për ta, po për gjithë bashkohësit. Një inxhinier flet për rritjen e interesave klasore

krijuese të njeriut tonë të ri, për interesimin e tij për problemet e mëdha politike që shqetësojnë botën, për hovet e rëndësishme në fushën e shkencës, teknikës, arsimit e kulturës, për zgjerimin e sferave të veprimtarisë dhe për zhvillimin e marrëdhënieve të reja shoqërore. Ja përse duhet shkruar, mendon ai. Duke ndjekur procesin e zhvillimit artistik të shoqërisë, ata i vënë artit detyra e qëllime të larta, fisnike, revolucionare. Por flasin edhe për marrëdhëniet e shkencës me letërsinë, me etikën, me të cilat duhet të merret më shumë arti, duke përqendruar vëmendjen te njeriu, te sjelljet, te etika, te mendimet e ndjenjat e tij.

* * *

Ja edhe anija e parë mbërriti nga kantieri detar me kamionët e tonazheve të rënda të shofer Metit. Ajo do të çajë ujërat e liqenit të ri nga Fierza në Kukës që i ka mbuluar tani shkrepat e lashtë. Një anije midis maleve të larta! Një anije! Jehon sirena e saj. Dalin njerëzit e lirë majë maleve dhe e përshëndesin.

Po lind dielli. Fierza gjëmon nga shpërthimet dhe duket sikur përshëndet të vëllanë, Komanin, aty më poshtë, për të cilin po punojnë projektuesit tanë të talentuar dhe dhjetëra e dhjetëra të tjerë inxhinierë e teknikë që ndjekin nga afër hidrocentralin, që i gdhijnë shpeshherë netët në digë, në sallën e makinave, apo përkullur mbi projektet.

* * *

Fierza gjëmon. Mbi 61 mijë m³ materiale iu hodhën digës për një javë. Mbetën pa gjumë mekanikët duke rregulluar defektet e makinave. Nuk pushojnë eskavatorët. Sa herë që të kalosh, do t'i shohësh gjithnjë duke montuar Agimin, Janin, Aleksin, Dhimon, Rahmiun e Qemalin. Të përqendruar në zgjidhjen e problemeve të mëdha e

delikate të hidroteknikës, duke filluar nga organizimi i drejtimit deri në jetën e përditshme të punëtorëve, janë gjithnjë në lëvizje drejtori i përgjithshëm, kryeinxhinieri, inxhinierët, drejtori i kantierit Nr. 3 e dhjetëra e dhjetëra organizatorë të tjerë me përvojë, të zot e të talentuar. Këtu ndriçon si dielli fjala komuniste: «Një për të gjithë, të gjithë për një». «Këtu, para së gjithash, puna është krijim dhe ndien kudo gjendjen e lartë shpirtërore të njeriut. Vërshojnë ujërat si katarakte. Gjëmojnë eksplozivët, këndon turbina këngën e dritës, fryhet liqeni i kaltër dhe të gjitha këto janë në duart e sigurta të njerëzve tanë.

«Drita», 8 tetor 1978

ZJARRI I KËNGËVE PARTIZANE

Në një kohë kur në shtypin fashist, poezia zyrtare, e nginjur nga nostalgjia, dekadenca e kotësia mikroborgjeze, u këndonte idileve, miteve, hidhërimit të ëmbël të dashurisë meskine, me qëllim që të largonte vëmendjen e popullit nga robëria, lindi një poezi e re, ilegale, patriotike e revolucionare, poezia e luftës, e cila ndikoi në popull për krijimin e një gjendjeje të re psikologjike. Përmbajtja e saj i bëri thirrje lexuesit që të dëgjonte gjithmonë zërin e së vërtetës, zërin e Shqipërisë së robëruar, të popullit e të Partisë Komuniste!

Ishte koha që, po të botoheshin poezi të tilla, poetëve të paktën u qepeshin buzët. Prandaj ato shkruheshin në fshehtësi të madhe, botoheshin si trakte në shtypin klandestin, poetët nuk njiheshin, ishin anonimë ose mbanin pseudonime.

Shqipëria ishte e pushtuar dhe duhej kënduar ndryshe, kundër rymës zyrtare. Duhej poezia e kushtimit, e dulleve të luftës. Vetë koha shtronte problemin që poezia e re, duke pasur si burim frymëzimi e forcë lidhjen me luftën, të pasqyronte këtë proces të ri revolucionar dhe të ndikonte mbi të.

Dhe filloi, që me themelimin e PKSH, seleksionimi, si në natyrë, edhe në poezi: ç'ishte e vjetruar, antipopullore, e keqe, u përbuz me neveri me gjithë përpjekjet e kota të kritikës reaksionare për ta ringjallur. Ç'ishte e re, e bukur, realiste, kombëtare, popullore e revolucionare, fi-

Iloi të çelte, të lulëzonte, të përhapej pavarësisht nga ngricat e robërisë. Kjo ishte dhuntia e poezisë së re, për të cilën, bënte thirrje Partia Komuniste. Kjo ishte mrekullia e poezisë së realizmit socialist. Prandaj edhe sot, gati pas katër dekadash, fillimet e saj mbeten të freskëta në kujtesën e popullit. Poezia e luftës pati, si të thuash, edhe fatin e madh që pjesa e mirë u kthye në këngë. Mbase poetët e paktë e të rinj të asaj kohe, si M.Meto, Sh. Musaraj, K.Jakova, A.Çaçi, A.Varfi etj. nuk shpreheshin me të gjitha mundësitë, mbase ende s'e kishin aq të fortë zërin poetik, por edhe melodia e këngës partizane i ndihmoi ata të bëhen themeluesit e poezisë së re të realizmit socialist. Sidoqoftë, zëri i tyre poetik mbetet origjinal. Poezia revolucionare e luftës nuk u mbështet as tek imitimi i verbër, as te dëshira që me çdo mjet e kusht ajo ta tregonte veten «novatore». Kjo poezi u frymëzua vetëm nga realiteti i ri revolucionar, nga këngët patriotike dhe nga eposi i pavdekshëm i popullit tonë.

Kur shkrova poezinë e parë partizane, isha plagosur në demonstratën e 8 Nëntorit 1941, ditën kur u themelua Partia. Isha në burg dhe e shfrevë dufin: «Rini, Rini, përpara ti, si djelli shkrep e vetëti» dhe ajo u bë këngë partizane. Para se të më arrestonin përsëri, në korrik 1942, dy shokë që morën pjesë në djegien e zyrës fashiste, pas torturave çnjerëzore, qëndruan heroikë edhe përpara litarit. Ishin shokë të rinj, të njohur, të luftës: Kiço Greço e Midhi Kostani. Ata i varën në sheshin e qytetit tim. Qarkori i Partisë na dërgoi ne të rinjve komunistë grupe-grupe që t'i nderonim heronjtë, në heshtje, dhe në heshtje të betoheshim se do të ndiqnim rrugën e tyre të lavdishme. Duke qëndruar para tyre, më lind ideja e hakmarrjes.

E shkrova poezinë që atë ditë. Po atë ditë u kompozua dhe po atë ditë filloi të mësohej ilegalisht në rininë e qytetit. Buçisnin burcat e errëta:

*Hakmarrje, rini,
dëshmori thërret...*

Vjersha u botua te revista e Rinisë Antifashiste të qytetit «Korça e re», u botua edhe te «Kushtrimi i lirisë». Në burg erdhën revistat ilegale, ku ishte botuar poezia «Hakmarrje» me pseudonimin «Poeti i ri». Po disa vargje të vjershës në dorëshkrim m'i kishin gjetur fashistët nga pakujdesia ime në kontrollin e shtëpisë. Shokët në burg i zhdukën revistat ilegale. Lajmëruan edhe Qarkorin e Partisë për të njëjtën gjë. Megjithatë, këndonin në burg po ato vargje që kishin rënë në dorë të fashistëve:

*Po ngrihet një zë nga fundi i varrit,
Si dielli kur shkrep e hapet mbi dhë:
Hakmarrje! Hakmarrje! Në grykë barbarit,
Përpara, o popull, mbi të si rrufe!...*

Pas këtyre shkrova vjersha të tjera që u kthyen të gjitha në kënaë: «Zëri i pushkës me furi, po buçet sot anembanë», «Plaku dhe i riu», «Maratonomaku Kristo Isak», «Për liri u vra një partizan», «Kudo malet buçasin», «Pushka partizane», «Kënga e Brigadës IV» etj.

Ishte tetor i vitit 1942. Më nisën për në malin e Moravës. «Shko, më thanë, e takoji!» E takova çetën maleve me dëborë. Qëndrova një javë aty dhe, kur më thirrën në qytet, dhashë vjershën, e cila u botua te «Kushtrimi i lirisë»:

*Ato maja rripa-rripa seç gjëmojnë.
Ndizet lufta për liri e derdhet gjak,
Janë trimat partizanë që luftojnë,
Janë bijtë e Shqipërisë që marrin hak...*

Pas disa muajsh ajo këndohej zonave të lira. Një fakt tjetër. Më kërkuan brenda ditës një vjershë për heroin e popullit Koci Bako. Ishte 7 nëntori i vitit 1942, përvjetori i parë i rënies së tij. Unë e njihja pak heroin, po e kisha parë të vrarë në demonstratë. Tërë paraditën «vrava» veten me fjalët dhe vargjet e vjershës. Më në fund e mbarova. U habita kur në mbrëmje më erdhi tufa e trakteve që duheshin shpërndarë. Trakti ishte vjersha

për heroin Koci Bako. Sigurisht e shpërndava me qejf. E futa nën dyert e lagjeve të varfra, e ngjita në mure e shtylla dhe, të nesërmen herët në mëngjes, rrija dhe e lexoja së bashku me qytetarët, traktin, që kishte vulën e Qarkorit të Partisë Komuniste Shqiptare dhe pseudo-nimin «Poeti i ri».

Dhe më në fund diçka për vjershën «Kudo malet buçasin nga lufta për liri...». E shkrova në Mokër, nja dy ditë para kalimit të Divizionit I në Veri të Shqipërisë. Di-kush nga partizanët këndonte pa fjalë një melodi të bukur, luftarake. Ia përshtata vargjet aty për aty:

*Ne trimat e Enverit
Me ideal në gji,
I japim grusht armikut,
E bëjmë shkrumb e hi.*

Shtova edhe refrenin:

*Me pushkë e bomba dore
Në sulm, në sulm, në zjarr!
S'ka më pranga mizore
Për popullin shqiptar...*

Këtë këngë e mësoi batalioni që atë ditë. Si kapërcyem Shkumbinin, e këndonin tërë Brigada dhe repartet e tjera të Divizionit. I. E mësoi malësia e Veriut. Aty u binda përfundimisht se kush hyn në këngët e popullit si udhëheqës e shpëtimtar i Shqipërisë, mbetet aty, në këngë, për jetë të jetëve.

Prandaj të gjitha këto këngë të thjeshta partizane edhe sot këndohen po me atë zjarrin dhe gjakun e kuq të luftës, po me ato ngjyra të nderura të revolucionit, po me atë dashuri në shpirtin e popullit, për Partinë dhe udhëheqësin e saj.

Kanë kaluar rreth katër dhjetëvjeçarë. Këngët partizane janë të dashura dhe të afërta, sikur janë shkruar sot, bisedon me njerëzit e mjeshtërive e të moshave të ndry-

shme, me punëtorë e ministra, me mësues e kooperativistë, me të rinj, e pionierë, pedagogë, shkrimtarë të rinj e këngëtarë profesionistë dhe të gjithë pa përjashtim të thonë me një zë se ato janë të bukura e të papërsëritshme, të mrekullueshme.

Përse?

Sepse në to ndihet me një forcë të madhe betimi sublim në besnikërinë ndaj Shqipërisë, popullit e Partisë. Sepse këdoja e kësaj poezie partizane ishte një: gjer në fund të qëndrojmë në radhët e luftëtarëve për çlirimin dhe lumturinë e Shqipërisë dhe të njerëzimit.

Ka dhe arsye të tjera:

Kjo poezi zbulon bukurinë e dramacitetit të njëzetvjeçarëve revolucionarë dhe njëkohësisht lumturinë e atyre që kaluan të gjitha provat e rënda të kohës, u ndanë nga vatrë e dashura familjare, ngjeshën gjerdan, yll e pushkë dhe shumë prej tyre ranë maleve për lirinë e Shqipërisë. Kjo poezi, me gjithë dhimbjet për shokët e vrarë e për shkatërrimet, në thelbin e saj ka hovet e fitores, besimin, optimizmin. Në të ndihet thirrja popullore për bashkimin e forcave antifashiste. Në thelbin e saj ajo është për solidaritetin internacionalist proletar. Me vështrimin e saj poetik përfshiu gjithë botën që është edhe sot në zjarrin e revolucionit dhe, me mundësitë e saj poetike, komunikuese e frymëzuese, lufton që të afrojë kohën e lirisë e të socializmit në botë. Me zërin e saj të fuqishëm bën ende, dhe do të vazhdojë të bëjë, thirrje për të ardhmen komuniste të njerëzimit.

Ka dhe një arsye tjetër të madhe që e bën atë të gjallë dhe e mban gjithnjë të freskët: arti! Alarmet e zemrës shqiptare ajo i jep me mjetet e thjeshtësisë më të madhe, ka konkretësi në shprehjen e mendimeve dhe ndjenjë të zjarrtë e të ndershme. Ajo s'përmban as metafora të guximshme, as epitete të hajthme, të jashtëzakonshme. Duket si një bisedë e përditshme, pa fjalë të rastit apo të kërkua për hir të rimës a të ritmit. Fjalët e bujshme, të zhurmshme dhe zbukurimet e jashtme nuk i pranon. Ka konkretësi maksimale. Të gjitha fjalët e

kursyera, që qëndrojnë në vendin e vet, në marrëdhëniet e tyre, e shpien më së mirë e me lehtësi mendimin poetik gjer në ndërgjegjen kombëtare. Fjala e saj është plumb. Ajo ngroh, të ngre peshë e të jep zjarr nga zjarri i madh i një prove të madhe.

«Nëntori» nr. 3, 1979

KRUJA. SA NDJENJA TË ZGJON KY EMËR

Sa herë përmendim këtë qytet, ose udhëtojmë drejt tij, menjëherë, thjesht e natyrshëm, në radhë të parë na kujtohen emri i Heroit Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeut dhe kalaja e betejave legjendare. Çdo gjë në Krujë, çdo shkëmb e hon, e shteg e gur, është lidhur përjetësisht me epopenë e lavdishme të popullit tonë në shekullin XV. Prandaj edhe kur ndërtohet një shtëpi e re, edhe kur hiqet a vihet një gur, mendohet gjithnjë se, mbase fshihet një legjendë.

Njëherësh kur shohim Krujën, na kujtohen vargjet e zjarra të Naim Frashërit:

*Krujë, o qytet i bekuar,
Prite, prite Skënderbenë,
Po vjen si pëllumb i shkruar
Të shpëtojë mëmëdhenë...*

Poeti këndon se si atëherë Kruja u bë «krei i Shqipërisë» dhe mbi kullat e larta të kalasë madhështore valoi flamuri i papërkulur, flamuri gjak e shkabë i Arbrit. Por, pas njëzet e pesë vjetësh të lirisë, Kruja «e bekuar» u përvëlua në zjarre dhe u bë rrafsh me tokën. Armiqtë e egër e fshinë nga faqja e shkëmbinjve që të mos ringjallej kurrë më dëshmia e lavdishme e popullit liridashës. E, megjithatë, gjurmët heroike mbetën, se gjurmë të tilla nuk s'uhën kurrë, sido që të hakmerren armiqtë e egër.

Mbetën luftërat për liri në kronikat e kohës, mbetën heroizmat e panumërta në legjenda e këngë që çanë shekujt e errësirës dhe mbërritën gjer tek ne. Kështu, Skënderbeu, me shpatë sheshit në rojë të atdheut, gjithend me shkronja gjaku nëpër shekuj lavdinë e Shqipërisë, biografinë heroike të tokës, të këtyre maleve të Krujës...

...Dhe përsëri na del lavdia e re. Kruja e lidhur ngushtë me Luftën Nacionalçlirimtare, me Partinë dhe Enver Hoxhën.

* * *

Ka qenë një kohë kur familja krutane kishte një histori të dhimbshme, tragjike. Atëherë pasiguria të ndiqte në çdo hap. Shpesh krutani vdiste nga plaga e plumbit të gjakësit. Hakmarrja ishte e egër, çnjerëzore. Hynte edhe në kulmin e gëzimeve të pakta dhe i kthente ato në vaje. Kjo ishte një jetë e kobshme, kapitulli i zi i së kaluarës.

Kështu ishte derisa lindi Partia. Kushtrimin e saj e dëgjuan bijtë dhe bijat e Krujës. Mustafa Kaçaçi, trimi, i mençuri, biri i denjë i Partisë, Rexhë Deliu, Xak Pengili, Bakushe Visha, Qemal Veseli e dhjetëra të tjerë dhanë jetën për liri. Nëntë lapidarë betejash e dëshmorësh ka vetëm në rrugën nga Fushë-Kruja gjer në të hyrë të Krujës. Aty mbi një kodër, ku përshëndet me grusht një partizan i derdhur në bronz, në varrezat, në blerimin e përjetshëm të ullaive, prehen dëshmorët e Krujës, eshtrat e të cilëve u mblodhën anembanë atdheut. Edhe brenda në qytet ka lapidarë për Brigadën I dhe XXIII, për Mustafa Kaçaçin. Pëllëmbë e histori, pëllëmbë e gjak, se, për rastësi, nëse Kruja pati nga osmanët tre rrethime, nga partizanët pati tre çlirime. Tre rrethime, tre çlirime. Gjaku u derdh lumë. Po u fitua liria, kësaj radhe në shekuj, po mbeti gjallë diçka e keqe. I mbetën Krujës si trashëgim i hidhur i së kaluarës 400 gjaqe. Kronikat shënojnë një vrasje në javë. Dhe po kaq i egër e hakmarrës u bë reaksioni që u vu në shërbim të të huajit. Toka krutane u bë dëshmitare e një lufte të re. Netëve dëgjo-

heshin krismat e pabesisë së diversantëve. Diku shuhej një kandil, fikej një jetë komunisti. Po Kruja nuk e përkuli kokën asnjëherë.

Si tërë Shqipëria, edhe Kruja asgjë nuk gjeti të gatshme. Ajo mbështeti kryet e Partia, si te nëna, mësoi nga vuajtjet e së kaluarës, nga mençuria e popullit. Nuk dinte ç'ishte socializmi e si ndërtohej ai. E mësoi në punë e sipër, në luftë e sipër, nga thesari i paçmueshëm, nga dokumentet e Partisë dhe nga veprat e shokut Enver Hoxha. Aty fitoi mençurinë dhe diturinë që kishte kërkuar në shekuj, aty gjeti guximin e besimin për të ecur me çdo kusht përpara në luftën e vështirë të ndërtimit të socializmit. Në këto beteja u formua njeriu i ri i Krujës së lashtë. Ai tani ka një koncept më të plotë për punën, është më i ndërgjegjshëm, si Heroi i Punës Socialiste M. Sefa që, ndonëse në pension, është ende plot gjallëri e në veprim si dikur i ri. Kështu edhe mijëra të tjerë.

Krutani tani ka një kuptim tjetër për jetën, për shoqërinë. Është bërë më e pasur bota e tij, kudo i riu ka respekt për të moshuarit, brenda familjes dhe jashtë saj. Kudo ka interes se si po mbillet gruri, si shkon puna në muzeun e ri dhe si po zbukurohet rruga që të shpie në kala. Ç'thotë Radio-Tirana e televizioni për Shqipërinë e për botën. Këto interesa të gjera ia ka ngjallur Partia. Një atmosferë e gjallë pune sundon në të pesë qytetet e dhjetëra fshatrat e rrethit me gati 100 mijë banorë. U deshën 40 vjet mundime, përpjekje e sakrifica, për të mbërritur te uniteti i pathyeshëm, te ky mal prej betoni Parti-Popull!

* * *

Kruja zgjohet shumë herët. Në orën pesë e gjysmë nisin rrugën autobusë urbanë. Në to ndihet që pa gdhirë entuziazmi i punëtorëve që shkojnë në uzinën e superfosfatit e në fabrikën e çimentos, në miniera, gurorë, ndërmarrjet bujqësore e në artistike. Kooperativistët derdhen fushave. Shkojnë njerëzit të gëzuar në punë, shkolla,

maternitete, kopshte, institucione artistike e shkencore, në llogore e transhe. Kruja historike dhe e bukur e Partisë vlon nga puna, nga kënga; vlon nga hareja e këtyre njerëzve të thjeshtë dhe heroikë, me shpirt e zemër të madhe. Partia i ka edukuar me virtyte të reja të larta. Shoferi i urbanit është bir i një shoferi të dalluar, tani pensionist dhe baba i një nxënësi që mëson frëngjishten në shkollën e gjuhëve të huaja në Tiranë. Ai sikur shkull fjalën nga zemra kur thotë «Partia! Enveri! Ç'do të ishim ne pa to!» Është ky sinonim emrash që i dha energjinë e pashtershme zemrës punëtore. Janë Partia dhe Enver Hoxha që bënë të vijë kjo kohë e lumtur. Nuk u lëmë brezave trashëgim një a dy rrënjë ullinj, një gomar e një dhi, që na i lanë baballarët e mirë. U lëmë uzinat, fabrikat e kombinatet që prodhojnë çdo gjë që i duhet njeriut, u lëmë brezaret, fushat e kodrat e gjelbëruara. U lëmë trashëgim pallatet e dijes, poezitë, romanet, këngët dhe, së bashku me to, u lëmë mjeshtërinë e madhe e të re të ndërtuesit të socializmit.

Duke u ngjitur rrugës së përpjetë e tërë dredha për në Krujë, menjëherë, po sidomos kur lë prapa guroret, të shfaqen përpara syve bregoret e blerta mbushur me pisha. Që aty e gjer në Milot janë një mijë e njëqind hektarë shkëmbinj mbjellë me dy milionë e dyqind mijë pisha! Dy milionë e dyqind mijë! Mbjellja e tyre filloi një dhjetëvjeçar më parë. I mbollën «dashnorët» e pyjeve bashkë me teknikët e inxhinierët. Tani pishat janë «burrëruar». Janë kthyer në mushkëri të blerta për këtë qytet malor.

Kruja ka ecur kaq përpara, sa nuk mund të bësh më krahasim me vitin 1938. Për disa sektorë ky krahasim është krejtësisht i pamundshëm. Raporti është si dita me natën. Po duhet thënë se në krahasim me vitin 1960, prodhimi industrial është sot gati 50 herë më i madh. Sot Kruja jep tri herë e gjysmë më shumë drithëra buke se në vitin 1960. Tri herë më shumë janë nxënësit e shkollave të mesme në krahasim me pesë vjet më parë dhe mbi 3 herë është rritur numri i mjekëve në krahasim me 75-n. Ritmet janë

kudo të larta. Ka dyzet vjet që krutani për këtë derdh
dijet, djersën, zemrën, shpirtin, rininë, këngët!

Kruja nderon njerëzit e punës dhe flet me respekt për
ta. Fotografitë e të dalluarve i gjen në qendër të qytetit.
Për ta shkruan gazeta e rrethit «Kastrioti» po edhe ga-
zetat qendrore, Flet Radioja. I nxjerr televizioni. Në
ndërmarrjen e prodhimeve artistike, punojnë gati 900 vaj-
za e gra. «S'di cilat të përmend, se të gjitha janë punë-
tore të mira», thotë sekretarja e Partisë. Drejtoresha vjen
nga toka e Budullës që e ka ujitur me djersë pëllëmbë
për pëllëmbë. I ati partizan, kur u vra, nuk e kishte parë
bijën e vet, që ia zbardhi faqen... Këtu punon Prenë, ko-
munistja e re nga Gjegjani i Pukës, end qilima me fije
e me ëndrrat e saj të bukura. Punon këtu Kumtia, nënë
fëmijësh dhe anëtare e Byrosë së Partisë të ndërmarrjes,
njëra nga luftëtarët e para krutane që theu zakonet pra-
panike. Këtu punon edhe Adelina, brigadierja e repartit
të sixhadeve, sekretare e Komitetit të Rinisë. Ajo është
shembull në punë, në aktivitete artistike, në aksionet lo-
kale e kombëtare. Duke shkruar këto radhë, më kujtohet
edhe një inxhinier i Fierzës që vë në lëvizje turbinat e
fuqishme. Nga Kruja është edhe ai djalë i ditur.

Ja kështu e ka krijuar krutani personalitetin e vet, me
punë të thjeshtë në dobi të njerëzve, me djersë të
ndershme.

* * *

Krujën e vizitojnë shumë turistë nga ana e anës.
Vijnë edhe arbëreshë, stërnipër të atyre që lanë Krujën të
shkretuar qindra vjet më parë, siç thotë kënga:

O, të fala dheu ynë,
Të falem se po të lë
E s'kam për të parë më...

Vijnë arbëreshët e s'i gëzohen dot bukurisë mahnitëse
të Krujës, kalasë së saj, tokës së rilindur. Vijnë dhe me

frymëmarrje të rrëmbyer u gëzohen lartësive, maleve nga shohin si në pëllëmbë të dorës qiellin e kaltër dhe fu-shën e blertë të Shqipërisë socialiste. Disa heshtin të tronditur. Ndonjë qan me ngashërim pa fjalë. Ndonjë përkulet si para altarit të shenjtë të hyrja e kalasë. Poeti i njohur arbëresh Vorea Ujko puthi gurët e mureve të kalasë.

Në Krujë është duke përfunduar Muzeu i ri kushtuar Skënderbeut. Kësaj vepre dinjitoze, projektuar me zotësi nga arkitektët tanë, po ia rritin vlerat më tej veprat e piktorëve e skulptorëve. Rreth 30 artistë punojnë prej kohësh. Sallat e muzeut janë kthyer në studio. Në hyrjen kryesore ndeshesh me Skënderbeun e trimat e tij që po e realizojnë Paçoja së bashku me skulptorin e ri të talentuar Gencin. Në sallën «Bashkim dhe Përballim» ka dy vjet që punon me këmbëngulje e pasion Naxhi Bakalli. Ai pikturon afreskun që paraqet betejën epike të shqiptarëve nën muret e kalasë. Në sallën e «Invazionit» Gavriili dhe Nikoleti po vendosin mozaikun që simbolizon kushtrimin për luftë.

Po derdhet në art historia legjendare.

Nër kohë na vjen ndër mend vlerësimi që i është bërë Krujës në lashtësi: «Ballkoni i Adriatikut». E bukura është e pranishme kudo. Sytë e njerëzve janë tek e ardhmja, tek perspektivat që çeli Kongresi i 8-të i Partisë.

«Zëri i popullit», 27.11.1981

PASQYRA E LËNDËS

DRAMA E KOMEDI

Rilindësi i fundit	5
Partizanët	51
Stina e kuqe	93
Vajza nga fshati (komedi)	145

PUBLICISTIKË

Mendime në prag të Kongresit	205
Në feniks, horizonti i pastër!	208
Mrekullia e shtatë e botës	218
Dashuria	227
Njerëzit dhe malet	233
Njëzet vjet me shkronja të arta	244
Duke shfletuar ditarin e luftës	250
Mendime para ditës së poezisë	254
Midis ugareve e brazdave	259
Një lapidar për dy shokë	265
Fejesë për mua nuk ka. Jam në ndjekje	272
Një vullnetar devolli	276
Lartësitë	280
Vazhdimësi brezash	289
Djemtë e mirë të Fierzës	296
Zjarri i këngëve partizane	303
Kruja. Sa ndjenja të zgjon ky emër	309